monumentet



DO NOT COPY

2007

DO NOT COPY

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

2007

DO NOT COPY

Redaksia:

Prof. Dr.	Emin Riza	kryeredaktor
	Behar Gjoka	sekretar kolegjiumi
Prof. Dr.	Valter Shtylla	anëtar
Dr.	Lorenc Bejko	anëtar
Prof. Dr.	Gjerak Karaiskaj	
	Sulejman Dashi	
	Edlira Çaushi	

Copyright: Instituti i Monumenteve të Kulturës
Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës
Tiranë, 2009

Në kopertinë : Lagjja Gorricë, Berat

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Ky numër i kushtohet Prof. Dr. Emin Rizës, në 70-vjetorin e lindjes.

PASQYRA E LËNDËS

Behar GJOKA 7
EMIN RIZA - NJË JETË KUSHTUAR MONUMENTEVE 7

John K. PAPADOPOULOS, Lorenc BEJKO dhe Sarah MORRIS 19
RINDËRTIMI I TUMËS PREHISTORIKE NË LOFKËND 19

Emin RIZA 34
MONUMENTET E KULTURËS DHE PROBLEMATIKA E SOTME E VLERËSIMIT TË TYRE 34

Dr. Nur AKIN, Prof. në Universitetin Teknik të Stambollit, Fakulteti i Arkitekturës, Departamenti i Restaurimit. 48
KONSERVIMI HISTORIK NË TURQI, POLITIKA DHE PROBLEME TË TRAJTUARA ME SHEMBUJ 48

Prof. Dr. Valter SHTYLLA 63
ILJAZ BEJ MIRAHORI – FIGURË HISTORIKE KOMBËTARE 63

Ioannis VITALIOTIS 69
SARANDË – BAZILIKA E 40 SHENJTORËVE. RAPORT PARAPRAK PËR AFRESKET - PIKTURAT PALEOKRISTIANE 69

Gazmend MUKA 78
SKENA E PROFETIT JONAS NË BAZILIKËN E 40 SHENJTORËVE NË SARANDË 78

Zamir MARIKAJ 91
VIZATIME NË SHKËMBIN E MALIGRADIT 91

Polikron THEODHORI - Frederik STAMATI 97
NJË STUDIM PETROGRAFIK PËR ALTARIN E ZBULUAR NË KËNETËN E DURRËSIT 97

Adem BUNGURI 100
GJETJE NGA KALAJA E GRAZHDANIT 100

Prof. Dr. Pirro THOMO 122
AMFITEATRI I DURRËSIT DHE PUNIMET E RESTAURIMIT 2004 122

Latif LAZIMI 143
STUDIM MBI ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS TAMPON TE QYTETIT TË DURRËSIT 143

Mustafa ARAPI 152
ZBULIME TË REJA MBI AUTORËSINË NË DISA IKONA 152

Gjerak KARAISKAJ 165
PARLAMENTI I PARË SHQIPTAR 165

DO NOT COPY

PASQYRA E LËNDËS

Agron ISLAMI, Elio HOBDARI *183*
PUNIME KONSERVUESE NË BAZILIKAT PALEOKRISTIANE TË BYLISIT 183

Shpresa PRIFTI *192*
TRASHËGIMIA KULTURORE E RRETHIT TË SHKODRËS DHE KRITERET E VLERËSIMIT TË SAJ 192

Kastriot DERVISHI *203*
ELEMENTE TË PIKTURËS LAIKE NË IKONOGRAFI 203

Hasan NALLBANI *208*
KISHA E SHËN MËRISË NË ZERVAT, GJIROKASTËR DHE RESTAURIMI I PIKTURAVE TË SAJ 208

Ali MUKA - etnolog *220*
BANESA POPULLORE QYTETARE E KOSOVËS TRASHËGIMI E VYER MBARËKOMBËTARE 220

DO NOT COPY

CONTENTS

Behar GJOKA 12
EMIN RIZA A LIVING ENCYCLOPAEDIA OF MONUMENTS 12

John K. PAPADOPOULOS, Lorenc BEJKO & Sarah P. MORRIS 30
RECONSTRUCTING THE PREHISTORIC BURIAL TUMULUS OF LOFKËND IN ALBANIA 30

Emin RIZA 45
CULTURE MONUMENTS AND THEIR EVALUATION PROBLEMS 45

Dr. Nur AKIN, Professor at Istanbul Technical University, Faculty of Architecture, Department of Restoration 59
HISTORIC PRESERVATION IN TURKEY POLICY AND PROBLEMS THROUGH EXAMPLES 59

Valter SHTYLLA 68
ILIAZ BEJ MIRAHORI A NATIONAL HISTORIC FIGURE 68

Ioannis VITALIOTIS 77
SARANDA – THE EARLY CHRISTIAN FRESCOES IN THE BASILICA OF THE FORTY MARTYRSA PRELIMINARY REPORT 77

Gazment MUKA 89
NEW DATAS FROM "40 SAINTS" BASILICA OF SARANDA 89

Zamir MARIKAJ 96
DRAWINGS AT (MALIGRAD) PRESPA LAKE ROCKS 96

Polikron THEODHORI - Frederik STAMATI 99
A PETROGRAPHIC STYDY FOR ALTAR DISCOVERED AT DURRES MOSS 99

Adem BUNGURI 119
FINDS AT GRAZHDAN'S CASTLE 119

Prof. Dr. Pirro Thomo 139
DURRES AMPHITHEATER AND RESTORATION WORKS 2004 139

Latif LAZIMI 148
RULE FOR HISTORIC CENTER OF DURRES CITY 148

Mustafa ARAPI 163
NEW DISCOVERIES OF SOME ICONS **163**

Gjerak KARAISKAJ 181
FIRST ALBANIAN PARLIAMENT 181

DO NOT COPY

CONTENTS

Agron ISLAMI, Elio HOBDARI *190*
CONSERVATION WORKS AT PRE-CHRISTIAN BASILICA, BYLIS. 190

Shpresa PRIFTI *201*
CULTURAL HERITAGE OF SHKODER REGION AND CRITERIA OF ITS EVALUATION 201

Kastriot DERVISHI *207*
ICONOGRAPHY LAIC ELEMENTS OF PAINTING 207

PhD. Prof. Hasan Nallbani *219*
RESTORATION OF MURAL PAINTING FOR SAINT MARIA CHURCH OF ZERVAT, GJIROKASTRA 219

Ali MUKA *230*
KOSOVAR CITIZEN DWELLING DURING XVIII-XIX CENTURIES 230

DO NOT COPY

Behar GJOKA

DO NOT COPY

EMIN RIZA - NJË JETË KUSHTUAR MONUMENTEVE

Viti 2007 për monumentet e kulturës dhe vlerat e memories materiale, përkoi me 70 vjetorin e ditëlindjes së Prof. Dr. **Emin Riza**, njërit prej themeluesëve të IMK-së, studiuesit dhe gjurmuesit të vlerave të tyre, e sidomos të banesës popullore, dëshmitarit të pandarë të rritjes së institucionit dhe specialistëve të saj të zot. Numri i revistës "***Monumentet 2007***", një botim special dhe vlerësues, i kushtohet jetës dhe veprës së Prof. **Emin Rizës**, në përvjetorin e lindjes, njërës prej figurave të mëdha në lëmin e studimit dhe verifikimit të monumenteve të kulturës, të mbrotjes dhe restaurimit të tyre, që me punën e pandërprerë dhe kërkimet e thella shkencore bëri të mundur rijetësimin e dhjetëra monumenteve të kulturës dhe shpëtimin e tyre, ku ka lënë gjurmë të pashlyera në vlerat e arkitekturës së banesave.

Kuptohet se emri i mirë që ka fituar IMK, Drejtoritë Rajonale, dikur ateljetë e rretheve, Parqet Arkeologjike, brenda dhe jashtë vendit, në fushat e restaurimit, konservimit dhe mbrotjes së monumenteve të kulturës, të arritjeve të shënuara shkencore në studimin dhe vlerësimin e monumenteve të kulturës, në ndërhyrjet shpëtimtare, të kryera ndër vite, e sidomos në realizimin e botimit të revistës "***Monumentet***", një periodik unik dhe nga më cilësorët i botuar në lëmin e kulturës materiale, padyshim që ka gjurmët e veta të pashlyera edhe **Emin Riza**, eciklopedia e gjallë e njohjes dhe vlerësimit të monumenteve të kulturës në vendin tonë, nëse mund të shprehemi kështu, njeriut të papërtuar dhe tepër të ndërgjegjshëm, që për asnjë moment nuk reshti së punuari për të ruajtur dhe shpëtuar vlerat materiale që mbartin monumentet e kulturës në të gjithë hapësirat shqiptare.

Plejada e përveçuar, e ideatorëve dhe krijuesve të IMK, të asaj pune të shkëlqyer të realizuar ndër vite dhe dhjetëvjeçare në studimin, vlerësimin dhe shpëtimin e vlerave shpirtërore materiale, të botimeve cilësor, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e IMK, si institucion kërkues dhe mbrojtës i monumenteve të kulturës, të procesit të ndërhyrjeve sipas tipologjisë dhe gjinive të monumenteve, që zë fill me **Gani Strazimirin, Selim Islamin, Aleksandër Meksin, Gjerak Kariskajn, Apollon Baçen, Valter Shtyllën, Hasan Nallbanin, Piro Thomën, Sulejman Dashin, Genc Samimin** etj., nuk mund të kuptohet dhe të jetë e plotë pa praninë dhe ndihmesën e vyer të Prof. **Emin Rizës**, në studimin e një morie monumentesh, pavarësisht tipeve dhe gjinive përfaqësuese, në shkrimin e disa librave mbi praktikën e restaurimit, të vlerave të banesave popullore, si dhe në hartimin e një sërë rregulloresh me rëndësi jetike për ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve, por edhe përmbi hartimin e rregulloreve për ndërhyrjet restauruese dhe konservuese për të gjithë monumentet e kulturës.

Dhe nuk kishte se si mund të ndodhte ndryshe, me këtë figurë dhe specialist përfaqësues të shkencatarit të fushës së monumenteve të kulturës, duke qenë një pinjoll i fiseve të shquara, nga e jëma dhe i ati, në mbrojtje të kulturës dhe kombit shqiptar, në mbrotje të dheut dhe qytetërimit shqiptar, e sidomos duke qenë i biri i **Selman Rizës**, i këtij shqiptari të madh në kohërat moderne, birit të Kosovës martire dhe heroike, shkenctarit nga më të shquar të gjuhës dhe letërsisë shqiptare, nga më të fuqishmit në gjithë historinë e ekzistencës së këtyre shkencave, Prof. **Emin Riza** ka ecur në rrugën e çelur prej të parëve të vetë për të njohur, studiuar dhe argumentuar vlefshmërinë e kombit dhe të kulturës shqiptare, tashmë në fushën e memories materiale, si rrallëkush në historinë e ekzistencës së përkujdesjes ndaj monumenteve të kulturës. Fillesat e kontributit të tij, në fushën e monumenteve të kulturës, shënohen aty nga viti 1962, që i përkon edhe kohës kur **Emin Riza** fillon punë në Institutin e Historisë dhe Gjuhësisë, posaçërisht në sektorin e restaurimit dhe të Historisë së Arkitekturës Shqiptare.

DOKTORATURA

Qysh asokohe shpërfaqet iteresimi i veçantë në fushën e studimit, veçmas të tipit të monumenteve të kulturës të arkitekturës popullore, banesat fashatare dhe qytetare, madje duke u specializuar ndër vite si njëri ndër specialistët dhe studiuesit më në zë të kësaj gjinie të rëndësishme të monumenteve jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë se sa kaq. Veprimtaria e tij, padyshim edhe e të gjithë personaliteteve veprimtarë të spikatur në fushën e monumenteve të kulturës, përson një ngjitje të madhe dhe jetike për vetë ekzistencën e tyre në vitin 1965, që lidhet ngushtësisht me krijimin e IMK, tanimë si institucion më vete dhe i specializuar në mbrojtjen, ruajatje, konservimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës. Krijimi i IMK, pra i të vetmit institucion kërkimor, shkencor dhe administrativ në vend, përbën ngjarjen më të madhe në fushën e mbrotjes dhe restaurimit të monumenteve të kulturës, sepse qysh prej asaj kohe dhe në vazhdim u vunë bazat shkencore dhe ligjore për të garantuar mbrotjen dhe restaurimin e tyre duke u mbrojtur nga shteti.

Puna e madhe kërkimore, shkencore, ndërhyrjet e shumta restauruese dhe konservuese u bën një shkollë e madhe e formimit të specialistëve dhe punonjësve të IMK, ku rritja e institucionit u shoqërua edhe më rritjen e specialistëve, studiuesve, njëri prej të cilëve është edhe Prof. **Riza**. Qysh prej asaj periudhe fillimtare, në punën fisnike të shpëtimit dhe restaurimit të vlerave materiale, **Emin Riza** i përkushtohet me zell dhe dashuri ndërtimeve popullore, dhe harton projekte për dhjetëra monumente të arkitekturës popullore, të kategorisë së parë dhe të dytë, si dhe është ideatori dhe hartuesi i rregulloreve të Qendrave Historike, për të gjithë qytetet e vendit tonë, një koncpet i domosdoshëm për të ruajtur në kujtesë vlerat e padyshimta materiale të krijuara nëpër shekuj në trojet shqiptare.

Viti 1971, për institucionin e specializuar në studimin dhe restaurimin e monumenteve, por edhe për punonjësit, specialistët dhe studiuesit e tij, është i shënuar për faktin e thjeshtë, por domethënës se prej këtu nis udhën historiku i revistës "***Monumentet***", një kontribut i dalluar kërkimor dhe shkencor i IMK dhe të gjithë atyre specialistëve që kanë dhënë ndihmesë të çmuar në rritjen e institucionit, një botim cilësor dhe i specializuar në fushën e monumenteve, që ka njohur vlerësime dhe konsiderata brenda dhe jashtë vendit, sidomos për hedhjen e themeleve në studimin shkencor të monumenteve të kulturës, për verifikimin e vlerave të pranishme që bartin, e sidomos të krijimit të përvojës për të realizuar ndërhyrjet e shumta restauruese dhe konservuese. Fakti që nëpër kaq vite të ekzistencës së vet, kjo revistë ka botuar mbi 44 numra special kushtuar monumenteve të kulturës, si dhe vlerave të shumanshme të tyre, është tregues domethënës i vlerave të pranishme, i punës së palodhur kërkimore të specialistëve, restauratorëve dhe shkencëtarëve të këtij institucioni jetik për të ruajtur dhe studiuar monumentet e kulturës. Gjatë gjithë kësaj kohe, relativisht të gjatë, **Emin Riza** ka botuar me qindra artikuj studimor, me vlera të veçanta në fushën e restaurimit dhe të metodikave të ndërhyrjeve restauruese, të teorisë dhe praktikës ndërhyrëse, sidomos në tipin e monumenteve të kulturës, që i përkasin arkitekturës popullore, ku numërohen rreth njëqind artikuj në revista dhe botime shkencore, brenda dhe jashtë vendit, që e zbulojnë të plotë përmasën e shkenctarit të shquar të monumenteve të kulturës, e njeriut që e vuri veten në shërbim të studimit dhe shpëtimit të monumenteve të kulturës, dëshmisë autentike të ekzitencës së jetës dhe të mbijetsës së shqiptarëve në këto troje.

Në të gjithë numrat e botuar të revistës "***Monumentet***", një periodik cilësor dhe i vlerësuar edhe nga personalitet dhe institucionet ndërkombëtare, pandërpreje ka qenë anëtar i redaksisë, por në periudha të caktuara ka mbuluar edhe detyrat e Sekretarit të Kolegjiumit dhe të Kryeredaktorit të kësaj reviste. Prania e tij, e plotë dhe funksionale, në të gjithë këto vite me artikuj të shumtë shkencor, me përvojën e gjatë në studimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës, me botimet e thelluara në fushën e restaurimit të banesave popullore, si dhe ndihmesën e dhënë edhe për tipet e tjera të monumenteve, por edhe me detyrat funksionale në praktikën e botimit dhe shpërndarjes së kësaj reviste, është mjaft e çmuar për ta ngritur edhe ca më tepër nivelin shkencor dhe realizues të saj. Figura e tij, në kuptimin njerëzor dhe të specialistit të ditur dhe të papërtuar të monumenteve të kulturës, është e gjithanshme, madje tiparet e tij organizative dhe të përgjegjshme shpalosen edhe në kryerjen e detyrave shtetërore, që ka mbuluar ndër vite, si ato të shefit të disa sektorëve të IMK, të nëndrejtorit dhe të drejtorit të

DO NOT COPY



Emin Riza në vitin 1962

Institutit të Monumenteve të Kulturës, për periudhën 1988-1992, të Sekretarit Shkencor të Akademisë së Shkencave për vitet 1993-1997. Gjithashtu, një kontribut i vyer për dmokracinë e brishtë shqiptare ka qenë edhe qenia e tij si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, zgjedhur në vitin 1996.

Në të gjitha këto funksione, poltike dhe shtetërore, shkencore dhe kërkimore, ka treguar përgjegjshmëri të lartë dhe ka rrezatuar kulturë dhe humanizëm shembullor. Gërshetimi dhe shkrirja në një personalitet të vetëm të shkenctarit të thekur me drejtuesin e zot dhe të papërtuar, të njeriut më specialistin, e shpërndërron jetën dhe veprën e Prof. **Rizës** në njërën nga përvojat më të vyer të IMK dhe përgjithësisht të mënyrës se si mund të drejtohet dhe orientohet edhe fusha e kulturës, pra e memories materiale, aq e nevojshme për historinë e trojeve dhe të kombit shqiptar, si dëshmi e pakontestueshme. Në trajtimin dhe vlerësimin e figurës shumëdimensionale të Prof. **Emin Rizës** nuk mund të harrohet kontributi i çmuar i dhënë në takimet ndërkombëtare, me kumtesa dhe në nivelin e përfaqësimit shtetëror, ku zbulohet aftësie e gjerë e paraqitjes gërshetuar fuqishëm me këmbënguljen për t'i shkuar deri në fund synimeve zbuluese, restauruese dhe shenjimit të dëshmive më përfaqësuese të vlerave të monumenteve të kulturës shqiptare.

Ndihmesa e tij në këtë aspekt, përveçse e gjithanshme, është e dallueshme dhe formaton specialistin e zotë, si historian dhe restaurator, që përpos tjerash e ka prezantuar kulturën tonë në lëmin e monumenteve të kulturës me mbi njëzet e pesë kumtesa të thelluara kërkimore dhe shkencore, nga të cilat njëzet janë mbajtur jashtë vendit, në forume dhe kongrese ndërkombëtare në lëmin e monumenteve të kulturës. Kështu, më 27 shtator-2 tetor 1987 në Kostur (Greqi), ku mban temën ***"Qyetet-muze të Beratit dhe Gjirokastrës, mbrojtja dhe restaurimi"***. Në qytetin e Margburgut (Gjermani), më 01.02.1990 në Kolokiumin e katedrës së Arkeologjisë Kristiane dhe historisë së arti bizantin në universitetin e qytetit me temën ***"Karakteri i arkitekturës qytetare shqiptare"***. Në sesionin XV të ICCROM. Romë (Itali), 10-11 maj 1988 ku ka mbajtur temën ***"Mbrojtja e monumenteve në Shqipëri"***. Në Simpoziumin ndërkombëtar të Stambollit (Turqi), 20-22 maj 1991, me temë ***"Qendrat Historike në Shqipëri"***. Në Maltë 16-17 janar 1992, me temë ***"Pasuritë Kulturore në Shqipëri"***. Në Selanik, më 12-14 qërshor, me temë



Prof. Emin Riza në studio

DOKTORATURA

"Durrësi dhe Apolonia, gjendja dhe problemet". Në Konferencën Ndërkombëtare *"Ikonoklasti në Europën lindore"* Berlin, 18-20 shkurt 1993, me temë *"Monumentet shqiptare gjatë 45 vjetëve të fundit"*. Në vitin 1994, në Paris me temë *"Akademia e Shkencave të Shqipërisë përpara problemesh"*. Në qytetin Minnea-polis (SHBA) nga 14-17 prill 1994, me temë *"Arkitektura e banesës shqiptare gjatë shek.XVII-XIX, evolucioni tipologjik në kontekstin historik"*. Në Selanik (Greqi) 29 gusht-4 shtator 1994, me temë *"Banesa shqiptare në kuadrin e banesës ballkanike"* Kongresi VII ndërkombëtar i AIESES. Në Veria (Greqi), 2-3 shtator 1995, më temë *"Qyteti-muze i Gjirokastrës, arritje dhe probleme pas një përvoje 34 vjeçare"*, në Kongresin ndërkombëtar *"Ndërhyrjet arkitektonike në qendrat historike të qyteteve"*. Në Stamboll (Turqi) 20-21 prill 1996, me temë *"Banesa me çardak në qytet shqiptare të shek. XVIII-XIX"*. Në Selanik më 3-5 nëntor 1997, me temë *"Qytet shqiptare gjatë shek.XIII-XIV"*, Konf. Ndërkombëtare, po aty më 7-10 nëntor 1997, me temë *"Arkitektura popullore në Ballkan probleme metodike lidhur me studimin e saj"*. Në Selanik, më 18-25 janar 1999, me temë *"L'etude, la mise e projet, l'application des fravaux-maillons inseparables de la restarurtion (La cas albanais)"*, etj.

Pjesëmarrja e tij në të gjitha këto veprimtari shkencore, jashtë vendit, me kumtesa dhe artikuj të rëndësishëm që shpërfaqin nivelin e studimit të monumenteve të kulturës, nivelin e ngritur të restaurimit dhe studimit të vlerave materiale, përveçse kontribut i vyer i porf. **Rizës**, shënojnë më së shumti edhe një arritje të IMK në rajon, por edhe në arenën ndërkombëtare. Në këtë aspekt një prurje në lëmin e studimit dhe të përvojës së çmuar për ndërhyrjet restaururese dhe konservuese, janë edhe kumtesat e mabjetura në veprimtaritë shkencore të mbajtura brenda vendit, si për teoritë e shumta të restaurimit, po ashtu edhe të teknikave të ndryshme në ndërhyrjet restaurures dhe konservuese. Të gjitha këto hallka të personalitetit të **Emin Rizës** përbëjnë vetëm një pjesë të asaj veprimtarie të gjerë dhe frytdhënëse, të ndihmesë së pandërprerë për kulturën dhe vlerat e shumta të monumenteve të kulturës, që përfaqëson ky personalitet, nga më të dalluarit në njohjen, studimin dhe vlerësimin e monumenteve të kulturës. Përmasë tjetër, e botuar kohë pas kohe, e njohur dhe shfrytëzuara nga breznitë më të reja të restauratorëve, po kaq e vlertë sa edhe figura e specialistit dhe drejtuesit të zot, e njeriut, bashkëshortit dhe prindit shembullor, është edhe fusha e gjerë dhe e larmishme studimore, e mbushur plot me tregues të formatit të tij shkencor.

Fakti i mbajtjes së titujve prof. dhe dr. përbën një shenjë të rëndësishme formale, ndërsa artikujt dhe kumtesat e shumta, si dhe librat e botuar prej tij, dëshmojnë arritjet dhe formimin e personalitetin e tij si natyrë e plotë dhe e gjithanshëm. Po të nisemi nga botimet e deri tanishme të autorit, ku përfshihen: *"Gjirokastra qytet-muze"*, album, Tiranë, 1978, *"Historia e arkitekutrës shqiptare"*, Tiranë, 1979 (bashkautor), *" Qyteti-muze i Gjirokastrës"*, Tiranë, 1980, *"Restaurimi i banesave popullore"*, Tiranë, 1981, *"Ndërtimet fshatare në Labëri"*, Tiranë, 1984, *"Historia e arkitekturës shqiptare"* (tekst universitar), Tiranë, 1987 (bashkautor), *"Berat, son historie et son architecture"*, Tiranë, 1986, *"Architecture traditionnelle des Balkans, Albanie"*, Athens, 1990 (bashkautor), *"Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë"*, Tiranë, 1991, *"Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve në Shqipëri"*, Tiranë, 1997, *"Teoria dhe praktika e restaurimit të monumenteve të arkitekturës"*, Tiranë, 2003, *"Banesa qytetare kosovare e shek. XVIII-XIX"*, Prishtinë, 2006 (bashkautor), prekim dhe shohim se kemi një numër të kosiderueshëm titujsh me libra shkencor, në lëm të monumenteve të kulturës, si dhe të teorisë së restaurimit. Emri i tij është i dalluar në të gjitha tipet e monumenteve, por talenti dhe forca e argumentit shkencor spiktatet në fushën e studimit dhe restaurimit të arklitekturës popullore. Titujtë e librave, padyshim edhe dhjetëra kumtesat dhe artikujtë shkencor, ta përforcojnë bindjen se jeta dhe vepra e Prof.Dr. **Emin Riza**, është e lidhur ngushtësisht me monumentet, me restaurimin dhe studimin e tyre, me ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurt, në mënyrë që t'u përcillen brezave si shenjë e vlerave kulturore të qenies dhe kombit shqiptar. Vihet re, nga lista e librave të botuar prej tij, larmia e studimeve në fushën e arkitekturës shqiptare, me botime mjaft të nevojshme në gjuhën shqipe dhe të huaj, e po

ashtu edhe botimet në fushën e teorisë dhe praktikës së ndërhyrjeve restauruese dhe konservuese, të cilat e dëshmojnë figurën dhe personalitetin e tij në aspëktin shkencor, duke shënuar kështu një dukuri të mëvetësishme, kërkimore dhe shkencore, në studimin dhe vlerësimin e monumenteve të kulturës.

Kontributi dhe prania e Prof. **Emin Rizës** është ndjerë edhe në Kosovë, ku ka punuar përmë tepër se sa një vit. Gjatë kësaj periudhe ka ndihmuar me përvojën e tij dhe gatishmërinë e lartë, si djalë Kosove, për vënien mbi baza shkencore të monumenteve të kulturës, madje edhe të studimit të tyre si vlerë e tipologjisë së banesës së krahinës, duke shkuar deri në krahasime mjaft interesante me banesën shqiptare, në rajon dhe më gjerë. Ky aspekt përbën njërin nga kontributet e shquara dhe të dashura të **Rizës**, sepse me punën e kryer, me pasion dhe bazament shkencor, vuri themelet e shpëtimit, ruajtjes dhe restaurimit të monumenteve të kulturës edhe atje. Pjesë e pandarë dhe tepër e rëndësishme e ndihmesës përfaqësuese të Prof. **Emin Rizës** është edhe hartimi i dosjeve të Gjirokastrës dhe Beratit, pavarësisht se kush mëton ta marrë për sipër këtë akt, që për nga rëndësia e vlerësimit të kulturës dhe monumenteve tona të kulturës është jetike dhe kryen funksionin e një pashporte prezantuese të dëshmisë së vlerave të këtyre qyteteve, por edhe të monumenteve të kulturës, përgjithësisht. Falë punës së thellë studimore, hartuese dhe përpiluese, kërkimore dhe shkencore, të shtrirë në disa vite të **Emin Rizës** dhe specialistëve të IMK, si dhe të Drejtorisë Rajonale të këtij qyteti, Gjirokastra, me të gjitha resurset e veta monumentale ka siguruar mbrotjen e Uneskos duke u shpallur prej saj "Pasuri Botërore", gjë që përbën edhe një vlerësim të jashtëzakonshëm për vlerat e kulturës materiale të vendit tonë, por edhe një akt shpëtimtar për të frenuar rrënimin e qytetit të gurtë.

Kjo përvojë e gjatë, studimore dhe vlerësuese, kërkimore dhe restauruese bëri të mundur hartimin dhe përgatitjen e kësaj dosje, nga më të vështirat dhe sipas kërkesave dhe kritereve të organizmave ndërkombëtare, ku kryen e vendit e zë padyshim UNESKO. Qysh nga momenti i marrjes në mbrotje të këtij qyteti është shtuar përkujdesja dhe mbështetja financiare për të ndërhyrë në ato pjesë të rrezikuara të pasurisë së qytetit. Po ashtu, në këtë periudhë, është hartuar nga Prof. **Emin Riza**, si dhe Drejtoria Rajonale e qytetit, si dhe nga specialistët e IMK, edhe dosja e Beratit, një punë e shkëlqyer në kuptimin e plotësimit dhe sqarimit të përfaqësimit të këtij qyteti dhe të gjithë vlerave materiale që bart, madje duke shënuar një rast unik në rajon dhe më gjerë se kaq. Përgatitje e dosjes së Beratit, një dosje e konceptuar si dosje çift, pra Gjirokatstra dhe Berati, kaq shpjet si kohë dhe me ato shenja identifikuese, ka bërë që në takimin e radhës të muajt korrik të vitit 2008, i cili u mbajt në Kanada, u dha përgjigjja pozitive përfundimtare për vlerat e këtij qyteti mbi 2400 vjeçar, duke e përfshirë nën emërtesën "Pasuri Botërore", padyshim një vlerë që i kapërcen kufijtë shqiptar.

Hartimi dhe plotësimi i këtyre dosjeve nga ana e Prof. **Rizës** është një punë e kryer me përgjegjshmëri dhe nivel shkencor dhe ngërthen brenda vetes një proces të gjatë studimi, kërkimi shkencor, si dhe të vlerësimit sa i përket vlefshmërisë së pasurisë që përmbajnë këto dy qytete, me të gjithë përbërësit e vetë tipologjik të monumenteve të kulturës. Duke nisur që prej vitit 1962 mbushen 47 vjet kontribut i pandërprerë në fushën e monumenteve të kulturës i prof. **Rizës**, ku përfshihen të gjitha veprimet dhe ndihmesa e dhëna në mbrojtjen, studimin dhe restaurimin e monumenteve, që kanë të vulosur edhe përmasat e personalitetit të tij. Personaliteti i gjithnashëm, sidomos roli i tij thelbësor për vlerat e monumenteve të kulturës, si dhe ndihmesa e vyer në fushën e studimit, mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve të kulturës, në të gjithë torjet shqiptare, bën që për vitin 2008, Prof. Dr. **Emin Riza** të marrë titullin si Akademik i asocuar në Akademinë e Shkencave dhe ta Arteve të Kosovës, si dhe në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Përvjetori i shtatëdhjetë i **E. Rizës** shënon një nder të veçantë për IMK, qendrës së vetme kërkimore dhe shkencore në lëmin e monumenteve të kulturës, edhe si një vlerësim për punën e bërë ndër vite nga ky institucion. Një jetë kushtuar monumenteve, një jetë njerëzore e jetuar thjesht dhe më jo pak sakrifica, por madhështore në përkushtimin e treguar ndaj Monumenteve të Kulturës, gjurmëve të pakontestueshme të ekzistencës dhe autoktonisë së shqiptarëve.

DO NOT COPY

Behar GJOKA

EMIN RIZA A LIVING ENCYCLOPAEDIA OF MONUMENTS

DO NOT COPY

The year 2007, was the 70-th birthday of Prof. Dc. Emin Riza one of the creators of IMK, witness of growing institution and its specialists. Emin Riza a living encyclopaedia of knowing and evaluation of monuments has its unique contribution at: good name of Institute of Culture Monuments (IMK) and Regional Directorate of Culture Monuments (DRMK), in and abroad of the country, fields of study; restoration; conservation and protection of culture monuments, notable scientific achievements at savings intervention made throw years, publication of "Monumentet" magazine one of the most qualitative periodic at material culture field. The work of Prof. Emin Riza on the monument studies, writing books for restoration practice and values of popular dwelling, compiling of rules with vital importance for protecting and preservations of monuments, will not understand and be complete from the work of Gani Strazimiri, Selim Islami, Aleksander Meksi, Gjerak Karaiskaj, Apollon Bacen, Valter Shtylla, Hasan Nallbani, Piro Thomon, Sulejman Dashi etc. which were pleiad of IMK creation. Their work throws years for studying, evaluation and salvation of spiritual material values, qualitative publications has effected on IMK growing and intervention process according to the typology and kind of monuments.

Emin Riza was a son of notable family well known for protection culture and Albanian nation. Selman Riza (the father) was a scientist on Albanian language and literature and his son continue the road for knowing, studying and argumentative values of Albanian culture, now in the field of material memory.

Beginnings of Riza's contribution on the field of Culture Monument are dated on 1962 when he began the work on the Institute of History and Language at sector restoration and Albanian architecture history. His activity and notable persons on the culture monument fields rose up on a year 1965 when IMK was created as a separate and specialised institution for the protection and restoring the culture monuments. Since from that period Emin Riza dedicated at popular dwelling and compile projects for many monuments of popular architecture which belong to the first and second category, and also he is creator of the Rules of the Historic Centres for same main cities.

The year 1971, for the specialised institution which study and restore culture monuments is notable for a simple fact, because from this year began publishing "Monumentet" magazine. This is an enormous contribute of IMK and its specialists who has give their notable contribute for institution growing.

During all this time Prof. Dc. Emin Riza has published studied articles, which has enormous values on the field of restoration and intervention restoration methods.

About 100 published articles in magazines, scientific works, in and out of the country are counted; these give the whole view of notable scientists of Culture Monuments.

He has been redaction board member at all published "Monumentet" magazine but for a certain period of time have been also Chief Redactor and Executive Committee Secretary.

His portrait is complete, and this is certified with conducting state duties also he during the years have been chief of different sectors of IMK, director of IMK for years 1988 up to 1992, Scientific Secretary of the Science Academy for the years 1993 up to 1997, deputy of Albania Public Assembly for the year 1996, and for all these functions has shown high responsibility, culture and humanism.

All of these mentioned above are only a part of the general activity and fruitful which represent this personality one of the most successive for knowing, studying and evaluation of the culture monuments. Study field with lot of scientists' indicator is another achievement like the figure of specialist and capable leader. Articles and books published by him testify his achievements and complete personality. Life and work of Prof. Dc. Emin Riza is linked tightly with monuments, studying and their restoration if we are counting from his publishing like: "Gjirokastra a museum city", photo album, Tirana 1978; "History of Albanian Architecture" co-author, Tirana 1979; "Museum City of Gjirokastra" Tirana, 1980; "History of Albanian Architecture" co-author, university text Tirana 1987; "Berat, son historie et son architecture" Tirana, 1986; "Architecture traditionnelle des Balkan, Albanie" co-author Athens 1990; "Albanian city and dwelling of late medieval period" Tirana, 1991; "Protection and restoring practice of monuments in Albania" Tirana 1997; "Theory and practice of architecture monument restoring" Tirana 2003; "Citizen Kosovar Dwelling of XVIII-XIX centuries" co-author Prishtina 2006.

Very important and integral part for representative help of Prof. Emin Riza is compile the Gjirokastra and Berati file. Selective and conductive work for several years made by Emin Riza, IMK specialists and representative DRMK of Berati and Gjirokastra was reward with accepting both as a "World Heritage Property" protected by UNECSO decided at Ontario Canada on July 2008. These were an extraordinary evaluation for museum city of Berat, 2.400 years old and salvation of degradation of "stone" museum city Gjirokastra.

The 70-th birthday of E. Riza is a special honour of IMK, for the work done by this institution throws years. An entire life dedicated to the monuments, a great human simple life but grateful for dedication shown to the Culture Monuments which are uncontested trace of existence and autochthony for Albanians.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

BIBLIOGRAFI E BOTIMEVE TË PROF. EMIN RIZËS

1. Emin **Riza**, **Punime për restaurimin e monumenteve të periudhës së Skënderbeut**, "Studime historike", Tiranë, 1967, 4, fq. 241.

2. Emin **Riza**, **Qytetet-muze, dëshmi e qartë e krijimtarisë sonë popullore**, "Të njohim monumentet e kulturës", Tiranë, 1967, fq. 101-103.

3. Emin **Riza**, **Banesa e fortifikuar gjirokastrite**, "Monumentet", Tiranë, 1971/1, fq. 127-147. Shoqërohet me 9 tabela. Rés.fr. L'habitation fortifiée de Gjirokastër.

4. Emin **Riza**, Koço Zhegu, **Banesa tiranase**, "Monumentet", Tiranë, 1971/2, fq.113-127. Rés. fr. La maison tiranois.

5. Emin **Riza**, Burhan Strazimiri, **Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës**, "Monumentet", Tiranë, 1972/3, fq.119-134. Rés. fr. Aperçu de l'architecture de la ville de Korça.

6. Emin **Riza**, Thanas Kamberi, **Kulla në fshatin Goranxi**, «Monumentet», Tiranë, 1972/3, fq.179-188. Rés.fr. Les «kulla» du village de Goranxi.

7. Emin **Riza**, **Banesa popullore në Shkodër gjatë shek.XVIII-XIX**, «Monumentet», Tiranë, 1972/4, fq.141-184. Res. fr. L'habitation type shkodrane aux XVIII-XIX siècles.

8. Emin **Riza**, **Banesa popullore në disa qendra qytetare të Shqipërisë së Mesme**, «Monumentet», 1973/5-6, fq.101-120. Res.fr. La maison type de certains centres urbains de L'Albanie moyenne.

9. Emin **Riza**, Aleksandër **Meksi**, **Ndërtime në fshatin rrënojë të Kamenicës**, Res.fr. Constructions du village en ruine de Kamenice.

10. Emin **Riza**, **Banesa me gjysmëkat perpendikulare**, «Monumentet», 1974/7-8, fq.203-215. Rés.fr. L'habitation à demi-étage perpendiculaire.

11. Emin **Riza**, **Studim për restaurimin e një banese me çardak në qytetin e Krujës**, "Monumentet", 1975/9, fq.107-125. Rés.fr. Etude concernant la restauration d'une maison a tchardak dans la ville de Kruja.

12. Emin **Riza**, **Banesa popullore në Kurveleshin e Sipërm**, «Monumentet», 1975/9, fq.141-159. L'Habitation populaire dans le haut Kurvelesh.

13. Emin **Riza**, Hasan **Nallbani**, **Një ndërtim i tipit kullë në Berat** (Arkitektura, dekoracioni dhe restaurimi), «Monumentet», 1975/10, fq.117-123. Rés.fr. Une habitation de type «kulla» à Berat.

14. Emin **Riza**, **Banesa popullore shkodrane gjatë shek.XVIII-XIX**, "Monumente të kulturës në Shqipëri», 1975/1, fq. 91-95.

15. Emin **Riza**, **Një banesë karakteristike gjirokastrite**, « Monumente të kulturës në Shqipëri», 1975/1, fq. 73-78.

16. Emin **Riza**, **Arkitektura e banesave popullore në qytetet tona gjatë shek.XVIII-XIX**, «Monumente të kulturës në Shqipëri», 1975, fq.75-85.

17. Emin **Riza**, **Mbi kriteret për restaurimin e banesës popullore**, «Monumentet», 1976/11, fq.159-172. Rés.fr. A propos des critéres de restauration des maisons caractéristiques.

18. Emin **Riza**, **Tipologjia e banesës qytetare shqiptare gjatë shek.XVIII deri rreth mesit të shek.XIX**, "Studime historike", 1976/3, fq.107-112, rés.fr. «Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike», 1977, fq. 417-428. «Studia Albanica», 1977/1, fq.109-126, éd.fr. «La Conférence Nationale des Etudes Ethnographiques (28-30 juin 1976), 1977, fq. 461-472, éd.fr. La typologie de l'habitation urbaine albanaise (XVIII moitié du XIX siècle).

19. Emin **Riza**, **L'habitation type gjirokastrite** (XVIII-XIX siècles), «Ethnographie Albanaise», 1976, fq. 171-192.

20. Emin **Riza**, **Banesa e qytetit-muze të Beratit**, «Mjeshtrit dhe arkitektura popullore» 1976, fq.98-103.

Do not copy

21.Emin **Riza**, **Mjeshtrit dhe arkitektura popullore**, «Mjeshtrit dhe arkitektura popullore», 1976, fq.186-191.

22. Emin **Riza**, bashkëautor, **Gjendja dhe arritjet e studimeve të historisë së arkitekturës shqiptare** (deri në vitin 1912).

23. Emin **Riza, Arkitektura dhe restaurimi i banesës së Zekatëve** (Gjirokastër), «Monumentet», 1977/14, fq.107-132. Rés.fr. Architecture et restauration de la maison des Zekat à Gjirokastër.

24. Emin **Riza, Vështrim mbi urbanistikën e qytetit shqiptar** (shek.XII-XX), «Monumentet», 1977/14, fq. 47-73, Rés.fr. Aperçu sur l'urbanistique de la ville albanaise XII-XX siècles.

25. Emin **Riza, Gjirokastra, qytet-muze** (album), Tiranë, 1978. (botuar shqip, anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht).

26. Emin **Riza, Ansamblet ndërtimore të Pazareve dhe restaurimi i tyre**, "Monumentet", 1978/15-16, fq.117-138. Rés.fr. Les ensembles des marchés et leur restauration.

27. Emin **Riza, Banesa popullore në fshatrat e rrethit të Vlorës**, "Monumentet", 1978/15-16, fq.185-219. Rés.fr. L'habitation populaire dans les villages du district de Vlora.

28. Emin **Riza, Kullat në Shqipërinë e Jugut**, «Monumente historike në vendin tonë», 1978, fq.16-21

29. Emin **Riza, Oda e miqve në banesën qytetare shqiptare**, «Monumente historike në vendin tonë», 1978, fq.124-129.

30. Emin **Riza**, bashkautor, **Historia e arkitekturës shqiptare** (maket).

31. Emin **Riza, Arkitektura e vendbanimit rrënojë të Kardhiqit**, "Monumentet", 1979, fq. 97-120. Rés.fr. L'architecture de l'agglomeration urbaine en ruine de Kardhiq.

32. Emin **Riza, Arkitektura dhe restaurimi i kullave të Dervish Aliut në fshatin Dukat** (Vlorë), «Monumentet», 1979/18, fq.105-120. Rés.fr. A'architecture et la restauration des tours de Dervish Aliu dans le village de Dukat (Vlorë).

33. Emin **Riza, Qyteti-muze i Gjirokastrës**, 1980

34. Emin **Riza, Restaurimi i banesës popullore**, 1980

35. Emin **Riza, Arkitektura e banesës popullore në zonën e "Bregut të detit"(Labëri),** "Monumentet", 1980/19, fq. 5-49. Rés. fr. L'Architecture de l'habitation populairedans le zone "Bregu i Detit (en Labëri).

36. Emin **Riza, Banesa qytetare shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX deri rreth çerekut të parë të shek.XX**, «Monumentet», 1980/2-, fq. 83-103, Rés. Fr. L'Habitation urbaine albanaise au cours de la seconde moitié du XIX siècle jusqu'au premier quart du XX siècle environ.

37. Emin **Riza, Arkitektura popullore në qytetet tona gjatë shek. XVIII-XIX** «Kultura Popullore», 1980/2, fq.13-20, «Culture populaire albanaise», Tiranë, 1981/1, fq. 87-111. Ed. fr. L'architecture populaire dans nos villes pendants XVIII-XIX.

38. Emin **Riza, Arkitektura e ansambleve të pazareve në qytetet e shek. XVIII-XIX** , "Tradita në arkitekturë dhe art", Tiranë, 1980, fq.16-21.

39. Emin **Riza, Arkitektura e banesës fshatare në Shqipërinë e Jugut nëpërmjet fshatrave rrënojë**, "Tradita në arkitekturë dhe art", Tiranë, 1980, fq. 66-71

40. Emin **Riza, Banesa popullore në qytetin - muze të Beratit**, "Monumentet", 1981/1 (21), fq. 5-34. Rés. fr. Habitation populaire de la ville-musée de Berat.

41. Emin **Riza, Banesa dyfamiljare në qytet**, «Monumentet», 1981/2 (22), fq.115-125. Rés. fr. L'habitation urbaine pour deux familles.

42. Emin **Riza, Shtëpia ku u themelua organizata e rinisë komuniste shqiptare**, "Shtëpi-muze dhe monumente kulture", Tiranë, 1981, fq. 7-9.

43. Emin **Riza, Banesa e Selam Musait, Hero i Popullit**, "Shtëpi-muze dhe monumente kulture", Tiranë, 1981, fq. 34-36.

44. Emin **Riza, Banesa popullore e Himarës**, "Shtëpi-muze dhe monumente kulture", Tiranë, 1981, fq. 66-70.

45. Emin **Riza, Banesa për dy familje**, "Shtëpi – muze dhe monumente kulture", Tiranë, 1981, fq. 98-101.

46. Emin **Riza, Zhvillimi urbanistik i qytetit të Beratit**, "Tradita ndërtimore në Shqipëri", Tiranë, 1981, fq.3-9.

DOWNLOAD

47. Emin **Riza**, **Kameriet në banesën qytetare shqiptare**, "Traditat ndërtimore në Shqipëri', Tiranë, 1981, fq. 75-79.

48. Emin **Riza**, Pirro **Thomo**, **Banesa fshatare e Shqipërisë Veriore**, "Monumentet", 1982/1(23), fq.133-136. Rés. fr. P. Thomo, "L'Habitation paysanne de l'Albanie du nord".

49. Emin **Riza**, **Katër numra të revistës shkencore** «Kultura popullore», «Monumentet», Tiranë, 1982/1 (23), fq.137-140. Rés. fr. Les quatre premiers numéros de la revue scientifique «La Culture Populaire».

50. Emin **Riza**, **Kameriet në banesën shqiptare**, «Kultura popullore», Tiranë, 1982/1, fq. 47-69. «Culture populaire albanaise», Tiranë, 1983/3, fq.113-119. éd. fr. Les kameriete dans la maison albanaise.

51. Emin **Riza**, **Tipare të krijimtarisë popullore në banesën qytetare shqiptare**, «Monumentet», 1982/1 (24), fq.5-27. Rés. fr. Traitsde la création populaire dans l'habitation urbaine albanaise.

52. Emin **Riza**, **Seminar mbi kriteret e restaurimit dhe dokumentimit të banesës popullore**, «Monumentet», 1982/2 (24), fq.157-158. Rés. fr. Séminaire sur les critères de la restauration et de la documentation des habitations populaires.

53. Emin **Riza**, Pirro **Thomo**, **Kritere dhe metoda për gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve popullore në RPSSH**. Rés. fr. Critères et méthodes de recherches et protection des constructions populaires en R.P.S.d'Albanie.

54. Emin **Riza**, **Përvoja e derisotme mbi qëndrimin karshi fazave të ndërtimit në banesën popullore**, «Monumentet», 1983/2 (26), fq.47-56. Rés. fr. L'expérience acquise jusqu'à ce jour sur l'attitude envers les phases de construction de l'habitation populaire.

55. Emin **Riza**, **Oda e miqve në banesën qytetare shqiptare**, "Etnografia shqiptare", Tiranë, 1983/3, fq. 255-279.«Ethnographie albanaise», Tiranë, 1984/13, fq. 249-273, éd. fr, La chambre des amis dans la maison populaire albanaise.

56. Emin **Riza**, P.**Thomo**, **Karakteri dhe tiparet e vendbanimeve të banesave fshatare shqiptare në shek. XIV-XVIII**, «Kultura popullore», 1983/2, fq.123-150, «Culture populaire albanaise» Tiranë, 1984/4. fq.45-74, éd.fr. Le caractère et les traits des agglomérations villageoise albanaises à XIV-XVIII sc.

57. Emin **Riza**, **Lidhja e ndërtimeve popullore me truallin**, «Vepra të mjeshtërve tanë», Tiranë, 1983, fq. 3-10.

58. Emin **Riza**, **Arkitektura popullore dhe materialet e ndërtimit**, «Vepra të mjeshtërve tanë», Tiranë, 1983, fq. 41-47.

59. Emin **Riza**, **Historia e arkitekturës dhe restaurimi, dy disiplina plotësuese**, "Monumentet" 1984/1 (27), fq. 5-15. Rés.fr. L'histoire de l'architecture et la restauration, deux disciplines complémentaire.

60. Emin **Riza**, **Një shembull i zhvilluar i banesës gjirokastrite (banesa e Skëndulajve)**, «Monumentet» 1984/2, fq. 77-93. Rés.fr. Un exemple de l'habitation de Gjirokastër (l'habitation des Skëndulaj).

61.Emin **Riza**, **Shtëpia e zjarrit në banesën qytetare shqiptare**, «Etnografia shqiptare», 1984/14.

62. Emin **Riza**, **Banesa fshatare dhe ajo qytetare në raport midis tyre**, «Pasuri e trashëguar në shekuj», Tiranë, 1984, fq. 89-93.

63. Emin Riza, **Ndërtimet fshatare në Labëri**, Tiranë, 1984.

64. Emin **Riza**, **Arkitektura popullore në veprën e shokut E.Hoxha "Vite të vegjëlisë – Kujtime për Gjirokastrën"**, "Monumentet", Tiranë, 1985/1 (29), fq. 19-26. Trad. fr. L'architecture populaire dans l'ouvrage du camarade E.Hoxha, "Années d'enfance – Mémoires sur Gjirokaster».

65. Emin **Riza**, **Tipologjia e banesës qytetare në raport me formulimin e ambienteve të elementeve arkitektonike dhe teknikën e ndërtimit**, «Monumentet», 1985/2, fq. 83-94. Rés. fr. La typologie de l'habitation urbaine en relation avec la formulation des ambiances, les éléments architectoniques et la technique de construction.

66. Emin **Riza**, **Shtëpia e zjarrit në banesën qytetare shqiptare**, «Etnografia shqiptare», Tiranë, 1985/14, fq. 75-99.

67. Emin **Riza**, **Dy komplekse të zhvilluara banimi**, «Monumentet», Tiranë, 1986/1 (31), fq. 85-92. Rés.fr. Deux complexes evolues d'habitation..

68. Emin **Riza**, Pirro **Thomo**, **Trajtimi i urbanistikës dhe arkitekturës në monografinë e Zija Shkodrës**, "Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare".

DO NOT COPY

69. Emin **Riza, Mbledhje jubilare**, "Monumentet", 1986/1, fq.161-164, Réf. Session jubilaire.

70. Emin **Riza, Kultura popullore** 1/1985, 2/1985, Tiranë, 1985. Botim i Institutit të Kulturës Popullore, «Monumentet», Tiranë, 1986/2 (32), fq.169-172. Trad.fr. «LA culture populaire», 1,2, 1985, Tiranë 1985 édition de l'Institut de Culture Populaire.

71. Emin **Riza**, Dashnor **Nikaj, Restaurimi i rrugës «Justin Godar» në Vlorë**, «Restaurimi 1985», Tiranë, 1986/2, fq. 28-30.

72. Emin **Riza**, bashkautor, **Historia e arkitekturës shqiptare I**, (Nga fillimet deri në vitin 1912).

73. Emin **Riza**, **Orendimi dhe pajisjet arkitektonike në banesën popullore qytetare**, «Etnografia shqiptare», Tiranë, 1987/15, fq.165-178, rés. fr. «Ethnographie albanaise», 1987/15, fq.105-117, éd. fr. Les meubles et l'appareillage architectonique dans la demeure populaire albanaise.

74. Emin **Riza**, **Qytetet-muze dhe vendi i tyre në jetën e sotme**, «Monumentet» 1988/2 (36), fq. 41-45. Rés. fr. Les villes musées et la place qu'elles occupent dans la vie actuelle.

75. Emin **Riza,** shih.nr.170, **Berati, historia dhe arkitektura**. Rés.germ. Berati geschichte und arkitekture.

76. Emin **Riza**, Pirro **Thomo**, **Korça – Urbanistika dhe arkitektura**, Botim i IKP pranë Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë, 1988. "Kultura popullore", Tiranë, 1989/1, fq.174-179. "Culture populaire albanaise", Tiranë, 1990, Publication de l'ICP près de l'Académie des Sciences de la RPSA, Tiranë, 1988,.Ed. fr. Korça – l'urbanistique et l'architecture.

77. Emin **Riza**, **Qyteti – muze i Beratit, arritje dhe prespektiva**, «Monumentet», 1990/2 (40), fq. 9-27. Trad.fr. La ville musée de Berat, réussites et perspectives.

78. Emin **Riza**, **Banesa beratase në kuadrin e banesës shqiptare**, "Monumentet", 1990/2 (40), fq.175-178. Trad.fr. L'habitation de Berat dans le cadre de l'habitation albanaise.

79. Emin **Riza**, bashkautor, **Historia e artit shqiptar**.

80. Emin **Riza**, Pirro **Thomo**, **Architecture traditionnelle des Balkans**, Albanie, Athènes, 1990.

81. Emin **Riza**, **Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë**, Tiranë, 1991. Botim i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë. Rés. fr. La ville albanaise a la veille de l'occupation ottomane et le caractère de son évolution au cours du bas moyen age.

82. Emin **Riza**, **L'habitation albanaise dans le cadre de l'habitation Balkanique**. Septième congres international d'études du sud-est Européen (Thessalonique, 29, août – 4 septembre 1994), Athènes, 1994, fq. 84.

83. Emin **Riza**, **Les monuments albanais pendant les 45 dernières années**, «Bildersturm in osteuropa», Mynih, 1994, fq.46-47.

84. Emin **Riza**, bashkautor, **Berat son histoire et son architecture**.

85. Emin **Riza**, **Banesa gjirokastrite dhe zhvillimi i saj tipologjik**, «Perla» , Revistë shkencore-kulturore 3-mujore, Tiranë 1990/2, fq. 59-68. Sum.angl. The dwelling house of Gjirokastra and its typological development.

86. Emin **Riza**, **"Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve në Shqipëri"**, Tiranë, 1997. Rés. fr. La protection et la restauration des monuments en Albanie.

87. Emin **Riza**, **Arkitektura shqiptare**, «Perla», Revistë shkencore-kulturore 3-mujore, Tiranë, 1997, 2,3, fq. 45-57. Sum. engl. The albanian architecture.

88. Emin **Riza**, **Arkitektura popullore shqiptare** (sprovë për vlerësimin e arritjeve të deritanishme), "Monumentet", 1992-1999, fq. 211-218. Sum.engl. Albanian folk architecture.

89. Emin **Riza**, **L'architecture populaire dans les Balkans – Problèmes méthodiques concernant son étude**. Në «ARCHITECTURE BALKANIQUE TRADITIONELLE» ACTES DU CONGRES INTERNATIONAL THESSALONIQUE 7-10, NOV.1997, THESSALONIKI, 1999, fq. 125-128.

90. Emin **Riza**, **Banesa shqiptare, dëshmi historiko-kulturore**, «Atdheu», New-York 2000, fq.130-133.

91. Emin **Riza**, **L'habitation albanaise dans son contexte historique**, «7 centuries of ottoman architecture Asupra –National Heritage» 2000, fq. 292-296.

92. Emin **Riza**, **Die albanische Stadt im Mittelalter und in der osmanichen Zeit**, «ALBANIEN», Reichtum und Vielfalt alter Kultur, 2001, fq. 79-84.

POROTOKOLL

93. Emin **Riza**, **Monumentet e kulturës shqiptare**, «Univers», Revistë shkencore-kulturore, Tiranë, 2001, fq.139-154.

94. Emin **Riza**, **Monografi me vlera të vërteta shkencore** (A. Muka), "Banesa fshatare dhe familja e madhe", Tiranë 2001. "Perla", Revistë shkencore kulturore 3-mujore, Tiranë, 2001, 1-2, fq.146-151. Sum.engl. Monography with real scientific values.

95. Emin **Riza, Monumentet e kulturës shqiptare**, "Univers", Revistë shkencore-kulturore, Tiranë, 2001, 1, fq.139-154. Sum.engl. The albanian monuments.

96. Emin **Riza**, **Teoria dhe praktika e restaurimit të monumenteve të arkitekturës** , Tiranë, 2002.

97. Emin **Riza**, **Restaurimi i teqesë së Sheh-Dyrit – Tiranë**, "Monumentet", Tiranë, 2002, fq.58-66. Sum.engl. The restoration of Sheh Dyri –Tirana.

98. Emin **Riza**, **Universiteti i Tiranës: Ç'ka kemi mësuar nga projektet e ngjashme në të kaluarën në Shqipëri**, "Ruajtja e qytetit të vjetër të Prizrenit (drejt njerëzve- së bashku me njerëzit)", Prizren, 2002, fq.18-21. Trad.engl. University of Tirana: Lessons learned from similar projects in the past, Albania.

99. Emin **Riza**, **Iterieri i banesës shqiptare**, "Perla", Revistë shkencore, kulturore 3-mujore, Tiranë, 2002, 4, fq.15-21. Sum.engl.Internal of Albanian private residence.

100. Emin **Riza**, **Lagjja "Mangalem", një ansambël me vlera madhore**, "Monumentet", Tiranë, 2003, fq. 46-69. Sum.engl. "Mangalem" quarter, great values ensemble.

101. Emin **Riza**, **Trajtimet e pamjes së jashtme dhe brendësisë së banesës gjirokastrite**, "Univers", Revistë shkencore, kulturore 3-mujore, Tiranë, 2003,4, fq. 141-152. Sum. engl. Approaches of the inner and outer aspects of the Gjirokastra's dwlling.

102. Emin **Riza, "Monumentet nëpër shekuj dhe në kohët moderne"**, Politika kulturore në Shqipëri, Tiranë, 2001.

103. Emin **Riza**, Albanian dwelling in 15-th -19-th centuries" në Balkanlar ' da kulturel et kilesim ve Turk mimarisi uluslarasi sempozyumi Bilderileri (17-19 mayis 2000, Sumnu-Bulgaristan) cilt 2, Ankara, 2001.

104. Emin **Riza**, **Rëndësia e trashëgimisë kulturore**, "Ura", Prishtinë, korrik, 2003.

105. Emin **Riza**, **L'habitation albanaise comme réalité balkanique**, "Revue des études sud-est européennes», tom.XLI, 1-4, 2003.

106. Emin **Riza**, **Qyteti muze i Gjirokastrës**, Tiranë, 2004.

107. Emin **Riza**, **Banesat popullore në Kalanë e Himarës**, «Himara në shekuj», Tiranë, 2004.

108. Emin **Riza**, **La mise en valeurs des monuments dans l'interprétation albanaise**, «Monument and environnement» 8/2004, Thessalonique.

109. Emin **Riza**, **Monumentet e arkitekturës dhe identifikimi i tyre**, "Monumentet e Kosovës, Prishtinë, 2004.

110. Emin **Riza**, **Një histori për konservimin arkitektonik, një vepër me vlera madhore**, "Monumentet", 2004.

111. Emin **Riza**, **Vlerësimi i arkitekturës popullore në 40 vjet veprimtari të Institutit të Monumenteve të Kulturës**, "Monumentet", 2005.

112. Emin **Riza**, **Propozim për përfshirjen në Listën e Pasurive Botërore, dorëzuar nga Shqipëria – Qendra historike e Beratit**, 2005, "Monumentet", 2005.

113. Emin **Riza, Ç'ka kemi mësuar nga projektet e ngjashme në të kaluarën në Shqipëri, në** "Ruajtja e qytetit të vjetër të Prizrenit".

114. Emin **Riza**, Njazi **Haliti**, **Banesa qytetare kosovare e shek.XVIII-XIX**, Prishtinë, 2006.

John K. PAPADOPOULOS[1], Lorenc BEJKO[2] dhe Sarah MORRIS

RINDËRTIMI I TUMËS PREHISTORIKE NË LOFKËND

DO NOT COPY

Mjedisi, kujtesa dhe tumat

Kodërvarret (tumat) janë monumentet më të spikatur të prehistorisë në mjedisin e sotëm të Shqipërisë, sikurse edhe të disa vendeve të tjera fqinje, që përfshiheshin në territorin e dikurshëm të Ilirisë. Ndryshe nga vendbanimet *tell* të Lindjes së Mesme dhe ato të tipit *toumba* ose *magoula* të Greqisë veriore, tumat tona janë kodërvarre për të vdekurit dhe jo vendbanime për të gjallët. Zgjedhja e vendit për ngritjen e tumave dhe të varrezave në përgjithësi, përfaqëson një veprim dhe qendrim të kujdesshëm dhe të menduar mirë nga ana e komuniteteve të të gjallëve[3]. Pikërisht për shkak të pozicionit të tyre dominues, tumat përbëjnë monumente të vërteta në shumë kuptime: janë struktura të konceptuara në mënyrë të qëllimshme dhe ngritur në një periudhë të gjatë kohe dhe bëhen pjesë e mjedisit që ka marrë kuptim social nëpërmjet veprimtarisë së njeriut,[4] monumente që kthehen në fokus të kujtesës dhe identitetit[5], që e shprehin lidhjen ndërmjet "të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes nëpërmjet materialitetit të tyre"[6]. Qëndrueshmëria në kohë dhe shpërndarja e tumave kudo, i ka integruar ato edhe në mjedisin e sotëm gjithmonë në ndryshim, mjedis që mund të studiohet nëpërmjet perspektivave të ndryshme[7]. Në mjedisin e Britanisë neolitike Richard Bradley thekson ekzistencën e monumenteve të ngjashëm të ngritur me dhé: "ata dominojnë mjedisin e brezave pasues në mënyrë aq të plotë sa u janë imponuar edhe ndërgjegjeve të tyre"[8]. Më shumë se kaq, ndërtimi i një tume e transformon një *hapësirë* të caktuar në një *vend*[9]. Ambienti natyror çon në krijimin e 'imazheve kulturore' që na informojnë shumë për mënyrën sesi grupet kulturore e pozicionoin vetveten në mjedisin e tyre, territori i ndërtuar ose transformuar nga njeriu e bëjnë këtë në mënyrë të dyfishtë[10]. Eshtë mëse e qartë se kuadri përkujtimor i mjedisit dhe monumenteve krijon vetë rrethanat në të cilat vepron kujtesa; njerëzit marrin dhe krijojnë identitet nga kujtesa e përbashkët ose nga memoria shoqërore[11].

Tuma e Lofkëndit dominon një mjedis kodrinor dhe lumor (Fig. 1, 2). Edhe pse me përmasa relativisht të vogla (20.54 x 10.54m) dhe vendosur në një lartësi vetëm rreth 318 m mbi nivelin e detit, tuma e Lofkëndit duket nga distanca të largëta. Ndodhet pranë rrugës nacionale që të çon drejt jugut, shumë pranë Ballshit, në një territor naftëmbajtës dhe me probleme serioze të degradimit mjedisor. Zona është pjesë e territorit kodrinor të Mallakastrës, në jug-lindje të Fierit, jo shumë

---

[1] Departamenti i Studimeve Klasike dhe Instituti Cotsen i Arkeologjisë, Universiteti i Kalifornisë në Los Angeles, SHBA (email: jkp@humnet.ucla.edu; sarahm@humnet.ucla.edu).

[2] Qendra Ndërkombëtare për Arkeologjinë Shqiptare, Universiteti i Tiranës Departamenti i Historisë, Fakulteti Histori-Filologji, Tiranë (email: albarchunit@albaniaonline.net).

[3] Parker Pearson, M. *The archaeology of death and burial.* Stroud: Sutton; College Station (TX): Texas A&M University 1999: 124.

[4] Bender, B. (ed) *Landscapes: politics and perspectives.* Providence (RI): Berg, 1993: 11.

[5] Alcock, S. *Archaeologies of the Greek past: landscape, monuments and memories.* Cambridge: Cambridge University Press, 2002: 28.

[6] Rowlands, M. "The role of memory in the transmission of culture," në *World Archaeology* 25, 1993: 144.

[7] Cosgrove, D. "Geography is everywhere: culture and symbolism in human landscapes," në D. Gregory & R. Walford (eds.) *Horizons in human geography*: 118–135.

[8] Bradley, R. *Consumption, change and the archaeological record: the archaeology of monuments and the archaeology of deliberate deposits.* University of Edinburgh: Department of Archaeology Occasional Papers 13. Edinburgh: Edinburgh University Press, 1985: 9.

[9] Tuan, Y. F. *Space and place: the perspective of experience.* Minneapolis: University of Minnesota Press, 1977.

[10] Daniels, S dhe D. Cosgrove "Introduction: iconography and landscape," në D. Cosgrove & S. Daniels (eds.) *The iconography of landscape.* Cambridge: Cambridge University Press, 1988: 1.

[11] Alcock, S. *Archaeologies of the Greek past: landscape, monuments and memories.* Cambridge: Cambridge University Press, 2002: 1, 183.

DO NOT COPY



Fig. 1 Pamje e tumës së Lofkëndit nga jugu (foto nga Rich MacDonald).



Fig. 2 Pamje ajrore e tumës së Lofkëndit në përfundim të sezonit 2005 nga veri/verilindja (foto Alket Islami).



Fig. 3. Harta e Shqipërisë (majtas) dhe harta e rajonit rreth tumës së Lofkëndit (djathtas) (përgatitur nga Stanislav Parfenov).

larg fshatrave të Lofkëndit dhe Ngrançies (Fig. 3). Gërmimet arkeologjike u ndërmorrën në këtë tumë në vitet 2004–2007 si bashkëpunim i Institutit Arkeologjik, Qendrës Ndërkombëtare për Arkeologjinë Shqiptare dhe Institutit Cotsen të Arkeologjisë në Universitetin e Kalifornisë, Los Angeles, bashkëdrejtuar nga autorët[12]. Në përfundim të sezonit 2007 një total prej 100 varresh u gërmuan, shumë prej këtyre varre të shumëfishtë që përmbanin dy-tre, e disa herë më shumë individë dhe që datohen në periudhën nga shekujt 11/10 p.e.s. në shek. 6 p.e.s. mbi bazën e kronologjisë konvencionale[13] (Fig. 4). Datat e kalibruara C14 nga 16 kampione karboni dhe 10 kampione kockash njerëzore, të kryera nga Brian Damiata në laboratorin Keck AMS në Universitetin e Kalifornisë në Irvine, kanë shërbyer për të verifikuar kronologjinë konvencionale. Ato kanë shtytur mbrapa disa data të varreve më të hershëm, të paktën në shekujt e 14të dhe 13të p.e.s., që do të thotë, në periudhën e Bronzit të vonë. Mes shumë varreve kemi ilustruar këtu vetëm dy varre tipikë të periudhës së Hekurit të hershëm (Fig. 5).

[12] Për një raport paraprak të dy sezoneve të para shih Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007: 105 –147. Shih edhe Papadopoulos, J. K. "Mounds of memory: burial tumuli in the Illyrian landscape," në L. Bejko & R. Hodges (eds.) *New directions in Albanian archaeology: studies presented to Muzafer Korkuti*. International Center for Albanian Archaeology, Tirana 2006: 75–84.

[13] Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007: 138–139.

DO NOT COPY



Fig. 3. Harta e Shqipërisë (majtas) dhe harta e rajonit rreth tumës së Lofkëndit (djathtas) (përgatitur nga Stanislav Parfenov).



Fig. 4. Planimetria e të gjithë varreve të tumës së Lofkëndit në përfundim të gërmimeve 2007 (përgatitur nga Max Farrar).



Fig. 5. Varret 41 (majtas) dhe 42 (djathtas) nga perëndimi (foto nga Rich MacDonald).

Zgjedhja e qendrës arkeologjike dhe qëllimet e përgjithshme të projektit në Lofkënd janë përshkruar në mënyrë të detajuar gjetkë[14]. U mendua paraprakisht se eksplorimi i një qendre të rëndësishme arkeologjike në këtë rajon datuar përpara dhe pjesërisht bashkëkohës me themelimin e kolonive greke në bregdet (veçanërisht Apolonia dhe Epidamnos), si dhe me qendrat proto-urbane të prapatokës (Margëlliç, Mashkiezë, Bylis dhe Klos) do të çonte në një kuptim më të mirë të procesit historik, që kontribuoi në lindjen e urbanizmit në Iliri. Gërmimi i kujdesshëm i një tume të padëmtuar si ajo e Lofkëndit ka dhënë një informacion të pasur për procesin e ndërtimit dhe formimit të saj, për marrëdhëniet komplekse të saj me qendrat proto-urbane dhe kolonitë, si dhe për zakonet mortore pre dhe proto-historike të kësaj zone të Shqipërisë.

[14] Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007.

Duke vazhduar monumentin

Më shumë se çdo gjë tjetër ishte pikërisht vizibiliteti i tumës së Lofkëndit që e bëri atë objekt kërkimi shkencor shumë evident: për të kuptuar mjedisin, fillimisht duhet kuptuar tuma. Ishte pikërisht vizibiliteti i shprehur fort në topografinë e zonës dhe materialiteti i tumës që çuan në vendimin e marrë qysh në fillim të projektit, për ta ringritur tumën pas gërmimit. Rrjedhimisht, u caktua qysh në fillim të projektit buxheti i nevojshëm për ringritjen e tumës në mënyrën më të ngjashme të mundshme më formën e saj para gërmimit.

Vendimi për ringritjen e tumës u mor edhe si një përgjigje alternative ndaj praktikës së zhvendosjes së plotë dhe përfundimtare të tumave nga mjedisi si pasojë e gërmimit. Rreth 200 tuma janë gërmuar në Shqipëri, ndër të cilat ato të Barçit, Matit, Pazhokut, Dukatit, Çinamakut, Kënetës, Kuçit të Zi, Piskovës, Vajzës, Vodhinës, Dropullit, Bajkajt, etj. dhe që shfaqen në të gjitha përshkrimet e përgjithshme të prehistorisë shqiptare.[15] Politika e gërmimit total të këtyre tumave ka çuar në mënyrë të pashmangshme në zhdukjen e tyre nga mjedisi historik. Kështu p.sh. tuma më e afërt dhe bashkëkohëse me tumën tonë të Lofkëndit, ajo në Patos,[16] është zhvendosur tërësisht nga mjedisi i saj natyror dhe në vend të saj gjenden tani themelet e një banese moderne. Rrjedhimisht, mjediset e dominuar nga tumat nuk ekzistojnë më.

Humbje të ngjashme janë ndier edhe në pjesë të tjera të Europës, si pasojë e praktikës së gërmimit total të kodërvarreve. Në shekujt e mëparshëm tuma të mëdha dhe të dukshme janë dëmtuar me anë të gërmimit në to të transheve, kanaleve dhe tuneleve gjatësorë, por megjithë dëmtimet ato mbetën pjesë integrale e mjedisit. Një shembull klasik përbëjnë kodërvarret mbretërore në Gamla Uppsala në Suedi, datuar në shek. 5–6 e.s., veçanërisht kodërvarri lindor, ose ai i Aunit[17]. Sidoqoftë në Gamla Uppsala shumë kodërvarre më pak të spikatur janë zhdukur si pasojë e praktikave bujqësore dhe guroreve: nga 2000-3000 kodërvarre që llogaritet të kenë ekzistuar, vetëm 250 syresh mbeten.

Gjetkë, është realizuar rindërtimi dhe administrimi i kodërvarreve. Në Ladby të Danimarkës p.sh., një strukturë e ngjashme me një anije të plotë nën të është gërmuar totalisht dhe më pas rindërtuar, së bashku me anijen nga fondacioni Carlsberg[18]. Një numër jo i vogël rindërtimesh të siteve arkeologjike janë pasuar nga debate dhe kundërshti të shumta[19] dhe në grupin e kodërvarreve, një nga rastet më të debatuara ka qenë restaurimi i Newgrange në Irlandë. Atje u ndërtua një mur mbajtës prej betoni nga Zyra e Punëve Publike për të mbajtur materialin që shërbente për rindërtim. Këtij materiali iu shtuan kuarc dhe granit fiksuar me llaç dhe kapse metalike për të prezantuar opinionin e gërmuesit se kodërvarri kishte fillimisht një formë cilindrike[20]. Sidoqoftë, studiues të mëvonshëm e interpretuan në mënyrë të ndryshme si sekuencën stratigrafike të kodërvarrit, ashtu edhe formën e tij (kube dhe jo cilindrike), sikurse edhe rolin e shtresës me kuarc e granit[21]. Një ndërhyrje e tillë, vështirë në mos e pamundur për tu rikthyer, i imponon mjedisit një vizion të interpretuar dhe shpesh të kundërshtuar të monumentit. Në përfundim të artikullit të fundit për Newgrange, Palle Eriksen shkruan: "forma e monumentit u transformua në mënyrë dramatike

[15] Hammond, N. G. L. *Illyris, Epirus and Macedonia in the Early Iron Age.* Cambridge Ancient History 3,1 (second edition). Cambridge: Cambridge University Press, 1982: 624–636; Prendi, F. *The prehistory of Albania.* Cambridge Ancient History 3,1 (second edition). Cambridge: Cambridge University Press, 1982: 189, 211, 214, 216–218, 222, 235; Për më shumë bibliografi të kohëve të fundit shih Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007: 105–147.

[16] Korkuti, M. "Tuma e Patosit," në *Iliria* 11 (1), 1981: 7–55.

[17] Anund, J., W. Duczko, H. Göthberg, N. Price & J. Wikborg *Gamla Uppsala: centralplats och omland. Arkeologisk förundersökning på ostkustbanan 1996-97. Gamla Uppsalaprojektet* (UV Uppsala, rapport 1997: 26). Uppsala: Riksantikvarieämbetet, 1998; Gräslund, B., "Gamla Uppsala during the migration period," në *Myth, Might, and Man: ten essays on Gamla Uppsala.* Stockholm: Riksantikvarieämbetet, 2000; Klingmark, E. H., *Gamla Uppsala.* Svenska Kulturminnen 59. Stockholm: Riksantikvarieämbetet, 2003.

[18] Sørensen, A. C. *Ladby: a Danish ship-grave from the Viking Age.* Roskilde: Viking Ship Museum, 2001.

[19] Shih një numër artikujsh në De La Torre, M. *The conservation of archaeological sites in the Mediterranean region: an international conference organized by the Getty Conservation Institute and the J. Paul Getty Museum, 6-12 May 1995.* Los Angeles (CA): Getty Conservation Institute, 1997.

[20] O'Kelly, M. J. "The restoration of Newgrange," në *Antiquity* 53, 1979: 205–210; Cooney, G. "Newgrange: a view from the platform," në *Antiquity* 80, 2006: 697.

[21] Për diskutimet dhe bibliografinë shih ; Cooney, G. "Newgrange: a view from the platform," në *Antiquity* 80, 2006: 697–708; Eriksen, P. "The rolling stones of Newgrange," në *Antiquity* 80, 2006: 709–710.

DO NOT COPY

kur ndërtuesit e rinj të kodërvarrit i dhanë atij një majë të sheshtë – në një lloj mini Silbury Hill irlandez. Sikurse edhe paraardhësit e tyre, ata krijuan Newgrange-n e tyre, sikurse edhe ne kemi fatkeqësisht tonin sot!"[22].

Rindërtimi ynë i tumës së Lofkëndit nuk synonte interpretimin e pamjes që ajo mund të ketë patur në ndonjë moment të caktuar të historisë së saj. Përkundrazi, synonte rindërtimin e kodërvarrit në një formë sa më afër asaj të vitit 2004, para fillimit të gërmimeve. Në këtë kuptim, qëllimet tona ishin më pranë projektit të menaxhimit të Sutton Hoo në Suffolk të Anglisë juglindore, filluar në 1992, ku të gjithë kodërvarret, me përjashtim të atij me nr. 2, u restauruan në lartësitë e tyre të vitit 1983[23]. Në rastin e kodërvarrit 2 u iniciua një projekt më ambicioz në 1997, kur ai u rindërtua në bazë të gërmimeve dhe një ekuacioni matematik për të përcaktuar lartësinë e vet origjinale të shekullit të 7të të e.s[24]. Përveç rindërtimit, konsolidimit dhe administrimit të tij, kodërvarri 2 në Sutton Hoo krijoi mundësinë edhe të vrojtimit të ritmeve të errozionit të tij[25].

Në këtë artikull ne duam të përshkruajmë projektin e rindërtimit të tumës së Lofkëndit. Ai fillon me një detajim të stratigrafisë dhe gjeomorfologjisë së tumës, për të vazhduar me metodën e rindërtimit. Për këtë qëllim u prodhuan më shumë se 2000 blloqe qerpiçi duke përdorur dheun e nxjerrë gjatë gërmimit të tumës, të cilët u përdorën për rindërtimin e trapeve të monumentit. Pikërisht kjo strukturë shërbeu si bërthamë rreth të cilës u ringrit tuma me po të njëjtin dhé të nxjerrë nga gërmimi i saj. Ideja themelore e projektit tonë të rindërtimit ishte se me kalimin e kohës blloqet e qerpiçit do të dizintegrohen për tu shndërruar në pjesë organike të tumës. Jemi përpjekur gjithashtu të diskutojmë përfitimet lokale dhe sociale të rindërtimit dhe rezultatet eksperimentale të këtij procesi.

[22] Eriksen, P. "The rolling stones of Newgrange," në *Antiquity* 80, 2006: 710.

[23] Carver, M. *Sutton Hoo: a seventh century princely burial ground and its context.* Reports of the Research Committee of the Society of Antiquaries of London 69. London: British Museum Press, 2005: 57.

[24] Carver, M. *Sutton Hoo: burial ground of kings?* London: British Museum Press, 1998; *Sutton Hoo: a seventh century princely burial ground and its context.* Reports of the Research Committee of the Society of Antiquaries of London 69. London: British Museum Press, 2005: 46, tab. 15; 57.

[25] Carver, M. *Sutton Hoo: a seventh century princely burial ground and its context.* Reports of the Research Committee of the Society of Antiquaries of London 69. London: British Museum Press, 2005: 57.

Stratigrafia dhe gjeomorfologjia në tumën e Lofkëndit

Duke patur parasysh pozitën e saj dominuese në një vend kaq të ekspozuar, është shumë e rëndësishme të theksohet se tuma ishte e paprekur për më shumë se 2500 vjet pas periudhës së përdorimit primar të saj. Të vetmet dëmtime vinin nga errozioni i disa varreve në anët e tumës, veçanërisht përgjatë anës jugore të thepisur. Meqenëse tuma nuk ishte dëmtuar rëndë nga errozioni, menduam në fazën e hershme të gërmimit se ishte konceptuar në mënyrë të tillë që t'i rezistonte kohës, duke përdorur p.sh. struktura të tilla si unaza rrethore me gurë, apo kësula/mbulesa realizuar po me gurë, siç është evidentuar në tumat e tjera ilire[26]. Në të vërtetë, gjatë gërmimit u ndeshëm me depozitime të dendura e të forta dherash. Megjithëse evidentuam një linjë të harkuar gurësh të mëdhenj, vendosur në thellësi në sektorin verior të tumës,[27] ajo e vetme nuk mund ta mbante gjithë tumën së bashku, kështu që iu kthyem studimit të përbërjes së mbushjes së saj.

Për të studiuar në mënyrë sistematike gjeomorfologjinë e tumës, u ftuan të bashkëpunojnë në projekt John Foss dhe Mike Timpson të Soils International, Inc. Raporti i tyre paraprak[28] konfirmoi dyshimin tonë. Ata sugjeruan se një sediment me teksturë të imët, përftuar në territorin përreth tumës ishte shtuar herë pas here në mbushjen e tumës për të neutralizuar errozionin. Sikurse u konstatua nga

[26] Andrea, Zh. *Kultura ilire e tumave në pellgun e Korçës.* Tiranë: Qendra e Kërkimeve Arkeologjike, 1985: 242–243, 245–246, 249–250; Aliu, S. *Tuma e Luarasit.* Tiranë: Instituti Arkeologjik, 2004: 22–31; Aliu, S. "Recent prehistoric research in southeast Albania: a review," në L. Bejko & R. Hodges (eds.) *New directions in Albanian archaeology: studies presented to Muzafer Korkuti.* Tiranë: International Center for Albanian Archaeology, 2006: 52, Fig. 5: 4; Bejko, L., T. Fenton & D. Foran "Recent advances in Albanian mortuary archaeology, human osteology and ancient DNA," në L. Bejko & R. Hodges (eds.) *New directions in Albanian archaeology: studies presented to Muzafer Korkuti.* Tiranë: International Center for Albanian Archaeology, 2006: 312–315, Figs. 3–5.

[27] E dukshme në figurën 2 këtu. Shih edhe Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007: 131, Fig. 25.

[28] Foss, J. E. & M. E. Timpson "Appendix 2: preliminary report on the soils of the Lofkënd archaeological site," në Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007: 140–144.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

sondimet e kryera, materiali mëmë kryesor për dherat e ndeshura në Lofkënd përbëhet nga gur ranor i Pliocenit i çimentifikuar në mënyrë shumë të dobët. Rërat e imëta dhe shumë të imëta të formuara nga dizintegrimi i shkëmbinjve ranorë, gëlqerorë janë shumë pak rezistente ndaj errozionit dhe si të tilla krijojnë shumë vështirësi për stabilizimin e matriksit gjeologjik të varreve të veçantë dhe të tumës në përgjithësi. Pikërisht këtij materiali primar, së bashku me dheun e sjellë nga territori përreth tumës u shtohej sistematikisht lëndë argjilore që të sigurohej lidhje më e mirë dhe kontrollohej errozioni[29]. Që një pjesë e depozitave të tumës ishin sjellë nga territori më i gjerë rreth Lofkëndit, ndoshta edhe në sasira të konsiderueshme, provohet nga prezenca e stralleve Paleolitike, Neolitike dhe të epokës së Bronzit, si dhe e gjetjeve të tjera veçanërisht e shumë fragmenteve të pareteve të kasolleve (argjilë e pjekur që ruan gjurmë kallamash apo thuprash të vendosur në mënyrë lineare), bashkëkohëse ose edhe më të hershme se varret[30].

Stratigrafikisht tuma është krijuar për një periudhë rreth 500 vjeçare (rreth 1100–600 p.e.s.) me një numër të pakët depozitimesh, me shtrirje në pjesën më të madhe të kodërvarrit. Detajet e stratigrafisë së tumës janë prezantuar gjetkë,[31] sidoqoftë dy aspekte të saj janë të rëndësishme të përmenden këtu. Së pari, procesi i krijimit të kodrës artificiale duket se ka filluar qysh me vendosjen e varreve më të hershëm (fig. 6) dhe së dyti, në zona të caktuara të tumës gjenden depozitime lokale të dallueshme mirë. Ky elementi i fundit u qartësua jo pak gjatë eksperiencave tona të mbulimit të pjesës së gërmuar të kodërvarrit në fund të çdo sezoni dhe zhvendosjes së mbulesës në fillimin e sezonit pasardhës. Veçanërisht gjatë zhvendosjes së dheut që shërbente si



Fig. 6. Profili lindje-perëndim i tumës, faqja veriore e trapit të sektorëve 1 dhe 4 në përfundim të gërmimit (përgatitur nga Max Farrar).

mbulesë e pjesës së pagërmuar, vumë re krijimin e rrethanave stratigrafike të ngjashme me ato të tumës origjinale. Në njërin rast depozitimet e dallueshme reflektonin ngarkesa të veçanta të karrocave të dorës, kurrse në rastin e tumës origjinale përfaqësonin depozitimet e lidhura me varrimet e veçanta. Kështu që stratigrafia komplekse dhe disa herë konfuze e tumës gjeti njëlloj spjegimi eksperimental nga procesi ynë modern i mbulim/zbulimit të pjesës së pagërmuar të sitit.

Një nga aspektet më interesante të përbërjes së mbushjes së tumës është padyshim kombinimi i veglave/ashklave prej stralli me mbetjet e arkitekturës së kasolleve prehistorike. Së bashku, këto gjetje ngrenë mundësinë që të gjallët, që varrosnin të vdekurit e tyre, sillnin me vete material në mënyrë të qëllimshme nga vende të caktuara për ta përdorur si mbushje të tumës. Nëse kjo hipotezë merret si e mirëqënë, atëhere materiali arkeologjik që vjen nga mbushja e tumës nuk përputhet me strukturën e gjetjeve qe normalisht vijnë nga vendbanimet prehistorike. Mungojnë nga mbushja e tumës gjetje organike të karbonizuara apo kocka kafshësh. Ato kocka kafshësh që kemi evidentuar nga gërmimi i kujdeshëm i tumës lidhen me kontekstet e veçantë të varreve dhe me ritualet e varrimit sikurse edhe me brejtësit që kanë gjetur rrugën e tyre në kodërvarr në periudhën pas përdorimit të tij si varrezë. Nga ana tjetër, kemi dhe vështirësinë se nuk njohim ende asnjë vendbanim prehistorik në zonën përreth të gërmuar në mënyrë sistematike, kështu që nuk kemi një referencë të qartë të asaj që mund të konsiderohet kampion i materialeve të vendbanimit dhe, për më tepër, nuk e kemi të qartë evolucionin e tij në kohë. Për këto arsye është e vështirë të themi, ose të mohojmë se dheu i sjellë në tumë nga ndonjë vendbanim i nënështrohej një procesi zgjedhjeje apo seleksionimi

[29] Për përshkrimin e detajuar të dherave në Lofkënd dhe territorin përreth shih Foss, J. E. & M. E. Timpson 2007, veçanërisht Tabs. 1–3.

[30] Për një diskutim më të plotë shih Papadopoulos, J. K. "Mounds of memory: burial tumuli in the Illyrian landscape," në L. Bejko & R. Hodges (eds.) *New directions in Albanian archaeology: studies presented to Muzafer Korkuti.* International Center for Albanian Archaeology, Tirana 2006: 81–83, Figs. 6–7; Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007: 134–135, Figs. 29–30.

[31] Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007: 127–135.

DO NOT COPY

(sitjeje) për arsye të prezencës/mungesës së gjetjeve të tipeve të caktuar[32]. Sidoqoftë, mundësia që materiali i sjellë qëllimisht në tumën e Lofkëndit nga site të tjerë që edhe në kohën e ngritjes së tumës konsideroheshin "të vjetër" ngre një hipotezë tjetër të rëndësishme që duhet testuar edhe nga gërmimi i tumave të tjera. Nëse dheu i përdorur për ngritjen e tumës, ose qoftë edhe një pjesë e tij, sillej nga site të tjerë, atëhere ky fenomen e thekson akoma më shumë karakterin përkujtimor të tumës. Jo vetëm kaq, por ai e shndërron tumën në një element të rëndësishëm të mjedisit, brenda mjedisit ekzistues: një mal të vërtetë përkujtimor.

Rindërtimi i tumës

Meqenëse tuma ishte ndarë në katër sektorë të ndarë nga njëri-tjetri nga trape 50 cm të gjerë, procesi i mbulimit të pjesës së pagërmuar të tumës në fund të çdo sezoni (2004, 2005 dhe 2006) ishte i thjeshtë. Fletë plastike shtroheshin mbi pjesët e pagërmuara të tumës dhe anët e trapeve dhe dheu i zhvendosur nga gërmimi i ri kthehej në hapësirat e krijuara në secilin sektor. Struktura bazë dhe silueta e tumës përcaktoheshin nga format e trapeve të ruajtur me rigorozitet gjatë procesit të gërmimit. Në thelb, trapet përfaqësonin kuadrin i cili shërbente edhe si guidë për mbushjen e sektorëve. Gjatë mbushjes, përpiqeshim ta ngjeshnim dheun periodikisht me aq sa ishte e mundur. Kjo metodë ishte sa efektive, aq edhe me pak shpenzime. Kur riktheheshim pas një viti, vinim re disa dëmtime të vogla të interfaqes së trapeve me mbushjen, jo më shumë se pak centimetra. Ndërkohë vegjetacioni zhvillohej shpejt në pjesën relativisht më të shkrifët të mbushjes dhe gjatë një viti shumë barëra, lule dhe shkurre të ulëta me rrënjët e tyre stabilizonin sipërfaqen e tumës, duke e mbrojtur atë nga errozioni. Sidoqoftë, errozioni nuk mund të evitohej tërësisht, veçanërisht në anën jugore më të ekspozuar të tumës, që është edhe ana më e thepisur e kodërvarrit. Në anët e tjera, veçanërisht atë veriore me kalime më graduale të shpateve të tumës në territorin përrreth, errozioni ishte shumë i vogël, ose inekzistent.

Për aq kohë sa trapet ruheshin, nuk ishte i nevojshëm përgatitja e një plani alternativ për rindërtimin e tumës. Por, për arsye të eksplorimit të plotë të tumës ishte i detyrueshëm gërmimi dhe zhvendosja e tyre. Një model dixhital tredimensional i tumës ishte ndërtuar paraprakisht nga Chris Johanson dhe Itay Zaharovitz të Qendrës së Teknologjive Eksperimentale të Universitetit të Kalifornisë në Los Angeles,[33] kështu që kishim të dhëna të mjaftueshme për të riprodhuar profilin origjinal të tumës. Sidoqoftë, pa trapet rindërtimi i formës origjinale ishte më kompleks.

Ishte e qartë se për të qenë të suksesshëm, çdo zgjidhje duhet të përqendrohej në përdorimin e materialeve që gjendeshin në mjedisin natyror përrreth tumës, kështu që ishim të vendosur të shmangnim çdo përdorim të teknologjisë moderne. Bazuar në eksperiencën e tre viteve të mbushjes së tumës dhe eksperimentimi i ruajtjes së saj gjatë periudhës njëvjeçare ndërmjet sezoneve, vendosëm të bazoheshim në ringritjen me materiale rrethanore të trapeve që të shërbenin si strukturë mbajtëse e saj. Ngritjen e trapeve vendosëm ta bëjmë me anë të blloqeve prej qerpiçi, që do të prodhoheshin me argjilën e nxjerrë nga gërmimi i tumës. Ideja kryesore ishte që blloqet prej qerpiçi do të dizintegroheshin pas disa vitesh për t'u bërë pjesë organike e tumës.

Gjeoarkeologu i projektit, John Foss theksoi nevojën e përdorimit të sedimenteve të pastra argjilore për bërjen e qerpiçit, por punëtorët lokalë me përvojë në prodhimin e tyre, e kishin të qartë llojin e depozitave që duheshin përdorur, duke mënjanuar dherat ranore. Ata preferuan përzierjen e materialeve argjilore dhe ranore, që çoi esencialisht në përdorimin e dheut të nxjerrë nga gërmimi i tumës. Katër punëtorë nga fshatrat e Ngrançies dhe Gjinoqarës përgatitën rreth 1200 blloqe qerpiçi 42x18x17 cm dhe me peshë rreth 20 kg secili për një periudhë prej dhjetë ditësh në verën e 2006 duke përdorur vetëm një kallëp të dyfishtë (Fig.7). Katër punëtorët punuan në grupe dyshe, pasi hapën dy gropa

[32] Procesi i ngritjes, riparimit dhe mirëmbajtjes së kodërvarreve është një element që është vërejtur në disa syresh përgjatë Mississipi-t, për të cilin shih Saunders, J. W., R. D. Mandel, C. G. Sampson, C. M. Allen, E. T. Allen, D. A. Bush, J. K. Feathers, K. J. Gremillion, C. T. Hallmark, H. E. Jackson, J. K. Johnson, R. Jones, R. T. Saucier, G. L. Stringer & M. F. Vidrine "Watson Brake, a middle archaic mound complex in northeast Louisiana," në *American Antiquity* 70, 2006: 631–668.

[33] Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007: 135–138, Fig. 33.

DO NOT COPY





Fig.7. Përgatitja e blloqeve prej qerpiçi: a) gropat e përzierjes së argjilës me ujë dhe kashtë. c) mbushja e kallëpit me materialin e përzierë.





b) Baki Ymeri me kallëpin e dyfishtë të derdhjes.

d) blloqet e qerpiçit të tharë (pjekur) plotësisht në stivë dhe blloqe në faza të ndryshme të tharjes (foto nga Rich MacDonald).

drejtkëndore për përzierjen e dheut, ujit dhe kashtës. Grupi i parë i përbërë nga dy punonjësit më me eksperiencë, përzienin komponentët përbërës me këmbë. Konsistenca e duhur e përzierjes testohej me ndjesinë e kontaktit të këmbëve dhe materialet shtoheshin sipas nevojës. Pasi përzierja ishte gati, ajo grumbullohej mbi një fletë plastike, gati për skuadrën tjetër. Grupi tjetër, përbërë nga punëtorë më të rinj, por sidoqoftë me eksperiencë të mirë, vendosnin përzierjen në kallëp duke e ngjeshur me aq sa të ishte e mundur, e lëmonin me duar të lagura dhe e kthenin kallëpin në zonën e tharjes në diell të qerpiçëve. Çdo ditë blloqet ktheheshin për të bërë një tharje uniforme, e cila plotësohej pas katër ditësh.

Vendimi ynë për të rindërtuar trapet e gërmimit me blloqe qerpiçi nuk frymëzohej nga studimet etno-arkeologjike dhe arkeologjia eksperimentale dhe nuk kishte për qëllim të përbëntë një kontribut për to. Ishte për ne një vendim i thjeshtë logjik, por që pati ndikime të gjera, meqë pak ose aspak dihet për përdorimin e qerpiçit në prehistorinë shqiptare. Procesi i regjistrimit të përgatitjes së blloqeve prej qerpiçi dokumenton një zanat që është duke humbur në këtë zonë të Shqipërisë. Punëtorët që përgatitën qerpiçet e Lofkëndit përfaqësojnë ndoshta brezin e fundit të atyre që e njohin këtë procedurë, meqë tullat industriale dhe betoni janë jo vetëm të lirë, por edhe konkurues të fortë

DO NOT COPY

të teknikave tradicionale. Duke diskutuar prodhimin e tullave prej qerpiçi në Lindjen e Mesme, Delougaz shkruan se "përgatitja e tullave nuk kërkon ndonjë njohuri të veçantë teknike, kështu që pothuajse çdo fshatar e bënte atë periodikisht. Sidoqoftë, kishte burra të caktuar në secilin fshat me aftësi të veçanta në përgatitjen dhe manipulimin e tullave prej qerpiçi"[34]. Delougaz thekson gjithashtu se një qerpiçbërës në rajonin Diyala në fillimet e viteve 1930 përgatiste rreth 3000 tulla në ditë[35]. Kur u informuan për këto shifra, punëtorët e Lofkëndit shprehën habi dhe skepticizëm.

Në fund të sezonit të 2007, pjerrësia e shpateve të shkëmbit natyror, ranor të ekspozuar, mbi të cilin ngrihej tuma, ishte shumë e theksuar, veçanërisht në anën jugore, por edhe në lindje e perëndim. Një në mënyrë të mjaftueshme për të stabilizuar sipërfaqjen e tumës së rindërtuar. Rrjedhimisht, në verën e 2007 përgatitëm edhe 787 blloqe të tjerë qerpiçi për plotësimin e trapeve dhe për t'i përdorur si mur mbajtës në anët e tumës. U përdor e njëjta procedurë si në 2006, përveçse kallëpët këtë radhë ishin diçka më të vegjël (48x18x14 cm). Figura 8 tregon rindërtimin e trapeve me anë të blloqeve prej qerpiçi. Këto përbënin pikërisht strukturën rreth të cilës u krye mbushja e fundit e sektorëve të gërmuar të tumës.

Sikurse ishte theksuar nga Foss dhe Timpson[36], tuma ishte vendosur mbi një shkëmb natyror ranor të çimentifikuar në mënyrë shumë të dobët nga karbonate dhe që gërmohej me shumë lehtësi, edhe pse kishte zona të izoluara ku çimentifikimi ishte shumë i fortë. Kjo ishte arsyeja që në këtë rindërtimin e fundit vendosëm t'i hedhim depozitat direkt mbi shkëmbin natyror, pa shtresë plastike apo gjeotekstili. Një pamje e tumës së rindërtuar në fund të 2007 jepet në figurën 9, kurse në verën e 2008 konstatuam me kënaqësi se mbushja e tumës ishte stabilizuar dhe vegjetacioni



Fig. 8. Rindërtimi i trapeve të gërmimit me blloqe qerpiçi (foto John Papadopoulos).



Fig. 9. Pamje e tumës së rindërtuar në fund të sezonit 2007 (foto Rich MacDonald).

(kryesisht bar dhe lule të egra) kishin mbuluar sistematikisht sipërfaqen e tumës duke e ruajtur nga errozioni.

Rindërtime të tjera tumash

Rindërtimi i tumës së Lofkëndit përfaqëson njërin nga pak monumente të ngjashëm të rindërtuar/muzealizuar në mjedisin ballkanik. Në Shqipëri, e vetmja tumë që ka njohur një trajtim të kujdesshëm konservimi dhe muzealizimi është ajo e Kamenicës në pellgun e Korçës. Ndryshe nga Lofkëndi, tuma e Kamenicës përmbante një strukturë të madhe rrethore (unaza e varrit qëndror), për fazën e hershme të varreve të Bronzit të vonë, si dhe një zgjerim akoma më të madh të bërë me gurë dhe varre monumentalë në periudhën e pas-shekullit të 7të

[34] Delougaz, P. *Plano-convex bricks and the methods of their employment.* Studies in Ancient Oriental Civilization 7. Chicago: Oriental Institute, University of Chicago, 1933: 6–7.

[35] Cituar në Moorey, P. R. S. *Ancient Mesopotamian materials and industries: the archaeological evidence.* Winona Lake (IN): Eisenbrauns, 1999: 305.

[36] Foss, J. E. & M. E. Timpson "Appendix 2: preliminary report on the soils of the Lofkënd archaeological site," në Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007: 140.

p.e.s.[37] Duke u bazuar në përmasat e tumës së Kamenicës, domethënien dhe natyrën e arkitekturës së saj funerale, u mor vendimi që ajo të shndërrohej në një qendër të vizitueshme, muze në natyrë (Fig. 10). Nën drejtimin e Lorenc Bejkos, u krye shpronësimi dhe rrethimi i territorit të sitit arkeologjik, elementët e arkitekturës funerale u konservuan, u krye drenazhimi i ujërave mbi e nën-tokësore dhe devijimi i tyre nga strukturat arkeologjike dhe u ngrit një qendër vizitorësh në të cilën jepen historia dhe rezultatet e gërmimit, sikurse edhe riprodhime të objekteve dhe kontekseve të tyre në tumë (qendra u inaugurua dhe muzeu u hap për publikun në Qershor 2007).



Fig. 10. Pamje e tumës së Kamenicës (Korçë) pasi është prezantuar si qendër muzeale (foto Rich MacDonald).

Ndoshta tuma më e madhe e "rindërtuar" në Ballkan përfaqësohet nga ngritja e një krypte masive dhe muzeu, së bashku me rindërtimin e tumës mbi to në sitin e varreve mbretërore të fundit të shek. të 4[t] p.e.s. në Vergina të Greqisë veriore. Ky projekt i madh filloi në 1983 dhe përfundoi në 1993, kur muzeu dhe siti u hapën për publikun me një kosto totale rreth 7.02 milionë dollarë[38]. Tuma e rindërtuar në formë muzeu në Verginë jo vetëm mbron varret dhe monumentet e tjerë antikë, por është strehë edhe e gjetjeve të shumta e të pasura që vijnë prej tyre, duke u dhënë mundësi të vizitohen nga mijra njerëz çdo vit.

Në ndryshim nga Vergina dhe Kamenica, ajo që mbetej nga gërmimi i plotë i tumës së Lofkëndit ishte vetëm shkëmbi natyror mbi të cilin ajo ishte ngritur. Nuk kishim asgjë të krahasueshme me strukturat funerale të Kamenicës apo ato të periudhës klasike e helenistike të Verginës. Sfida jonë ishte si rrjedhim, më e thjeshtë dhe më lehtësisht e realizueshme: të ringrinim kodërvarrin dikur të dukshëm në mjedisin e vet. Si rezultat i këtij projekti, çdokush që udhëton në rrugën Fier-Tepelenë do të vazhdojë të shohë tumën e vogël, por shumë dominuese që ka marrë emrin e Lofkëndit në kodrat e Mallakastrës, në anën veriore të rrugës midis Patosit dhe Ballshit.

Përfundime

Në hyrjen e këtij artikulli dhe në sythin pararendës u diskutuan qëllimet e projektit të rindërtimit të tumës së Lofkëndit, në kontekstin e disa përpjekjeve të ngjashme në Europë, veçanërisht në Skandinavi, Britani dhe Ballkan. Këta projekte, si dhe i yni, jo vetëm që janë pjesë e debatit më të gjerë të ruajtjes, restaurimit dhe rindërtimit të monumenteve arkeologjike[39], por dëshmojnë edhe ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në disiplinën e arkeologjisë në drejtim të rritjes së vëmendjes dhe kujdesit për pasojat fizike dhe sociale të gërmimit arkeologjik[40]. E kaluara është një pasuri e rrezikuar dhe e kontestuar dhe një nga qëllimet e arkeologjisë duhet të jetë pajtimi i tre objektivave - kërkimi shkencor, aksesi i publikut dhe konservimi afatgjatë - shpesh në kundërshti me njëra-tjetrën[41].

[37] Bejko, L., T. Fenton & D. Foran "Recent advances in Albanian mortuary archaeology, human osteology and ancient DNA," në L. Bejko & R. Hodges (eds.) *New directions in Albanian archaeology: studies presented to Muzafer Korkuti*. Tiranë: International Center for Albanian Archaeology, 2006: 312–315, Figs. 3–5.

[38] Dimacopoulos, J. E. *A shelter in the style of a tumulus: Vergina, an underground archaeological site and museum in the typr of a crypt* (second edition). Athens: Ministry of Culture, 1997.

[39] Sullivan, S. "A planning model for the management of archaeological sites," në M. de la Torre (ed.) *The conservation of archaeological sites in the Mediterranean region: an international conference organized by the Getty Conservation Institute and the J. Paul Getty Museum, 6-12 May 1995*. Los Angeles (CA): Getty Conservation Institute, 1997: 15–26; Schmidt, H. "Reconstruction of ancient buildings," në në M. de la Torre (ed.) *The conservation of archaeological sites in the Mediterranean region: an international conference organized by the Getty Conservation Institute and the J. Paul Getty Museum, 6-12 May 1995*. Los Angeles (CA): Getty Conservation Institute, 1997: 41–50.

[40] Lyons, C. L. "Archaeology, conservation, and the ethics of sustainability," në J. K. Papadopoulos & R. Leventhal(eds.) *Theory and practice in Mediterranean archaeology: Old World and New World perspectives*. Los Angeles (CA): Cotsen Institute of Archaeology, University of California, 2003: 299–308.

[41] Lyons, C. L. "Archaeology, conservation, and the ethics of sustainability," në J. K. Papadopoulos & R. Leventhal (eds.) *Theory and practice in Mediterranean archaeology: Old World and New World perspectives*. Los Angeles (CA): Cotsen Institute of Archaeology, University of California, 2003.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Administrimi i pasurisë kulturore kërkon integrimin e interesave të komuniteteve lokale në të gjithë nivelet dhe, që procesi i dialogimit me të gjithë grupet e interesit, të mbajë parasysh faktin se pasuria arkeologjike ka domethënie të ndryshme tek njerëz të ndryshëm[42]. Konservimi dhe interpretimi eventual i sitit arkeologjik shihet gjithnjë e më shumë si pjesë integrale e projektit qysh në fazën e konceptimit të tij. Sikurse thekson Nicholas Stanley-Price, "në historinë e gjatë të gërmimeve arkeologjike në Mesdhe, probleme të tilla si konservimi, prezantimi për publikun, apo administrimi i siteve arkeologjike është trajtuar zakonisht pas përfundimit të gërmimit. Në të kundërt, koncepti bashkëkohor nënvizon se ato duhet të konsiderohen qysh përpara fillimit të fushatës dhe veçanërisht përpara përdorimit të çfarëdo teknike shkatërruese si p.sh. gërmimi"[43].

Në rrethanat e Lofkëndit duket me interes të theksohet ajo që banorët lokalë mendonin për kodërvarrin përpara gërmimit. Pyetjes se çfarë përfaqësonte tuma, pothuajse të gjithë banorët e fshatrave Ngrançie e Gjinoqarë iu përgjigjën se e konsideronin varrezë për njerëz përtej kujtesës së tyre. Në disa raste tuma konsiderohej si varr kolektiv për ushtarë të huaj, të rënë gjatë Luftës së Parë Botërore, ose të një prej betejave të luftërave ballkanike. Për ironi, tuma që ishte aty prej një kohe shumë më të gjatë, konsiderohej si diçka e importuar, monument i një kulture të huaj. Fakti se në të vërtetë tuma përmbante varre prehistorikë, çoi në diçka më shumë se zgjimin e një lloj krenarie lokale. Krijoi kushtet për abstragimin e kohës dhe kujtesës dhe i përqendroi ata edhe një here në një vend të caktuar: një tumë që dominonte mjedisin lokal. Në prehistori tuma ishte epiqendra e kujtesës dhe identitetit. Ajo u ofronte banorëve të epokës së Hekurit të hershëm të kësaj pjese të luginës së Gjanicës jo vetëm imazhin e saj, por edhe pikën e referimit për të kaluarën e tyre, sikurse edhe një këndvështrim për të përqasur të ardhmen[44]. Në një mënyrë të ngjashme, rindërtimi i tumës rikrijon kuadrin përkujtimor të mjedisit natyror dhe të monumentit specifik brenda këtij mjedisi. Përfitimi lokal dhe social nga rindërtimi i tumës qëndron pikërisht në faktin se ai përmbush nevojat e të tashmes pa i bërë të pamundura ato të së ardhmes.

Falenderime

Projekti i Lofkëndit është financuar në mënyrë gjeneroze nga Fondacioni i familjes Steinmetz, Fondacioni Kres, Fondacioni Mellon, Instituti Arkeologjik Cotsen në Universitetin e Kalifornisë në Los Angeles dhe Fondi Ahmanson i Institutit Cotsen. Autorët dëshirojnë të falenderojnë këto institucione, sikurse edhe të gjithë anëtarët e ekipit të Lofkëndit për kontributet e tyre, veçanërisht Muzafer Korkutin për mbështetjen e projektit si një bashkëpunim shqiptaro-amerikan, John Foss dhe Mike Timpson të Soils International Inc. për analizat e tyre gjeoarkeologjike në tumën e Lofkëndit dhe zonën përrreth, Brian Damiata për datimet radiokarbon dhe Clairy Palivou për opinionet e këmbyera lidhur me konservimin e monumentit. Mbi të gjitha u jemi mirënjohës të gjithë punëtorëve nga fshatrat Ngrançie e Gjinoqarë, veçanërisht Baki Ymeri, Ndriçim Beqiri, Arben Malaj dhe Adriatik Malaj që e bënë të mundur rindërtimin e tumës duke na mësuar procesin e prodhimit të tullave prej qerpiçi dhe për prodhimin e mbi 2000 syresh në një periudhë aq të shkurtër.

[42] Lyons, C. L. "Archaeology, conservation, and the ethics of sustainability," në J. K. Papadopoulos & R. Leventhal (eds.) *Theory and practice in Mediterranean archaeology: Old World and New World perspectives*. Los Angeles (CA): Cotsen Institute of Archaeology, University of California, 2003: 303.

[43] Stanley-Price, N. "Site preservation and archaeology in the Mediterranean region," në J. K. Papadopoulos & R. Leventhal (eds.) *Theory and practice in Mediterranean archaeology: Old World and New World perspectives*. Los Angeles (CA): Cotsen Institute of Archaeology, University of California, 2003: 269.

[44] Papadopoulos, J. K., L. Bejko & S. P. Morris "Excavations at the prehistoric burial tumulus of Lofkënd in Albania: a preliminary report for the 2004-2005 seasons," në *American Journal of Archaeology* 111, 2007: 83–84.

John K. PAPADOPOULOS, Lorenc BEJKO & Sarah P. MORRIS

RECONSTRUCTING THE PREHISTORIC BURIAL TUMULUS OF LOFKËND IN ALBANIA

DO NOT COPY

Tumuli, Memory and Landscape

The burial tumulus of Lofkënd dominates a hilly and riverine landscape. Despite its relatively small size (20.54 x 10.54 m), and the fact that it is situated only some 318 m above sea level, the Lofkënd tumulus is visible from substantial distances. The tumulus lies in the Malakastër hills, which rise to the southeast of the modern regional center of Fier, not far from the village of Lofkënd. Excavations were conducted at the mound from 2004 to 2007 as a collaboration of the Cotsen Institute of Archaeology at the University of California, Los Angeles (UCLA), and the Institute of Archaeology, Academy of Sciences, Tirana, with the International Center for Albanian Archaeology, and was co-directed by the authors. By the conclusion of the 2007 season a total of 100 graves had been excavated, many of them multiple burials containing two, three, or sometimes more individuals, all dating to the period from the 11th or 10th century B.C. down to about 600 B.C. on the basis of the conventional chronology. The choice of site and the overall aims of the archaeological project at Lofkënd are outlined in detail elsewhere. It was anticipated that the exploration of a major site in this region pre-dating and partly chronologically overlapping both the foundation of the Greek colonies on the coast (especially Apollonia and Epidamnos) and the so-called proto-urban centers of the hinterland (including Margëlliç, Mashkjezë, Byllis, and Klos/Nikaia) would lead to a better understanding of the historical processes that contributed to the rise of urbanism in Illyria. Indeed, the careful excavation of an undisturbed burial tumulus such as Lofkënd has provided much new information on the processes of tumulus formation and construction; it has also yielded interesting evidence for a more complex relationship with both the proto-urban centers and the colonies than hitherto anticipated, and has revealed much new data on prehistoric and proto-historic mortuary customs in this part of Albania.

More than anything else, however, it was the visibility of the Lofkënd tumulus that made it such an obvious target of investigation: to understand the landscape, one must first understand the tumulus. It was also the blatant visibility and materiality of the Lofkënd tumulus that prompted the decision, from the very inception of the project, to rebuild the mound. Accordingly, funding was allocated from the beginning of the project for the ultimate rebuilding or reconstruction of the tumulus as close to its original appearance as possible.

Stratigraphy and Soil Morphology

Given its dominating position in the landscape, on such a naturally imposing spot, it is noteworthy that the mound was essentially intact for well over two and a half thousand years after its period of primary use, although some erosion of burials was noted prior to excavation around the edges of the tumulus, especially along the steep south side. Because the tumulus did not collapse or erode more than it had, or wash away in the periodic storms that can be ferocious in this part of Albania, we suspected early on in our excavations that something in its composition assisted in holding it together. Perhaps this was nothing more than the existence of an underlying structure, such as a ring of stones or other means of soil retention seen in other tumuli. Indeed, the excavation of individual tombs in the Lofkënd tumulus was exacerbated by the dense, hard, cement-like quality of the soil. Although a partly preserved curved line of stone was encountered at depth

DO NOT COPY

in the northern sector of the tumulus this by itself did not hold the tumulus together and so it was to the composition of the fill of the tumulus that we turned to.

In order to explore the composition of the soil more systematically, John Foss and Mike Timpson (of Soils International, Inc.) were invited to collaborate on the project. Their preliminary report confirmed our suspicions. They suggest that a fine-textured sediment obtained off-site was added periodically to help prevent erosion of the tumulus. As determined by coring, this clayey fine-textured sediment derived from soils weathered from shale, located about 30 m north of the site. The basic parent material for soils occurring at Lofkënd is weakly cemented Pliocene sandstone. The fine and very fine sands that weathered from the calcareous sandstone are quite erosive and would pose difficulties for stabilizing the earth matrix during individual burials, as well as for the completed tumulus. It was to this parent material, in addition to soil brought in from elsewhere in the landscape, that the clayey sediment deriving from shale was added throughout the tumulus to control erosion. That some earth was brought to the site from the greater region of Lofkënd, and perhaps even substantial volumes, is indicated by the presence of Paleolithic, Neolithic and Bronze Age lithics, as well as other finds, such as numerous pieces of clay daub (fire-hardened clay preserving reed, rod or stake impressions used as lining in wattle-and-daub architecture) contemporary with, or predating, the burials.

Stratigraphically, the tumulus was formed over a period of about half a millennium (ca. 1100-600 B.C.) by a relatively limited number of soil units, which tended to be consistent over large areas of the mound. A more detailed account of the stratigraphy of the tumulus is presented elsewhere, but here two aspects regarding the fill of the mound are worth noting. First of all, the process of mounding appears to have begun fairly early in the creation of the tumulus and, secondly, in certain areas throughout the tumulus there were distinct localized dumps of earth. This latter feature of the stratigraphy was in no small measure clarified by the process of backfilling the tumulus at the end of each excavation season and its subsequent reopening at the beginning of the following season, which protected the unexcavated remains and kept the integrity of the tumulus in its landscape. In re-excavating our own backfill, we noticed clear variations in the soil that were the result of separate loads of earth – whether wheel-barrow or bucket loads – piled on top of one another that were virtually identical to the ancient stratigraphy of the tumulus as excavated. The process of following the ancient stratigraphy, which consisted of variations, sometimes slight, sometimes prominent, in the color and texture of the earth proved frustrating and in cases elusive. Occasionally, a clearly distinct type of fill could be followed for some depth, whereas elsewhere it would disappear, only to reappear within what proved to be a larger matrix of fill. Thus, what in certain points seemed to be a most confusing stratigraphy was clarified by the modern process of backfilling, within which it was possible to see different loads of dumped earth as distinct stratigraphic units that were nevertheless part of a single event. Such a process, repeated over time, gave the tumulus its distinctive stratigraphic profile.

Reconstructing the Tumulus

Since the tumulus was divided into four sectors each separated by baulks of 0.50 m, the process of backfilling at the end of each excavation season (2004, 2005 and 2006) was straightforward. Plastic sheeting was laid out on the unexcavated deposits and along the sides of the baulks, and the soil from the excavation dump was reintroduced to each of the sectors. The basic structure of the tumulus was indicated by the unexcavated baulks, against which the earth was piled; in essence, the baulks served as a framework for the backfill. In the process of backfilling we attempted, periodically, to compact the earth as much as possible. This method of backfilling proved both inexpensive and effective. On returning to the tumulus the following season, we noted slight subsidence at the interface of the baulks and the backfill, but this was never more than a few centimeters. Moreover, vegetation had quickly taken root in the comparatively looser earth of the backfill and within a year a dense array of shrubs, grasses and flowers effectively stabilized the tumulus and held it together, preventing further erosion. Some erosion was noted, especially along the more exposed south side of the tumulus, but this was at the steepest point of the mound and where its height was greatest from the

surrounding surface. Elsewhere, particularly to the north, the mound sloped more gently toward the surface of the ridge on which the site was located and here erosion was either minor or non-existent.

So long as the baulks were in place, the need to conceive of an alternate plan of reconstruction was unnecessary. On account of a variety of factors – including the location of numerous graves, not least of which was the central grave, and to clarify a number of stratigraphic features – it was necessary to remove the baulks. We had originally decided to leave intact a 0.50 m square pillar of unexcavated earth at the highest point of the tumulus and near its center as a remnant of one section of the stratigraphic sequence, but the location of the central grave and fear of collapse of the resulting pillar made us abandon this idea. Without the baulks, however, the whole issue of reconstruction was more complex, despite the fact that a three-dimensional digital model of the tumulus had been constructed by Chris Johanson and Itay Zaharovitz of the Experiential Technologies Center at UCLA.

Given our knowledge of the soils of the Lofkënd region and given our experience in backfilling the tumulus over a period of three successive years, we settled on the low-tech and inexpensive expedient of rebuilding the baulks and using them as a framework for retaining the excavation soil. We explored a number of options as to the material to be used in the rebuilding of the baulks. But in the end the obvious solution was to construct mud-bricks made out of the soil of the tumulus, and to use these to (re)construct the baulks. Our soil scientist, John Foss, stressed the need for using the fine, clayey sediment that derived from weathered shale, but the local excavation workmen, experienced in the making of mud-brick, were sensitive to the different types of soil and had independently rejected the sandy parent soil of the area that had weathered from sandstone. They did, however, prefer a mixture of the shaley and sandy earth and in the end they essentially used the earth of the tumulus – minus the human-made material – to make their mud-bricks.

Four workmen from the nearby villages of Ngrançija and Gjinoqara made approximately 1,200 mud-bricks, each measuring 42 x 18 x 17 cm and weighing about 20 kg, over a period of some ten days in the summer of 2006 using one double mould. The four men worked in teams of two, having first dug two rectangular pits for the mixing of soil, water and straw. The first team, consisting of the two older and more experienced men, mixed the earth, straw and water by treading with their feet; the correct consistency was gauged by feel, with the various components added as needed in the process of treading. Once the mixture was ready, they would pile it on a sheet of plastic ready for the other team to take over. The second team of the two younger but also experienced men would throw the mixture into the mould, making sure that it was as compact as possible, smooth it off with wet hands, and then together they would lift the mould, carry it to the drying area, up-end it, and let the bricks dry (the process of lifting the mould and exposing the wet bricks was compared by the workmen to the production of squares of loukoum or Turkish Delight). Every day or so, the bricks were turned to promote better drying. Under the normal summer conditions, the drying of the bricks was complete in about four days. As there is no water supply at hand on the site, all the water was brought up in large plastic containers by donkey, and the straw used for binding the mud was prepared each day from the wheat and barley chaff from the local fields.

By the end of the 2007 campaign, the steepness of the exposed bedrock ridge on which the tumulus was built, particularly to the south, but also to the east and west, necessitated some form of retention, at least until such time as the undergrowth could take hold and help stabilize the soil. Consequently, in the summer of 2007, we made an additional 878 mud-bricks for the rebuilding of the baulks and to use them around the edges of the tumulus for retention. The process was precisely that described for the bricks made in 2006, except that we used two very slightly smaller moulds, measuring 40 x 18 x 14 cm. We preferred not to make significantly smaller bricks but to keep to a more or less standard size that would be better for rebuilding the walls of the baulks.

As Foss and Timpson noted, the site is located in sandstone that was loosely cemented by carbonates and bedrock was easily dug in most cases, though some strongly cemented beds occurred at points. In this final reconstruction of the tumulus, we decided to replace the backfill directly onto the bedrock of the site, without any intervening geo-textiles or plastic sheeting.

The reconstruction of the Lofkënd tumulus represents one of the few monuments of this type to have been rebuilt

DO NOT COPY

DO NOT COPY

and restored to its landscape. Elsewhere in Albania, the only other burial tumulus to have received any attention of this sort is the tumulus of Kamenicë in the Korçë Basin in southeast Albania. Unlike Lofkënd, the Kamenicë tumulus had a substantial structure of stone rings for the earlier burials of the Early Iron Age, and an even more considerable stone-constructed extension for the later, post-seventh-century B.C., tombs. Given the size and nature of the funerary architecture, the decision was taken to prepare the Kameniçë site as an open-air museum accessible to the public, and under the direction of Lorenc Bejko, the site was fenced, the stone-constructed elements of the tumulus were stabilized and conserved, a water channel was dug to divert rain-water away from the archaeological remains, and a visitor center was built, housing an overview of the excavation and a history of tumulus excavations, as well as replicas of the finds from the tumulus (the site was inaugurated and the museum was opened to the public in June 2007).

Perhaps the largest tumulus to have been "reconstructed," and certainly the most elaborate and expensive undertaking of its type, was the construction of the massive crypt and museum, together with the reconstruction of the tumulus above it, at the site of the royal tombs of the late fourth century B.C. at Vergina in northern Greece, including the tomb considered by some scholars to be that of Philip II, the father of Alexander the Great. This massive undertaking, initiated in 1983 and finally completed in July of 1993 when the site and museum were open to the public, with a total project cost of 7.02 million US dollars, involved the construction of a crypt to cover the substantial stone-built monuments, including the "royal tomb," the "tomb of the prince," the "tomb of the free-standing columns," the "tomb of Persephone," as well as the Heroön. The reconstructed tumulus-cum-museum at Vergina not only protects the tombs and other ancient constructed monuments, it also houses the extraordinary finds from these rich burials, and provides access to thousands of people who visit the site annually.

In contrast to both Vergina and Kamenicë, the dearth of architectural remains at Lofkënd meant that once our tumulus was excavated, the only thing visible was the bedrock ridge on which the mound was built. There was nothing of the substantial stone-constructed funerary architecture of Kamenicë, not to mention the spectacular late Classical and early Hellenistic monuments of Vergina. Our dilemma was, therefore, a much simpler one: how to restore a once conspicuous mound to its landscape?

Conclusions

As Nicholas Stanley-Price notes: "In the long history of archaeological excavation in the Mediterranean region, issues such as site preservation, presentation to the public and management have tended to be addressed after the fieldwork has finished. By contrast, contemporary thinking would stress that they need to be considered in advance of any fieldwork, and especially in advance of the use of any destructive technique such as excavation."

To be sure, our reconstruction of the Lofkënd tumulus is little more than a representation, a pale simulacrum of the original that had withstood the test of time for over two and half millennia until archaeology removed it from its landscape. But to leave this landscape to posterity without the tumulus was a decision we could not take. Moreover, our solution to the problem of reconstructing the tumulus may not have been the best under the circumstances, and we are sure that alternative methods may have resulted in a better constructed and enduring feature. Nevertheless, our earth tumulus reuses all the original soil of the mound (minus the cultural and anthropological remains) – the same soil used for both the mud-bricks and the backfill – together with local additives (straw and water). The excavated soil of the tumulus, together with the various stones found during the excavation of the mound, was recontextualized: no new or foreign material was introduced, and the only cost was labor and time. Once the undergrowth takes hold, the tumulus should not require future conservation or maintenance: the result is sustainable.

Consequently, anyone traveling on the main road between Fier and Tepelenë – indeed, what is still today, though perhaps not for long, the main road between Albania and Greece – will continue to notice the small but prominent mound that has taken the name of Lofkënd, located in the Mallakastër Hills on the north side of the road between Patos and Ballsh.

Emin RIZA

MONUMENTET E KULTURËS DHE PROBLEMATIKA E SOTME E VLERËSIMIT TË TYRE

DO NOT COPY

Hapësirat shqiptare në shekuj kanë pësuar tkurrje të vazhdueshme, apo siç shprehet Prof.E.Çabej "trojet shqiptare janë troje restriksioni". Në këto hapësira etnosi i njëjtë treemërsh iliro-arbëresho-shqiptar ka jetuar, gjithë duke ndërtuar vijueshëm, për të përmbushur kërkesa jetësore dhe kulturore. Shumë prej këtyre ndërtimeve, për arsye funksionale, përkushtimi ndaj besimit fetar, si dhe respektit të bashkëlindur për dëshmitë e së kaluarës, ruhen sot e kësaj dite. Pas Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri u shfaq përkujdesja e institucionalizuar për këto vlera, e cila në pak vite arriti përfundime të prekshme madhore në fushën e vlerësimit të monumenteve, të kuptuar si bashkësia e gjurmimit, dokumentimit, mbrojtjes, studimit, restaurimit dhe propagandimit.

Monumentet shqiptare, sepse të ndërtuar prej shqiptarëve për shqiptarët, përfshijnë një hapësirë kohore tepër të gjerë, që prej muzgut të historisë dhe deri në ditët tona, dhe një mori gjinish ndërtimore, duke pasur brenda tyre zhvillime të qarta tipologjike dhe trajtimi tekniko-arkitekturor. Shumësia e këtyre ndërtimeve, në rritje të pareshtur, shpjegohet me pozicionin e veçantë gjeografik të trojeve shqiptare, si dhe vitalitetit të etnosit që i banoi këto troje. Ashtu si mbarë kombet edhe kombi shqiptar u përfshi natyrshëm dhe pa asnjë kompleks në rrymat e mëdha kulturore të kohëve, duke përfshirë dhe atë ndërtimoren. Të ashtuquajturat arkitekturat e mëdha grekolashta, romake e bizantine, përfshinë edhe trojet shqiptare. Lidhur me këto rryma arkitekturore, duhet të kemi parasysh se ato i referoheshin thuajse kryesisht ndërtimeve të kultit dhe atyre shoqërore, duke cekur vetëm shkarazi arkitekturën e banesës, e cila rrallë konsiderohet vetëm në arritjet e saja madhore. Së dyti, identifikimi i tipareve arkitekturore me kufijtë e perandorive të mëdha, në të kaluarën është inadekuat. Në këtë kontekst, mendojmë se duhet folur për arkitekturë shqiptare në periudhën e përfshirjes së saj në hapësirat e perandorive romake, bizantine etj. Veçantitë e qarta të arkitekturës shqiptare, ashtu si të mbarë atyre kombëtare shfaqen më qartazi në arkitekturën e banesës dhe veçanërisht atyre të shtresave të mesme, programi i të cilave shpreh dukshëm mënyrën e jetesës, pasqyruese e kushteve ekonomiko-shoqërore. Përkundrazi ndërtimet e kultit kanë një programim të rreptë funksional dhe për pasojë kompozicional, duke i lënë më shumë hapësirë trajtimit arkitekturor. Edhe ndërtimet inxhinierike shfaqen me tipizim të spikatur për arsye të repertorit të kufizuar teknik, në të cilin deri vonë dalloheshin sistemet kollonë-tra dhe ato hark-qemer-kupolë, të parët zotërues në arkitekturën e emërtuar greke dhe të dytët në atë romake. Evolucioni i fortifikimeve është në bashkëpërputhje me atë të armëve të luftimit. Përfundimisht arkitektura shqiptare, gjithë duke qenë e tillë, ka jetuar në kontekste më të gjera kulturore, duke përvetësuar prej tyre atë që e quante racionale, pra në thelb, të bashkëpërputhshme me kushtet jetësore të periudhave të ndryshme.

Veprimtaria ndërtuese e shqiptarëve, e cila është cilësuar e "një pasurie të pakrahasueshme", prej Drejtorit të Përgjithshëm të UNESKO-s, Kaishiro Matsura, i përket arealit ballkanik dhe më gjerë, atij europian. Ashtu si përgjithësisht, në vendet ballkanike, veprimtaria vlerësuese e monumenteve në Shqipëri zë fill pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa në planin thjesht juridik-kjo veprimtari shfaqet shpejt, pas shpalljes së Pavarësisë së vendit, më 1912.

Veprimtaria vlerësuese e monumenteve të palëvizshëm në Shqipëri, fillon natyrshëm me vënien në mbrojtje të vlerave të rëndësishme historiko-kulturore, e cila lidhet me listën e parë të monumenteve të vitit 1948, e cila vinte në mbrojtje 107 vepra, kryesisht fortifikime dhe ndërtime kulti. Më pas,

DO NOT COPY

veçanërisht pas krijimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës, më 1965, veprimtaria gjurmuese dhe e vënies në mbrojtje të veprave përfaqësuese, të trashëgimisë kulturore të paluajtshme në këmbë, apo në gjendje rrënojë, dalë shpesh në dritë prej gërmimesh arkeologjike, dendësohet ndjeshëm. Monumentet e rinj, i përkisnin hapësirave të gjera kohore dhe një larmie të gjerë gjinore, duke u mbështetur në tre kritere kryesore, vlerat tipologjike, shkallën e autenticitetit dhe vlerat arkitekturore. Për t'u theksuar është vendi i rëndësishëm që iu dha vlerësimit të arkitekturës popullore, thuajse tërësisht e gjinisë së banesës qytetare dhe fshatare. Kjo kategori ndërtimore, u vlerësua si në njësi të veçanta, ashtu edhe në ansamble, duke kulmuar me Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, të vëna në mbrojtje që në vitin 1961.

Veprimtaria restauruese, mbi parimet e njohura ndërkombëtarisht, ka ndjekur atë të vënies në mbrojtje, duke u rritur dhe thelluar me ritme të shpejta. Kjo veprimtari është paraprirë dhe ka shoqëruar atë restauruesen, me dokumentimin e gjendjes së monumenteve, grafik, fotografik dhe përshkrimor.

Veprimtaritë ligjore për kodifikimin e vlerësimit të monumenteve dhe ato të propagandimit me përbërësin thelbësor, botimet shkencore dhe ato popullore, kanë pasur arritje të rëndësishme. Siç do të trajtojmë më tej, fushat e mësipërme, kanë nevojë për t'u ridimensionuar në përputhje me gjendjen e re, nga disa pikëshikime.

Tashmë, madje që gjatë gjysmës së parë të shekullit të kaluar, parimet e mbarështrimit të veprimtarisë komplekse të emërtuar vlerësim monumentesh, kanë arritur nivelet e duhura profesionale të karakterit të parimeve dhe metodikës së zbatimit të tyre. Të vështruara me realizëm, si pasuri e mbarë njerëzimit, këto parime në karakterin e tyre, të themi ndërkombëtar, nuk përjashtojnë, por nënkuptojnë natyrshëm, qenien e veçantive me karakter kombëtar edhe në fushën e vlerësimit të monumenteve. Këto veçanti, për arsye specifikash historiko-kulturore, pasqyrohen në mënyrën e zbatimit të parimeve të restaurimit, pa përjashtuar edhe interpretime që kufizojnë, apo zgjerojnë parime të veçanta. Në përgjithësi, institucionet e ngarkuara me vlerësimin e monumenteve në Shqipëri, janë mbështetur fort mbi Kartën Ndërkombëtare të Konservimit dhe Restaurimit të Monumenteve dhe Ansambleve Monumentale, të miratuar në Kongresin II Ndërkombëtar të arkitektëve dhe teknikëve të monumenteve historike, mbledhur në Venecie prej 25-31 maj 1964, në të cilin mori pjesë edhe një delegacion shqiptar. Ky dokument themelor për restaurimin, apo "monument për monumentet", sipas cilësimit lapidar të Prof. Xhevat Erderit, dy herë drejtor i ICCROM-it, ruan sot e kësaj dite vlerat e veta, sepse paraqet parime të patjetërsueshme të bazuara në vlerësimin e monumenteve si dëshmi historiko-kulturore. Aktet shqiptare të fushës si "kritere për restaurimin e monumenteve kulturore të arkitekturës dhe arteve", miratuar më 10.02.1986, si dhe rregulloreve për problematika të veçanta të fushës, kanë ndjekur kriteret e njohura ndërkombëtare, duke shfaqur në to edhe veçantitë e rastit shqiptar. Monumentet shqiptarë, në sajë të identifikimit dhe përkujdesjeve komplekse për to, janë bërë faktor aktiv i jetës kulturore të vendit. Në frymën e shëndoshë të konsiderimit të tyre pasuri e njerëzimit, siç vërehet edhe në Raportin e misionit të UNESCO-s për Shqipërinë : "Sot është urgjente që të ndërgjegjësohemi se është e rëndësishme të ruhet kjo pasuri, në mënyrë që t'i transmetohet brezave të ardhshëm si pjesë përbërëse e pasurisë universale të njerëzimit". Nga sa më sipër, kuptohet se përkujdesja e duhur, si në shkallën e përkushtimit, ashtu dhe atë të profesionalizmit, duhet të arrijë nivele të barasvlefshme me vlerat e monumenteve shqiptarë. Në këtë kontekst, duke marrë në konsiderim arritjet e derisotme në këtë fushë dhe kufijtë më lartsynuese, është e domosdoshme që gjithë duke pasur udhëheqëse parimet e njohura konceptuale dhe metodike, në planin praktik të synohet një rritje cilësore në mbarë veprimtarinë me monumentet.

Kuadri restaurator

Ashtu si në çdo fushë të veprimtarisë njerëzore edhe në atë të vlerësimit të monumenteve, faktori njerëzor, në kuptimin e atij profesional, është thelbësori për arritjen e synimeve. Qenia e parimeve konceptuale dhe metodike të fushës, është një premisë e domosdoshme, por e pamjaftueshme, nëse nuk përthithet prej specialistësh të përgatitur dhe më tej të përkushtuar për vlerësimin e monumenteve. Rruga për formimin e kuadrit restaurator, veçanërisht për vende të vegjël si yni, në të cilët mungojnë institucione mësimdhënie të kësaj fushe,

paraqet një problematikë të vërtetë. Formimi fillestar, në universitete të specializuara jashtë vendit, natyrisht është i mirëpritur, por praktikisht i rrallë, prandaj rrugët e vetëformimit profesional mbeten kryesoret. Praktika e brezit të parë të restauratorëve shqiptarë, njëherazi, me rrugë të natyrshme edhe studiues të mirëfilltë të gjinive të monumenteve që restaurojnë, është padyshim një përvojë për t'u mbajtur parasysh sepse rezultoi thelbësisht rezultateve. Megjithëkëtë nëse parimet e restaurimit, besojmë se tashmë kanë arritje thuajse të patjetërsueshme në thelbin e tyre, zgjerimi i dijeve profesionale të restauratorëve dhe rrugët për arritjen e këtij zgjerimi, besojmë se do të mbeten vijueshëm një proces në rritje.

Në gjendjen e sotme të realitetit shqiptar të fushës, duke përfshirë edhe hapësirën e Kosovës, banuar prej të njëjtit popull dhe bartës të së njëjtës gjuhë dhe kulturë, formimi profesional i brezit të ri të restauratorëve paraqet synimin e vetëm garantues për të ardhmen e ruajtjes së këtyre vlerave të papërsëritshme historiko-kulturore.

Formimi i kuadrit restaurator, fillon që me pranimin e kandidatëve që kërkojnë të punojnë në fushën e vlerësimit të monumenteve. Së pari, është e domosdoshme që restauratorët e monumenteve të arkitekturës të jenë arkitektë, inxhinierë ndërtimi, apo arkeologë, ndërsa ata të fushës së arteve të kenë kryer shkollë të lartë arti, apo të jenë kimistë. Që në krye, restauratorët e arkitekturës do të ndahen sipas tre fushave të monumenteve, ndërtimeve mbrojtëse, atyre të kultit dhe ndërtimeve popullore, thuajse sinonim i banesës. I interesuari për punësim, sipas formimit universitar të përmendur, duhet të pranohet në institucionin shtetëror të ngarkuar për vlerësimin e monumenteve, pas lidhjes së një kontrate trevjeçare. Gjatë kësaj periudhe, përveç detyrimesh të tjera, i punësuari me kontratë duhet të japë provim pasuniversitar të Teorisë së restaurimit, Historisë së arkitekturës shqiptare dhe gjuhës së huaj. Pas periudhës tre vjeçare, sipas rastit punonjësi, punësohet përfundimisht ose jo. Restauratorët e rinj, duhet të bashkëpërfshihen ndjeshëm në veprimtarinë përzgjedhëse për ndërhyrjet vjetore për restaurim, si dhe të jenë bashkautorë në projekte të ndryshme restaurimi, së bashku me restauratorë me përvojë. Specializimet brenda dhe jashtë vendit, duke ndjekur kurse të ndryshme profesionale, apo bashkëpunime me specialistë të huaj për ndërhyrje restauruese janë rrugë frutdhënëse. Është e rëndësishme të theksojmë se krahas specialistëve me arsim të lartë, është e domosdoshme që në institucionet që merren me vlerësimin e monumenteve, të punojnë kuadro të mesme, tepër të nevojshëm për një veprimtari sa më efektive në fushën e monumenteve.

Lidhur me këtë temë, për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së institucioneve shtetërore të ngarkuara me vlerësimin e monumenteve, është kusht i domosdoshëm që drejtuesit e këtyre institucioneve dhe sektorëve përkatës të restaurimit të jenë me të njëjtin formim profesional bazë si të restauratorëve.

Shpallja e monumenteve

Ashtu si në mbarë vendet edhe në Shqipëri, shpallja e monumenteve, pra identifikimi i tyre nëpërmjet përzgjedhjes në bashkësinë e trashëgimisë ndërtimore, sipas kritereve tipologjike, shkallës së autenticitetit, vlerave arkitektoniko-artistike dhe atyre historiko-kulturore në përgjithësi, ka një fillesë. Gjatë saj, kryhet një veprimtari e gjerë, mund të themi gjithëpërfshirëse, duke hedhur bazat e një dukurie të re kulturore, e cila intuitivisht, apo për shkaqe të tjera ka bërë vepruese ruajtjen e dëshmive ndërtimore të së kaluarës. Kështu në Shqipëri, në vitin 1948, u shpall lista e parë e monumenteve. Ajo u pasua prej një veprimtarie sistematike, veçanërisht pas viteve 1965 me krijimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës. Vënia në mbrojtje e vlerave ndërtimore dhe atyre artistike pjesë e tyre, është një proces i rëndësisë së veçantë, i cili parakupton përgatitje të gjerë dhe të thellë profesionale të gjurmuesve, e cila natyrshëm lidhet me qenien e studimeve për dukuritë ndërtimore dhe ato historike në përgjithësi. Në rastin shqiptar dhe jo vetëm në atë, për arsye të kuptueshme, në momentin apo fazën e parë të gjurmimit dhe përzgjedhjes së ndërtimeve për t'u cilësuar monumente, veprimtarët e fushës, përgjithësisht fillestarë, nuk mund të kryenin veprimtari shteruese si në planin numerik dhe atë profesional.

Vënia në mbrojtje e monumenteve, madje dhe e kundërta është një proces i pandërprerë, si për shkak të gjurmimeve të reja, përgjithësisht më të gjera dhe më të thelluara, daljes në dritë të veprave prej gërmimesh arkeologjike dhe përfshirjes në vlerat historiko-kulturore të ndërtimeve të reja, dëshmi autentike të epokës që i

DO NOT COPY

DO NOT COPY

krijoi. Kuptohet se vënia në mbrojtje e monumenteve parakupton si monumentet e veçuar, ashtu edhe ansamblet dhe Qendrat historike në qytet dhe në fshat. Rritje e nivelit profesional të profesionistëve të fushës problematike të vlerësimit të monumenteve, drejtpërdrejt ndikon në përmirësimin e veprimtarisë për vënien në mbrojtje të monumenteve, ashtu si edhe të mbarë veprimtarive pasuese.

Dokumentimi i monumenteve

Dokumentimi i monumentit, është një proces i vazhdueshëm i paraqitjes me mënyra dhe thellësi të ndryshme i gjendjes së tij në një moment të caktuar kohor. Dokumentimi, paraqet kështu zhvillimin në kohë të monumentit, karakteristikat e tij tipologjike, teknikat dhe materialet e ndërtimit, ndërhyrjet restauruese dhe botimet mbi të. Nëse vetë monumenti në rrjedhë të kohës, natyrshëm pëson ndryshime të vogla dhe progresive, apo edhe të rëndësishme për shkaqe që lidhen me faktorë të patjetërsueshëm natyrorë ose me veprimtarinë, apo pakujdesinë njerëzore, dokumentacioni synon dhe arrin të përjetësojë gjendjen e monumentit në periudha të ndryshme kohore.

Dokumentacioni ndahet në dy grupe, atë të gjendjes së monumentit dhe të ndërhyrjeve restauruese, apo të atyre në hapësirën përreth tij, pa prekur drejtpërdrejt vetë atë. Dokumentacioni i gjendjes fikson me mënyra të ndryshme gjendjen ekzistuese të monumentit në kohën e kryerjes së tij. Ai përgjithësisht lidhet me dokumentimin themelor, që kryhet fill pas vënies në mbrojtje të veprës, duke u pasuar vazhdimisht me pasqyrimin e ndryshimeve për rrethanat e natyrshme të vetëkonsumimit të veprës, apo rrethanave të tjera. Grupi tjetër i dokumentacionit, përfshin atë të ndërhyrjeve restauruese në monument.

Të dy grupet e mësipërme, përfshijnë dokumentacionin grafik, fotografik dhe përshkrimor. Krahas, në arkivin e monumenteve, ruhen të dhëna mbi botimet, apo përmendjet në vepra të ndryshme të monumentit, si dhe të dhëna gojore të mbledhura prej subjektesh të ndryshëm. Dokumentacioni grafik, përfshin planin e përgjithshëm, planimetri, pamje, prerje, hapje brendish, hollësi të ndryshme etj. Dokumentacioni fotografik, duhet të jetë sa më i gjerë, që prej pamjeve të përgjithshme e deri në hollësi. Në këtë lloj dokumentacioni përfshihen edhe fillimet dhe teknikat e reja të fiksimit pamor. Dokumentacioni përshkrues saktëson konsiderata mbi fazat e ndërtimit të monumentit, karakteristikat tipologjike dhe teknike. Lidhur me ndërhyrjet restauruese, ai përfshin gjendjen teknike, mënyrën dhe radhën e këtyre ndërhyrjeve si dhe preventivin.

Dokumentacioni i kryer deri më sot me metodat tradicionale, i cili ruhet në arkivin e monumenteve të Institutit të Monumenteve të Kulturës, duhet pasuruar me të dhëna të reja, mbi ndryshimet eventuale në gjendjen e monumenteve. Krahas është i domosdoshëm dixhitalizimi i këtij dokumentacioni, për përparësitë e njohura që sjell ai. Hartimi i dokumentacionit të përmbledhur për çdo monument, apo bashkësi monumentesh, është i domosdoshëm që të hartohet dhe të lidhet në rrjetin e internetit për t'u bërë i arritshëm prej specialistëve të fushës, brenda dhe jashtë vendit, në dobi të thellimit të studimeve për këto vlera në vetvete dhe në bashkësinë e tyre kohore dhe tipologjike.

Njohja e gjendjes së monumenteve

Veprat ndërtimore të vëna në mbrojtje për vlerat e tyre arkitekturore dhe sipas rastit edhe artistike, siç ndeshim shpesh në ndërtimet e kultit, për vetë natyrën e tyre duhet të jenë të përfshira në përkujdesjet e vazhdueshme për njohjen e gjendjes së tyre. Kjo njohje kryhet në dy nivele, vazhdueshëm prej të ngarkuarish me këtë detyrë, përgjithësisht kujdestarë monumentesh dhe nëpërmjet vëzhgimesh të herëpashershme prej specialistëve të fushës, anëtarë të sektorëve përkatës të Institutit të Monumenteve të Kulturës. Njohja e gjendjes së monumenteve është kusht i domosdoshëm për vlerësimin e tyre, sepse kështu ndërhyrjet mirëmbajtëse dhe restauruese kryhen në kohën e duhur, duke ndërprerë dëmtimin e mëtejshëm të vlerave të papërsëritshme të monumenteve. Në gjendjen e sotme, rrjeti i kujdestarëve është shkrirë dhe kontrolli i gjendjes së monumenteve prej sektorëve përkatës ka arrirë në shkallën më të ulët. Për arsyet e mësipërme është e domosdoshme ringritja e këtij rrjeti dhe dendësimi i ekspeditave kontrolluese të gjendjes së monumenteve, kusht i patjetërsueshëm për të arritur në planifikime të drejta për ndërhyrje restauruese.

Planifikimi i ndërhyrjeve restauruese.

Siç përmendëm, planifikimi i ndërhyrjeve të shkallëve të ndryshme në monumente, kryesisht për ruajtjen dhe nxjerrjen në pah të vlerave autentike është garanci për kryerjen e funksionit të pazëvendësueshëm të tyre. Ndërhyrjet sistematike në monumentet përgjithësisht konsiderohen, duke pasur parasysh vlerat historiko-kulturore të tyre, gjendjen teknike, funksionin e sotëm, shkallën e vizitueshmërisë etj.

Theksimi i ndërhyrjeve të vazhdueshëm mirëmbajtëse të cilat përgjithësisht janë të karakterit mirëmbajtës, është i një rëndësie parësore për ruajtjen e vlerave të monumenteve, madje do të thoshim thelbi i restaurimit. Sa më sistematike të jenë ndërhyrjet mirëmbajtëse, aq më shumë shmangen ndërhyrjet e gjera restauruese, të cilat, për vetë natyrën e tyre, duke prekur disi gjerë monumentin, bartin vetëm rreziqe të prekshme për cenim, apo tjetërsim të vlerave origjinale të monumentit.

Mirëmbajtja e vazhdueshme e monumenteve, sipas treguesve prej rrjetit të kujdestarëve dhe kontrolleve të vazhdueshme të gjendjes së këtyre vlerave, prej specialistëve të sektorëve përkatës të Institutit të Monumenteve të Kulturës, nuk mund të zgjidhë problemin e vërtetë të ruajtjes së këtyre vlerave, pra të mënjanojë ndërhyrjet restauruese. Planifikimi i këtyre ndërhyrjeve, shfaqet i një rëndësie parësore për të ardhmen e monumenteve, duke u vendosur radha e ndërhyrjeve në kohë dhe në shkallën e ndërhyrjes. Natyrisht, rëndësi të veçantë fiton mënyra e miratimit të planit përfundimtar të ndërhyrjeve restauruese, e cila arrihet në muajt e fundit të vitit paraardhës. Në këtë drejtim vitet e fundit janë shfaqur shmangie të rëndësishme prej procedurës normale, e cila thuajse garanton shpërndarjen e duhur të përkujdesjeve mirëmbajtëse dhe restauruese në morinë e monumenteve, shpesh në gjendje problematike.

Ndërhyrjet mirëmbajtëse dhe restauruese, dallohen thelbësisht prej njëra-tjetrës. Të parat përgjithësisht shoqërohen vetëm me një fond, i cili gjatë vitit pasardhës shpërndahet sipas nevojës prej Drejtorive Rajonale, me miratimin e Sektorëve përkatës të Institutit të Monumenteve të Kulturës, duke u shoqëruar përgjithësisht prej relacionit teknik dhe preventivit, pa përjashtuar rastet e hartimit të projekteve. Ndërhyrjet restauruese shoqërohen me projekt, relacion teknik dhe preventiv.

Propozimet për ndërhyrje restauruese në monumentet vijnë prej Drejtorive Rajonale të Monumenteve, organeve të pushtetit lokal, individëve, apo organizatave të veçanta dhe natyrisht prej sektorëve përkatës të Institutit të Monumenteve. Subjektet, apo individët, propozimet e tyre për nevojën e ndërhyrjeve restauruese ia drejtojnë Institutit të Monumenteve. Këto kërkesa, shqyrtohen në sektorët përkatës të Institutit, duke u bashkëpërfshirë me propozimet e vetë këtyre sektorëve. Prej sektorëve, ky projekt –plan kalon në Këshillin shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe përfundimisht duhet të miratohet në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve. Në vitet e fundit, po kristalizohet një praktikë e dëmshme, e cila në bazën e saj ka marrjen e kompetencave, për këtë çështje thelbësore për të ardhmen e monumenteve shqiptare, prej Drejtorisë së Trashëgimisë kulturore në Ministrinë përkatëse. Ky deformim, tepër i dëmshëm, i cili në thelbin e tij ka mënjanimin e kompetencës profesionale të një institucioni të ngritur posaçërisht për veprimtarinë komplekse të vlerësimit të monumenteve, duhet të mënjanohet menjëherë, pa përjashtuar të drejtën e Ministrisë s Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për të vendosur ndryshime të diktuara prej synimeve të politikave kulturore.

Ndërhyrjet restauruese

Një herë e përcaktuar radha e ndërhyrjeve restauruese, shoqërohet me dy procese të një rëndësie madhore, atij të hartimit të projekteve të restaurimit dhe zbatimit të këtyre punimeve. Në gjendjen e sotme këto dy procese kanë pësuar ndryshime, do të thoshim thelbësore, të cilat në vend që të përmirësonin efikasitetin e ndërhyrjeve restauruese në disa këndshikime e kanë cënuar atë.

Projektimi në fushën e ndërhyrjeve restauruese, parakupton njohjen e thellë të gjendjes së monumentit që do t'i nënshtrohet restaurimit, në planin tipologjik, vlerave arkitekturore dhe teknikës së ndërtimit, madje edhe të mbarë gjinisë ndërtimore në të cilën ai bën pjesë. Natyrisht krahas, restauratori duhet të njohë dhe të ketë përvetësuar parimet e restaurimit. Para vitit 1990, profesionistët e fushës kishin të drejtën përjashtuese për të projektuar ndërhyrje restauruese, ashtu si dhe organizmat e specializuara në përbërjen e Institutit të Monumenteve për zbatimin e ndërhyrjeve restauruese.

DO NOT COPY

Fotokopje

Në gjendjen e sotme, projektimi i ndërhyrjeve restauruese kryhet prej specialistëve të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe atyre të licensuar, sipas rregullave në fuqi, për fushën e restaurimit të monumenteve të arkitekturës dhe artit.

Të gjithë projektet për të qenë të zbatueshëm, duhet të miratohen prej sektorëve përkatës të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Këshillit shkencor të tij dhe përfundimisht prej Këshillit Kombëtar të Restaurimeve. Kjo zgjidhje është një garanci e prekshme e hartimit të projekteve në përputhje me kriteret e restaurimit. Duhet vënë në dukje se në praktikën e dhënies së licensave të projektimit, duhet të ketë më shumë përpjekje për zbatimin sa më rigoroz të kërkesave të institucionalizuara në rregulloret përkatëse.

Lidhur me zbatimin e punimeve restauruese, e kaluara, pra periudha deri në vitet 1990, gjatë së cilës punimet e mirëmbajtjes dhe restaurimit kryheshin vetëm prej institucioneve në përbërje të Institutit të Monumenteve ishte me përparësi tejet të qarta. Synimi për arritjen e standardeve të restaurimit, larg çdo synimi për përfitime materiale, rritja e vazhdueshme e nivelit profesional të stafit të projektuesve, ndjekës të zbatimit të punimeve restauruese, e atij teknik dhe e mjeshtrave të ndërtimit, punonjës të institucionit shtetëror të ngarkuar me vlerësimin e monumenteve, kanë qenë garanci të vërteta për kryerjen e procesit të restaurimit në nivelet e duhura. Është rasti të përmendim se sistemi i mësipërm, ka qenë realizimi i prekshëm i së vërtetës së procesi i restaurimit kurrsesi nuk mund të njësohet vetëm me projektimin sipas kërkesave të fushës dhe se projekti i restaurimit përfundon me përfundimin e punimeve. Përkundrazi sot, thuajse të gjitha punimet e restaurimit zbatohen prej ndërmarrjesh ndërtimi të zakonshme të cilat kanë në përbërje vetëm një profesionist të licensuar, pesha e të cilit kuptohet se është minimale në institucionin, i cili ka, natyrshëm synim kryesor fitimin. Më tej këto ndërmarrje ndërtimi përzgjidhen me sistemin e tenderimit, i cili në bazën e tij ka kërkesat më të ulëta financiare për kryerjen e restaurimit dhe aspak kryerjen e tyre sipas kritereve të restaurimit. Për shumë arsye të tjera, tenderimi është një mënyrë krejtësisht në kundërshtim me synimin madhor për ruajtjen e vlerave të monumenteve. Të qenit e autorit të projektit supervizor dhe qenia e kolaudatorit gjithashtu profesionist i fushës së restaurimit, nuk mund të shmangin rreziqet e prekshme të kësaj mënyre organizimi. Duke qenë ruajtja e vlerave të monumenteve thelbi i veprimtarisë për vlerësimin e tyre, duhej që ligji dhe aktet e tjera nënligjore dhe normative në përgjithësi, t'i shërbenin qëllimit të mësipërm. Edhe prej konsideratave thjesht ekonomike, del qartë se ky sistem është i dëmshëm, kur për arsyet e njohura rreth 40% e fondeve për restaurim i hiqen shumës së caktuar për këtë veprimtari. Kthimi në sistemin qartësisht të arsyeshëm në shumë plane, sepse thellësisht në shërbim të vlerësimit të monumenteve, në të cilin punimet e restaurimit kryhen prej institucionit të ngarkuar për mbrojtjen e monumenteve është i domosdoshëm, madje thellësisht i domosdoshëm për t'ia hequr këtë fushe të veprimtarisë shkencore diletantizmit dhe shpërdorimeve.

Teknologjia e ndërhyrjeve restauruese

Përparimi në fushën e materialeve të ndërtimit, që pasqyrohet në materialet e rinj dhe rritjen e cilësisë së materialeve tradicionale, krahas zhvillimit të shpejtë të teknologjisë së realizimit të ndërhyrjeve restauruese, sot paraqitet një faktor i rëndësishëm pozitiv. Për arsyet e njohura, këto materiale dhe këto teknika, shpesh të zbatueshme nëpërmjet pajisjesh të veçanta, ende janë pak të njohura dhe për pasojë pak të zbatueshme në realitetin shqiptar të restaurimit. Veçanërisht e ndjeshme shfaqet kjo gjendje në fushën e gjerë dhe problematike të restaurimit te veprat e artit, kryesisht piktura murale, ikona, punime në dru, gurë etj. Kujdes i veçantë i duhet kushtuar përdorimit të materialeve të rinj në këtë fushë, sepse shumë prej këtyre materialeve janë të panjohur sa duhet në llojin e tyre dhe ajo që është më e rëndësishmja të panjohur në veprimin mbi veprën e artit mbi të cilën aplikohet. Po të kemi parasysh se këto materiale dhe teknika aplikimi janë eksperimentuar mbi vepra në hapësira jashtëshqiptare, pra mbi vepra të ngjashme, por aspak krejt të njëjta me ato të Shqipërisë, përsa i përket teknikave të pikturës dhe llojit të ngjyrave, kujdesi duhet të rritet, duke pasur parasysh edhe të vërtetën se shpesh, pasojat eventualisht negative të materialeve të rinj mbi veprën e artit shfaqen vonë, madje mjaft vonë, me pasoja shpesh të pariparueshme.

Centralizmi profesional në fushën e monumenteve

Shpesh termat shprehëse të realiteteve, marrin konotacione konceptesh të tejkaluara dhe të pavolitshme, për të mos thënë të dëmshme. Në këtë kontekst termi centralizëm, në sferën administrative, kundrohet me të drejtë si i papërshtatshëm në sistemin demokratik të administrimit. Konsiderimi gjithëpërfshirës i këtij koncepti, pra, të themi i negativitetit të tij për mbarë sferat e veprimtarisë, besojmë se nuk mund të pranohet. Edhe në këtë kontekst, rastet e veçanta shfaqen dukshëm. Njëri prej tyre është sfera e vlerësimit të monumenteve në rastin shqiptar.

Për dy arsye përplotësuese dhe pikërisht mungesa e kuadrit të duhur restaurues, në numër dhe përgatitje profesionale dhe domosdoshmëria për njësimin e vlerësimit profesional të restaurimit të monumenteve nëpërmjet instancave adekuate si sektorët dhe Këshilli shkencor i Institutit të Monumenteve, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve etj, e bëjnë të nevojshëm centralizmin profesional në fushën e vlerësimit të monumenteve. Edhe faktori hapësinor, pra Shqipëria krahasimisht e vogël, është një rrethanë që e sugjeron centralizmin profesional në fushën e monumenteve.

Me centralizëm profesional, kuptojmë shtrirjen e tij në sferën organizative dhe atë vendimmarrëse për problematikat e monumenteve. Kështu shkëputja e Drejtorive Rajonale të Monumenteve prej Institutit të Monumenteve dhe krijimi i Parqeve arkeologjike, duke qenë të dy këto kategori organizmash, në vartësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, paraqet papërshtatshmëri të dukshme për zbatimin sa më rigoroz të parimeve të restaurimit në të dy fazat, atë të projektimit dhe zbatimit. Centralizmi profesional nuk heq të drejtën e projektimit prej specialistëve të licensuar, me të vetmin kusht që këto projekte të ndjekin instancat e duhura për miratim. Së fundi, centralizmi profesional, tepër i përshtatshëm për rastin shqiptar në këtë periudhë të jetës administrative, nuk do të thotë se ai do të jetë i pandryshueshëm në rrethana të tjera që do të krijohen me zhvillimin e vendit.

Rijetëzimi i monumenteve

Koncepti i rijetëzimit të monumenteve është bashkërendës i vetë atij monument. Shfrytëzimi i monumenteve për qëllime të dobishme, pa cenuar vlerat për të cilat ai është vënë në mbrojtje është parim i njohur i fushës. Në bashkësinë e monumenteve shqiptare, shkalla dhe mënyra e rijetëzimit të tyre varet prej dy faktorësh, së pari gjendjes së tyre, rrënojë apo të shfrytëzueshëm dhe së dyti prej gjinisë së monumenteve. Kuptohet se monumentet, në gjendje rrënoje, kryesisht të dalë në dritë prej gërmimesh arkeologjike, apo të tillë pas rrënimit për shkaqe të ndryshme, mund të rijetëzohen vetëm si vlera historiko-kulturore për t'u soditur, në cilësinë e dokumentit historik. Ndryshe shtrohet çështja me monumentet që ruhen në gjendje të mirë teknike dhe funksionalisht të shfrytëzueshëm. Në këtë kategori të gjerë monumentesh, rijetëzimi kushtëzohet ndjeshëm prej gjinisë së monumenteve. Kështu gjinia e ndërtimeve mbrojtëse, përgjithësisht të ruajtur në gjendje të ndryshme rrënimi, nuk mund të shfrytëzohen për funksionet fillestare. Hapësira të veçanta të këtyre strukturave ndërtimore, pas ndërhyrjeve konsoliduese, apo përmirësimeve të kthyeshme funksionale, mund të përdoren për qëllime të ndryshme, ndër të cilat në radhë të parë qëndron ai i hapësirave të ekspozimit dhe i adaptimit, si mjedise të shfrytëzimit kolektiv për qëndrim të përkohshëm. Monumentet e kultit, për arsye të kuptueshme e ruajnë funksionin të patjetërsueshëm, me përjashtim të 32 vjeçarit, sui generis , në shkallë botërore, kur enverizmi ndaloi ushtrimin e besimit fetar. Ndërtimet shoqërore-inxhinjerike, si ura të vjetra, banjo publike etj, mund të përdoren me kushtëzime, për të mos lejuar dëmtimet e mundshme, ose të jenë shembuj për t'u vrojtuar. Kategoria e banesës, përgjithësisht e shfrytëzueshme në funksion fillestar, me kufizimet e njohura, sipas vlerës së monumentit, për të ruajtur të pa cënuar kompozimin fillestar dhe trajtimin e brendësisë dhe pamjes së jashtme, apo vetëm ruajtjen e volumeve dhe pamjes së jashtme, shfaqet më e qartë në rijetëzimin e saj.

Në gjendjen e sotme, rijetëzimi i monumenteve shfaqet me një farë problematike, lidhur me fuqizimin e të drejtave të pronarëve të monumenteve, pa qenë kjo një pengesë e pakapërcyeshme, sepse legjislacioni në

BOTIMET

fuqi e zgjidh këtë çështje. Hapësirat e rijetëzimit të monumenteve, janë krahasimisht të gjera. Që ky rijetëzim të jetë sa më i dobishëm, ai duhet të plotësojë kushtin themelor të mos cënimit të vlerave të monumenteve.

Turizmi kulturor

Turizmi kulturor në plan europian dhe më gjerë, shfaqet si dukuri e shek. XX. Ai kushtëzohet prej dy faktorësh, atij të rritjes së nivelit kulturor dhe rritjes ekonomike, shtytës dhe realizues të kontaktit me pasuritë historiko-kulturore, në hapësirat kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Shqipëria, potencialet e krijuara pas Luftës së Dytë Botërore për turizmin kulturor, nuk i shfrytëzoi thuajse aspak për vetë shqiptarët, kryesisht për arsye ekonomike, ndërsa aspak për të huajt, për shkak të vetizolimit vetëshkatërrues, një prej parimeve themelore të enverizmit, apo bolshevizmit të skajmë. Në kushtet e sotme, në hapat e para drejt zbatimit të parimeve demokratike, turizmi kulturor vjen si një kërkesë e domosdoshme e bashkëlidhur ngushtas me vlerësimin e monumenteve dhe më tej synimi finalizues i aktit të mësipërm të vlerësimit. Më prekshëm, vlerësimi i monumenteve si dokumenta historiko-kulturore, të shkallës më të lartë të vërtetësisë, një e vërtetë e patjetërsueshme kjo, do të mbetej i parealizueshëm, apo qëllim në vetvete, pa u bërë këto dokumente të njohur për një masë sa më të gjerë të qytetarëve. Turizmi kulturor, shfaqet kështu si realizimi apo rruga drejt realizimit të funksionit të monumenteve si dëshmi e prekshme historike, e cila plotëson, thellon dhe konkretizon njohjen e së kaluarës, premisë e patjetërsueshme për përmirësimin e së tashmes dhe së ardhmes. Krahas, turizmi kulturor, për vetë natyrën e tij bie të ardhura, duke rritur aftësitë mirëmbajtëse dhe restauruese të monumenteve. Por fatkeqësisht ky faktor shpesh merr përparësi dhe në vend të rolit nxitës të turizmit kulturor, shfaqet edhe si bartës i rreziqeve për dëmtimin e monumenteve. Eshtë fjala për ndërhyrje të palejueshme në vlerat e monumenteve nën shkakun dëmtues, për të bërë sa më të kuptueshme vlerat e tyre dhe sa më komod procesin e vrojtimit. Pa i konsideruar këto synime të pa arsyeshme, ato duhen zbatuar me masë, duke qenë kufiri i pakapërcyeshëm atje ku cënohen vlerat origjinale, në çfarëdo forme qoftë. Rreziqet më të prekshme lidhen me synimet rindërtuese, shtesat në kontekstin origjinal për të bërë më komod qëndrimin, apo soditjen e monumentit. Shembujt negativë në hapësirat europiane dhe më gjerë, madje së fundit edhe në Shqipëri i ndeshim qartazi. Prandaj, ashtu si përgjithësisht, çdo dukuri shfaqet me anë pozitive dhe negative, edhe turizmi kulturor, gjithë duke qenë dukuri e domosdoshme, sepse tejet e dobishme, nuk duhet që në asnjë rast të cënojë vlerat e monumenteve, objekt i natyrshëm vizitimi. Arritja e shkallëve më të larta të njohjes së monumenteve, shpesh të ardhur në gjendje rrënoje, si qendrat arkeologjike, ndërtimet mbrojtëse etj, nuk duhet të realizohet me rindërtime, por me mjete grafike, makete dhe botime, të cilat e çojnë më thellë njohjen e monumentit, pa cënuar vlerat e tij autentike, natyrshëm të papërsëritshme.

Propagandimi i monumenteve

Apo më saktë i vlerave të tyre, siç përmendëm më lart, synon të ndihmojë në finalizimin e qëllimit për vlerësimin e monumenteve, duke i bërë ata të afërt në mesazhet e tyre historiko-kulturorë për një masë sa më të gjerë qytetarësh. Sa më e gjerë dhe e kuptueshme të jetë veprimtaria për njohjen e monumenteve, aq më e lehtë dhe efikase do të ishte dhe veprimtaria për vlerësimin e kësaj trashëgimie. Vlerësimi i monumenteve nuk është një çështje thjeshtë profesionale, pra që kryhet prej specialistësh për specialistët, por një veprimtari e gjerë shoqërore, e cila suksesin e saj e ka përherë dhe më të siguruar në përpjesëtim të drejtë me gjerësinë e ndërgjegjësimit mbarëshoqëror për këto vlera. Mbrojtja e monumenteve është në radhë të parë një çështje e rëndësishme shoqërore, e cila në planin shkencor dhe teknik zgjidhet prej specialistëve të fushës.

Në gjendjen e sotme, në vendin tonë, mjetet potencialisht të gjera për propagandimin e monumenteve, as për së largu nuk i shërbejnë synimit për mbarëinformim për vlerat dhe gjendjen e kësaj pasurie, shenjë e prekshme e vlerësimit të pamjaftueshëm të saj. Specialistët e fushës kanë hapësira të gjera për propagandimin e monumenteve, me mjetet e shumëllojshme të informacionit masiv, i cili për vetë karakterin e tij ka akses kapilar në mbarë vendin dhe si i tillë mund dhe duhet t'i shërbejë përhapjes së njohurive shumëplanëshe për këtë pasuri madhore historiko-kulturore.

Do not copy

Botimet në fushën e monumenteve

Veprimtaria shumëplanëshe e cila emërtohet vlerësim i monumenteve, përfshin si fazë përfundimtare botimin e kësaj veprimtarie të karaktereve studimore-restauruese. Veprimtaria botuese në fushën e monumenteve, është veprimtaria themelore për njohjen dhe propagandimin e këtyre vlerave. Ritheksojmë se veprimtaria vlerësuese e monumenteve, në thelbin e saj është veprimtari kërkimore, e cila parakupton përgatitje adekuate profesionale prej kërkuesve të fushës. Theksojmë se restaurimi detyrimisht, sepse natyrshëm, është i paraprirë prej një veprimtarie të vërtetë kërkimore mbi monumentin, si produkt historik, apo me histori, të shprehur në evolucionin e tij kohor në treguesit tipologjik, arkitekturorë dhe teknikë. Në këtë kuptim vlerësimi i monumenteve dhe më ngushtas restaurimi i paraprirë prej studimit, e përfshijnë veprimtarinë restauruese në atë kërkimore. Shkalla e përgatitjes së restauratorëve nuk ka lidhje me të vërtetën e mësipërme, e cila lidhet me thelbin dokumentar të kategorisë monument, i cili urdhërueshëm pret trajtim në hapësirat e fushës kërkimore, për të mos përdorur termin sinonim shkencore. Kuptohet se veprimtaria kërkimore në fushën e monumenteve, detyrimisht duhet të shohë dritën e botimit për dy arsye bashkëplotësuese, atë të bërjes së njohur të përfundimeve të arritura dhe mundësimit për shqyrtim kritik të veprimtarisë subjekt i botimit.

Në bashkësinë e botimeve për monumentet, vendin kryesor e zënë botimet e veprimtarive kërkimore, në plan thjesht arkitekturor, apo atë restaurues, i cili vetiu përfshin vlerësimin arkitekturor.

Botimet e karakterit kërkimor, përbëjnë bazën e shëndoshë, sepse në përputhje me të vërtetën, për të kaluar në botime popullarizuese, ato me thelb figurativ, si dhe botime të tjera propaganduese më të pranueshme për të interesuarit e gjerë, pa formim të ngritur kulturor.

Në gjendjen e sotme, botimet në fushën e monumenteve në Shqipëri, për t'i emërtuar realitetet me prirje objektiviste, do të thoshim janë në nivele mjaft të ulëta. Komercializmi, kjo thikë me dy presa e shoqërive të sotme, i cili në thelbin e tij ka fitimin, nuk e sheh fushën e botimeve të vlerave të monumenteve në Shqipëri ende fitimprurëse. Në këtë kontekst, shoqëria me shtetin e saj, duhet të bëjnë detyrën e tyre për të nxitur dhe subvencionuar botimet e veprimtarisë kërkimore-vlerësuese për monumentet.

Vlerat historiko-kulturore në hapësirën shqiptare

Përfshirja e trojeve shqiptare në hapësirat e perandorisë romake dhe asaj turke, pa cënuar thelbësisht njësinë etnike të shqiptarëve dhe për pasojë të shprehura, krahas gjuhës, në trashëgiminë historiko-kulturore, është një dukuri e njohur. Në fillim të shekullit XX, në vazhdën e përpjekjeve për mëvetësi shtetërore në trojet e veta, shqiptarët u ndeshën me përpjekjet sa sistematike aq dhe kundër çdo të drejte të kodifikuar, apo morale të fqinjëve për zgjerime, duke përvetësuar troje shqiptare, madje me synime për zhbërje të Shqipërisë. Në këtë veprimtari unikale në hapësirën europiane, lakmitë e veshura me mashtrime trashanike pseudohistorike, gjetën mbështetje në partnerë të fuqishëm, të cilët kinse për të arritur baraspesha politiko-ushtarake, ndanë sa mundën troje shqiptare duke rrethuar Shqipërinë politike me një të dytë, madje më të gjerë. Në këtë të fundit trashëgimia historiko-kulturore e shqiptarëve u gjend përpara dy qëndrimeve barabar të papranueshme, sepse antihistorike, atë të injorimit dhe ç'identifikimit të këtyre vlerave prej ndërtuesve të tyre. Megjithëkëtë në trojet e Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë dhe Greqisë, ruhet ende një pasuri e rëndësishme kulturore e ndërtuar prej shqiptarëve për shqiptarët. Për t'i shërbyer së vërtetës historike, ashtu siç e kërkojnë kriteret e njohura ndërkombëtarisht, kjo pasuri e kombit tonë në shekuj, sipas normave të njohura, duhet të bëhet pjesë e rëndësishme e përkujdesjeve adekuate për identifikimin, dokumentimin dhe studimin e saj. Copëzimi i kulturës shqiptare nuk prek vetëm shqiptarët, por mbarë kulturën europiane, pjesë e së cilës ajo është, me identitetin e saj të vërtetë. Është rasti për të vënë në dukje korrektësinë me të cilën shteti shqiptar, gjithëheri është përkujdesur për monumente që lidhen me kultura të huaja të pranishme në trojet shqiptare në rrethana të ndryshme historike, në portën perëndimore të Ballkanit, Shqipërinë.

Konsiderimi serioz i këtyre vlerave dhe krijimi i mundësive praktike për njohjen me to, është sa detyrë e

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Shqipërisë aq edhe e komunitetit ndërkombëtar dhe organizmave të fushës. Kështu do të mundësohej gjurmimi i këtyre dëshmive, për të ndriçuar drejt historinë, shpesh pseudoinstrument i tjetërsimit të të vërtetave. Theks i veçantë i duhet kushtuar bashkëpunimit me organet paralele në Kosovë, në të cilën, thuajse vetëm kishat ortodokse janë vlerësuar, në shërbim të mashtrimit për të quajtur pushtimin-çlirim, duke lënë krejt mënjanë madje dëmtuar shumëmënyrash trashëgiminë shqiptare.

Bashkëpunimi me të huajt

Kjo temë vjen në konsiderim sa vijueshëm aq edhe në rritje për dy arsye bashkëplotësuese. Së pari vetizolimi, së paku absurd, na dëmtoi rëndë, së dyti bashkëpunimi me arritjet bashkëkohore i shërben edhe së vërtetës se pasuritë tona historiko-kulturore i përkasin krahas krijuesve të saj, shqiptarëve, edhe mbarë njerëzimit.

Natyrshëm, pas viteve 1990, marrëdhëniet me organizmat paralele përtej Shqipërisë, në fushën e monumenteve, kanë filluar të vendosen, megjithëse në mënyrë sporadike dhe kryesisht me nismën e të huajve. Këto marrëdhënie, veçanërisht në fushën e trashëgimisë kulturore, paraprihen prej bashkëmarrëdhëniesh formale me kërkesa, projekte, kontrata etj, të cilat për të shmangur keqpërdorimet e këtyre bashkëpunimeve, paraqesin një burokraci sa të vërtetë aq dhe lodhëse. Për arsyet e njohura të vetizolimit të përmendur dijet tona, lidhur me këto procedura, janë ende pak të njohura, prandaj shpesh nismat e bashkëpunimit ndërmerren prej institucionesh, apo edhe specialistësh të huaj. Në këto raste, deri më sot më të shpeshtat, iniciatorët e huaj individuale, apo institucionale, përzgjedhin vetë temën e veprimtarisë, dhe shpesh dhe bashkëpunëtorët. Në mjaft raste kjo përzgjedhje synon përfitimet financiare të veprimtarisë, të cilat në përqindje lartësisht të mëdha u kalojnë partnerëve të huaj. Kjo gjendje duhet të pësojë ndryshime rrënjësore, së pari në momentin thelbësor, atë të përzgjedhjes së veprimtarisë për bashkëpunim, e cila natyrshëm, thuajse gjithmonë duhet të përzgjidhet prej palës shqiptare, apo të miratohet para se të jetë fakt i kryer. Ngulim këmbë se domethënia e termit bashkëpunim kërkon vetiu bashkëpërfshirjen e palëve, ndërsa termi ndihmë, parakupton kërkesën e të interesuarit për t'u ndihmuar. Në këtë drejtim, roli i organeve udhëheqëse të veprimtarisë me monumentet, duhet të forcohet, madje ndjeshëm, për të bërë sa më efikas këto bashkëmarrëdhënie të specialistëve shqiptarë me të huajt me synime vërtet pozitive, por shpesh të paarritura për shkaqe dytësore e kryesisht të natyrës lukrative.

Rasti shqiptar i trajtimit të vlerave materiale të trashëgimisë kulturore, natyrshëm, gjithë duke u përfshirë në përvojën botërore, apo më saktë në atë europiane, bart veçanti të kushtëzuar prej faktorësh të ndryshëm, pa përjashtuar, madje ndjeshëm edhe ata politikë. Që prej fillimeve të prekshme të vlerësimit të monumenteve shqiptare në Shqipëri dhe deri në ditët tona, ndeshim dy periudha me dallime si në shkallën e përkujdesjeve, ashtu edhe atë të qëndrimit organizativo-profesional. Periudha e parë, fillon pas Luftës së Dytë Botërore dhe shtrihet deri rreth viteve 1990, ndërsa e dyta ajo pas këtyre viteve, duke qenë ende vepruese. Periudha e parë lidhet me vendosjen e vendit nën diktaturën sui generis, të bolshevizmit të skajmë apo enverizmit.

Gjatë kësaj periudhe u hodhën bazat metodike të restaurimit në Shqipëri, duke u mbështetur kryesisht në Kartën e Restaurimit të Venecias, u krye gjurmimi i gjerë i veprave ndërtimore të mbarë gjinive dhe hapësirave kohore në mbarë vendin, dokumentimi, filloi veprimtaria restauruese dhe ajo botuese. E rëndësishme është të theksohet se natyrshëm, veprimtaria restauruese u ndërthur me atë studimoren, duke u ndihmuar ndjeshëm prej ndarjes së restauratorëve të arkitekturës sipas fushave të ndërtimeve mbrojtëse, të kultit, shoqërore dhe inxhinjerike dhe së fundi fushës së ndërtimeve popullore, thuajse tërësisht banesa. Kjo ndarje shpejtoi lindjen e studiuesve të mirëfilltë të arkitekturës shqiptare, njëherazi restauratorë të veprave të kësaj fushe. Rëndësi të veçantë pati sistemi organizativ, me Institutin në qendër dhe Degët dhe Atelietë në rrethe. Ky sistem sa i njësuar, aq edhe kapilar, krahas detyrës për përcaktimin e radhës dhe shkallës së ndërhyrjeve restauruese, dhe hartimit të projekteve të restaurimit, ishte i ngarkuar edhe me zbatimin e këtyre ndërhyrjeve, duke njësuar të gjithë proceset që lidhen me termin përmbledhës vlerësim monumentesh. Botimet e shumta të monografive, krahas arritjes madhore, botimit të revistës "Monumentet", janë vlera të prekshme kulturore.

Këto arritje, të mbështetura në fonde të mjaftueshme, besojmë se shpjegohen me synimin ireal të kohës, për vetizolim, apo me saktë për autarki edhe në fushën e vlerësimit të monumenteve. Ky synim sa absurd aq edhe prapavajtës, pati edhe anën pozitive, sepse angazhoi maksimalisht forcat e brendshme. Edhe fusha e vlerësimit të monumenteve në Shqipërinë moniste, nuk mund të shkëputej prej drejtimit thelbësisht ideologjik. Kështu në vitin 1967, Shqipëria politike vetëzgjodhi primatin sa negativ aq edhe unikal, të ndalimit të ushtrimit të fesë, i cili u shoqërua me rrënime të papara vlerash historiko-kulturore. Potencialet negative të përkujdesjeve për monumentet, u shfaqën edhe në rëndësinë e shproporcionuar për të ashtuquajturit monumente të lidhur me figurat dhe ngjarjet e së ashtuquajturës Luftë Antifashiste Nacional-çlirimtare.

Vendosja e sistemit demokratik të qeverisjes, rreth viteve 1990, pruri një atmosferë të re në jetën politike të vendit dhe për pasojë edhe në fushën e vlerësimit të monumenteve. Siç kemi shkruar në vitin 1993 : "Duke qenë se përparësitë dhe ç'përparësitë janë në lidhje dialektike, ne duhet të ruajmë të mirën e së kaluarës dhe të bëjmë përpjekje të shumta për t'u përfshirë në mendësinë e përparuar të epokës që jetojmë [1]. Në këtë kontekst, në Shqipërinë paskomuniste, edhe në fushën e monumenteve, u hapën horizonte të reja potenciale, duke e çliruar atë prej instrumentalizimit ideologjik, dhe duke krijuar kushte për përfshirjen e problematikës së monumenteve në Shqipëri në hapësirën europiane dhe më gjerë. Megjithëkëtë kjo periudhë kalimtare, drejt më së mirës, ndaj së kaluarës po shfaqet me disa dukuri, të cilat mendojmë se nuk i shërbejnë siç duhet synimeve për përmirësimin e veprimtarisë shumëplanëshe me monumentet. Një numër i përfillshëm vendimesh të karaktereve organizative, profesionale, apo ekonomiko-financiare, mendojmë se nuk janë zgjidhjet e duhura për rritjen e efikasitetit në veprimtarinë problematike me monumentet.

Disa prej këtyre orientimeve, apo vendimeve, konsiderohen të arsyeshme sepse të tilla janë vepruese në vende të zhvilluara. Përvetësimi mekanik i përvojave të vendeve të përparuara në krahasim me Shqipërinë, kërkon kujdes të madh sepse këto zgjidhje nuk janë të mira në vetvete, por janë të tilla në një kontekst historiko-aktual të ndryshëm nga ai i yni. Mund të pohojmë, pa mëdyshje, se e reja duhet të zëvendësojë ekzistuesen vetëm kur është më racionale se ajo, në rast të kundërt e reja me, të themi të vjetrën, do të ishin në kontekstin e modës.

Më konkretisht, kohët e fundit ndeshim në përzgjedhje të dyshimta, për të mos thënë negative në disa fusha dhe problematika. Në planin organizativ, shkëputja e Drejtorive rajonale prej vartësisë së Institutit të Monumenteve të Kulturës, është një veprim me pasoja negative, sepse cënon domosdoshmërinë e qenies sa më të dukshme të centralizmit profesional, qoftë për mungesën dhe kompetencën e duhur të restauratorëve, qoftë për hapësirën krahasimisht të vogël të Shqipërisë. Kjo masë është shoqëruar edhe me marrjen e disa kompetencave të Institutit të Monumenteve të Kulturës, prej Drejtorisë së Trashëgimisë në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, siç është ajo e vendimmarrjes për radhën e ndërhyrjeve në monumente dhe fondet përkatëse për to. Kryerja e ndërhyrjeve restauruese nëpërmjet praktikave të tenderimit është një zgjidhje e gabuar, sepse mbetet dëmtuese për vlerat e monumenteve. Restaurimi, parakupton zbatimin e projektit të restaurimit, të ndryshueshëm vazhdimisht, gjatë hapjes së punimeve në monument, çka detyrimisht kërkon institucion zbatues me përvojë në këtë fushë dhe aspak ndërmarrje të zakonshme ndërtimi, qoftë edhe më një drejtues teknik të licensuar. Për t'u theksuar, është qartësimi i karakterit shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, sepse e tillë është fusha e veprimtarisë së tij, cilësim i cili do të ndikonte në përzgjedhjen më të lehtë të kuadrit për restaurim dhe specializimit të tij. Shtimi i fondeve për ndërhyrje restauruese është i domosdoshëm për të ndaluar humbjen e vlerave autentike, të papërsëritshme që ruajnë monumentet, në cilësinë e veprës ndërtimore dhe dokumentit historik. Pasojat e gabimeve, në fushën e vlerësimit të monumenteve janë të pakthyeshme, prandaj të rejat në këtë fushë duhet të jetësohen me përkujdesje të theksuara. Trashëgimia e kulturës materiale në Shqipëri, është përpara një gjendjeje, zgjidhja e së cilës kërkon maturi, profesionalizëm dhe përkushtim.

[1] Emin, Riza, Monumentet shqiptarë gjatë 45 vjetëve të fundit në "Bildersturm in Osteuropa", Munchen, 1994.

DO NOT COPY

Emin RIZA

CULTURE MONUMENTS AND THEIR EVALUATION PROBLEMS

DO NOT COPY

After the Second World War in Albania the institutional custodial care was shown up for cultural heritage values on the field of monuments evaluation. These were understandable as they're tracing, documenting, protecting, studying, and restoration and propagandise. Albanian monuments belong to very long time since beginning of history up to nowadays and they are of different kind by having clear typology developments and architecture-technical treatment. Special qualities of Albanian architecture are shown up at dwelling architecture. Evaluation of immobile monuments activity in Albanian begins with putting under protection their historic-cultural values, this is linked with first list of monuments of year 1948 which put under protection 107 works mainly fortifications and religion buildings. Restoring activity, under well-known international principles has follows thus of putting under protection, by growing and grooving with faster rhythms.

Restoring Personnel

Road for fulfilling restoring personnel especially for countries like Albania when is missing institutions which giving lessons represents a real problem.

This begins with selecting of candidates who like to work on the evaluation filed monument. Firstly is necessary for restaurateurs of architecture monuments to be architects, building engineers, archaeologists but these of art field to finish high art education or to be chemists. Since at beginning the personnel will divide in three monument fields: protective, religion and dwelling buildings. New restaurateurs must include at selective activity for annual restoring intervention, they must be co-authors of different restoring projects together with experienced restaurateurs. Specialisations in and out of country, by following professional courses, collaborations with foreign specialists for restoring interventions are fruitful process.

Monuments declaration

Albania declares first list of monuments on year 1948. This was follow by systematic activities especially after 1965 year when the Institute of Monuments of Culture (IMK) was created. Putting under protection is continuos process because of new investigations, discovering new remains and including new building at historic-cultural values as a witnesses of age which create them.

Monuments documenting.

Monuments' documenting is continuos process of representing state of document on different manner at a certain period of time. Documenting is divided in two groups first; state of document and second restoring interventions with or without intervening of monuments itself.

Documentation fulfilled up to date is traditional and is preserved at IMK archive and this must completed and computerised with new data that shows eventual changes on the monument state.

Monuments state knowing

Building works under protection for their architectural values and artistic ones that are faced at religion building must be under continuos care for knowing of their state. Custodian network must rebuilt and extending controlling expeditions for the reasons above mentioned to reach right planning at restoring interventions.

Planning of restoring interventions

Planning of interventions of different scales in monuments is guaranty for the fulfilling their irreplaceable function, mainly for showing their authentic values.

Restoring interventions are accompanied with project, technical relation and preventive. Proposals for restoring interventions come from Regional Directories of Monuments of Culture (DRMK), local government bodies, individuals or different organisations and naturally from different sectors of IMK. Damaging practice was shown these last years, which has at its base taking off competencies by Cultural Heritage Directory of relative Ministry for this essential case for the future of Albanian monuments.

Restoring interventions

Process of restoring interventions is accompanies by two main steps, first restoring project compiling and second applying of these projects. Projecting on the restoring field understands deep knowing of monument state which will be restored by typological, architectural side and building technique.

IMK before 1990 has under its dependence institutions that conduct well keeping and restoring works applying processes, which was very clear. Today almost all restoring works are conducted by usual building enterprise which has only one licensed professional with less power because the profit is main purpose at these enterprises.

Restoring technology interventions

Modernisation on the buildings materials which represents at new materials and growing quality of traditional materials today is a very important factor close by faster developing of restoring intervention technology. Especially this is faced at wide and problematic field of restoring art works, mainly wall paintings, wood carving, icons, stone works etc.

Professional centralism on the monument field

Centralism on administrative filed is inappropriate for the administration democratic system. Two complementary reasons: firstly especially lacking of restoring personnel in number and professional evaluation for monuments restoring; secondly necessity for unique professional monuments restoring evaluation by appropriate instances like sectors and Scientist Council of IMK, National Restoring Council made useful professional centralisation at monument evaluation field.

Revitalisation of monuments

Revitalisation monuments concept is linked with monument's life. This concept in nowadays has problems because the monument owner rights are became stronger, but this is not an obstacle. The legal acts in power solve this problem. Expanses of revitalisation are widely open.

Cultural tourism

Cultural tourism is XX century phenomenon. Albania does not use potentials created after Second World War for cultural tourism for Albanians because of economic reasons, while for foreign for self-isolation. Today cultural tourism comes as necessity demand linked closely with monument evaluation and final aim of above evaluation act.

Monuments propaganda

Knowing of their value aims helping finalisation of monument evaluation, by making them closer to so many citizens for their cultural-historic messages. Specialists have great spaces for monument propaganda that will serve spreading of many-plans knowledge for these great cultural-historic properties.

DO NOT COPY

Publication of monuments field

Many-plan activities named monuments evaluation include final phase that is publication of these activity with study-restoring characters.

Historical-cultural values on the Albanian community

Including the Albanian lands under the Romanian and Ottoman Empire without effecting at Albanian ethic unit, language and cultural-historic heritage is well-known phenomenon. Montenegro, Kosova, Macedonia and Greece lands exist today a very important cultural property built by Albanians. This property of our nation between centuries will must important part of its documentation, identification and study.

Collaboration with foreign

This theme comes under consideration because of two reasons. First reason self-isolation that brings lot of damages and second reason collaboration with nowadays achievements serves the pure truth that our properties belong its creators, Albanians, and entire human being.

Albanian case of treatments for material cultural heritage evaluation included at world or especially European heritage, without accepting even and political reasons kept particularity conditioned by different factors. Since from the beginning of evaluation of monuments in Albania up to today two different periods with changes on taking care and professional–organisational are faced. First period begins after Second World War up to beginning of 1990 and second after this year by being continuously active.

During the first period were established methodical restoration bases by focusing at Venice Chart, scientific investigation for all type of built work and documentation was done, restoring and publishing activity began.

New potential horizon on the monument field was opened at after communist area in Albanian by liberating from ideological instrumentalist conditions, and by creating spaces for including monument question in Albania in European space and further on.

Material heritage culture in Albania is before a state that asks devoting, professionalism and maturity.

DO NOT COPY

Dr. Nur AKIN
Prof. në Universitetin Teknik të Stambollit, Fakulteti i Arkitekturës, Departamenti i Restaurimit

DO NOT COPY

KONSERVIMI HISTORIK NE TURQI
POLITIKA DHE PROBLEME TE TRAJTUARA ME SHEMBUJ

Në Turqi, fillimi i veprimtarive restauruese nis në gjysmën e dytë të shekullit të XIX. Ligji i parë që lidhet me pasurinë Arkitekturore është ai i vitit 1874 dhe kishte për qëllim ruajtjen e grumbullimeve të siteve dhe objekteve arkeologjike të Anadollit. Me zgjerimin e këtij ligji në fillim të shekullit të XX (më 1906) ndërtimet turko-islamike u përfshinë në sistemin legal, ndërtesat si xhamitë, (fig.1) medresetë (fig. 2) institucionet otomane për edukimin e lartë, teqet, (shtëpitë e dervishëve) varret etj. Me vendosjen



Fig. 1



Fig. 2

e republikës me 1923, ndryshimet politike shkaktuan abrogimin e këtij sistemi. Më 1935, Akti i themelimit Pios, u vendos për të ruajtur ndërtimet turko-islamike. Në këtë kohë ndërtesat jo-islamike ishin nën mbrojtjen e Ministrisë së Arsimit. Ligji i vetëm për planet urbane ishte "të paktën 10 m nga monumenti duhet të jetë hapësirë boshe".

Më 1951 u themelua një institucion me emrin "Këshilli i lartë për pasuritë historike dhe monumentet", i cili ishte shumë i rëndësishëm për konservimin e ndërtesave dhe siteve. Deri atëherë, konservimi i zonave historike urbane nuk merrej në konsideratë. Ky këshill ishte shumë i cunguar në politikat për ndërhyrjet në ndërtesat e vjetra dhe zonave, si dhe ndaj regjistrimit të tyre. Vendimi i parë për konservimin e siteve historike urbane u mor më 1970, për restaurimin e shtëpive të Bosforit në Stamboll (fig. 3, 4).

Në Turqi që nga viti 1955 deri më 1970 urbanizimi i pakontrolluar dhe presioni ekonomik në zonat historike

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

urbane influencoi qytetet. Dy faktorë kryesore ndihmuan atë periudhë : imigracioni nga zonat rurale për në qytet dhe zhvillimi i klasës së lartë. Hapja e rrugëve të reja të gjera dhe rritja e ndërtesave shumëkatëshe shkaktoi spekullimin me tokën (fig. 5). Pavarësisht politikave të këshillit të lartë zhvilluesit me mbështetjen e politikanëve, filluan të rrisin çmimin e ndërtimit të shtëpive dhe shkaktuan shkatërrimin e zonave të vjetra për të ndërtuar ndërtesa të reja moderne. Kështu, gjatë asaj periudhe shumë site historike urbane humbën aspektet e tyre karakteristike. Diferencimi rajonal, aq i rëndësishëm për vendbanimet e Anadollit, filloi të ndryshojë. Ndërtimet e reja të larta që zëvendësuan të vjetrat ishin shumë homogjene dhe pa karakter.

Imazhi i perëndimit dhe modernizimit ishte i lidhur me ndërtimin e blloqeve të apartamenteve. Kështu klasat



Fig. 5

e larta dhe të mesme të kolonizimeve preferuan të qëndronin në këto ndërtesa të larta, të cilat shkaktuan një ndryshim të madh dhe të rëndësishëm social dhe fizik në zonat historike urbane, shtëpi të vjetra u braktisën nga pronarët e vet realë dhe u përdorën nga grupe krejt të ndryshme sociale nga ambientet rurale (fig. 6). Këto grupe të reja, të pandërgjegjshme për përdorimin origjinal të këtyre ndërtesave historike dhe pa mundësi financiare për mirëmbajtje, e ndryshuan shumë pamjen fizike të këtyre ndërtesave dhe zonave. Kështu duke filluar me Stambollin, Ankaranë, qytete të tjera të mëdha që vazhdonin deri në Anatalia (fig. 7), sitet historike urbane u bënë zona të vërteta tranzicioni.

Ndërkohë në 1973 ligji i parë i detajuar "Akti turk i konservimit", hyri në fuqi dhe përfshiu të gjitha termat



Fig. 6



Fig. 7

modern dhe rregullimet që lidheshin me konservimin. Më tej ndërtesa të veçuara monumentale dhe prona të mëdha, site që do të ruheshin u ndanë sipas karakteristikave të tyre si urbane, arkeologjike, historike dhe natyrale, të përshkruara në këtë akt. Kështu që pas kësaj date, sipas rregullimeve të aktit të konservimit, plane të ndryshme konservimi u përgatitën dhe u aplikuan nën kujdesin dhe supervizimin e Këshillit të Lartë për Pasuritë Historike dhe Monumentet, pavarësisht kundërshtimit nga bashkitë dhe pronarët e shtëpive historike.

Dhjetë vjet më vonë, më 1983, një Akt i Ri Konservimi, akoma në fuqi, me disa ndryshime dhe shtesa të bëra më 2004 zëvendësoi të parin. Me këtë akt një sistem i ri organizimi për mbrojtjen e trashëgimisë u instalua. Sipas sistemit të ri, në vend te Këshillit të Lartë për Pasurinë Historike dhe Monumentet, këshillat rajonal (13 në atë kohë/ 30 sot) u vendosën në të gjithë Anadollin dhe qendrat e tyre u vunë në qytete të rëndësishme historike. Autoritetet lokale ishin po ashtu të përfaqësuara në trupat e këtyre këshillave, anëtarët e të cilave (7 sot) janë arkitektë - restauratorë, planifikues qytetesh, historian arti, arkeolog dhe jurist. Është e sigurt që ky sistem i ri ishte një përmirësim i këshillit të vjetër të 1950 i cili u zbatua vetëm në Stamboll. Nën këto kushte, ishte qartësisht më e lehtë të kontrolloje ndryshimet e zonave historike urbane shumë më nga afër, të parandaloje shkatërrimet dhe të mirëmbaje monumentet e vjetra dhe ndërtesat në vend. Por përderisa numri i specialistëve në këto këshilla ishte i pamjaftueshëm për të kryer detyrën dhe opinionet e tyre për sa i përket politikave të restaurimit janë të ndryshme, ky sistem është subjekt i presionit lokal.

Këshillat Rajonal Lokal janë të gjitha të lidhura me Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit, të cilat janë përgjegjëse për kushtetutshmërinë e politikave ligjore për konservimin e rreth 194 siteve urbane. (fig. 8), si dhe 6192 siteve arkeologjike (fig. 9) dhe 947 siteve natyrore (fig. 10) dhe muzeve në Turqi. Një tjetër detyrë e kësaj Ministrie është regjistrimi i ndërtesave të vjetra dhe siteve të tjera urbane, nëpërmjet muzeve dhe zyrave lokale të konservimit. Roli i ministrisë është të mbështesë projekte të ndryshme në nivele të ndryshme, të rrisë ndërgjegjen e publikut për rëndësinë e konservimit me anë të projekteve për restaurim, kongreseve, konferencave, ekspozitave etj.



Fig. 8



Fig. 9

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10

Organizata e dytë e rëndësishme që lidhet me konservimin është Drejtoria e Përgjithshme e Fondacionit Pios e përmendur më lart. Siç thamë edhe më lart, detyra e tij kryesore është mbrojtja, ruajtja dhe mirëmbajtja e monumenteve publike dhe religjioze, ku përfshihen: xhamitë, medresetë, hanet, (fig.11) karavansarajet (fig.12), banjat, shatërvanët etj. Organizata të tjera zyrtare si Ministria e Punëve Publike (mirëmbajtja e bashkive, shkollave, spitaleve), Drejtoria e Përgjithshme e Pallateve Nacionale (shekulli i 19 Pallatet e Stambollit) (fig.13), Ministria e Agrikulturës dhe Pyjeve (Konservimi i Parqeve Nacionale) kanë përgjegjësi të ndryshme. Si rezultat, administrimi i monumenteve është kështu i ndarë midis këtyre institucioneve, të cilat e kanë të vështirë për të arritur marrëveshje në bazë të politikave për konservimin.



Fig. 11



Fig. 12



Fig. 13

Disa organizata jo-qeveritare janë gjithashtu të interesuara për konservimin e Trashëgimisë Kulturore. Midis të cilave mund të veçojmë: "Koç Foundation", "Turkish Touring and Auto Club" të cilat restauruan vullnetarisht disa banesa feudale dhe e dyta rehabilitoj një rrugë historike në Stamboll (fig.14,15).



Fig. 14

DO NOT COPY



Fig. 15

Përgatitje dhe Aprovim i Projekteve të Restaurimit dhe Konservimit Urban

Kur një ndërtesë e vjetër është e listuar dhe e regjistruar, çdo ndërhyrje në të duhet të miratohet nga Këshilli Rajonal. Dhe kur një sipërfaqe është e përcaktuar si "Zonë e Mbrojtur" fal densitetit arkitektural, historik dhe kulturor, këshilli duhet të përgatisë me anë të byrove të konservimit lidhur me këto zona "Rregulla Ndërtimi Tranzitore" për zona speciale, derisa të aprovohet një plan konservimi i përhershëm. Ndërtesat që duan restaurim, të tjerave që do t'u bëhen shtesa, dhe ato që do të restaurohen duhet të respektojnë këto rregulla.

Plani i konservimit për një sit historik urban do të plotësohet brenda dy vjetëve dhe duhet të miratohet nga Këshillat Rajonal. Ai duhet të aplikohet nën kujdesin dhe kontrollin e bashkive.

Dhjetë vjet më parë, ekzistonin tre kategori për ndërtesat historike të regjistruara. Grupi i parë përfshinte ndërtesat më të rëndësishme (sidomos shtëpitë) (fig.16), të cilat ruajtën karakteristikat në fasadën dhe interierin e tyre. Ato duhet të ruhen pa ndërhyrje të reja përveç modernizimit të instalimeve sanitare. Këto ndërtesa ishin të pakta në numër. Ndërtesat e grupit të dytë ishin ato që kishin humbur karakteristikat e tyre planimetrike ndërsa kishin ruajtur fasadat dhe interierin e tyre karakteristik (fig.17) shumica e ndërtesave karakteristike u listuan në grupin e dytë që i lejonin pronarit të bënin të gjitha llojet e ndryshimeve brenda ndërtesës, me qëllim që të ruanin pamjen në eksterierin karakteristik. Ishte e njëjta gjë dhe për grupin e tretë të ndërtesave që kishin humbur shumicën e detajeve të tyre tradicionale të fasadës dhe të interierit (fig.18). Disa ndryshime dhe ndërhyrje të reja u lejuan në fasadat e tyre gjithashtu. Kjo është dhe arsyeja pse nga lista e objekteve të listuara pronarët preferonin grupin e tretë.

Leja për të ndryshuar interierin u dha pronarëve dhe arkitektëve mundësinë të hidhnin poshtë ndërtesën origjinale dhe ta rindërtonin atë me çimento sipas planit të ri.

Fasadat e ndërtesave të reja u mbuluan me dru (fig. 19) gjatë këtij procesi rindërtimi, ndërtesa humbi origjinalitetin dhe karakteristikat historike, dhe disa herë dimensionet dhe proporcionet (fig. 20). Përfundimisht në atë kohë, shumë ndërtesa ishin "të reja" në vend të "restauruara" dhe vazhduan të jenë të listuara si "monumente".



Fig. 16

DO NOT COPY



Fig. 17



Fig. 18



Fig. 19



Fig. 20

Fatmirësisht momentalisht, sipas rregullimeve të fundit, nuk ka kategorizim të ndërtesave të vjetra. Çdo pasuri arkitekturale, e regjistruar një herë, duhet të vlerësohet sipas karakteristikave të veta. Pra, çdo ndërtesë e regjistruar duhet të ruhet me vlerat e saj arkitekturale dhe historike me ndryshime të lejuara në planimetri dhe do të rehabilitohet sipas kërkesave moderne të kohës.

Disa shembuj të restaurimit nga Stambolli

Muret e qytetit të cilat janë pika e kontaktit e gadishullit historik të Stambollit u bënë subjekt i një programi të rëndësishëm restaurimi që prej 20 vjetëve. Pjesa e parë që u rikonstruktua më 1986, të krijonte idenë e një "dekori" (fig. 21). Kjo punë ishte larg



Fig. 21

restaurimit arkeologjik. Që prej 10 vjetëve bashkia filloi procesin e restaurimit të pjesëve të tjera të murit (fig. 22). Ne mund të themi se disa pjesë të këtyre hapave janë shkencërisht të restauruara mirë, nëse krahasohen me pararendësit.



Fig. 22

Pasuria industriale

Restaurimi i ndërtesave industriale është në axhendën tonë që prej 10 vjetësh. Të regjistruara si pasuri arkitekturore, disa janë ripërdorur, planimetria e tyre është mbajtur siç ka qenë, fasada dhe eksterieri janë restauruar dhe ruajtur siç janë ndërsa brenda janë rinovuar sipas nevojave të reja. Këtu mund t'ju jap dy shembuj të ripërdorimit të përshtatur të një grupi ndërtesash:

E para është restaurimi dhe ripërdorimi i Fabrikës së Duhan- Cigareve e ndërtuar në bregun e Golden Hornit në gjysmën e dytë të shekullit të XIX. E restauruar midis 2000-2002, është tani duke funksionuar si universitet privat (fig. 23,24,25).

Shembulli i dytë i kësaj kategorie është restaurimi dhe adaptimi në ripërdorim i një Distilatori, i cili ishte pjesë e një kompleksi të madh, i ndërtuar në fillim të shekullit të XVIII, i regjistruar si pasuri industriale. Ishte planifikuar të përdorej si konservues në rajonin që ishte ndërtuar. Gjatë përgatitjes së projektit dhe procesit të restaurimit, i cili filloi më 1997, qëllimi kryesor ishte rivlerësimi i të gjitha të dhënave që kishin ngelur nga ndërtesa historike. Pjesët në të cilat detajet nuk ishin



Fig. 23



Fig. 24

shumë të qarta, u riprodhuan me materiale të reja bashkëkohore. Konsolidimi, pastrimi dhe riparimi i materialeve metalike si kolonat e hollit të hyrjes, trarët e tavanit, muret, harqet e tullave mbi mure janë restauruar aq shkencërisht sa qe e mundur. Ndërtesa është përdorur rregullisht nga banorët e rajonit që në vitin 2000 (fig. 26,27,28,29).

Bosfori

Restaurime të ndryshme janë bërë edhe në Bosfor. Mund t'ju citoj përsëri dy shembuj të kësaj kategorie:

E para është restaurimi dhe ripërdorimi i përshtatur i një ndërtese mbretërore "Adile Sultan Palace" që ndodhet në Kandili, në majën e një kodre që sheh nga gjiri i një bregu Aziatik në Bosfor. I ndërtuar në gjysmën

Do Not Copy

DO NOT COPY



Fig. 25



Fig. 26



Fig. 27



Fig. 28



Fig. 29

e dytë të shekullit të XIX si pallat i Sulltanit dhe i përdorur si gjimnaz për vajza që nga fillimi i shekullit të XX deri më 1986, i cili u shkatërrua nga zjarri. Në 1995 u morr vendimi për rinovimin e tij si qendër kulturore. Projektet u përgatitën nga një grup ekspertësh me specialitete të ndryshme: muret u konsoliduan, dyshemetë dhe tavanet u rikonstruktuan, si dhe detajet dekorative, ornamentet etj. Ai u vu në përdorim që në 2005 (fig. 30,31,32).



Fig. 30



Fig. 31

Shembulli i dytë është një Jali (shtëpi buzë deti) e rëndësishme. Kjo ndërtesë është e ndërtuar përsëri në bregun Aziatik. E listuar si "ndërtesë me interes të veçantë" "Yali of Sadullah Pasa" e shekullit të XIX është restauruar me shumë kujdes, pa ndërhyrje të reja, përveç modernizimit të ambienteve sanitare dhe



Fig. 32

sistemit ngrohës (fig. 33,34). Falë restaurimit të shkëlqyer, kjo ndërtesë u bë fituesja e Çmimit Kombëtar të Arkitekturës në 2004.

Projektet e konservimit urban Stamboll

Zonat historike të gadishullit të Stambollit janë të përfshira në Listën e Pasurive Botërore të UNESCO në 1985. Që nga kjo datë bashkia u interesua për rehabilitimin e Sulejmaniye dhe Zeyrek, dy zona të rëndësishme historike të rajonit. Sidomos lagjia Suleymani ishte vendi ku burokratët otomanë jetonin në shtëpi druri luksoze (fig.35). Që prej 20 vjetësh një plan rehabilitimi u përgatit për zonën e mësipërme. Restaurimi do të fillojë së shpejti dhe shpresojmë se do bëhet në mënyrë shkencore dhe i kontrolluar me kujdes nga bashkia. Fatkeqësisht, gjendja e tanishme e zonës nuk lë vend për shumë shpresa.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 33



Fig. 34



Fig. 35

- një projekt tjetër shumë i rëndësishëm që lidhet me skelën është procesi i rehabilitimit të distriktit të Fener-Balat që i takon shekullit të XIX e ndërtuar mbi bregun dhe kodrat e Golden Hornit (Briri të Artë). Ky projekt është përgatitur nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të mbështetur nga UNESCO dhe Bashkimi Europian. Qëllimi kryesor është rehabilitimi i distriktit vetëm për banorët dhe jo për qëllime turistike. Projekti i përgatitur më 1998, është në proces ekzekutimi që në vitin 2002 dhe do të përfundoj në vjeshtë të vitit 2007. Kështu, pra kohëzgjatja e këtij projekti është 5 vjet, dhe buxheti i tij është 7 milion Euro për rehabilitimin e rreth 150 shtëpive dhe e një tregu tradicional të rrethit. Ky do të jetë një shembull i shkëlqyer i një rehabilitimi urban në Stamboll (fig. 36, 37).



Fig. 36



Fig. 37

Anadolli

Që në 1973 plane të detajuara konservimi janë përgatitur për qytete të ndryshme të Anadollit. Ndërmjet tyre Antalia, një qytet i jugut, në bregun mesdhetar mund të përmendet si e para dhe më e rëndësishmja zonë ku do të ketë ndërhyrje konservuese. Zona e bregut e qytetit të vjetër ishte rehabilituar ndërmjet 1974 dhe 1985 për turizëm. Është një nga zonat më të preferuara të Anadollit jugor, sidomos për turistët që vinin këtu me jahte. Ndërtesat tradicionale të kësaj zone, si dhe ato në vazhdimësi në zonën në krah të "Antalia intra-muros", janë rehabilituar dhe vazhdojnë për disa të ngelura në këtë zonë. Kjo pjesë e qytetit është shumë tërheqëse gjatë kohës së verës, por është një përdorim i përkohshëm se në dimër zona është pothuajse bosh. Të gjitha shtëpitë historike janë konvertuar në hotele, pensione, kafe-bare dhe restorante. Pra, rehabilitimi i tyre nuk konsiston në krijimin e kushteve më të mira për jetesë të banorëve të zonës. Ky është fatkeqësisht një ndryshim social, një borgjezim i vërtetë (fig. 38,39,40).

Ky ishte dhe një përshkrim i shkurtër i problemeve dhe ndërhyrjeve, që lidhen me ndërtesat historike dhe çështje të konservimit urban. Siç shihet dhe nga shembujt, pa mjete teknike dhe financiare për pronarët për konservimin e pasurive të tyre dhe pa një restaurim shkencor shembullor, jo si shtëpi - muze as për qëllime turistike, por për përdorim privat dhe përfundimisht që është shumë e rëndësishme për Turqinë pa ndërgjegjësimin e autoriteteve vendore (bashki dhe ndërgjegjësim banorësh) nuk do të jetë e mundur të ruajmë (në sensin real) pasurinë tonë historike.



Fig. 38



Fig. 39



Fig. 40

DO NOT COPY

Dr. Nur AKIN
Professor at Istanbul Technical University, Faculty of Architecture, Department of Restoration

DO NOT COPY

HISTORIC PRESERVATION IN TURKEY POLICY AND PROBLEMS THROUGH EXAMPLES

In Turkey, the beginning of the conservation activities dates to the second half of the 19th.century. The first law related to architectural heritage dated 1874 and aimed to prevent the pillage of Anatolian archaeological sites and objects. With the extension of this law at the beginning of 20th century (in 1906), Turkish Islamic buildings were included in the legal system -the buildings such as the mosques, medrese's (Ottoman institutions for higher education), tekke's (derviche lodges), tombs etc. With the establishment of the Republic in 1923, political changes caused the repeal of this system. In 1935, a Pious Foundation Act was settled for the preservation of these Turkish-Islamic buildings. At this time, non-Islamic historic monuments were under the responsibility of the Ministry of Education. The only rule for the urban plans was that "at least 10 meters of the area surrounding the monuments should be kept empty".

In 1951, a new institution the "High Council for the Historical Properties and Monuments" which was very important for the conservation of buildings and sites was founded. Until this time, the conservation of historical urban areas was not taken into consideration. This council was very restrictive in its policies for interventions to old buildings and areas, as well as their registration. The first decision for the conservation of an historic urban site was taken in 1970 for the conservation of historic timber-framed shore houses of the Bosphorus in Istanbul.

In Turkey from about 1955 to 1970s, accelerated urbanization and economical pressures on the historical urban areas influenced the cities. Two main new facts affected this period: immigration from rural areas to cities, and the growth of a new upper class. The opening up of new broad streets and the increase of height of buildings caused great land speculations. In spite of the policies of the High Council, the developers, with the support of the politicians, began to raise the prices of housing, and to cause the destruction of old areas for new high and modern constructions. So, during this time many historic urban sites lost their characteristic aspects. Regional differences, so important for the Anatolian settlements, began to change. The new and high constructions which replaced the old ones were very homogeneous and without character.

The image of westernization and modernization was related to the convenience of the apartment blocks. So the local upper and middle classes of the settlements preferred to live in these new high buildings, which caused an important social and physical change within the historical urban areas; old historic houses were abandoned by their real owners, and used by totally different social groups from the rural environments. These new groups, unaware of the original use of these historical buildings and without financial possibilities for their maintenance, changed enormously the physical appearance of these buildings and areas. So, beginning with Istanbul, Ankara, other big cities and continuing throughout Anatolia, the historic urban sites became real transitional areas.

Meanwhile in 1973, the first detailed "Turkish Preservation Act" came into effect and included all modern terms and regulations relating to preservation. Besides single monumental buildings and large estates, the sites to preserve were divided according to their characteristics as urban; archaeological; historical and natural, and described in this act. So after this date,

according to the regulations of this Preservation Act, several urban conservation plans were prepared and applied under the supervision of the High Council for Historical Properties and Monuments, despite of the opposition of municipalities and owners of the historical houses.

Ten years later in 1983, a new Preservation Act -still current with some new changes and additions done in 2004- replaced the former one. By this act, a new organizational system for the conservation of the heritage was established. According to the new system, instead of one central High Council for the Historical Properties and Monuments, the regional councils (13 at this time/nearly 30 today) were established throughout Anatolia, their centers installed in historically important cities. The local authorities were also represented in the body of these councils whose members (7 today) are restorer-architects, city-planners, art-historians, archaeologists and lawyers. It is sure that this new system was an improvement over the former council of the 1950's which was established only in Istanbul. Under these conditions, it is obviously easier to control the changes of historic urban areas more closely, to prevent demolitions and to maintain the old monuments and buildings in place. But since the number of specialists, present in each of these councils is insufficient for the task, and their opinions relating to conservation policies differ, this system can be subject to local pressures.

The current regional councils are all connected to the Ministry of Culture and Tourism which is responsible for the constitution of legal policies for the preservation of around 194 urban sites, as well as 6 192 archaeological and 947 natural sites, and museums in Turkey. Another duty of this Ministry is the registration of old buildings and other historic urban sites, through museums and local bureaus of conservation. The role of the Ministry is to support different projects at different scales, to increase public consciousness of the importance of conservation by means of exemplary restoration projects, congresses, conferences, exhibitions and so on.

The second important organization related to conservation is the General Directorate of Pious Foundations mentioned above. As mentioned earlier, its basic task is to preserve and maintain religious and public monuments, including mosques, medrese's, khans, caravanserais, baths, fountains and so on. Other official organizations such as the Ministry of Public Works (Preservation of old town halls, schools, hospitals), the General Directorate of National Palaces (19th.century palaces of Istanbul), the Ministry of Agriculture and Forestry (Conservation of national parks) have different responsibilities. As a result, the administration of monuments and sites are so divided between these institutions that it is usually difficult to reach agreements on basic policies for preservation.

Some private organizations are also interested in the conservation of cultural heritage. Among them, "Koç Foundation" or another "Turkish Touring and Auto Club" restored voluntarely some important mansions and also the last one rehabilitated an historic street in Istanbul.

Preparation and Approbation of the Restoration Projects and Urban Conservation Area Plans

When an old building is listed and registered, any intervention to it must be approved by the regional councils. And when an urban area is designated as a "Conservation Area" due to its dense architectural, historical or cultural characteristics, the councils must prepare by means of conservation bureaus related to their areas "Transitional Construction Rules" for this special area, until the conservation plan is approved. Buildings to be restored, others to which new additions will be made, and those which will be constructed in vacant lots must respect these rules. The conservation plan for a registered urban historic site is to be completed within two years and must be approved by the regional councils. It has to be applied under the control of the municipalities.

Ten years ago, there were three essential categories for listed historical buildings. The first group included the most important buildings (especially the houses) which conserve their exterior and interior characteristics. They should be kept without any new interventions, except the modernization of the sanitary

DO NOT COPY

DO NOT COPY

installations. These buildings were few in number. The buildings of the second group were those which had lost their plan characteristics, while their traditional facades and exterior details remained. Most of the historical buildings were listed in this second group which permitted the owner to make all kinds of changes inside the building, in order to keep its exterior characteristic appearance. It was the same for the third group of buildings which had lost most of their traditional exterior details, as well as the interior's. Some changes and new interventions were permitted to their facades as well. That is why, most of the listed building owners preferred the third group.

The permission to change the interior gave to the owners and architects the possibility to tear down the original building, and rebuild it in concrete according to a new plan. The façades of the new building is covered with wood. During this rebuilding process, the building lost its originality and historic characteristics, and sometimes its dimensions and proportions. Finally at that time, many buildings were "new" instead of "restored" and they continued to be listed as "monuments".

Fortunately at present, according to the current new regulation, there is no categorization of old buildings. Every architectural heritage, once listed, must be evaluated according to its own characteristics. So, every listed building will be preserved with its original historic architectural value, with permitted changes to its plan and so it will be rehabilitated according to the modern needs of time.

Some Examples of Restoration from Istanbul

City walls which are the focal point of the historic peninsula of Istanbul were subject to an important programme of restoration since 20 years. The first part restored was rather reconstructed in 1986, in order to create an historical "décor". This work was away from an archaeological restoration. Since 10 years, the municipality began the process of the restoration of the other parts of the walls. We can say that some parts of this step is scientifically well restored, when compared to the former ones.

Industrial Heritage

The question of rehabilitating industrial buildings is on our agenda since 10 years. Registered as architectural heritage, some are re-utilized, their exteriors restored and conserved as it is, while their interiors are renovated according to the needs of the new function. Here I can give you two examples of adaptive re-use of this group of buildings:

-The first one is the restoration and re-utilisation of a Tobacco and Cigarette Factory constructed on the shore of the Golden Horn at the second half of the 19th century. Restored between 2000-2002, it is now used as a private university.

-The second example of this category is the restoration and adaptive re-use of a Distillary which was a part of a great complex constructed beginning of the 18th century. Registered as industrial heritage, it has to be used as conservatory of the region where it is situated. During the preparation of the project and the restoration process which began in 1997, the main aim was the valorization of all data remaining from the historical building. The parts where the details were not so clear, are reproduced by means of new contemporary materials. The consolidation, the cleaning up and the reparation of the metallic elements such as the entrance hall's columns, the ceiling beams, the texture of the walls, the brick arches over the walls are all restored as scientifically as possible. The building is very frequently used since 2000 by the inhabitants of the region.

Bosphorus

Several important restorations are done in the Bosphorus. I can cite again two examples for this category:

The first one is a restoration and adaptive re-use of an imperial residence "Adile Sultan Palace" situated at Kandilli at the top of a hill looking at a bay on the Asian shore of the Bosphorus. Constructed at the second half of the 19th century as a sultan palace and used as a gymnasium for girls since the beginning of the 20th century till 1986, it was destroyed by a fire. In 1995, the decision of its renovation as cultural center is taken.

The projects are prepared by a group of experts of different specializations: the walls are consolidated, the floors and the ceilings are reconstructed, as well as the decorative details, ornamentations etc. It is in use since November 2005.

The other example is an important yalý (waterfront house) situated again on the Asian shore. Registered as "building of special interest" the "Yalý of Sadullah Paþa" of the 19th century is restored very carefully, without any new intervention except the modernization of the sanitary equipments and the heating system. Due to this perfect restoration, it was the winner of the National Award of Architecture in 2004.

Urban Conservation Projects

Istanbul

The historic zones of the peninsula of Istanbul are included in the World Heritage List of Unesco in 1985. Since this date, the municipality is interested to the rehabilitation of Süleymaniye and Zeyrek, two very important historic districts of the region. Especially Süleymaniye neighborhood was the place where Ottoman bureaucrats were living in sumptuous wooden houses. Since 20 years, a rhabilitation project is prepared for the area. The restorations will begin soon and we all hope that they will be scientifically done and carefully controlled by the municipality. Unfortunately, the present state of the area is not so hopeful.

Another very important project related to this scale is the rehabilitation process of the districts of Fener-Balat of the end of the 19th century situated on the shore and the hills of the Golden Horn. This project is prepared by a national and international multi-disciplinary experts and supported by Unesco and the European Union. The main aim of this project is the rehabilitation of the district only for their inhabitants and not for touristic purposes. The project prepared at 1998, is now in execution since 2002 and it will be finished by fall 2007. So the total time of the project is 5 years, and its budget is 7 millions Euro for the rehabilitation of approx.150 houses and the traditional market place of the district. It will be an exemplary work of urban rehabilitation for Istanbul.

Anatolia

Since 1973's detailed conservation plans have been prepared for several Antolian cities. Among them Antalya, a town of the south, on the shore of the Mediterranean Sea can be mentioned as the first and the most important. The shore district of the old town was rehabilitated between 1974 and 1985, for tourism. It is now one of the most preferred area of the south Anatolia, especially for tourists who arrive there by yachts. The traditional buildings of this area as well as those of its continuation in the area which is next to it "Antalya intra-muros" are rehabilitated in order to be used "only for touristic purposes". Now, these rehabilitations are continuing for the last few examples of the area. This part of the town is very attractive during summer-time, but as it is a temporary use, in winter the region is approximately empty. All the historic houses are converted into hotels, pensions, coffees-bars and restaurants. So, it is not a rehabilitation regarding to the better conditions of live of the local inhabitants of the district. There is unfortunately a big social change in the area, a real gentrification.

This is a brief over-view of the problems and executions related to historic buildings and urban conservation issues. As seen from these examples, it is celar that without any technical and financial aid to the owners for the conservation of their properties, and without any exemplary scientific restorations, not as museum-houses or for tourist purposes but for private use, and finally -and it is really very important for Turkey- without the consciousness of local authorities/especially the municipalities and awareness of the inhabitants of architectural heritage, it will not be possible to preserve (in the real sense of the word) our historical properties.

DO NOT COPY

Prof. Dr. Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

ILJAZ BEJ MIRAHORI – FIGURË HISTORIKE KOMBËTARE

Për arsye të ndryshme, Historia e Shqipërisë është pasqyruar me shumë zbrazëtira, të cilat do të plotësohen me kohë për t'i dhënë asaj atributet e vërteta shkencore. Deri më sot, në të, nuk janë pasqyruar ngjarje dhe figura, nga ana tjetër, mjaft aktorë të saj, janë përmendur shkarazi ngaqë veprimtaria e tyre njihej më tepër jashtë vendit. Njëri nga këta ka qenë Iljaz Bej Mirahori i Korçës, i cili për vlerat ushtarake, politike dhe historike e tejkalon statusin e një prijësi dhe figure lokale. Ai, padyshim paraqet një personazh historik me përmasa kombëtare. Në vijim të historisë së shkruar për shumë pashallarë, vezirë, kryearkitektë të Perandorisë Osmane, Iljaz Bej Mirahori na paraqitet më i prekshëm, pasi ende deri në ditët tona ruhen veprat e bëra nga ai, si në Shqipëri ashtu edhe në Stamboll.

Për dy arsye e ndjej detyrim të hedh në letër disa rreshta për këtë figurë, që tashmë do ta quaja me plot gojën të një niveli kombëtar. Së pari, sepse origjina ime rrjedh nga zona e vakëfeve të Korçës, vendlindja e Mirahorit, dhe së dyti pasi kam vëzhguar dhe studiuar veprat e tij, madje deri në Stamboll.

Historia e djalit shqiptar nga Panariti i Korçës shtjellohet gjatë shekullit të XV me stabilizimin e administratës së Perandorisë Osmane në trojet tona. Në këtë kohë formohet shtresa e pronarëve të mëdhenj lokalë të tokave, e cila në mjaft raste qe një shans i veçantë i disa personave, të cilët për merita të shërbimeve, që ata bënë ndaj sulltanëve u ngarkuan me ofiqe të larta në territoret e tyre duke mundësuar edhe investime në to. Gjithashtu ata poseduan dhe hapësira të mëdha tokash. Këto prona të mëdha të dhuruara nga Porta e Lartë u njohën si të trashëgueshme, fakt që legjitimonte figurën e familjeve të mëdha[1].

Studiuesi dhe rilindasi i madh shqiptar Sami Frashëri në veprën e tij " Kamus'al Alam II, 1208"shprehet se Iljaz Bej Mirahori ka qenë stërgjyshi i tij nga ana e nënës[2]. Ai ka qenë biri i një prifti me influencë në këto anë. Në moshë të vogël quhej Ilo dhe kur ishte vetëm 10 vjeç ai u mor peng gjatë ekspeditave turke të Sulltan Muratit II (1421- 1451) kur ky kaloi nga këto anë[3]. Me kalimin e viteve panaritasi arriti të bëhej një nga ushtarakët e lartë të Perandorisë. Në vitin 1453 kur Sulltan Mehmeti II sulmoi Kostandinopojën Iljazi u shqua gjatë luftërave në lagjen Samatia në hyrje të qytetit, pranë fortesës Jedikule (Shtatë Kullat).

Për merita të veçanta, në këtë zonë, u ngritën disa vepra me emrin e këtij prijësi ushtarak. Në kuartjerin Jedikule të Stambollit u hap një xhami me emrin e Iljaz Beut, i cili pranë saj ndërtoi një Teqe të Rufaive, të cilit sekt ai i përkiste, si dhe një imaret. Xhamia e Iljazit në Jedikule ka një histori interesante, që e lartëson mjaft figurën e këtij prijësi me kombësi shqiptare (fig. 1). Në lagjen Jedikule, ngjitur Samatias, ka qenë një nga monumentet më të njohura bizantine. Në kohën e sundimit të perandorit Leon I (v. 457-474) patriarku Studios u emërua Konsull i lindjes. Në vitet 456-463 ai ndërtoi një kishë nën drejtimin e Johan Prodhromit[4] (fig.2). Më vonë pranë kishës ngriti manastirin. Kisha dhe manastiri mbajnë emrin e Studios. Për mjaft kohë ky manastir shërbeu si një qendër fetare. Perandorët që hynin në qytet, nëpërmjet Portës së Artë të Via Egnatias në kalanë Jedikule pranë, vizitonin këtë manastir. Gjatë fushatave të kryqëzatave (v.1204-1261) kisha dhe manastiri pësuan dëmtime (fig. 3).

---

[1] Aldo Gallota, Iljaz Beg, i mutevelli e le origini di Corizza , në The Via Egnatia under Ottoman Rule 1380-1699, Rethymnon, 1996,113.

[2] Sami Frashëri, Kamus'al Alam II, 1208, në Tahir Dizdari Fjalor Orjentalizmave në gjuhën shqipe, Tiranë 2005, 661.

[3] Nuci Naci, Korça edhe kayndet e Qarkut, Korçë 1923 , në The Via Egnatia....., fq. 115.

[4] Santa Sofia , Guia de los Museos, fq. 82.

DO NOT COPY



Fig. 1. Xhamia e Iljaz Bej Mirahorit në vitin 1877 në Jedikule, Stamboll.



Fig. 1. Planimetria e kishës së Studios në Jedukile.



Fig. 3. Pamje lindore e kishës së Studios

Në vitin 1293 ky objekt u restaurua nga Konstantin Paleologu dhe më pas u rrethua me mure nga Androniku i II (v. 1282-1295).

Pas pushtimit të Stambollit në vitin 1453 nga Mehmeti i II, Pushtuesi, kisha e Studios u transformua në xhami. Më pas gjatë perandorisë së Sulltan Bajazitit II (v.1481-1512) kjo xhami mori emrin e Iljaz Bej Mirahorit, i dalluar në betejën e Samatias. Në periudhën osmane xhamia e Mirahorit në Stamboll konsiderohej si një nga xhamitë më të mëdha të qytetit.

Në vitin 1782 objekti pësoi një djegie, nga e cila u dëmtua çatia, kolonat dhe galeria e sipërme. Më pas u restaurua në vitet 1820-1821. Në tërmetin e vitit 1894 kisha u dëmtua përsëri, ndërsa në vitin 1908 çatia e saj u rrëzua nga ngarkesa e dëborës. Kisha e tipit bazilikal përbëhet nga naosi qëndror dhe nga dy nefe anësore. Kolonat që ndërpresin hapësirat janë dëmtuar nga djegiet dhe tërmeti, duke mbetur vetëm gjashtë prej tyre. Në një qoshe të manastirit të kishës ruhen mbetjet e minares së xhamisë (fig. 4).

Gjatë shekujve XVIII-XIX në objekt janë kryer punime të rëndësishme për t'i dhënë asaj sa më tepër tiparet e një xhamie tashmë. Kjo kishë, më e vjetra e Stambollit, më pas xhami, është monument kulture dhe mbahet si qendër e vizitueshme turistike, duke qenë një nga pesë objektet më të rëndësishme muzeale nën administrimin e Shën Sofisë së famshme (fig. 5)[5].

Përshtatja në xhami e kishës së Johan Prodhromit të manastirit Studios u krye në vitin 1486 nga sulltan

[5] Po aty, fq. 84.

DO NOT COPY



Fig. 4. Kisha e Studios pas dëmtimit



Fig. 5. Hyrja e xhamisë-muze e Iljaz Bej Mirahorit në Jedikule - Stamboll

Bajaziti II (1481-1512), biri i Mehmetit të II[6]. Ekzistenca e një xhamie në Stamboll, pikërisht mbi themelet e kishës më të vjetër paleokristiane, me emrin e Iljaz Bej Mirahorit, dëshmon për vlerat e shqiptarit nga Panariti dhe për konsideratën që ai gëzonte në administratën e lartë të Stambollit. Mirahori arriti të bëhej dhe dhëndër i Sulltan Bajazitit të II[7]. Sot nga "Mirahor Mahalla" e asaj kohe, pranë xhamisë, ka mbetur një rrugë kryesore në Jedikule, e cila njihet me emrin Iljaz Bej Mirahor Xhadesi (fig. 6).

Kështu sot në Stambollin 12 miljonësh, ruhet xhamia muze e Mirahorit në lagjen Jedikule, një rrugë kryesore e lagjes mban emrin e tij dhe pranë xhamisë kanë qenë



Fig. 6. Imrahor Xhadesi në Jedukile - Stamboll

ndërtuar një Teqe e Rufajve dhe një Imaret për të varfërit prej tij. Të gjithë këto nuk janë pak për të vlerësuar një personalitet historik shqiptar në qendrën e Perandorisë së fuqishme Osmane të asaj kohe. Por vepra e Iljaz Beut nuk qe e njohur vetëm në qendrën e Perandorisë. Ai nuk e harroi vendlindjen e tij, Korçën.

Për meritat e mëdha në ekspeditat luftarake të perandorisë, Sulltan Bajaziti II i dha Iljaz Beut titullin "Mirahor Bej - Stallier i parë, njeri i ngarkuar në krye të mbikqyrjes dhe mbarështrimit të kuajve dhe stallave në sarajet e hershme të Sulltanit. Në moshë të thyer, Iljazi i kërkoi Sulltanit të kthehej në atdhe për të mbyllur atje ditët e tij. Bajaziti i II dha lejen dhe si shpërblim dhe me anën e një mylknameje i njohu atij pronësinë mbi fshatrat Leshnjë dhe Vithkuq në vitin 1484[8]. Dy vjet më vonë, në 1486, mylknameja (dokument për pronë vetiake), u shtua edhe me fshatin Boboshticë në kazanë e Korçës. Në vazhdim këtyre ju shtuan fshatrat Trebickë, Treskë, Vodicë, Stratobërdhë dhe Panarit. Në vitin 1495 mylku i tij në fshatrat Treskë e Panarit u shkëmbye me fshatin Peskopi, pasi ishte e vështirë vjelja e rentës së tyre[9]. Iljazi kishte statusin e "Princit" dhe me të drejtën e trashëgimit të pasurisë.

Në "Kodikun e Korçës" të vitit 1879 shënohet se "Korça , ky çiflig i vogël quhej atëherë Episkopi (fig. 7), që mezi përbëhej nga rreth 15 shtëpi çifçinjsh, të cilët më vonë me testamentin e tij Iljaz Beu i ngriti në rangun

[6] Istambul Ansiklopedisi, Instambull 1994, fq. 166.
[7] Selami Pulaha, Pronësia feudale në tokat shqiptare, Tiranë 1988, fq. 174.
[8] S. Pulaka, vep. Cit. fq.174.
[9] Po aty, fq. 175.



Fig. 7. Korça e viteve '20-të të shek. XX.

e vakëfeve[10]. Në fakt Korça dhe Peskëpia kanë qenë që para sundimit Osman dy vendbanime të afërta që u bashkuan në një, siç duket aty nga fillimi ose mezi i shekullit XVIII[11].

Në Vakëfnamenë e Iljaz Beut, e vitit 1505 theksohet fshati Peskopje, në vartësi të Gorrixhes (Korçës). Sipas Nuçi Naçit para vitit 1487, Korça ka qenë një fshat i vogël me 5-10 shtëpi dhe quhej "Peskëpi". Kujtohet dhe një kishë me emrin Shën Parasqevie (Shën e Premtja)[12]. Puna e parë që Iliaz Beu bëri në Korçë ishte ngritja e tempullit të tij, Xhamisë së Mirahorit. Ky objekt i njohur, vepër e tij, sipas mbishkrimit në gurin e portës i takon viteve 1495-96[13] (fig. 8). Xhamia e Mirahorit në Korçë



Fig. 8. Mbishkrimi me datën në hyrjen e xhamisë Mirahorit - Korçë

[10] Ligor Mile, Çështje të historisë agrare shqiptare, Tiranë 1984, fq.92.
[11] po aty.
[12] The Via Egnatia....., fq. 115.
[13] Machiele Kiel, Otoman Architecture in Albania, Instambul 1990, 162.

përfaqëson një nga ndërtimet më interesante të gjinisë së tij në vendin tonë (fig. 9). Ajo ka sallën qendrore të lutjeve, e pasur me piktura muzeale dhe me mafilin mbi portën e hyrjes (fig. 10). Mbulesa e sallës kryesore është një kupolë sferike veshur me plumb. Në hyrje ka hajatin, edhe ai i mbuluar me kupolë e veshur me plumb. Minareja e xhamisë është rrëzuar nga tërmeti i pas Luftës së Dytë Botërore dhe pret të ringrihet gjatë vitit 2006. Prapa xhamisë ndodhet tyrbja e Goxha Mirahorit (fig. 11).



Fig. 9. Fasada kryesore e xhamisë së Mirahorit - Korçë



Fig. 10. Luterjeri i xhamisë së Iljaz Bej Mirahorit - Korçë

Iljaz Bej Mirahori[14], gjithë pronat e tij i ktheu në "Vakëfe" që ishin "Pasuri e tundëshme ose e patundëshmen dhe toka në prona të insitucioneve fetare myslimane, të dhuruara nga Sulltanët, feudalët e mëdhenj ose besimtarët. Kthimi në vakëf i çdo pasurie bëhej me anën e një akti gjyqësor të hartuar nga kadiu,

[14] Burime të Zgjedhura per Historine e Shqiperise , v. III, 1962, 80.

DO NOT COPY



Fig. 11. Tyrbja dhe xhamia e Iljaz Bej Mirahorit në vitin 1946

që quhej "Vakufname". Është e njohur vakufnameja e Iljaz Bej Mirahorit e datës 5 shkurt 1505.

Këtu përmenden gjithë pronat e tij si në Kostandinopojë ashtu dhe në katundin Peskopie dhe në malësinë e Korçës, rreth fshatit Panarit, të cilat edhe sot njihen me emërtimin krahina e Vakëfeve.

Në këtë dokument shënohen qartë të gjithë veprat e ngritura prej tij si xhamitë, hamamet, minaret, depot, furrat, hanet, etj. Për administrimin e pronave të tij vakëfe, ai caktoi "Myteveli"-administrator, kujdestari i vakëfit që zbatonte në shpërndarjen e të ardhurave të vakëfit të gjitha kushtet e caktuara në vakëfname. Detyra e myteveliut ishte e trashëgueshme. Akoma sot në Korçë e Tiranë jetojnë pjesëtarë të familjes Myteveli, admnistratorë të vakëfeve të Iljaz Bej Mirahorit. Kur u kthye në Shqipëri Iljaz Beu kreu dhe funksione politiko - administrative. Për një pjesë kohe ai qe emëruar nga Sulltan Bajaziti II Sanxhakbej i Janinës, një nga njësitë administrative të njohura të Perandorisë Osmane në atë kohë. Sipas Sami Frashërit, Iljaz Bej Mirahori ka vdekur në vitin 1501[15]. Nuk dihet nëse ky dokument është shkruar pas vdekjes së tij, bazuar në testamentin e tij.

Ai është varrosur në Tyrben me emrin e tij prapa xhamisë së Mirahorit. Në këtë tyrbe ndodhen tre varre. Në mes ndodhet varri me eshtrat e Iljaz Bej Mirahorit, djathtas tij ndodhet varri i djalit, ndërsa në të majtë është varri i gruas së tij. Në hajatin e tyrbes kanë qenë varrosur gruaja e tij e dytë (mulate) dhe shërbyesja . Për të gjithë këto të dhëna falenderoj nënën time, Muhazes Pojani (Shtylla), familja e së cilës duke banuar shumë kohë në lagjen pranë xhamisë, ka pasur lidhje të hershme me këtë objekt të njohur kulti në qytetin e Korçës.

Objektet më dinjitoze të lidhura me emrin e Iljaz Bej Mirahorit, Imrahor Xhamia në lagjen Jedikule të Stambollit dhe Xhamia e Goxha Mirahorit në vendlindjen e tij Korçë, (Goxha - i respektuar, i madh) janë monumente kombëtare. Në Stamboll Manastiri Studios - xhamia Imrahor është objekt mjaft i vizitueshëm, me një pllakë bronzi me emrin e tij në hyrje të muzeut. Nën administrimin e muzeut me përmasa botërore të Shën Sofisë, objekti ruhet në gjendjen e monumentit rrënojë pa çati, me elementë të qartë të arkitekturës bizantine dhe osmane. Ajo përfaqëson një vepër të rëndësishme dhe të respektuar nga zyrtarët dhe banorët e lagjes Jedikule të Stambollit të madh. Edhe xhamia e Goxha Mirahorit në Korçë si monument kombëtar mbrohet me ligj nga shteti shqiptar. Ai mirëmbahet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe gjatë vitit 2006 është vendosur të ringrihet minareja e xhamisë me fondet e shtetit shqiptar.

Studimi i veprës së Iljaz Bej Mirahorit, si një udhëheqës ushtarak i Perandorisë Osmane të shekullit të XV dhe si themelues i qytetit të Korçës, përbën një detyrim për studiuesit tanë. Kjo edhe për të pasuruar listën e emrave të mëdhenj që historia e Shqipërisë ka nxjerrë gjatë shekujve për të mbushur faqet e saj. Duhet përgëzuar nisma e intelektualëve dhe njerëzve të thjeshtë nga krahina e vakëfeve, që kanë krijuar Shoqërinë Vakëfët me gazetën e saj "Tradita". Ata kanë të drejtë të krenohen me birin e madh të trevës së tyre, i cili me gjithë ofiqet dhe priviligjet që kishte në Stamboll preferoi të kthehej në vendlindjen e tij. Këtu Iljaz Bej Mirahori ngriti shumë vepra bamirësie duke i qëndruar pranë njerëzve të thjeshtë. Shpirti i tij i madh, bamirësitë që ai bënte dhe patriotizmi i tij e kanë ngritur figurën e tij në rangun e një shenjtori. Tempulli i Studios në Jedikule të Stambollit dhe Tyrbja e tij në xhaminë e Korçës përfaqësojnë vende të shenjta, të respektuara nga të gjithë. Korça duhet ta ketë për nder një themelues- figurë historike siç është ajo e Goxha Iljaz Bej Mirahorit.

[15] The Via Egnatia,....., fq. 121.

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

Iliaz Bej Mirahori a national historic figure

DO NOT COPY

History of the Albanian boy from Panariti, Korce clarified during XV century with stabilisation of Ottoman Empire on our country. Compared by the military, patriotic and politic values he overcomes the status of local leader. Sami Frasheri wrote that "Iliaz Bej Mirahori was his great grandfather by my mother side".

When he was 10 years old was taking as hostage by the Turkish military unit of Murati Sultan II (1421-51). Panariti boy was became one of the high military officers of Ottoman Empire. During the fight for conquer of Constantinople by Mehmeti Sultan II. Iliaz was distinguished during fights at Samatia quarter en entrance of the city close to Jedicule fortress (seven towers). Some building was built at this quarter for his merits. In Jedicule above the foundations of Johan Prodhromi church which belong V century was built up the mosque with his name and a tekke. Today main road of Jedicule quarter is named Iliaz Bej Mirahor Xhadesi.

Sultan Bajaziti for special merits give to the Iliaz Beu nomination "Mirahor Bej"-First Stableman-a person charged with Sultan Cavalry.

Iliaz when became older come back at his country and take as a property mountainous villages of Korca like Panarit, Treske, Trebicke, Vithkuq etc. also at 1495 he take village Peskopi or Korca nowadays. On Vakefnamen of 1505 year, is stressed name Peskopje which was depended from Gorrixhes (Korca). His temple Koxha Mirahorit Mosque was the first building raised up at Korca. Behind the Mosques is Koxha Mirahorit Tyrbe* when between three tombs is his tomb, on the right; tomb of his son and on the left; the tomb of his wife. The well-known objects linked with the name of Iliaz Beut are: Mosque at the Jedicule on Instambul and Koxha Mirahorit Mosque at Korca that have the Culture Monument Status.

*Tyrbe Mausoleum over a Moslem grave.

Ioannis VITALIOTIS

DO NOT COPY

SARANDË – BAZILIKA E 40 SHENJTORËVE
RAPORT PARAPRAK PËR AFRESKET - PIKTURAT PALEOKRISTIANE

Bazilika e 40 Shenjtorëve (Martirëve) në Sarandë (fig. 1) është nga monumentet më të rëndësishme jo vetëm në Shqipëri, por në një zonë gjeografike me të gjerë dhe përfshin krahinat e Epirit të Vjetër dhe Epirit të Ri (*Epirus vetus* dhe *Epirus Nova*)[1]. Gërmimet sistematike në këtë monument vazhdojnë prej vitit 2003 prej një ekipi shkencor të Institutit Arkeologjik të Tiranës nën drejtimin e Prof. Skënder Muçaj dhe prof. ass. Kosta Lako, në të cilin merr pjesë edhe autori i këtij shkrimi[2].



Fig.1 Bazilika e 40 Shejntorëve. Stoa jugore e portikut edhe muri jugor i nefit.

Bazilika është ndërtuar në një kodër të lartë shkëmbore që mbizotëron mbi qytetin e Sarandës, *Onchesmos*-in e lashtë (*Anchiasmos* paleokristian)[3]. Në veriperëndim të bazilikës është zbuluar pjesërisht një baptister, ku u gjetën edhe disa fragmente afreskesh. Përfundimi i gërmimeve në këtë monument, do të ndihmoj për t'u dhënë përgjigje mjaft pyetjeve që lidhen me fazat e ndryshme ndërtimore të monumentit. Nga të dhënat arkeologjike të deritanishme, duket së Bazilika e 40 Martirëve-Shenjtorëve, me formën që kishte marrë në shek.VI, duket së braktiset në në fund të këtij shekulli ose gjatë fillimit të shek.VII. Kjo përkon edhe me dyndjet avaro-sllave, për të cilat njohim se shkaktuan shkatërrime në shkallë të gjerë në një pjesë të mirë të Ilirikut, dhe në vitin 609 mbërritën përpara Selanikut. Këto dyndje është e sigurt se kishin pasoja serioze për krahinën sepse siç mësojmë nga burimet në Sinodin e 625 nuk përmendet më peshkopi i Anchiasmos. Në të kundërt ai përmendet gjatë gjithë shek. VII, si dhe në Sinodin

[1] Për bibliografin me të vjetër lidhur me monumentin e 40 Shenjtorëve shih : D. Pallas, *Epiros*, Reallexikon der byzantinischen Kunst, 2, Stuttgart 1971, colona 303-304, 307-308, J. Mitchell, *The Archaeology of Pilgrimage in Late Antique Albania: The Basilica of the Forty Martyrs*, W. Bowden, L. Lavan, C. Machado (ed.), Recent Research on the Late Antique Countryside, Brill, Leiden - Boston 2004, f. 147, 183-185.

[2] Autori i ketij artikulli merr pjesë në këtë projekt me cilësinë e studiuesit prej Qendrës Kërkimore për Artin Bizantin dhe Pasbizantin të Akademisë së Athinës. Do të doja të falenderoja kolegët e Institutit Arkeologjik të Tiranës dhe në radhë të parë prof. Skënder Muçaj, i cili më propozoi të marr pjesë në Projektin : "Monumente të Kultit Kristian në Shqiperi", ku m'u besua studimi i afreskeve, si dhe bashkëpunëtorët e tij Prof. ass. Kosta Lako dhe arkitektin Elio Hobdari për bashkëpunimin e frytshëm të deritanishëm si në Bazilikën e 40 Martirëve ashtu edhe në gërmimin dhe studimin në Kishat Bizantine të Shën Janit dhe të Peshkëpisë (pranë Nivice Bubarit). Do të doja gjithashtu të falenderoja Akademinë e Athinës dhe sidomos Akademikun prof. P.Vokotopoullo dhe Drejtoren e Qendrës së Kërkimeve të Artit Bizantin e Pasbizantin (KEVMT) z. Ioanna Bitha, të cilet propozuan dhe mbështetën bashkëpunimin tim me kolegët e Institutit Arkeologjik të Tiranës, duke e inkuadruar (përfshirë) atë në Projektin: Monumente të Kultit Kristian në Shqipëri - indeksi i afreskeve bizantin. **Dua gjithashtu të shpreh falenderim të përzemërt Prof: ass. Kosta Lakos për përkthimin e artikullit tim në shqip.**

[3] Për Onchesmos shih: K. Lako, *Kështjella e Onhezmit*, Iliria 2, 1984, f.153-205; po ai, *Dinamika e zhvillimit të Onhezmit*, Iliria 1,1986, f.273-281; po ai, *Bazilika e Onhezmit*, Iliria 1991, f.123-186; po ai, *Enë balte nga qyteti i Onhezem-Ankiazmit (Sarandë,)* Iliria 2001-2002, f. 283-316.

DO NOT COPY

e 516[4]. Me gjithë braktisjen, muret e monumentit ruheshin në një fare lartësie relativisht të mirë deri në Luften e Dytë Botërore[5]. Madje nderimi i 40 martirëve që u martirizuan gjatë sundimit të Licinit në liqenin e ngrirë të Sebastias[6], mbijeton ende në rajon. Këtë e përforcon edhe gjetja e afreskeve-pikturave që mund të datohen në shek.13 dhe që paraqesin martirizimin e 40 Martireve, në bazilikën e rrënuar të Peshkëpisë, pranë fshatit Nivicë, po edhe paraqitja e tyre në konkat anësore të kishës të manastirit pasbizantin të Kakomesë.

Si vendi në të cilin është ndërtuar monumenti, ashtu edhe tiparet e tij morfologjike (distancat, strukturat e mureve të bazilikës me konkat, kripti me mjediset e shumta) të cilat përbëjnë në fakt një *unicum*, tregojnë se kemi të bëjmë me një kishë me karakter pelegrinazhi, d.m.th me një *martirium*[7]. Fatkeqësisht për themelimin e bazilikës burimet heshtin. Katër mbishkrime me tulla në anët e jashme të mureve veriorë e perëndimorë përmendim tre emra dhuruesish, Parigorin, Qiriakon dhe Theodhorin, ndërsa në atë të katërtin emri ka humbur[8]. Mbishkrime paleokristianë me tulla me emra dhuruesish janë mjaft të rralla dhe është me rëndësi të veçantë që ruhen mbishkrime të tilla në këtë monument. Informacione më të vjetra përmendin dhe mbishkrime të tjera dedikuese, të cilat ndodheshin në muret e jashtme të bazilikës (duke përfshirë edhe absidën), por që tashmë nuk ruhen më.

Kripta e bazilikës përbën një tërësi mjedisesh dhe hapësirash me përmasa të ndryshme, të cilat kishin shpesh edhe funksione të ndryshme. Në fakt bërthamën e saj (kriptës) e përbëjnë dy radhë paralele mjedisesh[9], të cilat shtrihen nën pjesën e përparme të naosit, i cili kufizohet nga dy çiftet perëndimore të konkave (respektivisht në murin verior e jugor). Këto mjedise mbuloheshin me qemere guri dhe kanë planimetri drejtkëndore, me përjashtim të mjediseve **B15** (kapela lindore) dhe B24 (kapela perëndimore) (fig. 2) të cilat kanë edhe nga një konkë në anën e tyre lindore. Të gjitha



Fig. 2. Kripta e bazilikës. Mjedisi B24 (kapela perëndimore).

hyrjet e këtyre mjediseve ndodhen në anën e tyre perëndimore dhe përgjatë mureve gjatësor kanë bankina të ulëta. Dy radhët e mjediseve të bërthamës së kriptës (mjediset B15 deri B26)[10] lidhen (komunikojnë) midis

[4] E. Hrisos, *Simvoli stin istoria tis Ipeirou kata tin protovizantini epohi*, Ipirotika Hronika, vol.23, Joannina 1981, f. 79-80, 101.

[5] Foto të mureve të ruajtur të bazilikës janë botuar nga arkeologët: L. M. Ugolini, Albania antica I , Roma 1927, f. 144-146, E. Dyggve, *Die altchristlichen Kultbauten an der Westküste der Balkanhalbinsel*, Atti del IV Congresso internazionale di archeologia cristiana I, Città del Vaticano 1940, f. 391-414, fig. 20, 21 (shih edhe: Mitchell, *The Archaeology of Pilgrimage*, op.cit., fig. 1, 3, 4).

[6] Në përgjithësi për 40 Martirët e Sebastes shih : Lexikon der Christlichen Ikonographie, 8, Rome/Fribourg/Bâle/Vienne 1976, colona 550-553.

[7] Bibliografia për *Martirium*-et dhe në përgjithësi për kultin e martirëve në periudhën paleokristianë është mjaft e pasur. Përveç studimit bazë të A.Grabar, Martyrium. Recherches sur le culte de reliques et l'art chrétien antique, Paris 1946, shih edhe R. Krautheimer, *Mensa, coemeterium, martyrium*, Cahiers archéologiques 11 (1960), f. 15-40; B. Kötting, Die frühchristliche Reliquienkult und die Bestattung im Kirchengebäude, Cologne 1965; Friedrich Deichmann, *Märtyrerbasilika, Martyrion, Memoria und Altargrab*, Mitteilungen des deutschen archaeologischen Instituts, Römische Abteilung, 77 (1970), f. 144-69, Yvonne Duval, Loca Sanctorum Africae. Le culte des martyrs en Afrique du IVe au VIIe s., I-II, Rome 1982, J. Crook, The architectural Setting of the Cult of Saints in the Early Christian West c.300-c.1200, Oxford 2003, ku mund të kërkojë një bibliografi më të plotë për këtë qëllim. Për përhapjen e nderimit të martirëve gjatë periudhës paleokristiane shih: Lycy Grig, Making Martyrs in Late Antiquity, London 2004.

[8] Këto mbishkrime janë mbuluar në një fazë më të vonë ndërtimore, kur u shtua portiku i jashtëm.

[9] Parapëlqejmë termin "mjedise" në vend të "kapelë", sepse termi "kapelë" presupozon edhe kryerjen e ceremonisë fetare (meshës hyjnore) në të. (shih për përdorimin problematik të termit "kapelë" I. Vitaliotis, *Quelques remarques sur la fonction des compartiments dits 'chapelles' des églises byzantines*, Proceedings of the 21st International Congress of Byzantine Studies, London 21-26 August 2006, v. III, Abstracts of Communications, f. 256-257).

[10] Si planimetri është përdorur ajo e botuar prej J.Mitchellte (*The Archaeology of Pilgrimage, op.cit.*, f. 153 [W. Bowden]) të cilat janë emërtuar mjediset vijnë nga planimetria e kriptës që ka realizuar arkitekti Elio Hobdari, që është dhe anëtar i ekipit për gërmimin dhe studimin e monumentit, planimetri e cila do të botohet së afërmi.

që prej shek. 5[13] (fig. 4). Harqet e shkruar mbështeten mbi kapitele të shkruar. Në vartësi të gjerësisë së murit, harku që përmban kryqin mund të kufizohet prej dy me të vegjëlve. Gjurmë, por edhe një pjesë të madhe prej fazës II, gjejmë përveç se në B7, edhe në mjediset B15, B16, B17, B18, dhe B26 si dhe në B3 (poshtë stoas perëndimore të portikut).

Faza III mbuloi shtresën e fazës II dhe u shtri në të gjithë muret e mjediseve. Që të realizohej kjo, muri lindor i mjediseve u mbulua nga një shtresë e hollë suvaje, ndërsa në muret e tjerë tihografia duket së është bërë mbi suvanë ekzistuese. Si rrjedhim në murin lindor shtresa e re është shembur (ka rënë), në pjesën më të madhe dhe është shfaqur shtresa e vjetër, që lidhet me fazën e parë të dekorit pikturor.

Në të kundërt me shtresën me të hershme të vizatimit të afreskut (faza II), faza III përbëhet prej paraqitjeve figurative, të cilat plotësohen prej një dekori bimor shumëngjyrësh. Përmbajtja e dekorit është e larmishme: Kemi lokalizuar një skenë nga Dhiata E Re, një skenë që mund të interpretohet si procesion, skena që duket se paraqesin martirë, si dhe fragmente skenash, të cilat nuk është e mundur të lokalizohen qoftë dhe në mënyrë hipotetike. Faqet e mureve, duke filluar prej hyrjes së mjediseve duket se mbuloheshin me dekor bimor dhe floreal, në rast se mund të gjykojmë prej fragmenteve të ruajtura, si për shembull në **B15** (kapela lindore) (fig. 5). Fatkeqësisht "kapela perëndimore" (B24), që është edhe më e madhja, nuk ruan asnjë gjurmë të dekorit të pikturuar.



Fig. 4. Kripta e bazilikës. Mjedisi B17. Faza II e pikturës në murin lindor.



Fig. 5. Kripta e bazilikës. Hyrja e mjedisit B15 (kapela lindore). Faza III e pikturës (dekor floreal).

B7

Në murin lindor të mjedisit B7 ruhen gjurmë prej tri fazave të dekorit pikturor (fazat I, II, III), vetëm që nga faza e dytë ruhet vetëm një temë, konkretisht mbi hapësirën e nishës B5. Bëhet fjalë për temën e njohur edhe nga mjedise të tjera të kriptës, ate të kryqit me germën R (P greke, të pa mbyllur plotësisht), në formën e monogramës së njohur si kryqiformë[14] (fig. 6). Shtresa e

[13] Shih p.sh., W.Jobst, *Ein spatantiker Strassenbrunnen in Ephesos*, O.Feld & U.Peschlow (ed), Studien zur spätantiken und byzantinischen Kunst, Friedrich Wilhem Deichmann gewidmet, Bonne 1986, 1, f.47-62, tab.13, fig.1-3. Shih, gjithashtu kryqet në reliev që dekorojnë perdet ndarëse paleokristiane në kishën e Shën Françeskos në Ravena (fillimi I shek.6-të), ku çdo kryq kufizohet prej dy kolonetave që mbajnë konke në formë **guaske** (F.W.Deichmann, Ravenna. Geschichte und Monumentë, Wiesbaden 1969, f. 75 dhe fig.116, 116 A).

[14] Ndërthurja e kryqit me monogramin e krishtit, përbën një variant të kristogramit tipik dhe është veçanërisht i përhapur, sidomos në Mesdheun Lindor që nga mesi i shek.5 (Shih: M.Sulzberger, *Le Symbole de la Croix et les Monogrammes de Jésus chez les prémiers Chrétiens*, Byzantion 2 [1925], f.401, 427, 448, zërin *Christogramme* në Lexikon der Christlichen Ikonographie, Rom/Freiburg/Basel/Wien, 1 (1968), col. 456, zërin *Kreuz*, *op.cit.* vol.2(1970), col. 569-570 edhe N.Laskaris, Monuments funéraires paléochrétiens [et byzantins] de Grèce, Athènes 2000, f.453, n.54. Kryqi me P greke është një variant tjetër i së njëjtës temë dhe duket se shfaqet prej shek. V (Laskaris, Monuments funéraires, *op.cit.* f. 544-545).

DO NOT COPY

tyre nëpërmjet një korridori të mbuluar me qemer në formë eliptike (B14). Ky korridor ka nga një dalje në formë tuneli si në anën veriore ashtu edhe në anën jugore (dy dalje). Këto dalje të çojnë në atë pjesë të kriptës që përkon me anën jugore të portikut (mjediset B8-B7).

Kompleksi i kriptës përfshin gjithashtu edhe një hapësirë të gjerë, pothuaj të përbashkët, të mbuluar me qemer harkor, i cili ndodhet nën narteks (mjediset B9, B10, B11, B12), si dhe hapësirën nën portikët, duke patur kështu formën e germës Ð. Pjesa e kriptës poshtë stoas veriore të peristoas (B27), është plotësisht e hapur, përderisa peristoa në atë pjesë është shembur.

Së fundi, kripta përfshin edhe hapësirën poshtë anës jugore të peristoas. Kjo hapësirë gjatësore dallohet qartë në dy pjesë jo të njëjta në gjatësi, në perëndim (prej perëndimit në lindje: B4, B8), që është dhe më e gjata, dhe lindorja B7, që komunikon me B8 përmes një hapjeje harkore, që krijohet prej dy anëve të portës), respektivisht në muret e anës veriore e jugore. Me vlerë të veçantë në këto mjedise janë pangot e ndërtuara përgjatë mureve gjatësor, si dhe të dy hapjeve drejtkëndore, **në formë nishës** *(fenestellae)* në murin lindor[11], në një lartësi prej dyshemesë, afro 0.85-0.90 m. (fig. 3) Nishet të çojnë në dy mjedise gjatësore shumë të ulta e të mbuluara me qemer [B5 në veri e B6 në jug], të cilët në murin e tyre lindor përmbajnë edhe një nishe drejtkëndore më të vogël, që të çojnë secila, në një **hapësirë** shumë të vogel, të ndërtuar nga të gjitha anët [respektivisht B32 dhe B33]. Ka shumë mundësi që mjedisi B7 dhe **hapësirat** në vazhdim (fasada e të cilave ishte dekoruar me piktura), lidhej me kultin e relikeve të shenjtorëve, që ndoshta kanë qenë ato të **40 Martirëve të Sebastës**. Në këtë rast nishet ishin diçka e përafërt me *lokulit.*



Fig. 3. Kripta e bazilikës. Mjedisi B7.

Afresket e Kriptës

Fragmentet e afreskeve që ruhen në kriptë, kryesisht në mjediset e bërthamës, rekomandojnë, megjithë gjendjen e tyre fragmentare, një tregues të rëndësishëm për afreskun paleokristian, jo vetëm në Shqipëri, por edhe me gjerë në hapësirën gjeografike që përcaktonin krahinat romake të Epirit të Vjetër dhe Epirit të Ri (Ancienne et Nouvelle, *Epirus vetus, Epirus Nova).* Gjithashtu dekori pikturor i kriptës mund të sjellë të dhëna të rëndësishme për shpjegimin e **funksionit** të mjediseve[12].

Nga dekori vizatimor(pikturor) të fazës së parë, ruhet një fragment i vogël me ngjyrë të kuqe në murin lindor të mjedisit B7, konkretisht pranë **hapjes** që të çon në **hapësirën** B5. Ka shumë mundësi që faza I të kufizohej në **mjedisin** B7. Nga faza II ruhen mjaft fragmente. Duket se kjo fazë kufizohet vetëm në murin lindor të mjediseve me qemer të bërthamës së kriptës (ku faza II përbën shtresën më të hershme të afreskeve), si dhe të atyre të B7. Tema kryesore - që jepet me bikromi (dy ngjyra) apo monokromi (një ngjyrë), mbi sfond në ngjyrë oker- është nënvizimi i kryqit latin nën hark, me krahët të zgjeruar në anët e shtagave, temë kjo që përgjigjet shpesh në teknikën paleokristianë (afreske e skulpture),

[11] Këto nishe (*fenestellae*) lidhen me besimin dhe nderimin e relikeve të martirëve në kisha pelegrinazhi paleokristianë. Karakteristike janë ***fenestellae*** në kriptën e kishës së Shën Ioannit dhe Pavlit (San Giovanni e Paolo) në Romë (shih: Crook, The architectural Setting, *op.cit.*, f. 46, fig. 8 [sipas Colinit, 1944]).

[12] Dekori piktural është i pabotuar, me perjashtim të artikullit të **J. Mitchell,** *The Archaeology of Pilgrimage, op.cit.*, f.145-186. Theksojmë se ky artikull është shkruar përpara punimeve pastruese e konservuese të kryera nga restaurorë të Institutit të Monumenteve, fal të cilave, duhet thënë se u zbuluan afresket që nuk ishin fare të dukshme deri në 2006. Punimet ende nuk kanë përfunduar. Rishtas është botuar një guide popullarizuese për zonën e Sarandës foto nga afresket e mjedisit B18 (R. Hodges, Saranda, ancient Onchesmos. A short History and Guide, Tiranë, f. 47). Në **tekst** afresket datohen pa ndonjë argumentim në shek. 9.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 6. Kripta e bazilikës. Muri lindor i mjedisit B7 edhe hapësira e mjedisit B5.



Fig. 7. Kripta e bazilikës. Mjedisi B15 (kapela lindore). Faza III e pikturës në murin verior (grup grash).

dytë e pikturës (faza II) ka mbuluar një fazë me të hershme me pikture, prej të cilës ruhen vetëm në një pikë gjurmë të pakta në ngjyrë të kuqe (**faza I**). J.Mitchell përmend figura të plota trupore shenjtësh në murin verior të mjedisit[15], prej të cilave sot nuk ruhet asnjë gjurmë dhe nga gjurmët e suvasë në këtë zonë duket së shkatërrimi është kryer rishtas kohët e fundit, para se sa monumenti të mbrohej më me kujdes prej Institutit të Monumenteve.

B15[16]

Prej fazës II (shtresa më e hershme në bërthamë të kriptës) ruhen pjesërisht gjurmë të harkut të pikturuar, i cili ka shumë të ngjarë të përfshinte edhe konken. Në murin **verior** të mjedisit B15 paraqitet një grup grash me kokat e mbuluara me vello (fig. 7). Ka shumë të ngjarë që të përbënte pjesë të një kompleksi më të gjerë. Ngjyrat janë larguar dhe mbetet kryesisht ngjyra e kuqe, me të cilën janë dhënë tiparet karakteristike të figurave. E njëjta shtresë pikture vazhdon edhe në murin lindor. Këto piktura i takojnë fazës III.

B16[17]

Në B16 dallohen disa gjurmë pikture (Fazat II dhe III), por ende nuk janë kryer punime pastruese e konservuese.

B17[18]

Prej fazës II, në murin lindor, ruhet një pjesë e madhe e dekorit. Skena përbëhet prej tre harqesh të pikturuara të njëpasnjëshme (prej harkut në pjesën e dhjathtë/ jugore të murit ruhen disa fragmente të vogla). Harku qendror është më i madhi dhe më i larti prej të tre harqeve dhe përmban kryq me ekstremet e krahëve të zgjeruara (ruhen në gjendje fragmentare). Harqet dhe kryqi janë dhënë me ngjyrë të kuqe dhe të zezë, ndërsa anët e tyre të brendshme janë dekoruar me viza zigzage dhe me pika. Prej fazës III dallohen në pjesën lindore të murit verior dy figura ballore me nimb (fig. 8), ndërsa në një plan të dytë paraqiten struktura arkitektonike prej të cilave varen perde. Kompozimi nuk është i rrallë në artin paleokristian dhe të kujton martirë, që falen në kupolën e Rotondës së Selanikut.[19].

B18 [20]

Mjedisi B18 ruan dekorin pikturor në pjesën më të madhe në krahasim me të gjitha mjediset e kriptës. Pjesa

[15] Mitchell, *The Archaelogy of Pilgrimage, op.cit.*, f.171.
[16] Mitchell, *The Archaeology of Piligrimage, op.cit.*, Chapel 6.
[17] Mitchell, *The Archaeology of Piligrimage, op.cit.*, Chapel 5.
[18] Mitchell, *The Archaeology of Piligrimage, op.cit.*, Chapel 4.
[19] J.-M. Spieser, Thessalonique et ses monuments du IVe au VIe siècle. Contribution à l'étude d'une ville paléochrétienne, Paris 1984, f. 125-164, tab. XXIII.1, XXIV.1, XXV. 1. Për këta mozaikë tani mbisundon mendimi, që i daton ata në dhjetëvjeçarët e parë të shek.6.
[20] Mitchell, *The Archaeology of Piligrimage, op.cit.*, Chapel 3.



Fig. 8. Kripta e bazilikës. Mjedisi B17. Faza III e pikturës në murin verior (figurë ballore me nimb që falet).

qendrore e dekorit të shtresës me të hershme (Faza II), në murin lindor, është shkatërruar në pjesën më të madhe (fig. 9). Më mirë ruhet dekori në pjesën jugore të murit. Kompozimi (tre harqe të vazhdueshme dhe kryqe) janë mjaft të ngjashme me ato të murit në B17.

Prej fazës më të re (faza III) ruhen mjaft afreske, të cilat paraqesin një interes **të** veçantë, për arsye se pikërisht nuk është e lehtë që të interpretohen. Shpresojmë se me pastrimin e plotë të tyre do të zbulohen të dhëna të cilat do të na ndihmojnë në këtë drejtim. Në



Fig. 9. Kripta e bazilikës. Mjedisi B18. Faza II e pikturës në murin lindor.

murin verior paraqitet një skenë nga Dhiata e Re, që do të duhet të identifikohen me thirrjen e Ioannit dhe të Jakovit (Ungjilli sipas Markut, 1,19). Qendrën e skenës e përfshin pasqyrimi i një anijeje brenda në liqen që kufizohet prej kodrash (fig. 10). Brenda në anije, në të dy anët e direkut, paraqiten dy burra, në të majtë një me mjekër (Jakovi) dhe **në të djathtë** një pa mjekër



Fig. 10. Kripta e bazilikës. Mjedisi B18. Faza III e pikturës në murin verior (anije brenda në liqen).

(Ioanni), të cilët duken se bashkëbisedojnë. Në anën e djathtë të kompozimit paraqiten pemë dhe brenda në liqen **peshk** dhe oktapod. Në krahun e majtë paraqiten, në shkallë me të madhe në krahasim me dy figurat e mëparshme, një figurë pa mjekër në këmbë, me hiton në ngjyrë gështenje të errët dhe mantel në ngjyrë qielli të thellë. Përreth kokës ka një **nimb** (fig. 11). Kjo figurë paraqitet e kthyer ¾ drejt vizitorit, në drejtim të anijes. Tiparet e portretit jepen të përmbledhur, por të pikturuara. Kjo figurë pa asnjë dyshim do të duhet të identifikohet me Krishtin.

Shumë me tepër problematike, nga ana e interpretimit, janë skenat që ruhen në murin B18. Në pjesën e saj lindore një burrë i ulur në fron me nimb tërheq mjekrën e një burri të ri, i cili gjithashtu ka **nimb** (thirrje e Matheut?) (fig. 12). Në të djathtë dallohen disa paraqitje arkitektonike dhe në anën e poshtme të të njëjtës skenë pasqyrohet një objekt që **ngjan** me një tryezë dhe një figurë me nimb që është përkulur mbi të. Në anën perëndimore të murit jugor të të njëjtit mjedis pasqyrohet në këmbë një figurë ballore burri me mjekër,

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11. Kripta e bazilikës. Mjedisi B18. Faza III e pikturës në murin verior (figura e Krishtit).



Fig. 12. Kripta e bazilikës. Mjedisi B18. Faza III e pikturës në murin jugor (thirrja e Mattheut?).

i cili gjithashtu ka nimb. Nga sa jemi në gjendje të gjykojmë, duket se skenat që përbëjnë dekorin e B18 nuk përfshihen në ndonjë program ikonografik konkret.

B19

Në B19 dallohet një dekor floreal (Faza III), falë kjo disa përpjekjeve, që janë bërë deri tani për pastrimin e tyre. Ka shumë mundësi që pikturat të ruhen në një sipërfaqe të madhe.

B26

Në mjedisin B26, në murin lindor, ruhen fragmente nga paraqitja e një harku mbështetur mbi kapitele kolonetash elegante (Faza II).[21] Prej Fazës III ruhen disa fragmente vetëm në murin verior. Në të paraqitet një figurë e re (ndoshta eksizton të paktën edhe një figurë e dytë), me kokë lehtësisht të përkulur, në një pozicoin ¾ (fig. 13). Ka shumë të ngjarë të kemi një paraqitje të procesionit ose të lutjes (*Deisis*)[22].



Fig. 13. Kripta e bazilikës. Mjedisi B26. Faza III e pikturës në murin lindor (figurë një njeriu të ri).

B3

Në hapësirën poshtë stoas perëndimore të portikut, në murin lindor, ruhen gjurmë nga një hark i pikturuar, i cili ndjek konturet e harkut të murit (hapësira mbulohej nga një qemer gjysëmsferik). Harku është dhënë me një ngjyrë të kuqe mbi një sfond të bardhë. Ka gjasa që të kufizonte një kryq, që sot nuk ruhet, për arsye se suvaja ka rënë plotësisht. Kemi të bëjmë me të njëjtën temë prej fazës

[21] Për arsye të gjerësisë së vogël të mjedisit në të nuk kishte hapësirë për paraqitjen e tri harqeve të njëpasnjëshëm.

[22] Shih procesionin e grave martire në Shën Apollinario të Riun (rreth 549) në : F.W. Deichmann, Fruhchristliche Bauten und Mosaiken von Ravena, Wiesbaden 1958, fig.104-106, 120-125 dhe respektivisht fig.100-102, 128-132. Gjithashtu shih Shenjtët në pozicion analog në kishën e Drosianis në Nakso (shek.7-të) shih: N. Drandakis, i paleohristianiqes tihografies sti Drosiani tis Naksou, Athina 1988, tab. XII, XIII, fig. 18).

II, që është e njëjtë edhe në mjediset e tjera të Kriptës (shih më sipër) dhe duhet t'i përkasë të njëjtës fazë.

Baptisteri

Shumë pak fragmente të dekorit të pikturuar, me tema të ndryshme, janë gjetur edhe në baptister, që ndodhet në anën veriperëndimore të bazilikës.

Kronologjia

Një seri të dhënash, që kanë të bëjnë si me teknikën e ndërtimit ashtu edhe me ikonografinë e pikturave të ruajtura të Kriptës, na çojnë në datimin e tyre në periudhën paleokristiane dhe më konkretisht në shek.6. Përsa i përket ikonografisë përmendim p.sh. temën me kryqin dhe kolonetat (faza II), Krishti pa mjekër në B18, martirët që luten si dhe paraqitjet arkitektonike në B17 (faza III) të dhëna të cilat janë të mjaftueshme që të përcaktojmë me saktësi këto afreske në periudhën paleokristiane dhe jo në periudhën mesjetare.

Me datimin e pikturave në shek.6 përputhet edhe datimi i fragmenteve të skulpturës arkitektonike që janë gjetur në bazilikë, të cilat do të botohen së afërmi. Ka shumë mundësi që faza II datohet në fazën e dytë ndërtimore të kriptës së bazilikës, kur bërthama e kriptës mori formën e tanishme. Kjo ka më shumë të ngjarë që të përkojë me rindërtimin e bazilikës gjatë shek.6, ndoshta gjatë sundimit të Justinianit I (527-665) ose Anastasit I (491-518), duke përbërë në këtë mënyrë një ndërtim mjaft impozanta, që t'i përgjigjet shërbimit të monumentit si vend pelegrinazhi (*martirium*). Në veçanti lidhur me fazën III, nga sa mund të vlerësojmë prej pikturave murale që kanë ardhur në dritë deri tani, mund të krahasohen nga pikëpamja stilistike me pikturat paleokristiane në Dhrosianit të ishullit të Naksos, ku datohen në përgjithësi gjatë fillimit të shek.7[23]. Mbi bazën edhe të dhënave të tjera arkeologjike (qeramika) faza III nuk duhet të vendoset më vonë se sa fillimet e shek.7, kohë gjatë së cilës bazilika u braktis. Kështu që një datim i pikturave të fazës III në fund të shek. 6 na duket mjaft i pranueshëm.

DO NOT COPY

[23] Shih: Drandakis, I paleohristianiqes tihografies, *op.cit.*

Ioannis VITALIOTIS

SARANDA – THE EARLY CHRISTIAN FRESCOES IN THE BASILICA OF THE FORTY MARTYRSA PRELIMINARY REPORT

DO NOT COPY

The Early Christian Basilica of the 40 Martyrs is one of the most important monuments dating from the Early Christian Period in the geographical area of the Roman provinces of Old and New Epirus (Epirus Vetus, Epirus Nova). The systematic archaeological excavations of the basilica are being carried out since 2003 by the team of the Albanian Archaeological Insitute, under the direction of Prof. Skënder Muçaj. The author of the present report collaborates with the above mentioned team on behalf of the Center for Research in Byzantine and Postbyzantine Art of the Athens Academy.

Based on the present archaeological data, which agree with the historical sources, the basilica seems to have been abandoned around the year 600, as a consequence of the invasions by the Avars and Slavs.

In the Basilica's crypt, more than one structural period is witnessed. This site is of particular interest also due to the arrangement of the area in smaller compartments, out of which two seem to have functioned as chapels. Another area of the crypt (B7 and the linked smaller areas B5-B32 and B6-B33) seem to be associated with the placement and worship of holy relics. The crypt retains fragments of fresco decoration in three phases. It is possible that Phase I was limited to area B7 where the only fragment exists (a few marks of color). Phase II of the frescos is limited to the east wall of the compartments. It contains non-figurative decoration with arcs grounded on thin colonettes and latin cross combined with a hook-shaped Greek P. Small or larger fragments of Phase II exist in compartments B15, B16, B17, B18 and B26 as well as the area under the western portico of the ambulatory (B3). Phase III covered the layer of Phase II (since the eastern wall of the compartments was covered by a thin layer of mortar) and spread to all walls of the compartments of the crypt. Phase III is comprised of figurative portrayals which are supplemented by colorful vegetal and flower decorations. The frontal figurës of the northern wall of B7, which seem to belong to that Phase, were recently destroyed before the site of the basilica was secured by the Institute of Monuments. On the east wall of the compartment B17 two faded figurës of martyrs stand frontally in an architectural framework. The most significant mural paintings from Phase III exist in compartment B18, where on the northern wall a scene from a boat is depicted, which most evidently should be identified as the calling of John and Jacob (Marc 1,19). Christ is represented beardless. In the southern wall there is a scene with a man on a throne with a nimbus who pulls on the beard of a man, also with a nimbus, while further down faded figurës with a nimbus, as well as architectural representations and images of other objects, all of them in fragmentary condition. Pieces from at least one figurë tilted to the west exist in compartment B26. This is most probably a representation of a prayer or a procession. From Phase III in compartment B15 (east chapel of the crypt) fragments of a group of veiled women exist, while in compartments B16 and B19 one can discern traces of paintings (work on the cleaning of these has not yet been done, except for some trial works in B19 which uncovered a floral decoration).

A series of strong indications, regarding the iconography as well as the style, lead us to fix the date of the crypt's frescoes to the 6th century, which is compatible with the dating of the fragments of architectural sculptures and the pottery found in the basilica. It seems namely that Phase II is contemporary to the erection of the basilica in its present form (under Justinian I or even under Anastasius I), while Phase III may be dated to the late 6th century, relatively few years before the abandonment of the site.

DO NOT COPY

Gazmend MUKA

SKENA E PROFETIT JONAS NË BAZILIKËN E 40 SHENJTORËVE NË SARANDË

Gjatë ekspeditave në bazilikën e 40 Shenjtorëve, në periudhën nëntor 2006 dhe shtator 2007, në Sarandë, e njohur nga banorët e zonës si "dyzetdhomshi", konstatuam një rivlerësim të monumentit qoftë nga gërmimet arkeologjike, masat paraprake konservuese, si dhe restaurimin e disa skenave murale në ambientin nëntokësor nga ana e institucioneve përkatëse*(fig.1). Në korridorin oval të kriptoportikut, në kapelën e parë, të dytë dhe të tretë, nga ana e hyrjes veriore, ishin zbuluar nga mbivëniet disa skena të pikturuara. Piktura murale shfaq dy faza që dallohen mjaft mirë dhe nga plombimet e kryera nga restauratorë të IMK. Identifikimi i skenave të pikturuara si dhe koha e realizimit të tyre, përbën qëllimin e këtij shkrimi.

Manastiri i 40 Shenjtorëve ka tërhequr vëmendjen e mjaft studiuesve shqiptarë e të huaj,[1] Gjatë gërmimeve arkeologjike, ka filluar të dalë në pah dyshemeja e sallës së bazilikës, ambiente anësore e gjurmë të konakëve. Në katin nëntokësor është shfrytëzuar pjerrësia e terrenit dhe dallojmë që muret mbajtës korrespondojnë me themelet e bazilikës mbi tokë. Qemerët katakombalë të kriptoportikut, janë mbështetur mbi këto mure. Vetëm tre kapelat më të mëdha, ku ajo e mesit është me apsidë,



Fig. 1

janë të pajisura me kamare, që komunikojnë midis tyre. Aty ku duhet të kishte mur mbajtës si tek të tjerat, është bosh. Pas ndërhyrjes restauruese dhe valorizuese lexohen mirë ambientet e katit nëntokësor, dyshemeja si dhe kanalet e ajrimit në pjesën e sipërme, ku kanë mbetur akoma dhe sot gjurmët e tubave prej qeramike në anën jugore. Midis strukturave me qemer katakombalë, për nga perëndimi, ndodhet çisterna e mbuluar me qemer në formë tuneli, e cila kuptohet qartë, tashmë nga suvaja dhe dyshemeja e saj me llaç e me pluhur tulle, si dhe nga tre këmbë shkallë në hyrjen veriore të saj. Arkitekti i bazilikës ka bërë kujdes të veçantë për kullimin e ujërave të shiut dhe mbledhjen e tyre në cisternë. Në kulmin e kodrës ku ndodhet bazilika mungojnë burimet natyrore të ujit. Nga ana veriore kanë dalë gjurmët e konakëve të manastirit. Lindja e manastireve në Egjipt në shek. IV, dhe në vende të tjera në Siri, në Mesopotami, në Palestinë, e më pas në Anatolia etj. Midis shekujve IV dhe V, manastiret pa dyshim luajtën

[1]Ugolini, L. M. Butrinti: Miti i Eneas, Gërmimet. Instituti Italian i Kulturës, Tiranë, 2000. Ugolini.L.M. Ricerche archeologiche, (Albania Antica I), 1927, Societa editrice d'arte ilustrata. Dyggve, E., Die altchristlichen Kultbauten an der Westküste der Balkanhalbinsel. In Atti del IV Congresso Internazionale di archeologia cristiana I :pp. 391-414. Città del Vaticano, 1940. Meksi, Aleksandër. Arkitektura paleokristiane në Shqipëri, Monumentet, IMK, Tiranë, 1985/2., Hodges, Richard. Saranda, ancient Onchesmos. Migjeni, Tiranë, 2007. Bowden, Will. Mitchell, John. The Church of the Forty Martyrs. Minerva 31, 2001, pp. 31-33., Mitchell, John.The archaeology of pilgrimage in late antique Albania: the basilica of the forty martyrs. In W. Bowden , L.Lavan and C. Machado (eds.), Recent Research in the Late Antique Countryside, Brill, Leiden and Boston, 2004 , pp.145-186. Muka, Gazmend, Bazilika që i dha emrin Sarandës. Monumentet, IMK, Tiranë, 2002, f. 7-41. Muçaj, S., Hobdari, F., Lako, K., Vitaliotis,Y., Kisha e 40 Shenjtorëve, Raport gërmimi 2003-2004, arkivi IA, Tiranë.

një rol themelor në krishtërimin e botës rurale të territoreve perandorake dhe përtej kufijve të saj[2].

Nga gërmimet arkeologjike janë pasuruar të dhënat mbi planimetrinë e bazilikës së 40 Shenjtorëve në Sarandë. Duken qartë shtatë konkat apsidale të botuara dhe më parë[3]. Planimetria e bazilikës, tashmë lexohet më qartë e në të dallojmë naosin, narteksin (mbi cisternën, ku mblidheshin ujërat), si dhe një ambient më përpara nga ana perëndimore, i cili korrespondon mbi korridorin nëntokësor që të çon në dhomën e relikeve, duke na konsultuar një atrium të pajisur me *impulvium* (mbi sterën e ujit, në katin nëntokësor), tashmë të zhdukur, ndonëse në pjesën e poshtme duken qartë gjurmët e pedentivëve, që ndihmonin në ndërtimin e kësaj daljeje (fig.2).

Kalimet e zbuluara midis konkave apsidale në naosin e bazilikës, dëshmojnë qartë ngjashmërinë e bazilikës së 40 Shenjtorëve në Sarandë me bazilikën e Mazencios në Romë, të evidentuar dhe më parë prej autorit[4](fig.3).



Fig. 2



Fig. 3

Po kështu, me interes është dhe ngjashmëria e planimetrisë së bazilikës së 40 Shenjtorëve në Sarandë me planimetrinë multiapsidale të sallës së banketeve në pallatin e Lousos në Kostandinopojë, në veri të hipodromit, mbi cisternën (Birbindirek), evidentuar nga Hodges[5] (fig.4). Pallati Lousos është i shek.IV pas Kr. Në



Fig. 4

[2]Concino, Ennio. Le Arti di Bizanzio. Bruno Mondadori Editori, Milano, 2002. pp.3.

[3]Dyggve, E., art. cit..., 1940. Meksi, Aleksander., art. cit.., 1985. Bowden, Will. Mitchell, John., art. cit...,2001. Muka, Gazmend., art. cit... 2002. Hodges, Richard. Saranda...2007.

[4]Muka, Gazmend. art.cit..., 2002, f. 7-41. Shih planimetrinë tek: Kostof, Spiro. A History of Architecture: settings and rituals. Oxford University Press, 1985, New York., fig.11.10, bazilika e Maxentius, rikonstruksion i intererit f.252. Mund të konsultojmë dhe vizatimet e Giovanni Battista Piranesit tek: Ficacci, Luigi. Giovani Battista Piranesi. Tachen, 2001.p.171.

[5] Hodges, Richard. Saranda....p. 47.

Do not copy

shek.VI pallati Lousos ishte plotësisht i shkatërruar[6]. Planimetria e pallatit Lousos vjen e punuar sipas Mûller -Viener më 1977[7]. Dyshimi i M.L.Ugolinit se rrënoja e kishës së 40 Shenjtorëve në Sarandë, të krijonte përshtypjen e një ndërtese publike të periudhës romake më tepër se sa të një kishe bizantine, lë shteg për një funksion të ndryshëm fillestar të saj[8](fig.5). Inkorporimi me copa qeramike, i një numri të konsiderueshëm të mbishkrimeve votive të krishtera (greqisht) në muraturën



Fig. 5

e fasadave të bazilikës së 40 Shenjtorëve, si nga ana lindore, interieri i faqes jugore (foto nga Sh.Toptani, botohen për herë të parë, fig.6-7) si dhe në atë perëndimore e veriore, dëshmon për një objekt kulti të krishterë qysh në ngjizje[9]. Megjithatë, mënyra e vendosjes së mbishkrimeve votive të lë përshtypjen se janë realizuar pasi është përfunduar ndërtesa, duke hequr rreshta gurësh nga faqja e murit dhe duke i rivendosur së bashku me copat e qeramikës që formulojnë mbishkrimin (fig.8-9-10-11).

Vlen për t'u përmendur se mbishkrimet votive në bazilikën e 40 Shenjtorëve ofrojnë një kaligrafi të njohur në periudhën midis shekujve IV-VI pas Kr[10]. Po kështu dhe studimi i fragmenteve të qeramikës, të përdorura në realizimin e mbishkrimeve votive të inkorporuara në



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 8



Fig. 9

[6] Kazhdan, Alexander. The Oxford Dictionary of Byzantium, 3 vols., Oxford University Press, 1991, vol. 1,pp. 518-519;
[7] Müller-Wiener, Wolfgang. Bildlexikon zur Topographie Istanbuls, Deutsches Archäologisches Institut, Tübingen, 1977,pp. 280-281. Shih planimetrinë dhe tek: Krautheimer, Richard. Curèiè, Slobodan. Early Cristian and Byzantine Architecture. Yale University Press, 1986, p.71.
[8] Ugolini, L. M. Butrinti...f.24.
[9] Muka, Gazmend, art.cit... f. 15. shih dhe tek Hodges. Saranda...pp. 33-34.
[10] ΑΝΤΟΥΡΑΚΗ, ΓΕΟΡΓΙΟΥ Β. ΧΡΙΣΤΙΑΝΙΚΗ ΑΡΧΑΙΛΟΓΙΑ ΚΑΙ ΕΡΙΓΡΑΦΙΚΗ; ΑΘΗΝΑ, 1991, pp.126-132

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11

muraturën e bazilikës, gjen përdorim në vitet 400-500[11]. Në bazën me mermer prokonezian, të obeliskut të Tutmosit të III-të, marrë prej Teodosit I dhe të vendosur në hipodromin e Kostandinopolit më vitin 390, është trajtuar tema e Epifanisë Perandorake me vizionin *Augustus* në relieve[12] (fig.12). Në të dyja anët është gdhendur një tekst *skriptacontinua* në latinisht dhe në greqisht[13] (fig.13-14). Theksojmë se karakteri kaligrafik i germave në



Fig. 12



Fig. 13



Fig. 14

[11] Hodges, Richard. Saranda...p.33.
[12] Concino, Ennio. Le Arti di...p.24.
[13] Sodini, Jean-Pierre. "Images sculptées et propagande impériale du IVe au VIe siècles: recherches récentes sur les colonnes honorifiques et les reliefs politiques à Byzance", Byzance et les images, La Documentation Française, Paris, 1994, pp. 43-94.

mbishkrimet votive të bazilikës së 40 Shenjtorëve, kanë të njëjtën natyrë me germat e tekstit në greqisht, të gdhendur në bazën e obeliskut të Teodosit të I.

Pikturat murale

Gjatë ekspeditave në vitin 2001 kishim konstatuar gjurmët e një portreti të pikturuar, disa harqe të pajisura me kryq, si dhe motive floreale, që i përkisnin repertorit të artit të krishtërimit të hershëm.[14]

Zbulimi nga mbivëniet dhe restaurimi pikturave murale të dala rishtas, në disa kapela të kriptoportikut me qemerë katakombalë, është padyshim një vlerë e madhe e artit të kësaj periudhe, në fondin tonë deri-diku të pakët.[15]

Në shtresën e parë ku figurohen vetëm harqe dhe kryqe me mbyllje në krahët në formë spirance, kemi konstatuar dhe më parë ngjashmërinë e tyre me pikturat e katakombeve të krishtera[16]. Kjo fazë korrespondon me periudhën kur midis subjekteve kristianë ishte më i rëndësishëm, Krishti, i cili fillimisht paraqitej nëpërmjet simboleve të kryqit, peshkut të integruara me simbolin e bukës, qengjit etj. Më vonë duke filluar shek IV, shfaqet tipi fizonomik i Krishtit me një natyralizëm helenistik drejt formave joorganike. Qëllimi i artit kristian në këtë periudhë ishte të shprehë me të dukshmen të padukshmen, kuptimin trashendent të Perëndisë. Ai shfaqet para nesh konkret, por do të shprehë abstrakten. Çdo objekt në të ka një vlerë simbolike duke paraqitur një kuptim abstrakt. Ky art nuk tregon apo paraqet histori me një renditje kronologjike, por ide që duhen kuptuar sapo përballesh me një imazh të krishterë. Ndihet në të një influencë e imazheve hebreje[17].

Shtresa e dytë e pikturës zbuluar së fundi, duket se korrespondon edhe ajo me fillimet e artit të hershëm të krishterë (paleokristian). Kjo duket dhe nga figurimi episodik i tyre pa ndarje me njëra-tjetrën dhe në sfonde të qarta[18]. Pikturat duken të lehta pa shumë ngarkesa vendesh identifikuese. Ato sjellin fillimet e ngjizjes së artit të krishterë në pikturë, ku doktrina figurative paleokristiane, ndërtoi një vizion metafizik, dematerializim të realitetit, zhdukjen e hapësirës, perspektivës, horizontit, të gjithçkaje konkrete, duke krijuar sipas Plotinit një "sy të brendshëm". Gjithçka materiale bëhet transparente, duke ofruar vlera shpirtërore, si një braktisje e estetikës klasike tradicionale[19].

Duke hyrë në kriptë nga hyrja veriore, në kapelën e parë me qemere katakombalë, arrijmë të dallojmë në faqen veriore fragmente të shumta degësh palmash (fig.15). Në pamundësi të gjetjes së elementeve të tjerë,



Fig. 15

ka gjasa të theksojmë se një sfond i tillë rezervohet në pikturën paleokristiane për skenën "Krishti vë në vend Ligjin tek Moisiu"[20]. Në kapelën e dytë gjurmët e ngelura nga piktura murale, japin mundësi më të mëdha në konsultimin e disa skenave të krishtera. Në shtresën e dytë të pikturës murale, tek kapela e dytë në anën jugore, kemi dy figura me aureola në ngjyrë blu të hapët, ku dallojmë paraqitjen e Krishtit, deri-diku mjaft e dëmtuar, por që njihet lehtësisht nga rekuizita e tij (fig.16). Krishti tërheq nga mjekra shenjtin, i veshur me tunike të bardhë dhe shirita të zinj, veshje mjaft e njohur në pikturën e krishtërimit të hershëm (fig.17). Portreti i shenjtit të kujton ikonografinë e atribuar Shën Teodor Stratilatit[21] (fig.18). Ai është figuruar në bazilikën e Shën Dhimitrit në Selanik, ndërtuar në shek.V, ndonëse në një skenë në mozaik me një stil të maturuar bizantin (Shën Maria

[14] Muka,Gazmend. art.cit...f.30.
[15] Hodges,Richard. Saranda...p.47. Hodges mendon se faza e dytë e dekorimit mundësisht shkon në gjysmën e dytë të shek.IX.
[16] Della Portella, Ivana. Subterranean Rome. Könemann, 2000, Germany, p.105. Përdorimi i motiveve të pikturuara të luleve, frutave dhe zogjve në vendin e të vdekurve, (katakombet) shfaqin simbolikën e parajsës.
[17] Grabar, Andre, Le Premier Art Chretien, Gallimard, 1966.p.171.
[18] Neyret,Clémence, Art paléochrétien Art Byzantin. Paris: Ecole du Louvre, 1973. pp.19-33.
[19] Grabar, Andre. Le Premier...pp.56-57.
[20] Grabar, Andre. Le Premier...pp.192, fig: 207.
[21] Oficer në ushtrinë e perandorit Licin. Me emrin e Licinit lidhet dhe themelimi i kalasë së Paleokastrës në Gjirokastër. Shih tek Baçe, Apollon, Kështjella e Paleokastrës, Iliria, Tiranë, 1981.2, f.165-235.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 16



Fig. 17

dhe Shën Teodori në lutje).[22] Portreti i shenjtit që tërhiqet nga mjekra, afron një plastikë pikturimi, që procedon në mënyrë klasike në realizimin e hijes dhe dritës, ndryshe nga kanonet ikonografike bizantine të formatizuara më vonë. Në këtë skenë njohim tipin Krishtit Kryeprift (*archiereus*) që largon mëkatet dhe i



Fig. 18

tërheq besimtarët në lutje. Gjesti i tërheqjes nga mjekra në pikturën e mësipërme, duket mjaft i rrallë dhe nuk gjen krahasim në pikturat e krishtërimit të hershëm të njohura dhe më gjerë.[23]

Në mes të faqes jugore të kapelës së dytë të ambientit nëntokësor, njohim ikonografinë e një besimtari me krahë të hapura lart, në lutje (fig.19). Figura e Lutësit me duar të ngritur nga qielli, simbolizon nderimin, përkuljen e thellë ndaj Perëndisë dhe bëhet në këtë periudhë të artit të krishterë, formula ikonografike që paraqet kristianin e ndjerë dhe martirin në veçanti, tipi i besimtarit të cilit Krishti i zbulon dhe dhuron aspektin e jetës. Figura e lutësit, haset gjerësisht në fillimet e pikturës së krishterë. Grabar thekson se lutësit e shek IV kanë një frymëzim të ngjashëm[24].

Imazhi i lutësit, sugjeron shpirtin në lutje[25]. Pas tij, njohim të figuruar, një enë apo kanistër si edhe dy mbajtëse buke e peshqish sipër saj, duke na sugjeruar kështu skenën e shumëfishimit të bukëve, që

[22] Touratsoglou, Ioannis. La Macedoine, Histoire, Monuments, Musées. Greece : Ekdotike Athenon S.A. 1996. Fig.198. Kisha e Shën Dhimitrit në Selanik. Mozaiku i datuar në shek V-VII. pp. 168-169.

[23] Hodges.Saranda...p.47. Fig: Church of Forty Martyrs-a 9th-century painting showing Christ pulling a saint's beard.

[24] Grabar. Le Premier...p.116.

[25] Neyret,Clémence, Art paléochrétien ...p.19.

DO NOT COPY



Fig. 19

korrespondon me mrekullinë e Krishtit. Tek skena e shumëfishimit të bukëve, Krishti shumëfishon nga pesë bukë dhe dy peshq, dymbëdhjetë kanistra.

Pas skenës së shumëfishimit të bukëve, në qoshen jugperëndimore njohim skenën e ngjalljes së Llazarit, duket një sarkofag i hapur dhe një figurë e përkulur anash tij, Llazari, si dhe një figurë jo shumë e lexueshme në këmbë, Krishti, që për shkak të dëmtimit, i njihet vetëm silueta (fig.20). Llazari banonte në Betania, afër Jeruzalemit me dy motrat Marta e Maria. Sipas Ungjillit të Joanit, vdiq për shkak të një sëmundjeje, dhe vjen i ringjallur nga Krishti. Mrekullia e Ringjalljes së Llazarit (Joani,11,1-46), ka dëshmuar se shumë



Fig. 20

hebrenj shkonin për shkak të tij dhe besonin tek Krishti, duke e bërë një nga skenat ikonografike më të rëndësishme në fillimet e artit e krishtërimit të hershëm.

Në anën veriore, ndonëse të palexueshëm mirë, kemi figurën e Krishtit adoleshent, një pikturë mjaft përfaqësuese, përsa i përket vlerave piktorike të arritura gjatë realizimit (fig.21). Portreti i Krishtit, djalë i ri, është mjaft shprehës dhe deri diku mjaft realist, ndonëse konservon një bukuri antike. Rreth vitit 300 Mjeshtri shfaqet i ri midis apostujve dhe dinjitarëve të tjerë[26].



Fig. 21

Më tej në anën veriperëndimore njohim fragmente të skenës "Jonas hidhet tek balena", e përdorur në pikturat e katakombeve e shek. III, e sidomos në sarkofagët e shek. IV pas Kr[27] (fig.22-23-24-25-26-27). Duhet të dallojmë këtë skenë nga dy skenat e tjera të historisë së Jonas, si "Triologjia e Jonas" dhe "Jonas pushon nën *curcubita*" (kungull). Jonas kujtohet që ishte i

[26] Grabar. Le Premier...p.269. fig: 300.Rome.Le Christ adolescent. Musèe des Termes.

[27] Van Der Meer, F. Mohrmann, Christine. Atlas de l'Antiquité Chrétienne. Paris-Bruxelles : Editions Sequoia, 1960. Fig. 108-Jonas sous le curcubita, sarkofag Musee des Thermes, Rome. Fig.167 Le sarcophage de Jonas. Debut du IV siecle. Romë, Musée du Latran.

DO NOT COPY



Fig. 29

luten, pjesë të anijes, rremat si dhe duart e Jonas duke u hedhur në ujë. Figura e tij në tërësi është e palexueshme, veç një gjurme të lehtë të kokës. Portretet e peshkatarëve janë në gjendje pak më të mirë. Figura e peshkut të madh duhet të ketë qenë në pjesën e poshtme që sot i mungon pikturës murale. Ikonografia e skenës "Jonas hidhet tek balena" në repertorin e hershëm të krishterë zë një vend të rëndësishëm[30]. Ajo paraqet një "Zbritje" në pjesën e poshtme të anijes, në det që simbolizon errësirën, vetminë, duke humbur çdo gjë që posedonte. Deti për hebrenjtë simbolizon të keqen, vdekjen. Marinarët përfaqësojnë botën pagane. Ata e hodhën Jonasin në det pas fjalëve të tij: "Më merrni mua më hidhni në det, dhe deti do të qetësohet për ju!". Marinarët pas rënies së Jonas në det, ngrejnë duart në shenjë lutjeje. Paraqitja e Jonas dhe në hedhje dhe në të njëjtën anije, tregon se ai e ka jetuar aventurën e tij. Mesazhi i kësaj ikonografie nënkupton një apel hyjnor. Ai i largohet Perëndisë, dhe hidhet (nga anija) e ndalon në terr(deti, barku i peshkut të madh), duke na treguar që Dashuria e Perëndisë shkon me të vërtetë shumë larg. Ai kalon aty tre ditë e tre net, koha e një Ringjallje, ku vetmia dhe terri u kthyen në refleksion të Lutjes - drejt një marrëdhënie me Perëndinë "Ndërsa hynte në barkun e peshkut, Jonas lutej YAHVE, Perëndisë së tij".

Piktura murale e "Jonas hidhet tek balena" figuruar në faqen veriore të kapelës së dytë, në ambientin nëntokësor të bazilikës së 40 Shenjtorëve në Sarandë, me dimensionet 3.2 m e gjerë dhe 1.7 m e lartë (nga ku një fashë prej 3.2 x 0.43 m është dëmtuar), rezulton më e madhja, midis imazheve të tjera murale të artit paleokristian me këtë skenë ikonografike, të njohura deri më sot. Nisur nga kohëzgjatja e saj në repertorin ikonografik të krishtërimit të hershëm, mendoj se datimi i saj lidhur dhe me ndërtimin e kriptoportikut ku ndodhet, ka gjasa t'i përkasë shek. IV, megjithëse, shumica e rasteve të njohura deri tani i takojnë shek. III pas Kr. Nisur nga konteksti i datimit të skenës "Jonas hidhet tek balena", mendojmë që dhe skenat e tjera të pikturuara në shtresën e dytë të pikturës, të përmendura më sipër si "Krishti Kryeprift tërheq besimtarin në lutje", "Lutësi", "Shumëfishimi i bukëve", "Ngjallja e Llazarit", "Krishti adoleshent", "Hyrja në Jeruzalem", i përkasin të njëjtës periudhë realizimi. Mungesa e mbishkrimeve na jep mundësinë për një datim të hershëm, para se të rekomandoheshin *expressis verbis*.[31]

*Në valorizimin e vazhdueshëm të këtij monumenti të rëndësishëm, shpreh falenderimet e veçanta për Fondacionin Butrinti që e pajisi arkivin e IMK me planimetrinë të bazilikës dhe ambientit nëntokësor (kryer me metoda bashkëkohore), përkushtimin e ark.Artan

[30]Kjo skenë ikonografike në artin e krishtërimit të hershëm është e pranishme. Duke u thelluar tek skena, ndihmon të kuptojmë kontekstin e përdorimit të saj Jonas (Jonah për hebrejtë), radhitet i pesti në profetët minorë. Sipas Biblës, Perëndia i besoi misionin për të lajmëruar banorët e Ninivës, shkatërrimin e qytetit të tyre për drejtimin e keq të tij. Jonas pati frikë nga reagimi i banorëve të Ninivës, dhe nuk ju bind Perëndisë. Mendoi t'i zhdukej shikimit të Perëndisë, duke hypur në një anije për të shkuar në Tarse. Një shtërngatë e tmerrshme ngrihet në det, dhe anija rrezikonte të mbytej. Marinarët ngrejnë duart e kërkojnë fatin, për t'u çliruar nga hakmarrja e Perëndisë. Fati i varrit të Jonas ishte t'i bindej Përjetësisë. Atëherë ai u hodh në det duke u zhdukur plotësisht. Perëndia dërgon "peshkun e madh" që e gëlltit Jonasin. Profeti qëndron tre ditë e tre net në barkun e balenës, duke iu lutur Perëndisë. Përjetësia flet me peshkun dhe ai e vjell Jonasin mbi tokë. Jonas atëherë shkon në Ninive dhe deklaron se qyteti do të shkatërrohej brenda 40 ditësh. Banorët në ankth e terror, futen në rrugën e Perëndisë me pendim të plotë. Ndaj dhe Perëndia e kurseu jetën e tyre.
Jonas është profeti i parë që është dërguar në një qytet pagan për t'i konvertuar banorët e tij. Ai është i biri i profetit Amath. Apeli i Jonas është një apel i ndryshëm nga ai i profetëve të tjerë. Në fakt në Bibël, profetët përfaqësojnë të dërguarit e Perëndisë drejt popullit të Izraelit, ndërsa Jonas është profeti i parë i dërguar me mision drejt një qyteti pagan, për të konvertuar banorët e tij., të cilët konsideroheshin peshkatarë të mëdhenj, tregëtarë e gjakatarë. Emri i qytetit është Ninivë, (në memorien e Izraelit njihej si kryeqytet i Asirisë) që është shkatërruar në vitin 612 para Kr. Shkrimi për historinë e Jonas vendoset dy shekuj më pas. Shih tek (Mateu.12:38-41, si dhe Lluka. 11:29-32).

[31] Grabar, Le Premier....90-98

Shkrelit në sensibilizimin dhe gjetjen e fondeve të duhura për fillimin e një ndërhyrjeje konservuese dhe restauruese të këtij monumenti në shkallë më të gjerë, gatishmërinë dhe vullnetin e lavdërueshëm të arkeologut Skënder Muça në gërmimin gradual dhe shkencor të tij, si dhe komplimentet më të mira për kolegët restauratorë Skënder Mihalçka, Edlira Çaushi, Zamir Marika etj. që me pasionin dhe kujdesin e duhur zbuluan nga mbivëniet një numër skenash pikture murale, aq të pakta në trashëgiminë tonë të krishtërimit të hershëm.

DO NOT COPY

Gazment MUKA

NEW DATAS FROM "40 SAINTS" BASILICA OF SARANDA

DO NOT COPY

The aim of this article is discovery from superposition and restoring of mural paintings discovered at some chapel of crypt- portico with catacomb vaults of "40 Saints" basilica of Saranda.

Entering at crypt from north entrance, in first chapel with catacomb vaults we see some branch of palm tree fragments at north face. Wallpaper like this is pale ante Christian picture for "Christ establish law at Moses" scene. Traces remain from mural painting at second chapel give more possibilities for consulting of some Christian scenes. Second layer of mural painting at second chapel in south face, we see two light blue aureoles figure where is visible even that is very damage the Christ appearance which is knowable by its requisition. Christ drag the saint by its beard, dressed by white tunic with black stripes a well-known dress of earlier Christian painting. Saint portrait reminds Saint Theodore Stratilatit's iconography painted at Saint Dimitri's basilica in a Byzantine style mosaic scene (Saint Maria and Saint Theodore in praying, mosaic dated on V-VII centuries) at Thessalonika built on V century. Saint portrait drag by its beard, offered a plastic art painting which is used classically for light-shadow realisation, which is different from Byzantine iconography cannon formatted later. This scene has type of Provost Christ (archeries) who distanced the believers from sins and attracts them into praying. The scene of drag by its beard of the painting above it is very rare and there is no other if is compared with painting of earlier Christianise known widely.

In the middle of the south face of the second chapel of the underground ambience, is a believer iconography with open arms in praying. Prayer figure with arms raised at sky symbolised honouring, and declension by the God. This figure was became iconography formula of Christian and martyr, believer type who Christ give life aspect to him. Prayer figure is present widely at beginnings of Christian picture. After him is figured a pot or basked and two bread or fish holder over it, by suggesting bread multiply which correspondent with Christ miracles. Multiply bread scene, the Christ multiply five bread and two fishes, twelve baskets.

After bread multiply scene at south-west corner, we find the Lazarus's revive scene and a open sarcophagus and a bow figure close to its side, Lazarus, and another non readable standing figure, Christ, who because of damage is knowing only by its silhouette.

North side, even it is no clearly readable, we see Young Christ a very representative picture, by arrived painted values during realisation. Christ portrait, a young boy, is very expressive and somewhat realistic by conserving an antique beauty.

Northwest side has fragments of scene "Johan jump to whale". This is used at catacomb pictures of II century and especially at sarcophagus of IV century (after the Christ). We must distinguish this scene from two other scenes of the Jonas History, like "Jonas triple" and "Jonas rest under cucurbit".

Johan is the symbol of the intervention of God in the earth and was the first who bring the salvation message for the nobles. Scene "Johan jump to whale" is a scene of Old Testament so for that reason is accompanied with Christ figure on its side. This scene at north side of second chapel very damaged in appearance shows its composed elements, two praying sailors, ship, mast and its sail veil, Jonas hands that is jumped. Under carefully surveillance it helps more than the other paintings for understanding period of creation of the second layer picture at underground ambience of "40 Saints" basilica, because has limited use, III-IV centuries, as part of crypt-programme of earlier Christian iconography.

Third chapel we find much damaged picture of the scene "Entrance of Christ at Jerusalem" on the north face. The aureole of the Christ entering at Jerusalem is visible; also the door, city walls and a group of aureoles which is corresponding with disciplines are visible too. This scene realised in underground ambience of "40 Saints" basilica, which as a iconography we are learn to see widely at post Byzantine picture realised at our country, has chances to be the most earlier one. In front of it at south face we see another aureole figure very damaged.

Even that is damaged the big painted scene is "Johan jump to whale". The figures of two sailors who are prayed with raised hands are partially appearance, part of the ship, oars and the hands of Jonas jumping into the water. His figure is completely unreadable but exist only a light head track. Figure of the big fish may have been at the lower part that is missing today at mural painting.

Mural painting of "Johan jump to whale" at the north face of the second chapel at underground ambience of the "40 Saints" basilica at Saranda, with the measurements 3.2 metre wide and 1.7 metre high (when a banded with 3.2 m X 0.43m is damaged), results the bigger one, between images of other mural painting of pale pre Christian with this iconography scene, knowing up to date. Beginning by the longitude on the iconography repertory of earlier Christianity, I think that belong to IV century and is linked also with the building of crypt- portico where is establish. Examples of this scene of the mural painting know widely on the III century (after the Christ). Continuing by the context of date of the scene "Johan jump to whale", we think that the other scenes painted at second layer of the picture mentioned above like "Provost Christ withdraw believer for praying", "Prayer", "Bread multiply", "Lazarus revive", "Young Christ" and "Entrance at Jerusalem" belong to the same realism period. Inscriptions missing give the possibility for the earlier date before *expressis verbis* recommendation.

DO NOT COPY

Zamir MARIKAJ

VIZATIME NË SHKËMBIN E MALIGRADIT

DO NOT COPY

Rreth pesë milje në lindje të fshatit Liqenas, në zonën e liqenit të Prespës në rrethin e Korçës, ndodhet ishulli i vogël shkëmbor i Maligradit, i cili vitet e fundit ka ngjallur interesimin e vizitorëve për monumentet e lashtësisë, që përmban (fig. 1, 2).



Fig. 1



Fig. 2 Kisha e Shën Marisë Maligrad

E gjithë zona e Prespës njihet si zonë e rëndësishme arkeologjike me gjetje të kulturave të periudhave të ndryshme të lashtësisë, si dhe në antikitet siç e tregojnë dokumentat si zonë e banuar nga fiset ilire të Lynkestëve[1]. Gjurmë të kësaj periudhe të jetesës së tyre janë gjetur edhe në ishullin e Maligradit. Në Antikitetin e Vonë ky vend ndodhej në kufirin midis Epirit të Ri (Nova) dhe Maqedonisë të banuar nga fise shqiptare. Gjithashtu në pllajën shkëmbore të këtij ishulli, që ka formën e një stadiumi të vogël, janë gjetur gjurmë të ekzistencës së një bazilike paleokristiane të shek V-VI[2] (fig. 3, 4, 5) si dhe gjurmë të një varreze të kësaj periudhe, pjesë muri të një vile që mbreti i Bullgarëve



Fig. 3

Samuell (988-1018) u vendos para se të shkonte në qytetin e Ohrit. Por mbi të gjitha ky ishull është i njohur për kishën e Shën Mërisë, me vlera të veçanta historike dhe artistike, e ndërtuar në një nga guvat natyrore të tij, kisha është e dekoruar me afreske në shek e XIV (në dy faza ndërtimi dhe në tre faza dekorimi me piktura që

[1] *Dr. Jur Johan Georg von Han, "Studime Shqiptare„ 2007 f 407-420*
[2] *Gjurmë të gjetura si tjegulla, kapitel, kolonë prej guri e sipas konsultës me prof. S.Muçaj dhe me ark.E. Hobdari të Institutit të Arkeologjisë në Tiranë, këto objekte i përkasin një kishe paleokristiane të shek V-VI m.k.*

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

i përkasin viteve 1345, 1369 dhe 1607)[3]. Këto gjurmë aekeologjike e shpërfaqin ishullin dhe njëkohësisht shkëmbin e Maligradit, si një sit arkeologjik i veçantë.

[3] *A. Meksi –"Arkitektura e kishave të Shqipërisë" faqe 195.*
Th. Popa-"Mbishkrimet e kishave në Shqipëri" viti 1998 , faqe 150-151

Në shtator të vitit 2006 një ekspeditë restauruese e IMK zbulon në faqen e një shkëmbi, fare pranë shpellës ku ndodhet kisha, një pikturë të rrallë, me rreth 20 figura të ndryshme të vizatuara me bojë të kuqe të oksidit të hekurit. Vizatimet paraqesin portretet e tre figurave, të një burri dhe të një gruaje me aureolë në kokë dhe në mes tyre një fëmijë (fig 6 + skica). Tre figurat, që përbëjnë



Fig. 6



Skica

dhe qendrën e kësaj pikture, janë të rrethuara me një numër të madh portretesh e figurash të stilizuara në mënyrë naive (fig. 7 + skica) të cilat simbolizojnë kristianizmin e që akoma nuk na japin asnjë shpjegim.



Fig. 7



Skica

Portretet e burrit dhe të gruas në qendër, si dhe disa portrete, që ndodhen të "shpërndara" në pjesë të ndryshme të shkëmbit, janë të stilizuar dhe të vizatuara në mënyrë interesante dhe naive, me sy të mëdhenj dhe hundë dhe gojë të madhe, figura që duke i parë me vëmendje ngjallin thellësisht tension, tragjizmin dhe shprehje të gjithanshme të karakterit shpirtëror.

Sipas Lazarjev -"Figurat që bërtasin dhe lëvizin tregojnë për figura që nuk janë afruar me zotin sepse njeriu që nuk është afruar me zotin është gjithë tension dhe lëvizje"[4].(fig 8 + skica).

Sipër portretit të burrit dhe të gruas me fëmijën që janë edhe figurat me dimensione më të mëdha, rreth 2 m, ndodhet një figurë e stilizuar e "skeletit të peshkut", brenda kësaj figure paraqitet një kryq i stilizuar, si dhe katër gërma "E" në gjuhën Greke të vjetër (sipas



Fig. 8

[4] *V. Lazarev –"Storia della pittura bizantina", Torino 1967.*

Do not COPY

DO NOT COPY



Skica



Fig. 9

mendimit të studiuesit Jani Vitalioti)[5] (fig. 9). *"Ato janë shkronja nistore për të cilat ka dy variante interpretimi"*

1. Ἑλένη Εὗρεν Ἐλέους Ἔρεισμα

*1. **Elena gjeti mbështetëse (bazë) përdëllimi***

2. Ἑλένης Εὕρημα Ἑβραίων Ἔλεγχος

*2. **Gjë e gjetur nga Elena (është) qortim (kontroll edhe gjëneshtrim) i çifutëve.***

Më lart ndodhen edhe dy figura të tjera, një figurë e vogël që mendohet se simbolizon "Embrionin e jetës" dhe sipër saj një figurë tjetër burri komplet.

Në anën e djathtë të figurave kryesore vizatohet një figurë antropomorfe, me katër këmbë, me fytyrë njeriu dhe me krahë (fig. 10 + skica) e cila nuk ka një qëndrim statik. Pak poshtë kësaj figure ndodhen simbolet e germës "O" apo gjurmë të figurave të tjera të dëmtuara akoma të pa shpjeguara. Figura e dëmtuar rëndë e një "Peshku me



Fig. 10

[5] *Jani Vitaliotis,*

DO NOT COPY



Skica

fytyrë njeriu" e gjetur e thyer në tokë etj. Germa "Fi" (fig. 11) mendohet se i përket fillimit të një shprehjeje të paidentifikuar që sipas Vitaliotis *mund të jetë fund i frazës*

(Φῶς Χριστοῦ) Φαίνει Πᾶσι.

(Drita Krishti) ndriçon në të gjithë (njerëzit).

Në anën e majtë të figurave kryesore janë edhe disa portrete, një figurë njeriu komplet veshur me pelerinë si dhe një tjetër me veshje të zonës. Dy figura me kokë të madhe të ekzagjeruar dhe me një trup të vogël. Gjithashtu pranë këtyre figurave ndodhen sipërfaqe të vogla horizontale të shkëmbit të cilat janë të lyera me ngjyrë të kuqe, që sipas mendimit tonë tregon për një vend ku bëhej procesion fetar (fig. 12).

Në pikturën shkëmbore të Maligradit ndodhen figura, që në vetvete kanë trazim shpirtëror (portreti i burrit) dhe tregojnë e shprehin tragjizmin që përveç simboleve kristiane (kryqet në veshjet e figurave apo dhe "skeleti i Peshkut") e gjithë piktura ka një shprehje të përgjithshme të karakterit spiritual. Në përgjithësi në këto piktura dominon koka e madhe dhe e ekzagjeruar, si ndërmjetëse e shprehjes shpirtërore, kurse trupi është pa peshë dhe në përgjithësi në dimensione të vogla. Këto lloj pikturash sipas Lazarjev "... janë shprehje të vegimeve të një kristiani të pakulturuar,



Fig. 11



Fig. 12

ku çdo nacionalitet përpunoi gjuhën e vet artistike dhe shprehëse, ku stilet popullore bëhen faktor kryesor në zhvillimin e Artit[6].

Mendojmë se studimi i mëtejshëm do të sqarojë më mirë kohën e realizimit dhe funksionin e këtyre pikturave.

[6] *Lazarjev, po aty*

Zamir MARIKAJ

DRAWINGS AT (MALIGRAD) PRESPA LAKE ROCKS

DO NOT COPY

Five mile around at the east of Liqenas village, close to the area of Prespa Lake is established a small rocky island. This island last years has attracted many ancients' monument visitors.

Prespa area is known archaeological place habituated by Illyrian Lllynkesteve tribe since antiquity. Remains of this period are discovered at Maligradi Island. Rocked part of this island has the small stadium form; there are discovered traces of pale Christian basilica of V-VI century and traces of cemetery of this period. This island is known for Saint Maria church, with unique historic and artistic values built at one of its natural caves. Church is decorated with frescoes of XIV century (two building phases and three decoration phases on painting which belong to 1369 and 1607 years.

On September 2006 wad discovered a very rare painting with 20 different figures paint with red iron oxide colour at rocked cheek close to cave where church is established. Drawings are portraits of three figures; a man, a woman with aureole over her head and a child between them. Three figures which compound centre of this painting are surrounding with some portraits and styled figures in a naïve manner which symbolise Christianise and needs explanation.

Portraits of man, woman on the centre and some other portraits that are at different parts of rock which have interesting stylising and drawing with big eyes, nose and mouth, figures if are looked carefully feel stress, tragic and general expression of a spiritual character.

According to the Lazarjev "Figures which yell shows for the figures which are not closer to the god, because a man who is not closed to the god has lot of tension and movement".

Over the portrait of a man and a woman with the child which has the biggest figures, about 2 metres, is established a stylised figure "fish bones" and within this figure is a stylised crux and also four "E" of old Greek letters (according to the Jani Vitalioti researcher).

More over are two other figures, a small figure, for it is supposed that symbolised "life embryo" and over it another one of a whole man.

On the right side of the main figures is drawing an anthropomorphic figure with four legs with man face and arms, without static standing.

On the left side of the main figures are and some portraits, a man figure dressed with cape and another one with local dressing. Two big enormous head figures and small body are there. Close to this two figures are horizontal rock small surface painted with red which according to our opinion we think for a place where is done religion procession.

Rocks painting of Maligrad are established figures which itself has tension (man portrait) and shows, express tragic which except Christian symbols (crux ate figure dressing or, and "fish bone") all painting has a general spiritual character. These paintings according to the Lazarjev "are expressions of visions which are part of uncultured Christian, when each nationality processes its artistic and express artistic language when popular styles are main factor for art development".

Polikron THEODHORI - Frederik STAMATI

NJË STUDIM PETROGRAFIK PËR ALTARIN E ZBULUAR NË KËNETËN E DURRËSIT

DO NOT COPY

Altari i zbuluar në kënetën e Durrësit nga arkeologu Halil Myrto në vitin 1986-1987 është një monument kulti për të cilin duhen realizuar studime të mëtejshme në përcaktimin kronologjik nga periudha e vonshme klasike, në atë të hershme helenistike për ta integruar në monumentet e tjerë të kultit të zbuluara në Dyrrah (Durrës).

Por në ditët e sotme veç studimit arkeologjik, shkenca gjeologjike e petrografisë, përcakton, lëndën e parë shkëmbore të përdorur në monumente të ndryshme; ajo jep të dhëna edhe për origjinën e llojeve shkëmbore (litologjive) të përdorura.

Për këtë qëllim u krye analiza petrografike nga gurët e altarit të zbuluar në kënetën e Durrësit (fig. 1). Kampionet e nevojshëm për përgatitjen e shlifeve petrografike janë marrë në Muzeun Arkeologjik të Durrësit.



Fig. 1

Më poshtë po japim analizën petrografike të kampionit përfaqësues të këtij altari.

Kampioni makroskopikisht paraqet një shkëmb karbonat natyral (fig. 2), dhe nga studimi petrografik-microfacies i shlifit të përgatitur (fig. 3), përcaktohet:

Kalkarenit oölitik, me strukturë depozicionale të një gëlqerori oölitik,(me pamjen e një ranori) me një matriks mergelor të paktë, i cili përmban edhe alevrit silikat, nganjëherë elemente bioklastikë tepër të imët.



Fig. 1



Fig. 1

Në bërthamë të oöideve ndodhen shpesh fosile, si gastropodë të vegjël, fragmente bivalvia dhe Ostracodae të vetmuar (fig. 4).



Fig.1

Duke krahasuar tipet e oödive me klasifikimin e oöideve të dhënë nga Strasser 1986 dhe me Microfacies italiane AGIP 1959, Tavol XL, rezulton se kemi të bëjmë me një gëlqeror facies neritik të lagunave detare në ambient ujërash të lëvizshme dhe të qeta, (gjë që dëshmohet edhe nga prania në shlifin tonë të oöideve të tipit onkolit), i prekur pak nga diagjeneza, (ka një zëvëndësim të pjesshëm me lëndë silësore të bioklasteve dhe detritit bioklastik), i ngjashëm me microfacies të Jurës, (të Liasit të poshtëm).

Lidhur me origjinën e gurëve të përdorur mund të jepen dy mendime:

1. Ky lloj gëlqerori material ndërtimi mural mund të jetë sjellë nga Italia, meqenëse në zonën shqiptare tektonike të Sazanit, (Sazan, Karaburun), nuk dalin në sipërfaqe shkëmbij karbonatë të Kretës së poshtme deri të Eocenit.

2. Nuk përjashtohet mundësia që shkëmbi i përpunuar në blloqe i këtij lloji gëlqerori të jetë sjellë nga Zona Tektonike Joniane e Shqipërisë, ku shkëmbijtë karbonatë të Triasit të sipërm-Liasit të poshtëm janë të facies neritike, pra të detit të cekët.

Guri i altarit i gjetur në kënetën e Durrësit, tani është në procesin e dekompozimit të vazhduar të tij, për shkak të hidrolizës, tretjes së materialit lidhës (matriksit) midis onkolit- oödive shkëmbformuese të këtij tipi të shkëmbit karbonat.

Referencat

AGIP (1959)- *Micrafcies italiane* Dal Carbonifero al Eoceno medie.

Carla W. Montgomery (1993)- *Sediment and Sedimentary Rocks*-USA (përkthim i Kap.VI, nga libri Physical Geology, realizuar nga Prof. Dr. Polikron Theodori-Tiranë 1998)

Dunham, R.J. (1962)- *Classification of carbonate rocks according to depositional texture.* Mem. Am. Assoc. Pet. Geol., 1:108-121 (përkthimi i artikullit nga Prof. Dr. Polikron Theodori-Tiranë), Gjeollogjia e Shqipërisë,1990, f. 234 dhe f. 246.

Greensmith J.T. (1978)- *Petrology of the sendimentary Rocks.*Queen Mary College, University of London,Sixth Edition © George Allen and Unwin Ltd, London (përkthimi i plotë i librit nga Prof. Dr. Polikron Theodori, Tiranë 1990)

Folk, R. L., (1959)- *Practikal petrographic classification of limestones.* Bull. Am. Assoc. Pet. Geol., 43:1-38. Përkthim nga Tomi Kristo, Tiranë

Sanders (1978)- *Principles of sedimentology.* NewYork(përkthimi i pjeshëm i librit nga Prof. Dr. Polikron Theodori, Tiranë 1982)

Theodhori P., Pirdeni A., (1977)- *Microfacies të zonës së Alpeve* Shqiptare (nga Permiani i sipërm në Eocen) Fondi ISPGJ- Tiranë.

V. P. Wright (1992)- *A revised classification of limestones.* Sendimentary Geology, 76-177-185 Amsterdam.

DO NOT COPY

Polikron THEODHORI - Frederik STAMATI

A PETROGRAPHIC STYDY FOR ALTAR DISCOVERED AT DURRES MOSS

DO NOT COPY

Altar which was discovered at Durres moss by archeologist Halil Myrto on the years 1986-1987 is an cult monument and for it is necessary to do a further studies, also to finish chronological evaluation from late classic era to earlier Hellenistic era with the purpose of integrate with other cult monuments discovered at Dyrrah.

Geological science of petrography in nowadays except archeological study define the first raw rock material used at different monuments and also give records for origin of rock type (litologjive) used.

The petrography analyses were done for the altar stones discovered at Durres Moss (photo1). The necessary samples for prepare petrography rock samplings (shlifeve) which are taken from Archeological Museum of Durres.

Below is petrography analyzing of the representative sample of this altar.

Macroscopic sample represent a natural carbonate rock (photo 2), and from the petrography study microfacies of the prepared rock samplings (shlifit),(photo 3), define :

Oölitik calcareous, with a depositional structure of the oölitik calcareous (with gritty view). This has a less mergelor matriks, which contends and alevrit silicate, sometimes bioclastic elements very thin.

On the nucleus of oöideve often are fossils, like small gastropod, bivalvia fragments and bleak Ostracodae.

Comparison the oödive types with the oöideve classification given by the Strasser 1986 and Italian Microfacies AGIP 1959, Tavol XL, results we have a facies neritik calcareous of sea lagoon at movable and languor waters, (this is certified by the presence of oöideve onkolit type at our shlifin), less affected by diagenesis, (is a partial replacement with bioclasteve and detritit bioclastic silicum material), similar with Jura microfacies, (down Liasit).

For the used stones origin we can give two opinions:

1. This calcareous building mural material may be has come from Italy, because at tectonics Albanian area of Sazanit, (Sazan, Karaburun), do not appear at surface carbonate rocks of down Cretan up to Eocene.

2. Exist also the possibility that the rock processed by blocks of this calcareous may be has come from the Ionian Tectonic Area of Albania, when the carbonate rocks of upper Triasit – down Liasit are neritice facies, so of the shoal sea.

Altar stone funded at Durrësit Moss now is at continuous decomposition process, because of hydrolysis, dissolution of connective material (matriksit) between onkolit- oödive rocky formations of this carbonate cliff.

Adem BUNGURI

DO NOT COPY

GJETJE NË KALANË E GRAZHDANIT

Kalaja e Grazhdanit[1] ndodhet në veri të pellgut të Dibrës, thuajse në mesin e rrugës që lidh qytetin e Peshkopisë dhe atë të Dibrës, përkatësisht në distancat lineare jugore dhe veriore 11 dhe 10 km. Ajo është vendosur në fushën e fshatit homonim, në perëndim të malit të Deshatit, midis përroit të Kamenicës në veri dhe atij të Bresnicës në jug. Muri lindor i kalasë kalon disa metra në lindje të rrugës nacionale, ndërsa ai perëndimor i afrohet bregut të djathtë të Drinit të Zi deri afër 2 km. Kalaja e Grazhdanit shtrihet në të gjithë këtë hapësirë, midis kuotave 550 – 593 m, në një terren fushor në lindje dhe të pjerrët në perëndim (fig. 1). Ajo ka një pozitë të rëndësishme strategjike në kontroll të rrugës së Drinit të Zi, që e lidh atë me dy arteriet më të



Fig. 1. Pamje e përgjithshme e kalasë së Grazhdanit

rëndësishme transballkanike të periudhës romake: via Egnatian në Jug dhe atë Lissus – Naissus në veri. Rëndësia e kësaj pozite rritet edhe nga fakti se ajo ndodhet në pikëtakimin e provincave të Epirit të Ri, Macedonia Secunda, Prevalitanisë dhe Dardanisë.

Kalaja e Grazhdanit është monumenti më i madh sipërfaqësor i rajonit të Dibrës dhe ndër më të mëdhatë në Shqipëri e rajon. Për përmasat e saj ballkanike dhe pozitën qëndrore në luginën e Drinit të Zi, ajo ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve. Nga sa dimë, kjo kala përmendet për herë të parë nga gjeologu dhe gjeografi francez A. Boué. Sipas tij, Grazhdani zinte një vend qëndror në sistemin rrugor ndërkrahinor. Ai shënon gjatësinë në orë këmbësore të *„rrugës së karvaneve„* që lidhte kalanë e Grazhdanit me Styberën (Cepigovën:18 orë) Ohrin (10 orë), Shkodrën (25 orë) dhe Prizrenin (18 orë)[2] .

J. G. Hahn mund të konsiderohet si studiuesi i parë serioz i kalasë së Grazhdanit. Që në vitin 1863 ai shënonte se territori ku është ndërtuar kjo kala njihet me emrin *"shehër" (qytet)* dhe mendon se aty duhet të ketë patur një *"qytet të rëndësishëm dhe të lashtë"*, i cili ishte rrënuar përdhunisht dhe nuk ishte rindërtuar përsëri në të njëjtin vend. Ai na njofton gjithashtu se në kohën e tij shiheshin pa vështirësi muret e banesave të brendshme të qytetit[3].

Shënime interesante mbi këtë kala, ka lënë edhe konsulli rus në Shkodër, I. S. Jastrebov. Sipas tij, kalaja e Grazhdanit nuk ka qenë as qytet e as kala, por *"një koloni e vjetër romake, një municip ose një karavansaraj (stacion rrugor) në rrugën Egnatia për në veri"*. Ai mendon se në periudhën romake *"Grazhdani duhet të ketë qenë qendra e të dy Dibrave"*, por beson se *" si çdo qytet romak ishte rrënuar plotësisht nga Atila"* [4].

---

[1] Qëllimi i këtij artikulli është publikimi i informacionit arkeologjik të grumbulluar nga autori gjatë punimeve të ndryshme në hapësirën e këtij monumenti. Lënda arkeologjike ruhet në fondet e Bërthamës Arkeologjike pranë Muzeut Historik Peshkopi. Vizatimet janë të skicografit Y. Pupli dhe arkeologut S. Lela, ndërsa fotografitë të autorit.

[2] A.Boue, *La Turquie d'Europe*, vol. IV, Paris 1840, f. 545-546

[3] J.G. Hahn, *Reise durch Drin und Wardar Gebiechte*, Wiena 1867, f. 163-165 .

[4] I.S. Jastrebov, *Staraja Srbija i Albania*, Spomenik SK XLI, Beograd 1904, f. 135-136.

Nga intelektualët vendas të para Luftës së Dytë Botërore, përmendim shkrimtarin H. Stërmilli që e viziton këtë kala dhe e konsideron atë si fortifikim mesjetar *"të periudhës skënderiane plot ngadhnjime"* [5].

Në vjeshtën e vitit 1950, kalaja e Grazhdanit vizitohet nga prof. H. Ceka e ing. J. Adami dhe datohet si ndërtim i periudhës së vonë antike. Prof. H. Ceka, na njofton mbi zbulimin e një bazamenti kolone (me lartësi 0.60 m), si dhe mbi ekzistencën e gjurmëve të një kishe pranë murit lindor të kalasë[6].

Në mesin e viteve '70 të shek. XX, A. Baçe bën planimetrinë e parë të kalasë së Grazhdanit, dhe jep të dhënat përkatëse lidhur me madhësinë dhe sistemin fortifikues të saj[7].

Në dhjetor 1982, gjatë punimeve për zgjerimin e rrugës nacionale, në segementin që ajo kalon brenda kalasë së Grazhdanit, u zbulua një varrezë mesjetare dhe një trakt muri kuadratik, ndërsa në shtator 1983 u bë këtu një gërmim i vogël sondazhi[8].

Në vitet 1986 – 90, në kalanë e Grazhdanit u kryen punime të pastrimit të mureve nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Me këtë rast, u pastruan nga dherat dhe shkurret plotësisht muret e anës lindore e jugore dhe pjesërisht ato të anës perëndimore[9]. Në vitet 2000-2004 në këtë kala janë kryer gërmime në trasenë e murit dhe të dy hyrjeve kryesore të saj, për saktësimin e planimetrisë ekzistuese[10].

Në vitet 70 – 80 të shekullit të kaluar bëhen përpjekje për lokalizimin në këtë kala të qyteteve ilire të Draudakut[11], Uskanës[12], apo qytetit të periudhës romake të Dobërit[13], ndërkohë që studiuesit pranojnë si kohë të ndërtimit të mureve të saj rrethuese periudhën e vonë antike. Krijohet kështu një kontradiktë në mendimin arkeologjik nga mospërputhja në kohë e mureve rrethuese të kalasë dhe qytetit të supozuar apo kastrumit të mbrojtur prej tyre. Punimi ynë, me publikimin e informacionit të derisotëm mbi këtë kala, synon të ndihmojë në zgjidhjen apo zbutjen e kësaj kontradikte.

Punimi është ndërtuar kryesisht mbi gjetjet e rastit në këtë kala. Përveç tyre në të janë përfshirë edhe të dhënat e gërmimeve të sondazhit të vitit 1983, të përqëndruara në dy pika: A dhe B.

Sondazhi A me përmasa 3m x 3m, u vendos në afërsi të hyrjes jugore të kalasë, në parcelën e quajtur "Livanivi", ndërsa sondazhi B me përmasa 11m x 3m, pranë murit kuadratik dhe hyrjes lindore të saj. Lënda arkeologjike e sondazhit A përbëhet nga fragmente shumë të copëzuara enësh e tjegullash, kronologjikisht të lidhur me shek. II-III dhe IV-VI pas Kr.[14], ndërsa ajo e sondazhit B i takon periudhës mesjetare. Ajo do të trajtohet sipas kriterit kronologjik*(fig.2)*.



Fig. 2. Planimetria e kalasë së Grazhdanit

[5] H. Stërmilli, Dibra në prak të historisë, *Tiranë 1940, f. 8* (ruhet në Muzeun Historik të Peshkopisë. Më tej : MHP).
[6] H. Ceka – J. Adami, *Raport mbi ekspeditën në Peshkopi, Mat e rrethe,* Tiranë, 6.12. 1950, Arkivi i Isntitutit Arkeologjik Tiranë (më tej: AIA).
[7] *A. Baçe,* Fortifikimet e antikitetit të vonë në vendin tonë, *Monumentet 1976, 11, f.49, tab. III.*
[8] Gërmimet u kryen në periudhën 22-29.10.1983 nën drejtimin e D. Komatës, me pjesëmarrjen e arkeologëve Gj. Saraçi e A. Bunguri dhe skicografit Y. Pupli. Lënda arkeologjike ruhet në fondet e Institutit Arkeologjik Tiranë. Për më tepër shih: D. Komata, *Raport mbi gërmimet e sondazhit të vitit 1983 në kalanë e Grazhdanit,* AIA, nr.inv. 4523.
[9] Punimet u kryen nga ATL-ja e Peshkopisë. U punua me nga 6-10 punëtorë në vit. Autori i punimeve pastruese të pambaruara nga Instituti i Monumenteve ka qenë A. Baçe. Ato janë ndjekur në terren nga autori i këtij punimi.
[10] Gërmimet u drejtuan nga L. Përzhita dhe G. Hoxha.
[11] H. Sadiku, *Përpjekje për lokalizimin e disa kështjellave dhe qyteteve peneste,* Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, Tiranë 1969, f. 255.
[12] K. Frashëri, *Në gjurmë të qyteteve peneste, Studime Historike 1975, 4, f.144;* I. Kaca, *Kontribut për lokalizimin e disa qyteteve peneste sipas të dhënave burimore e arkeologjike,* "Dibra dhe Dibranët" Peshkopi 1981, f.74-77.
[13] K. Frashëri, *Në gjurmë... f. 151;* A. Baçe, *Fortifikimet... f.49-50;* Po ai, *Doberi një qytet i vjetër, Ylli, 1982, 3 f. 15;* I. Kaca, *Herbeli venbanim ilir,* Ylli , 1983, 7 f. 31.
[14] D. Komata, *Raport mbi gërmimet e sondazhit të viti 1983 në kalanë e Grazhdanit* , AIA, nr.inv. 4523, f. 3.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gjithashtu në këtë punim janë përfshirë edhe dy objekte të periudhës helenistike, që vijnë nga fshati Grazhdan[15] dhe nuk kanë lidhje me kalanë në fjalë.

I. Periudha helenistike (shek. IV-I para Kr.)

a. Rrethina e kalasë

1. Pitos masiv (fig. 3, 4). Gjetur gjatë punimeve bujqësore në vitin 1989[16]. Pitosi ka trup sferik, qafë të shkurtër, buzë të shtrira nga jashtë në trajtë strehe dhe fund të ngushtë cilindrik. Buzët me prerje trapezoidale kanë gjerësi 0.11 m. Lartësia e pitosit është 1.40m, diametri i trupit 1.20 m, ai i grykës 0.75 m dhe i fundit 0.16 m.Vëllimi i tij arrin afër 1m^3. Në zonën e supeve është i zbukuruar nga një shirit plastik horizontal i kanelyruar. Në pjesën e poshtme të trupit pitosi është i plasaritur. Pikërisht në



Fig. 3. Çaste nga nxjerrja e pitosit të Grazhdanit



Fig. 4. Pitosi i Grazhdanit i restauruar

këto plasaritje u gjetën disa kapse në trajtë kanxhash (fig. 5.) Kapset kanë trajtën e kanxhave me thumba vertikal në të dy skajet. Ato janë bërë prej plumbi të



Fig. 5. Detaj i restaurimit antik të pitosit

[15] Emri i sotëm Grazhdan është i mëvonshëm dhe lidhet me kalanë eponyme të ngritur pranë tij. Një shpjegim për këtë e ka dhënë K. Frashëri, sipas të cilit ky emër rrjedh nga bullgarishtja e vjetër" *grazb*„,vendbanim i rrethuar", „*gr·zdanin*" „qytetar" dhe „ *gra·danb*" vendbanim qytetarësh. Shih : K.Frashëri, *Në gjurmë të qyteteve peneste*...f. 144, shën. 57. Me këtë përmbajtje, emrin Grazhdan e ndeshim edhe në zonat e tjera të Shqipërisë, si psh.në Rosujë, në trajtën *"Përroi i Grazhdanit"* (B. Jubani - N. Ceka, *Gërmime në qytezën ilire të Rosujës*, Iliria I, 1971, f. 50) apo në Gjirokastër në trajtën *" mali i Grazhdanit"* (933 m, harta fizike e Shqipërisë) etj.

[16] Pitosi u gjet në oborrin e shtëpisë të z. B. Aga. Ai u dëmtua në grykë nga ndërhyrja e zbuluesit dhe është restaruar nga skicografi Y. Pupli.

përzier me nishadër. Trupi i tyre me gjatësi 6-10 cm ka prerje gjysëm rrethore, ndërsa thumbat me gjatësi të ruajtur 2-3 cm, kanë prerje rrethore. *(fig. 6; tab. I, 2).*



Fig. 6. Kanxha të restaurimit antik të pitosit

Pitosi i mësipërm tipologjikisht daton në shek. III-II para Kr. Pitosa të këtij tipi ose të ngjashëm me të, të përdorura si hambarë drithërash, janë gjetur në shumë vendbanime të periudhës helenistike. Përmendim këtu horizontin e fundit të shtresës së shek.IV-II para Kr. të qytezës ilire të Rosujës të lidhur me një hambar me pitosa për ruajtje drithi, si dhe pellgun e Korçës, ku janë gjetur rreth 40 pitosa të përdorur si hambarë drithi të kësaj periudhe[17]. Gjetja e një pitosi të tillë dëshmon për ekzistencën e një fshati ilir të periudhës helenistike në Grazhdan. Për këtë flet jo vetëm funksioni i tij si depozitë familjare drithrash, por edhe restaurimi i tij antik, dukuri e zakonshme e fshatit të kësaj periudhe, kur enë të tilla ishin të kushtueshme.

2. Kupë gjysmësferike me buzë të kthyera nga brenda, e gjetur pranë pitosit. *(tab. I, 1).* Punuar me çark dore. Balta e pastër okër në rozë. Lëmimi i mirë pa vërnik. Prodhim lokal i njërës nga format më të zakonshme të enëve të tavolinës të shekujve të III-II para Kr.[18].



Tabela I (1-15)

b. Blloqe antik të ripërdorur në kala

Në sistemin fortifikues të kalasë së Grazhdanit, gjenden të ripërdorur një numër i madh blloqesh kuadratikë të periudhës helenistike. Gjetja për herë të parë e tyre në vitin 1982 *(fig. 7-8)*, u pasua në vitet e mëvonshme me zbulimin e blloqeve të tjerë kuadratikë,

[17] B.Jubani-N.Ceka, *Gërmime në qytezën ilire të Rosujës*, Iliria I, 1971, f, 51,57, tab.IV, 3; P. Lera, *Pitosa antike me vula nga rrethi i Korçës*, Iliria 1983, 2, f. 211-212 tab. I ,4; Një pitos i plotë me përmasa më të vogla i këtij tipi është gjetur edhe në Deshat afër Peshkopisë. Ruhet në MHP. Pitosa të ngjashëm, por me përmasa më të vogla, janë zbuluar edhe në shtresën e shek. II-I para Kr. të kalasë së Irmajt(Gramsh). Shih : F. Prendi-Dh. Budina, *Kalaja e Irmajt,* Iliria II, 1972, f. 32, tab. IX, a, 2-3.

[18] H. Hidri, *Nekropoli antik i Dyrrahut*, Iliria 1986, 2, tab. X, 3-5; B. Lahi, *Qyteza e fortifikuar e Beltojës*, Iliria 1988, 2, tab.VI, 79-83; S. Anamali, *Kështjella e Pogradecit*, Iliria IX-X, 1979-1980, tab. XIII, 1015; A. Bunguri, *Periudhat postneolitike të vendbanimit të Topojanit,* Ilira 1997, 1-2, tab. VII, 8-12

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7. Trakt muri kuadratik me blloqe të ripërdorur



Fig. 8. Planimetria e murit kuadraik

të ripërdorur kryesisht në hyrjet e kalasë ose pranë tyre, në murin lindor e atë jugor të kalasë, si dhe në kullat gjegjëse e kontrafortet. Këta blloqe janë gdhendur prej guri të pastër gëlqeror, me ngjyrë të bardhë të mbyllur. Ato kanë përmasa të përafërta 0.60 x 0.70 x 0.80 m dhe zakonisht janë të gdhendura mirë në 5-6 faqe. *(fig. 2. pamje e murit kuadratik)*. Gurë të tillë gëlqerorë nuk gjenden në zonën përreth kalasë së Grazdanit. Ato duhet të jenë sjellë këtu nga ndonjë qendër helenistike ose antike e pellgut të Dibrës, e ndoshta nga vetë trualli i qytetit të Dibrës, ku në shekujt e parë të erës sonë, ka të dhëna për ekzistencën e një qendre qytetare (Dobëri ?)[19], apo drejtpërdrejtë nga gurorja e Banishtit pranë qytetit të sotëm të Dibrës[20]. E njëjta dukuri ndeshet edhe në castrumin Skampis, në themelet e tri hyrjeve të të cilit, janë zbuluar shumë blloqe kuadratikë të ripërdorur të periudhave më të hershme[21].

II. Periudha e hershme perandorake (shek. I-III pas Kr.)

Materiali i lëvizshëm arkeologjik i kësaj periudhe, kronologjikisht i lidhur me fazën e vonë të saj(shek. II-III pas Kr) është shumë i paktë dhe përfaqësohet nga disa fragmente enësh dhe një monedhë perandorake:

1. Fragmente enësh.

Fragmentet e enëve të shek. II-III pas Kr. janë shumë të pakta. Ato vijnë kryesisht nga sondazhi A i vitit1983. Në stratigrafinë vertikale të shtresës kulturore me trashësi 1.50 m, u veçuan dy periudha suksesive, kronologjikisht të lidhura me shekujt e parë të erës sonë(shek.II-III pas Kr.) dhe periudhën e vonë antike(shek. IV-VI pas Kr.). Shtresa e parë më e hershme, përbëhet nga dhe argjilor me ngjyrë kafe në të verdhë, e përzier me fragmente enësh të pakta e të copëzuara. Ato janë bërë me brumë të pastër okër të kuq, me pjekje të lehtë e të njëtrajtshme. Faqja e jashtme e tyre shpesh është lyer me një ajkë të kuqërremtë, të tipit terrasigilata, që nuk ruhet e plotë. Faqja e brendshme përshkohet nga kanelyrat rrethore që në disa enë zbukurojnë edhe faqen e jashtme të tyre,

[19] Është fjala për gjetjen në truallin e këtij qyteti në vitin 1953 të bustit të një nëpunësi romak, si një element i qendrave urbane, sot të ekspozuar në Muzeun Popullor të Ohrit, Shih: V. Bitrakova – Grozdonova në: *"Prilog kod antičkata Istorja na Debarskijot kraj*, Spisanje na Sojuzot na druzvata na istoriçarite na Republika Makedonija, Scopje 1966, f. 200; V. Sokolovska, *"Antičkata Skulptura vo SR Makedonija"*, Skopje 1987, f. 126-127, tab. 23 (1-3). Ata nuk mund të jenë marrë nga ndonjë qendër e supozuar brenda kalasë së Grazhdanit, pasi në këtë kala, depozitimet më të hershme kulturore, nuk e kalojnë shek. II pas Kr. Lokalizimi i qytetit antik të Doberit në truallin e qytetit të sotëm të Dibrës trajtohet në një punim të veçantë.

[20] Për këtë mendim mbështetemi në përbërjen e njëjtë gëlqerore të tyre me gëlqerorët e gurores së Banishtit, 3 km në veri të qytetit të Dibrës, që mendohet të jetë shfrytëzuar që në periudhën romake. Gjithashtu në lagjen e vjetër të këtij qyteti, gjenden shumë blloqe të tillë me të njëjtën përbërje, të ripërdorur si spolie në ndërtimet e shek. XVIII-XIX, si dhe disa trungje kollonash cilindrike të shëndruara në dybeqe.

[21] Y. Cerova- *Bazilika paleokristiane Elbasan*, Vitit arkeologjik 2008, Tiranë 8 janar 2009.

DO NOT COPY

zakonisht në zonën e supeve *(tab. I, 3-5, 7)*. Midis gjetjeve të kësaj periudhe, D. Komata përmend edhe disa copa qeramike që i përkasin një terrakote të vogël[22].

2. Monedhë bronzi e perandorit Filipi Arab (244-249).

Gjetur në sondazhin A/1983, në thellësinë 1.50m. Ruhet në kabinetin numizmatik të IKA-së, nr. inv. 8361. *(fig.9-10).*



Fig. 9. Monedhë bronzi e F. Arab (faqe)



Fig. 10. Monedhë bronzi e F. Arab (shpinë)

Æ : D = 25 mm
P = 15.6 gr.
Fq. = Koka e perandorit *Filipi Arab* majtas me brerore.
IMP. PHILIPPVS AVG.
Shp. = Shtat femre në këmbë, me bririn e bollëkut në një dorë dhe peshoren në tjetrën.

[22] D. Komata, *Raport mbi gërmimet...* f. 3

Sipër kokës: **AEQVITAS**
Poshtë **S - C.**
Prerje e vitit 247 pas Kr[23].

Këto pak të dhëna, na shtyjnë të mendojmë se në hapësirën e kalasë së Grazhdanit, në periudhën e hershme perandorake(shek.II-III pas Kr.) duhet të ketë ekzistuar një vendbanim i hapur urban, duke filluar të paktën që nga shek. II pas Kr. dhe se rrethimi me mure nuk është bërë *ex-novo*. Një indikacion interesant në mbështetje të këtij mendimi është edhe toponimi "stadium" i ruajtur deri më sot në memorien popullore. Ai i referohet një parcele me formë të rregullt gjysëmeliptike, me sipërfaqe rreth 0.3 ha, me aks veri-jug dhe hapje të orientuar nga perëndimi. Ajo gjendet jashtë murit jugor të kalasë, i cili në këtë segment pëson një harkim mjaft të rregullt e intrigues, dhe ndjek linjën e lakuar të tarracës lindore mbi këtë parcelë, e cila ka të ngjarë të ketë shërbyer si bazë e shkallares së ndonjë stadiumi apo teatri romak të shek. II-III pas Kr.[24] *(fig. 11).*



Fig. 11. Pamje e "stadiumit" pranë hyrjes jugore

[23] H. Cohen, *Monnaies, Medailles Imperiales,* Lepzig 1830, vol. 5, f. 95, nr.7.
[24] "Stadiumi" ndodhet në anën e jashtme të murit jugor të kalasë, tek kthesa e fortë dhe e rregullt që pëson muri midis kullës nr. 11 dhe 12 dhe në njëfarë mënyre "plotëson" urbanistikën e qytetit të shek. II-III pas Kr. të supozuar në këtë kala. Konfigurimi i terrenit i ngjan në të vërtetë një teatri romak. "Skena" ka formë eliptike me diametër 80 m dhe reze 50 m. Skarpati ku duhet të ketë qenë "cavea" ka formë të harkuar, lartësi 15-16m dhe pjerrësi mbi 60°, të përshtatshme për vendosjen e "shkallares". Në se ky supozim rezulton i vërtetë nga gërmimet arkeologjke, konfirmohet ekzistenca këtu e një qyteti të periudhës romake. Parcela ku gjendet "stadiumi" thirret me emrin "Jedeli", toponim i lidhur me nënshtresën osmane.

DO NOT COPY

III. Periudha e vonë perandorake (shek. III - IV pas Kr.)

Sistemi fortifikues

Sistemi fortifikues i kalasë së Grazhdanit kryhet gjatë një faze që i referohet shek. III-IV pas Kr., ndonëse në një fazë të dytë më të vonë, përkatësisht në shek. V-VI pas Kr. rifortifikohet ndonjë element pjesorë i tij.

a. Faza e parë (fundi i shek. III - fillimi i shek. IV)

Gjatë kësaj faze, kryhet fortifikimi i plotë i kalasë së Grazhdanit. Në këtë përfundim të çojnë disa elementë datues, që do të cilësohen gjatë përshkrimit të sistemit fortifikues të saj.

Planimetria e kalasë së Grazhdanit ka trajtën e një drejtkëndëshi, vetëm dy brinjët e ngushta të të cilit, ajo lindore dhe perëndimore janë të drejta. Ndërkaq brinjët e gjata, ajo jugore dhe veriore, duke shfrytëzuar aftësitë mbrojtëse të terrenit ndjekin izoipset skajore të tarracave përkatëse dhe i shmangen linjave rreptësisht të drejta *(fig. 12)*. Sipas A. Baçes, muret rrethuese me perimetër 2760m, rrethojnë një sipërfaqe prej 34 ha[25]. Ato ruhen



Fig. 12. Planimetria e përgjithshme e kalasë

[25] *A. Baçe, Fortifikimet ...* f.49. tab. III. Shënojmë se siparfaqja prej 34 ha përputhet me të dhënat e marra nga zyra kadastrale e Peshkopisë, për 8 parcelat e përfshira brenda mureve të kësaj kalaje, që sipas radhës janë: 1. Ograde – 6 ha, 2. Kukale – 4 ha, 3. Ceste – 4 ha, 4. Livanivi – 4 ha, 5. Skuçillë – 2 ha, 6. Bejze – 4 ha, 7. Rankovicë – 4 ha, 8. Çelebicë – 6 ha.

gati në të gjithë gjatësinë e tyre, përveç disa trakteve të anës veriore, të shembura mbi përroin e Kamenicës. Lartësia e ruajtjes së mureve lëviz nga 1-1.5 m, ndërsa gjerësia e tyre është 2.80- 3.20 m. Siç shihet nga një trakt i murit jugor, i prerë nga rruga nacionale, themelet e mureve janë thelluar deri në tabanin e fortë argjilor, që varësisht terrenit shfaqet në thellësitë 0.70-1.50 m. Mbi këtë taban natyror është hedhur një shtresë llaçi gëlqeror, me trashësi 0.08-0.10 m, që ka shërbyer si baza fillestare e murit *(fig. 13)*. Muret janë ndërtuar me gurë



Fig. 13. Trakt i murit jugor i prerë nga rruga nacionale

lumorë të madhësive mesatare, të lidhura me llaç të bollshëm gëlqeror. Përveç teknikës *opus incertum*, që mbizotëron, ndeshet edhe teknika *opus mixtum*, kjo e fundit kryesisht tek tri hyrjet e castrumit. Llaçi përveç gëlqeres është i përzier me rërë lumi e guralecë, gjë që ka rritur fortësinë e tij. Muri përbëhet nga dy faqet anësore dhe bërthama ose emplektoni midis tyre, gjerësia e të cilit ndryshon varësisht nga gjerësia e mureve rrethuese. Emplektoni tek muret rrethuese është 1.80 - 2.20 m, ndërsa tek kullat arrin në1-1.20 m. Gurët më të mëdhenj janë zgjedhur për në dy faqet anësore të murit, kurse bërthama e tij është mbushur me gurë më të vegjël të hedhur në llaç të bollshëm gëlqeror. Llaçi është hedhur me bollëk edhe në fasadën e jashtme të murit, duke e mbuluar jo vetëm fugat, por dhe një pjesë të faqes së gurëve. Megjithatë në pjesë të veçanta të murit, lexohen rreshta horizontal të gurëve, të ndara nga fuga llaçi me gjerësinë 2 - 3 cm. Teknika e ndërtimit të tyre është tipike për shek. III – IV pas Kr. Mbi themel lihet nën të dy anët një cokol me gjerësi 0.20 m *(fig. 14-15)*, e cila tek kullat zbret deri në 0.12 m. Kjo normë teknike ndeshet edhe në fortifikime të tjera



Fig. 14. Pamje nga muri lindor i kalasë



Fig. 15. Pamje nga muri lindor i kalasë

bashkëkohëse si në kalanë e Elbasanit, Pogradecit, Beratit, Durrësit, Bushatit, qytetit të periudhës së vonë antike të Shkodrës[26]etj dhe jashtë vendit tonë edhe në Abritus apo kala të tjera romake të kësaj periudhe[27].

Ajo tregon se ndërtuesit i kanë zbatuar kërkesat inxhinierike të rekomanduara nga arkitektët e kohës për rritjen e qëndrueshmërisë së murit [28].

Kullat dhe hyrjet

Muret rrethuese të kalasë së Grazhdanit, përforcohen nga 44 kulla në të gjithë gjatësinë e tyre, por jo të gjitha ruhen [29]. Sistemi fortifikues i kësaj kalaje, kombinon 4 tipe kullash: kullat në formë "U "-je, ato katrore dhe drejtëkëndore midis tyre si dhe kullat në trajtë freskoreje në këndet dhe kthesat e forta. Bashkëjetesa e këtyre 4 tipe kullash, ndeshet në kala të tipit castrum në Shqipëri (Vig, Skampin, Paleokastër, Bushat)[30], dhe jashtë saj në një hapësirë të gjerë të perandorisë, që nga Lindja e Afërt, në Arabi (el-Leggun, Odruh), në Siri (ed-Dumer), në Bullgari (Abritus), në Rumani (Ulmetum, Troesmis, Capidava) dhe deri në Angli (Porchester)[31]. Përdorimin e 4 tipeve të kullave në të njëjtin fortifikim, studiuesit e konsiderojnë si një fazë të re dhe më të avancuar të fortifikimeve romake, të përdorur në intervalin e shek. III – IV pas Kr [32].

Në kalanë e Grazhdanit, mbizotërojnë kullat në formë "U"-je, që përbëjnë një veçori të sistemit fortifikues të saj. Ato përforcojnë muret anësore dhe mbrojnë të tri hyrjet e kalasë. Kullat lidhen organikisht me murin rrethues. Ato dalin me faqe të drejta prej tyre dhe pastaj rrumbullakosen lehtë në pjesën ballore të tyre, aq sa gjatësia e harkut qëndror të kullës thuajse përputhet me kordën që e tendos atë. Ato kanë përmasa të jashtme 9.50 x 8.40 m dhe gjerësinë e mureve 2.20 – 2.40 m. Hyrjet e këtyre kullave kanë gjerësi 1-1.20 m, ndërsa thellësia e brendshme e kontrafortëve arrin në 0.60 m. Këto kulla janë të dëmtuara kryesisht në pjesën ballore. Lartësia më e madhe e ruajtes së tyre, gjendet në disa kulla të murit jugor, ku arrin nga 2.5 – 3 m. *(fig.16).*

[26] Y. Cerova, *Castrum Skampis*, Iliria 1997, 1-2, f. 289 dhe shënimi nr. 23-24 i kësaj faqeje ; S. Anamali, *Kështjella e Pogradecit*, Iliria IX-X, 1979-1980, f. 222; H. Spahiu, *Gërmimet arkeologjike të vitit 1973 në kalanë e Beratit*, Iliria III, 1974, f. 483-487, A. Baçe, *Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë*, Monumentet 9, 1975, f. 91-103; L. Përzhita, *Kështjella e Bushatit*, Iliria 1986, 2, f. 191; G. Hoxha, *Muri rrethues e periudhës së vonë antike në qytetin e Shkodrës*, Iliria 1994, 1-2, f. 233.

[27] T. Ivanov, *Abritus*, Sofie 1980, f. 242.

[28] *Philon de Byzance*, "Syntaxe Mecanique " livre V, A, 13; *Vitruv*, I, V,3. (Cituar sipas G.Hoxhës, *Muri rrethues*...f. 234, shën.13-14).

[29] Kulla e qoshes verilindore të kësaj kalaje, është asgjësuar nga ndërtimi aty i një lokali shërbimi në vitin 1991. Me gjithë dërgimin e çështjes në gjyq, mosfunksionimi i shtetit, favorizoi ndërtimin e këtij lokali.

[30] Y. Cerova, *Catrum Scampis... f. 291*, A. Baçe *Kështjella e Vigut, arkitektura, rikonstruksioni dhe restaurimi i saj. Monumentet 14, 1977, f. 77-83;* Po ai, *Kështjella e Paleokastrës, Iliria 1981, 2, f. 171;* L. Përzhita, *Kështjella e Bushatit... f. 192.*

[31] T. Ivanov, *Abritus*, Sofie 1980, f. 242 – 246, fig. 183-189.

[32] Po aty, *f. 248*

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 16. Pamje e një kulle në formë "U"-je në murin jugor

Kullat katrore dhe ato drejtkëndore janë më të pakta në numër dhe kanë përmasa më të vogla se kulla të tipit të parë. Ato kanë gjatësi të ruajtur 8-9 m, gjërësi 6.60 – 6.80 m dhe gjërësinë e mureve 1.80 – 2.20 m *(fig. 17)*.



Fig. 17. Kullë katore në murin verior

Kullat në trajtë freskoreje, deri më tani ndeshen vetëm në një rast *(fig. 18)*. Ajo gjendet në kthesën e parë të fortë të murit jugor nga perëndimi[33]. Këtë kullë e kemi emërtuar kulla nr. 10, duke e filluar numërimin nga kulla në të djathtë të hyrjes lindore të kalasë. Kjo kullë krijon me murin rrethues kënd të drejtë në krahun e majtë dhe të gjerë në krahun e djathtë të saj, aty ku fillon kthesa e murit. Gjerësia e mureve të saj është 2 m, ndërsa gjerësia e xokolës në të dy faqet, 0.12 m. Baza e jashtme e kullës është 6.60m e gjërë dhe ajo e brendshme 2.60 m. Gjatësia e jashtme e kullës është 12 m dhe ajo e brendshme 9 m, ndërsa gjërësia e jashtme e saj është 11.60 m dhe ajo e brendshme 8 m. Segmentet përkatëse të tyre tendosin kordën me rreze 4.40 m. Hyrja e kullës nuk mund të matet pa gërmime të posaçme. Kulla të këtij tipi duhet të kenë qenë edhe kullat e qosheve me nr. 5, 11, 23, 26, 33 dhe 43[34], duke ruajtur kriterin e mësipërm të numërimit të tyre *(fig. 12)*. Kulla freskore krejt identike



Fig. 18. Kullë freskore në murin jugor

me kullën e përshkruar të Grazhdanit, gjenden në kullën nr.1 të qoshes jugperëndimore të kalasë së Skampinit[35], kullat e qosheve të kështjellave të Paleokastrës dhe të Vigut [36], ndërsa jashtë Shqipërisë në kalanë e Abritusit në Bullgari (kullat nr. 10, 16, 26)[37].

Largësia midis kullave, e ashtuquajtura kurtinë, nuk është e njëjtë dhe duket se ka qenë kushtëzuar nga faktorë

[33] Zbuluar në vitin 1986 gjatë pastrimit të murit jugor nga ATL Monumenteve Peshkopi.

[34] Kulla nr. 43 është asgjësuar nga lokali tregtar i sipërpërmendur.

[35] Gj. Karaiskaj, *Disa të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit*, Buletin Arkeologjik , 1971, f. 169, tab. I, 1.

[36] Po ai, *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Tiranë 1981, fig. 78-79.

[37] T. Ivanov, *Abritus*, Sofie 1980, fig. 10, 12,60, 69.

topografik e ushtarakë, të rëndësishëm për kohën (rrezja e veprimit të shigjetës, forca goditëse e balistave, thyerja e terrenit, kthesat e murit si dhe nevoja e një mbrotjeje më të fuqishme në hyrjet). Kështu, largësia maksimale e kullave në terren të sheshtë për murin verior është 40-58 m dhe për murin jugor 40 - 43 m, ndërsa tek këndet e mureve dhe thyerjet e relievit ajo ulet deri në 35 - 40 m.

Kalaja ka patur tri hyrje, dy në një aks veri-jug dhe një në faqen lindore të saj. Vendosja e dy hyrjeve kryesore të kalasë në të njëjtin aks, sipas stilit të ashtuquajtur *via principalis*, përbën një tipar dallues të fortifikimeve romake të tipit të castrumit. Secila nga hyrjet mbrohej nga dy kulla në formë "U" -je të vendosura në të dy anët e hyrjes. Kjo mënyrë e mbrojtjes së hyrjeve është karakteristike për castrumet e gjysmës së parë të shek. IV pas Kr., siç dëshmohet në hyrjet lindore e perëndimore të Skampinit dhe të Vigut. Hyrja jugore e kalasë së Grazhdanit përfaqëson një model klasik të hyrjeve me dy porta *(fig.19)*.

Grazhdan '89. Hyrja jugore. Sh.1:50



Fig. 19. Hyrja jugore e kalasë

Midis tyre krijohet një oborr i brendshëm katërkëndësh i fortifikuar i tipit *propognaculum*, që shërbente si qendra e fundit e asgjësimit të sulmuesëve. Ajo është krejt identike me portën lindore të Skampinit (Elbasan) dhe atë perëndimore të Vigut (Shkodër)[38], me njerën nga hyrjet e Ulpianës (Justiniana Secunda)[39], si dhe me portën veriore të Abritusit (Bullgari)[40]. Studiuesit kanë konstatuar se ky tip hyrjesh i kështjellave, që fillon të përdoret që me perandorin Vespasian, nis të zhduket në vazhdim të shek. IV pas Kr.[41].

Hyrja lindore e kalasë, gjendet tek vendi i quajtur *"kisha"* dhe mbrohet nga dy kulla në formë "U"-je[42].

Kalaja e Grazhdanit është fortifikimi më i madh i tipit të castrumit në Shqipëri dhe ndër më të mëdhatë në rajon. Ajo ka sipërfaqe 34 ha ose 3.2 herë më të madhe se Skampini (10.718 ha), 37 herë më të madhe se Paleokastra (0.915 ha), 48.6 herë më të madhe se Bushati (0.7 ha), 56.6 herë më të madhe se Vigu (0.615 ha), 2.27 herë më të madhe se Abritusi (15 ha) etj.

Ndërtimet e brendshme

Nga gjurmët e ndërtimeve të ruajtura në hapësirën e brendshme të kalasë së Grazhdanit, krijohet përshtypja e organizimit të tyre sipas një plani ortogonal. Një gjë e tillë është kushtëzuar nga konceptimi i saj si një castrum i mirëfilltë dhe është e përcaktuar nga kryqëzimi në kënd të drejtë i dy rrugëve kryesore të tij.

1. Rruga I (cardo maximus) bashkonte dy hyrjet kryesore të kalasë, atë jugore dhe atë veriore dhe në pikëpamje strategjike ishte rruga më e rëndësishme e saj. Sot kjo rrugë është pjesërisht në funksion dhe është emërtuar sipas emrit të parcelave që përshkon: rruga *Livanivi*, dhe rruga e *Jedelit*[43] *(f. 19)*.

2. *Rruga II (decumanus maximus)*, e quajtur *"Çelebia"* përshkon qytetin mespërmes nga hyrja lindore e kalasë, deri në parcelën fundore brenda murit perëndimor të emërtuar nga kjo rrugë *(Çelebicë)*. Kjo rrugë është në funksion edhe sot. Të dy rrugët priten në pjesën qëndrore të qytetit, në parcelën e quajtur *"Ceste"*. Pikërisht në këtë parcelë, në anën perëndimore të rrugës *Livanivi* dhe në jug të rrugës *Çelebia*, ende ruhen trakte muresh me gjerësi afro 1 m, të ndërtuara me të njëjtën teknikë, ashtu si dhe muret rrethuese. Sipas mendimit tonë, ata u takojnë godinave shoqërore apo ushtarake të qytetit. Gjithashtu në pjesën qëndrore të sipërfaqes së kalasë, në parcelën e quajtur *"Ceste"*, deri vonë shihej një pus

[38] Gj. Karaiskaj, *5000 vjet fortifikime në Shqipëri.* fig. 79, 81; Po ai, *Disa të dhëna...* Tab. I,3, A. Baçe, *Kështjella e Vigut* fig. 20.
[39] E. Cerskov, *Ulpiana,* "Glasnik Kosova I Metohija " IV-V,Prishtinë 1959-1960. f.375-376.
[40] T. Ivanov, *Abritus...*, f. 42. fig. 30.
[41] Gj. Karaiskaj, *Disa të dhëna...* f.169; Y. Cerova, *Castrum Skampis*, Iliria 1997, 1-2, f. 295 dhe citimi nr. 56 i kësaj faqeje.
[42] Konturet e kullave lexohen në sipërfaqe, por për dimensionet e tyre duhen punime pastrimi.
[43] Kjo rrugë sot është zhvendosur disa metra në jug të aksit të dikurshëm.

DO NOT COPY

i thatë uji me thellësi të lexueshme 1.5 – 2 m. Pikërisht në këtë zonë, vite më parë, janë konstatuar gjurmët e një ndërtese me dyshemenë mbi kolloneta tulle, që i përkisnin njerës nga banjot e qytetit[44].

Planimetria e kalase së Grazhdanit, i shmanget formës klasike te castrumit romak, duke ju përshtatur terrenit jo krejt fushor të saj . Megjithatë, kjo veçori nuk mund të shërbejë si argument për për të mos e përfshirë atë brenda tipit të castrumit apo për një datim para shek. III-IV të mureve të saj , siç është menduar në ndonjë rast[45]. Sipas të dhënave të paraqitura më lart, kalaja e Grazhdanit është një fortifikim i tipit të castrumit romak, i ndërtuar në fundin e shek. III dhe fillimin e shek. IV pas Kr. Ky përfundim rrjedh nga teknika e ndërtimit të mureve mbrojtëse dhe analogjitë e sistemit të saj fortifikues me atë të castrumeve të Skampinit, Vigut, Bushatit e Paleokastrës.

Lidhur me kronologjinë e ndërtimit të mureve të kalasë së Grazhdanit, mund të shfrytëzojmë analogjitë e sistemit të tij fortifikues me atë të castrumit të Skampinit, koha e ndërtimit të të cilit është zbritur tani së fundi deri në periudhën e Dioklecianit (284-305)[46]. Duke u mbështetur në ngjashmërinë e disa elementëve të përbashkët të sistemit fortifikues të këtyre dy fortifikimeve, siç janë, teknika e njëjtë e ndërtimit të mureve, përdorimi i tipave të njëjtë të kullave, pajisja e të dy fortifikimeve me tri hyrje të të njëjtit tip planimetrik, vendosja e tyre në të njëjtin aks veri-jug, mbrojtja e secilës hyrje nga dy kulla në formë U-je etj, mendojmë se ekziston mundësia e kësaj zbritjeje kronologjike edhe për rastin e Grazhdanit, duke patur parasysh edhe qetësinë relative të perandorisë romake, të rivendosur gjatë sundimit të Dioklecianit. Por për përmasat shumë të mëdha të kalasë së Grazhdanit, mendojmë se ky fortifikim duhet të ketë vazhduar edhe në kohën e Licinit I (205-324) e ndoshta edhe në atë të Konstandinit (324-337). Por gjithsesi, ne ende nuk kemi në dorë të dhëna më të plota arkeologjike, numizmatike apo epigrafike, për të argumentuar plotësisht mendimin e mësipërm, ndaj mundësia e një datimi më të ngushtë mbetet e hapur.

b. Periudha e vonë antike(shek. IV-VI pas Kr.)

Kjo periudhë në sistemin fortifikues të kalasë së Grazhdanit, është përfaqësuar, të paktën deri tani, vetëm nga një element mbrojtës. Është fjala për një mur tërthor të ndërtuar në krahun e djathtë të hyrjes lindore të kalasë, pranë kullës nr. 1, i zbuluar nga sondazhi B i vitit 1983 *(fig.20)*. Muri ka drejtim lindje-perëndim, gjatësi 11m



Fig. 20. Planimetria e murit përforcues pranë hyrjes lindore të kalasë

dhe gjerësi 2.60 m. Fasada perëndimore e tij është ndërtuar nga 4 blloqe kuadratikë me përmasa 0.71 x 0.69 x 0.43 m, 0.84 x 0.53 m, 0.70 x 0.50 m dhe 1.10 x 0.58 m. Blloqet janë të lidhur në të thatë dhe të puthitur mirë, sipas teknikës *opus implectum*. Ato janë vendosur mbi një bazament muri të ndërtuar me gurë lumore të lidhur me llaç gëlqerorë, me lartësi 0.30 m. Në

[44] A. Baçe, *Dobëri një qytet i vjetër, f. 18.* Duhet thënë se pas kolektivizimit të bujqësisë, në pjesën qëndrore të qytetit (*Livanivi dhe Ceste*), janë shkatërruar me traktor themele të shumtë të godinave të ndryshme dhe janë gjetur mjaft blloqe kuadratikë, tulla të mëdha me sipërfaqe të zbukuruar me vija të lakuara gishtash, fragmente enësh etj . Emri "*Çeste*" është toponim i rrjedhur nga latinishtja "cisterna" = sterë = pus.

[45] A. Baçe, *Dobëri një qytet i vjetër*, Revista " Ylli ", 1983, f. 18.

[46] Y. Cerova, *Castrum Scampis...* f. 295.

DO NOT COPY

Do not copy

të dy faqet e dukshme të tij, në atë jugore dhe perëndimore, ai krijon një xokol me gjërësi përkatësisht 0.12 m dhe 0.25 m. Ky themel është e ndërtuar me gurë lumorë me përmasa mesatare, 0.40 x 0.22 m, 0.33 x 0.13 m, 0.33 x 0.10 m, 0.17 x 0.07 m, 0.32 x 0.06 m etj. Struktura e murit përbëhet nga dy faqet anësore dhe emplektoni. Ky i fundit është mbushur me gurë lumorë të madhësive të ndryshme, si dhe tulla me brinjë 0.40 m, me faqe të zbukuruar me vija të lakuara gishtash. Gjatë gërmimit, pranë murit janë gjetur edhe copa tullash me trashësi 3.5, 4 dhe 4.5 cm dhe gjatësi 28 cm dhe 29.5 cm, shpesh të zbukuruara në faqen e sipërme të tyre me kanëlyra të lakuara ose diagonale. Lidhja e murit është bërë me llaç të fortë gëlqerorë, i cili në faqen e jashtme, shpesh mbulon edhe fugat bashkë më sipërfaqen e gurëve. Megjithëse teknika e ndërtimit të këtij muri është e njëjtë me atë të mureve rrethuese të kalasë, mendojmë se ai është ndërtuar në periudhën e vonë antike sepse:

a. Ai nuk përputhet me skemën planimetrike të kalasë dhe nuk është pjesë organike e saj.

b. Shtresa kulturore ku gjendet ai përmban fragmente enësh të shek. V-VI pas Kr. dhe i takon kësaj periudhe, për të cilat do të flitet më poshtë.

c. Në emplektonin e këtij muri janë përdorur si material mbushës tulla me kanëlyra të lakuara, të hequra nga dyshemetë e godinave më të hershme shoqërore apo kultike.

Për këto arsye mendojmë se vendosja e këtij muri ketu, është bërë ndoshta gjatë rifortifikimit të pjesshëm të kalasë, gjasisht në periudhën e Justinianit (527-565), për të përforcuar mbrojtjen e hyrjes lindore te kalasë.

III. Gjetjet arkeologjike të periudhës së vonë antike (shek. IV-VI pas Kr)

a. Elementë arkitektonikë

Këto elementë përfaqësohen nga dy bazamente kollonash dhe një kapitel i vonë korinthik, të gjetura veç e veç, në kohë të ndryshme.

1. Bazament kollone korinthike, i profiluar në trajtë altari, me lartësi 0.18m. *(fig.21)*. Gëlqeror i mermerizuar me ngjyrë të bardhë të mbyllur. Përbëhet nga plinti katror me bazë 0.36 m, torusi i sipërm dhe ai i poshtëm që ndahen nga një scotia plastike. Torusi i poshtëm me formë rrethore i brendashkruhet katrorit të plintit me diametër të njëjtë me brinjën e tij 0.36 m. Torusi i sipërm me diametër 0.28 m, përshkohet në mes nga brima për derdhjen e plumbit.



Fig. 21. Bazament kolone i plotë

2. Bazament kollone korinthike i përgjysmuar, me lartësi 0.13 m. *(fig.22)*. Gëlqeror i mermerizuar me ngjyrë të bardhë të mbyllur. Plinti katror me brinjë 0.28 m është i dëmtuar. Torusi i poshtëm brendashkruar tij dhe ai i sipërm ndahen nga dy scotia plastike, midis të cilëve është profiluar një ulluk horizontal. Ndryshe nga bazamenti i parë, torusit e këtij kanë diametra të përafërt. Diametri i torusit të sipërm është 0.25 m. ky i fundit përshkohet nga vrima për derdhjen e plumbit, e cila përshkon dhe pjesën e poshtme të plintit (6 x 6 x 6 cm).



Fig. 22. Bazament kolone i pjesshëm

3. Kapiteli i tipit korinthik. Gjetur në Gradec, shumë afër kalasë së Grazhdanit. Baza mbajtëse 0.45 x 0.45 m, baza mbështetëse 0.34m, lartësia-0.30m, lënda-mermer me ngjyrë të bardhë të mbyllur. *(fig. 23).* Në



Fig. 23. Kapitel korinthikë (kompozitë).

pjesën e poshtme, gjerësia dhe gjatësia zvogëlohen përkatësisht në 0.30 m dhe 0.25 m duke i dhënë kapitelit trajtën e një këmbane të përmbysur. Pjesa kryesore e tij përbëhet nga ekini me lartësi 0.23 m. Ai zbukurohet nga 8 gjethe akanthi me majë dhe me reliev të thellë të vendosura në dy kate, të cilat, në pjesën e sipërme të ekinit, modelojnë po aq voluta. Si element teknik për t'u përmendur janë vrimat e thella të trapanit mbi gjethet e akanthit, dukuri që i referohet shek. IV-V pas Kr[47]. Për një trajtim më voluminoz shquhen volutat e qosheve të cilat përveç kësaj, janë një fishe. Ekini ndahet nga abaku nga një kornizë guri me gjerësi 1.5 cm. Pjesa e përparme e kapitelit, veçohet nga pjesët anësore, nga parapete të holla të trajtuara cekët. Faqja e pasme e kapitelit është e drejtë veç krahëve anësorë të kthyer me kënde të gjerë. Në bazën mbajtëse kapiteli është pajisur me një vrimë për kapjen e arkitraut (9 x 7 x 5 cm), që ende ruan një sasi të vogël plumbi, të derdhur për këtë qëllim.

Kombinimi i gjethes së akanthit, si motivi bazë i stilit korinthik, me volutat, që shfaqen si reminishencë e stilit jonik, dëshmojnë se kapiteli i mësipërm anon më tepër nga kompozitat se sa nga kapitelet e një stili të pastër arkitektonik. Vetë stili korinthik gjeti përdorim më të madh në dekorin e brendshëm të tempujve. Thyerja e kanoneve të ngurta të stileve arkitektonike të periudhës klasike e helenistike dhe futja gjerësisht në përdorim e stilit korinthik të përzier me elementë të jonikut, është një dukuri që nis të shfaqet në periudhën e hershme perandorake dhe atë të vonë të saj, ndërsa kjo është dukuri e zakonshme në periudhën e vonë antike, skulptura e të cilës riciklon traditat antike, duke ruajtur tiparet e punimit dhe simbolet e artit paleokristian[48]. Në Shqipëri kapitele të ngjashëm me atë të Grazhdanit janë gjetur në bazilikën e Tepes së Elbasanit [49] si dhe në qytetin e Butrintit[50], ndërsa jashtë vendit kapitele korinthikë të këtij tipi janë gjetur në qytetin e Kostandinopolit[51] si dhe në Siri, Greqi[52] etj. Kapiteli të tillë, të quajtur "teodosianë" në muzeun e Konstandinopolit datohen në mesin e shek. V pas Kr. ose midis viteve 447-461 pas Kr[53], kohë të cilës duhet t'i përkasë edhe kapiteli korinthik i Grazhdanit. Për analogji të njëjtën datë do të pranonim edhe për dy bazamentet e kollonave korinthike të paraqitura më lart. Megjithëse të gjetura rastësisht dhe të shkëputura nga njëri tjetri, elementët e mësipërm arkitektonik dëshmojnë për njohjen dhe zhvillimin e elementëve arkitektonike të paraqitur më lart në qytetin e Grazhdanit apo rrethinën e tij gjatë periudhës së vonë antike. Nga ana tjetër ata na shtyjnë të besojmë për mundësinë e zbulimit në të ardhmen në rajonin e Dibrës, edhe të ndonjë bazilike paleokristiane, të lidhur me këto elementët arkitektonikë.

b. Fragmente enësh

Fragmente të pakta enësh të periudhës së vonë antike janë gjetur herë pas here në sipërfaqen e brendshme të kalasë së Grazhdanit. Por depozitime kulturore të kësaj periudhe, u zbuluan nga zgjerimi i rrugës nacionale në vitin 1982, si dhe në nivelet e sipërme të

[47] A. Hoti, *Plastikë arkitektonike dekorative paleokristiane nga qyteti i Durrësit,* Iliria 1997, 1-2, f. 325.

[48] R. Kautzsch, *Kapitellstudien Beiträge zu einer Geschichte des Spätantiken Kapitells im Osten vom vierten bis ins siebente Jahrhundert,* Berlin, Lepzig 1936, f. 40-45.

[49] A. Meksi-N. Ceka, *Bazilika paleokristiane në Tepe të Elbasanit,* Buletin Arkeologjik, 3, 1971, f. 186-187; A. Meksi, *Arkitektura mesjetare në Shqipëri (shek. VII-XV),* Tiranë 1983, f. 32-23.

[50] Falenderoj kolegun E. Hobdari që më ofroi për krahasim disa kapitele të ngjashëm të pabotuar të Butrintit.

[51] R. Kautzsch, *Kapitellstudien...* f. 46, tab. XXI, nr. 321.

[52] *Po aty,* f. 45-46.

[53] *Po aty,* f. 44-46.

DO NOT COPY

shtresës kulturore të zbuluar në sondazhin A të vitit 1983. Shtresa II e dheut e sondazhit A, me ngjyrë kafe në okër, ishte e përzier me copa enësh e tjegullash tepër të fragmentuara. Fragmentet e pakta të enëve të saj janë gatuar prej brumi argjilor të përzier me kokrriza ranore, me pjekje relativisht të mirë dhe ngjyrë okër në kafe.

Punimet për zgjerimet e rrugës nacionale të vitit 1982, pranë murit lindor të kalasë krijuan një profil në trajtë skarpati me gjatësi 50 m dhe lartësi 2.20 – 2.50 m. Nga prerja vertikale e tij, dallohen lehtë dy shtresa kulturore, përkatësisht të lidhura me shek. IV-VI dhe VII-IX pas Kr. *(fig. 24)*.



Fig. 24. Profili lindor i rrugës së hapur pranë hyrjes lindore të kalasë (1982)

Shtresa e parë, kronologjikisht e lidhur me periudhën e vonë antike, është vendosur direkt mbi tabanin e vendbanimit. Ajo është formuar prej dheu argjilor me ngyrë okër në të verdhë, të përzier me pak gurë mesatarë e të vegjël, fragmente tullash romake, mbetje llaçi, dhe pak fragmente enësh të kësaj periudhe. Trashësia e saj lëviz nga 0.70 – 1.40m, ndërsa në një gropë të thelluar nën taban (me përmasa 1.00 x 1.30 m), arrin në 1.80 m. Me këtë shtresë kulturore lidhet muri kuadratik, i ndërtuar pranë hyrjes lindore të kalasë, si dhe 8 varre të tipit çist, të futura aty më vonë gjatë periudhës mesjetare.

Në nivelet e sipërme të kësaj shtrese, gjendet e depozituar një shtresë dheu e djegur me ngjyrë të zezë me gjatësi 5 m dhe trashësi 0.10 – 1.00 m, me pak fragmente enësh të së njëjtës periudhë. Ajo është tregues i qartë i djegjes që ka pësuar vendbanimi dhe dëshmon për një fund të dhunshëm, të paktën të pjesës lindore të tij. Pozicioni i saj stratigrafik si dhe fragmentet e enëve të gjetura aty, na orientojnë për ta datuar atë në fundin e periudhës së vonë antike. Megjithëse një datim më i saktë aktualisht nuk është i mundur, ajo shërben si një *terminus ante quem* i ekzistencës së fortifikimit të kalasë së Grazhdanit.

Në gjetjet metalike të kësaj shtrese përmendim një thikë brezi prej hekuri.Thika është një tehëshe me kurriz të drejtë, punuar me teknikën e rrahjes. Ajo ka gjatësi të përgjithshme 13 cm dhe gjatësi të bishtit 4cm. Presa me gjerësi maksimale 3 cm ka prerje trekëndëshe të



Fig. 25. Thikë e Grazhdanit

shtrirë *(fig. 25; tab. I, 7)*. Thika të tilla të ngjashme, të përdorura si vegla pune, janë zbuluar edhe në mjaft qendër banime të periudhës së vonë antike, si në gradishtën e Pesjakës, në Çidhnën e Poshtme, kështjellën e Pogradecit, atë të Pecës, kalanë e Qafës (Elbasan), atë të Shkodrës [54]etj.

Fragmentet e enëve të kësaj periudhe janë të pakta dhe u përkasin enëve të tavolinës. Ato janë punuar me çark këmbe, me brum të përzier me rërë dhe grimca ranore me ngjyrë kafe të hapur në bezhë. Ndër format më kryesore përmendim kotruvet me grykë cilindrike të profiluar dhe të zbukuruar me kanëlyra rrethore çarku, amforat me grykë të ngushtë *(tab. I, 9-10)*, tasat trungkonikë me buzë të kthyer nga brenda ose të drejtë *(tab. I, 12 – 13)*, ojnohetë *(tab. I, 11)*, kupat me fund të lartë *(tab. I, 14-15)* etj. Forma

[54] A. Bunguri, *Vendbanimi ilir i Pesjakës, pjesa. II (në shtyp);* Po ai. *Të dhëna arkeologjike nga Çidhna e Poshtme* (në shtyp); S. Anamali, *Kështjella e Pogradecit,* Iliria IX-X, 1979-1980, f. 230, tab. X,2,6; L. Përzhita, *Kështjella e Pecës në periudhën e antikitetit të vonë dhe në mesjetë,* Iliria 1990, 1, f. 217, tab. XI, 4; Y. Cerova, *Kalaja e Qafës në krahinën e Sulovës,* Iliria, 1987, 2 tab. VIII,1-2; G. Hoxha, *Skodra dhe Praevalis*... f. 201, tab. XXXVIII, 2.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të ngjashme enësh ndeshën në një numër të madh qendërbanimesh të periudhës së vonë antike[55]. Gjithashtu është gjetur edhe një fragment çerepi i punuar me dorë, me formë të ngjashme me çerepë të shtresës së periudhës së vonë antike të kalasë së Shkodrës[56] etj *(tab. I, 8)*. Në sipërfaqen e kalasë, gjenden gjithashtu edhe fragmente tullash të vogla dhe fragmente tjegullash me buzë të lakuara. Si një dëshmi të fundit të jetës qytetare, A. Baçe përmend një monedhë bakri të shek. VI pas Kr., nga sipërfaqja e brendshme e kalasë [57].

IV. Periudha e hershme mesjetare (shek. VII-XI pas Kr.)

Shtresa kulturore e lidhur me këtë periudhë, është dokumentuar stratigrafikisht në profilin e përshkruar më lart *(fig. 24 - Profili lindor i rrugës)*. Ajo është vendosur direkt mbi shtresën e periudhës së vonë antike dhe djegien e fuqishme që vijon mbi të. Eshtë formuar prej dheu argjilor me ngjyrë kafe të hapur, me përmbajtje gurësh përmasash të ndryshme dhe pak fragmente enësh mesjetare. Në këtë shtresë me trashësi 0.50-0.90 m, gjenden 10 varre të tipit çist, të një periudhe më të vonë[58]. Shtresa recente e dheut e mbivendosur mbi të, me trashësi 0.50-0.70 m, është artificiale dhe nuk paraqet interes arkeologjik.

Materiali qeramik i përftuar është i paktë, e i fragmentuar dhe lidhet me shtresën kulturore të vendbanimit. Fragmentet e enëve kanë kryesisht ngjyrë kafe të zezë, gri në të zezë dhe rrallë okër në kafe. Balta e tyre është e përzier me grimca ranore e kuarcite dhe shpesh është poroze, pjekja është e njëtrajtshme, por jo e plotë. Enët janë punuar me çark këmbe. Shumica e tyre ka qenë lyer me një ajkë të hollë balte, me furçën e çarkut, para pjekjes, që ruhet pjesërisht. Format e enëve janë të pakta dhe përfaqësohen vetëm nga vorbat dhe kotruvet. Vorbat i përkasin tipit me trup të fryrë sterik, grykë konike



Fig. 26. Tabela II (1-15)

ose në trajtë hinke dhe buzë të drejta ose të holluara në majë *(tab. II, 1-5)*. Ato kanë përmasa mesatare me diametër 6-21cm. Zbukurohen në zonën e qafës me inçizim të valëzuar *(tab.II, 3-5)*. Kotruvja e vetme i takon tipit me trup në formë dardhe me qafë të profiluar dhe grykë cilindrike. Ajo është zbukuruar me teknikën e ngulitjes. Dekori formohet nga dy rreshta vijash të pjerrta, një prej të cilave vendoset në profilimin e qafës *(tab. II, 6)*. Fundet e vorbave janë të sheshtë ose lehtë të thelluar *(tab. II, 7-8)*, ndërsa vegjet shiritore me prerje petullicë. Disa prej tyre zbukurohen me teknikën e ngulitjes me maje thike *(tab. II, 9-13)*. Zbukurimi me glazurë ndeshet vetëm në një vegjë të tipit shiritor e zbukuruar me glazurë të bardhë mbi faqen okër të saj. *(tab. II, 14)*. Forma të

[55] Gj. Karaiskaj, *Gradishta e Symizës...* tab. III, 6-7; IV, 3 – 5.
[56] *G. Hoxha, Skodra dhe Praevalis në antikitetin e vonë*, Shkodër 2003, f. 98, tab. XXXVI, 9.
[57] A. Baçe, *Dobëri...* f. 18
[58] Varret çist të të dy shtresave të dheut i takojnë një periudhe më të vonë dhe nuk kanë lidhje me shtresat kulturore përkatëse.

DO NOT COPY

ngjashme enësh, të zbukuara me të njëjtat teknika dekorative, ndeshen në shumë vendbanime mesjetare të Shqipërisë[59].

V. Periudha e mesme mesjetare (shek. XII-XIV pas Kr.)

Kësaj periudhe i takojnë 18 varret e zbuluara nga zgjerimi i rrugës, pranë murit lindor të kalasë, si dhe kisha rrënojat e të cilës gjenden pranë tyre. Të gjithë varret janë të tipit çist, dhe kanë orientimin lindje - perëndim *(fig. 27)*. Anët e gjata të arkës së varrit formohen nga 3-4



Fig. 27. Varr çist i varrezës pranë murit kuadratik dhe kishës

pllaka gëlqerore të vëna pingul, të cilat mungonin ose ishin hequr në anën ballore, pranë kokës. Përmasat e disa pllakave janë 1 x 0.36 m, 0.73 x 0.53 m, 0.66 x 0.32 m, 0.49 x 0.15 m. Mbulesa ose tavani i varrit formohet nga 3-4 pllaka horizontale, që shkelin mbi njëra-tjetrën dhe dalin paksa jashtë pllakave anësore. Gjatësia e saktë e varreve nuk mund të matet, ngaqë këtu nuk janë kryer gërmime, ndërsa lartësia e tyre është 0.40 – 0.50 m. Varret janë vendosur në thellësi të ndryshme nga tabani, që do të thotë se varreza është përdorur për një kohë të gjatë. Megjithë dëmtimin e shkaktuar, shihet se riti i varrimit është me trupvënie direkt mbi tokë, pa ndonjë konstruksion mbrojtës. Skeleti është i shtrirë në shpinë, ndërsa pozicioni i duarve nuk ishte i qartë.

Varret e kalasë së Grazhdanit si nga arkitektura ashtu edhe nga riti i varrimit janë të njëjtë me varret e kulturës së hershme shqiptare. Ato janë të ngjashëm me varret e kalasë së Dalmacies[60], Shurdhahut[61], Buklit[62], Prosekut [63], Krujës [64], Lezhës [65] etj, të datuara në shek. VII – VIII pas Kr., dhe të rivlerësuara kronologjikisht si të shek. X-XI pas Kr[66]. Madje sipas H. Cekës varre të këtij tipi janë përdorur edhe në shek. XIII-XIV deri në pushtimin turk[67]. Ky mendim konfirmohet nga varreza e kalasë së Grazhdanit, që sipas nesh duhet datuar në shek. XII-XIV pas Kr. Për këtë datim mbështetemi jo vetëm në parimin e përgjithshëm sipas të cilit varreza është kronologjikisht më e vonë se pjesa e vendbanimit të kthyer në varrezë, por dhe në dy objekte metalike, që duket se lidhen me inventarin e varreve të shkatërruara.

1. Unazë bronzi, punuar me teknikën e rrahjes. Formohet nga një petë monolite, me prerje gjysëm rrethore, që zgjerohet drejt fushës. Fusha eliptike me diametra 1.3 dhe 0.8 cm është zbukuruar me gërricje. Me anë vijash dhe pikësimesh është krijuar motivi i kallirit grurit *(tab. II, 15)*. Megjithëse pa shembuj adekuat krahasimi, tipologjikisht është e ngjashme me unazën e Gjoricës së Poshtme (Dibër), dhe datohet në shek. XI-

[59] D. Komata, *Disa tipare të qeramikës mesjetare në Shqipëri,* Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, 1969, f. 225, tab. VII, 1-5, VIII, 1-3; L. Përzhita, *Kështjella e Bushatit,* Iliria 1986, 2, tab. V, 3-6; Gj. Karaiskaj, *Gradishta e Symizës...* tab. X, 5, 9, 12-14; A. Hoti, *Enë me glazurë nga qyteti i Durrësit (shek.X-XV),* Iliria 1989, 1, f. 214, 222.

[60] H. Spahiu, *Varreza arbërore e kalasë së Dalmacias (gërmime të vitit 1961*), Iliria IX-X, 1979-1980, f. 25-26).

[61] D. Komata, *Varreza arbërore e Shurdhahut,* Iliria IX-X, 1979, 1980, f. 107

[62] *S. Anamali, Një varrezë e mesjetës së hershme në Bukël të Mirditës, Iliria I, 1971, f. 211*

[63] *N. Doda, Varreza arbërore e Prosekut, (rrethi i Mirditës), Iliria 1989, 1, f. 139-140, 144.*

[64] S. Anamali – H. Spahiu, *Varreza arbërore e Krujës,* Iliria IX-X, 1979-1980, f. 50.

[65] F. Prendi, *Një varrezë e kulturës arbërore në Lezhë,* Iliria IX-X, 1979-1980, f. 124-125.

[66] H. Ceka, *Të cilës kohë janë varret e Komanit,* B.I.SH, 1949, 2, f. 89-93. Ribotuar në:
Në kërkim të historisë ilire, Tiranë 1998,f. 61- 64 ; Po ai, *Mbishkrimet bizantine të unazave të Komanit dhe datimi i tyre,* Studime historike 1965, 4, f. 39-46 Ribotuar në:
Në kërkim të historisë ilire, f. 65 – 71.

[67] Po aty.

XII pas Kr[68]. Studiuesit i konsiderojnë ato si prodhime të punishteve bizantine të bizhuterisë të kësaj periudhe[69].

2. Monedhë bronzi bizantine e vonë. Ruhet në kabinetin numizmatik të IKA, Tiranë, nr. inv. 8360 *(fig. 28-29).*



Fig. 28. Monedhë bizantine (Androniku III) (faqe)



Fig. 29. Monedhë bizantine (Androniku III) (shpinë)

Æ : D = 15 mm
P = 2.2 gr

Monedhë 6 këndëshe e konsumuar. Ruhen 5 brinjë të drejta.

Fq. = Busti i perandorit Androniku III Paleolog (?) në profil, i veshur me parzmore metalike. Dora e djathtë mban në brez mamuzin trikokësh të mbështetur në supin e djathtë. E gjitha e rrethuar me rreth pikash.

Shp. = Shën Maria në këmbë e rrethuar me një gjysëm rrethi plastik në anën e djathtë.

Monedha duket se i përket perandorit Androniku III Paleolog (1330-1337)[70].

Kthimi në varrezë i një pjese të vendbanimit dhe vendosja e saj brenda murit lindor të kalasë, do të thotë se në këtë periudhë, vendbanimi është zvogëluar në mënyrë të ndjeshme dhe se muri rrethues e kishte humbur funksionin e tij mbrojtës.

Përfundime:

Të dhënat e paraqitura më lart, lejojnë formulimin e disa përfundimeve të përgjithshme:

Gjurmët më të hershme të jetës në rrethinën e afërt të kalasë së Grazhdanit i përkasin periudhës helenistike, gjegjësisht shek. III-II para Kr. Objekte të kësaj periudhe janë gjetur në fshatin Grazhdan, si dhe në Herbel[71], vetëm 1 km në veri të kalasë së Grazhdanit, që duket se përfaqësojnë fshatra ilire të kësaj periudhe.

Në periudhën e hershme perandorake (shek. I-III pas Kr.) rruga e Drinit të Zi, e quajtur edhe *"Rruga e Madhe"*, ose *"Rruga e karvaneve"*, bashkonte dy arteriet më të rëndësishme transballkanike të periudhës romake, rrugën *Egnatia* në jug dhe rrugën *Lissus-Naissus* në veri. Kjo ishte degëzimi verior më i rëndësishëm i via Egnatias dhe arteria kryesore që lidhte Epirin e ri me provincat e Macedonia secunda, Dardanisë dhe Prevalitanisë. Në këtë periudhë pranë këtij degëzimi rugor, në territorin e kalasë së Grazhdanit duket se krijohet një qendërbanim me fizionomi qytetare. Pikërisht kësaj periudhe i takojnë disa fragmente enësh të tipit terrasigilata të kuqe si dhe një monedhë bronzi e Filipit Arab (244-249). Me këtë qendër urbane do mund të vihej në lidhje edhe i ashtuquajturi "stadium" në anën jugore të kalasë së Grazhdanit, që duket se ruan tiparet e një teatri të periudhës romake, por për të verifikuar këtë supozim,

[68] A. Bunguri, *Gjetje nga varreza e Gjoricës së Poshtme (rrethi i Dibrës)*, Iliria 1992, 12, f. 307, tab.III,12.
[69] P. Gatev, *Nakiti ot progrebinja ot XI-XII vek*, Archaeologia, 1977, 1, f. 42, tab. II, 4.
[70] Literaturë për këtë monedhë nuk është gjetur. Leximi është bërë nga Sh. Gjongecaj, të cilën e falenderojmë për ndihmën e dhënë.
[71] I. Kaca, *Herbeli venbanim ilir, Ylli, 1983, 7, f. 31*

DO NOT COPY

duhen kryer më parë kërkime arkeologjike. Kjo qendër antike, aktualisht e supozuar jo pa mbështjetje arkeologjike, duket se ka shërbyer si embrion i qytetit që do të lindte aty rreth një shekull më vonë. Statusin e qytetit Grazhdani duket se do ta marrë në fillimet e shek. IV. pas Kr. dhe shkak për këtë do të bëhej ngritja këtu e castrumit dhe rëndësia e re që fiton në këtë periudhë rruga e Drinit të Zi. Në bazë të të dhënave të paraqitura më lart, mendojmë se në hapësirën e kalasë së Grazhdanit, në periudhën e hershme perandorake (shek. II-III pas Kr.) duhet të ketë ekzistuar një vendbanim i hapur urban, duke filluar të paktën që nga shek. II pas Kr. dhe se ndërtimi i castrumit nuk është bërë *ex-novo*.

Kalaja e Grazhdanit është një fortifikim i tipit të castrumit romak. Në pikëpamje kronologjike ajo i referohet fazës së parë të veprimtarisë fortifikuese perandorake në provincat ballkanike, e lidhur me fundin e shek.III dhe fillimin e shek. IV pas Kr, ose me harkun kohor që fillon me Dioklecianin (284-305) dhe vazhdon me Licinin (305-324) dhe Konstandinin (324-337). Ky përfundim rrjedh nga teknika e ndërtimit të mureve mbrojtëse dhe analogjitë e sistemit të saj fortifikues me atë të castrumeve të Skampinit, Vigut, Bushatit e Paleokastrës. Ai kishte një pozitë mjaft të përshtatshme gjeostrategjike, pasi ndodhej kështu në pikëtakimin e provincës së Epirit të Ri, me Macedonia Secunda, Dardaninë dhe Prevalitaninë.

Për mungesë të gërmimeve arkeologjike, studiuesit nuk janë të një mendimi lidhur me gjenezën e këtij qyteti. Kështu D. Komata e përfshin Grazhdanin në grupin e qendrave të reja të fortifikuara, që lindin në brendësi të vendit në shek. IV-VI pas Kr., krahas Skupit, Ulpianës, Justiniana Primës dhe të një numri qendrash më të vogla të fortifikuara, me funksione kryesisht ushtarake[72]. Ndryshe prej tij, Gj. Karaiskaj e mendon atë si një qytet të lindur në periudhën romake dhe të rrethuar për herë të parë me mure në shek. e IV pas Kr.[73] . Sipas A. Baçes, qyteti i Grazhdanit është krijuar që në shek. I pas Kr. si një qendër buzë rrugore tregtare e zejtare, që dora dorës u zhvillua si qytet[74]. Ndërsa prof. S. Anamali, e përfshin Grazhdanin në grupin e kështjellave të lashta ilire të rifortifikuara, të tipit të castrave ushtarake, krahas Skampinit, Vigut, Bushatit e Paleokastrës [75].

Castrumi i Grazhdanit, është fortifikimi më i madh i tipit të castrumit në Shqipëri dhe ndër më të mëdhatë në rajon. Siç u përmend më lart, ajo ka sipërfaqe 3.2 herë më të madhe se Skampini (10.718 ha), 37 herë më të madhe se Paleokastra (0.915 ha), 48.6 herë më të madhe se Bushati (0.7 ha), 56.6 herë më të madhe se Vigu (0.615 ha), 2.27 herë më të madhe se Abritusi (15 ha) etj. Për përmasat shumë të mëdha të saj, ajo mund të konsiderohet si një *grand castrum*, me funksione kryesisht ushtarake. Një ndërtim i tillë gjigant, ishte konceptuar nga ekspertët ushtarak të perandorisë si një bazë e fuqishme ushtarake në brendësinë kontinentale të provincave ballkanike. Krahasuar me kështjella të tjera legjionare, duke u mbështetur vetëm në sipërfaqen e madhe të kësaj kalaje, rezulton se aty mund të sistemohej një garnizon i madh romak, i përbërë nga të paktën 2 legjione ose rreth 10.000-12.000 trupa ushtarake[76]. Ato janë mbajtur aty të gatshëm për çdo emergjencë përballë rrezikut të sulmeve gote. Një ndërtim i përmasave të tilla, tregon rëndësinë e madhe që kishte për perandorinë romake rruga e Drinit të Zi dhe rajoni i Dibrës në përgjithësi, në kontekst me provincat tjera ballkanike.

Në shekujt V-VI pas Kr., castrumi i Grazhdanit, ruan pozitën e tij strategjike në kontroll të rrugës tregtaro-ushtarake të Drinit që lidhte provincën *Epirus Nova* me provincat e Macedonia secunda, atë të Prevalitanisë dhe të Dardanisë. Në këtë periudhë, Grazhdani ishte qendra e një sistemi të plotë fortifikimesh, që e rrethojnë luginën e Drinit të Zi në trajtë kurore. Në të dy anë të luginës numërohen 14 fortifikime të kësaj periudhe, që siguronin mbrojtjen e këtij rajoni dhe rrugës së rëndësishme të Drinit të Zi që e përshkonte atë.

Kalaja e Grazhdanit duket se e humbi funksionin e saj mbrojtës rreth mesit të shek. VI pas Kr. Afërsisht

[72] D. Komata. *Të dhëna arkeologjike për qytetin arbëror (shek. VII-XI)*, Iliria, 1983, 1, f. 210.
[73] Gj. Karaiskaj, *5000 vjet fortikime...* f. 113.
[74] A. Baçe, *Dobëri...* f. 18.
[75] S. Anamali, *Proçese shndërrimi në trevën jugore ilire në shek. IV e.j.*, Iliria 1986, 1, f.22-23.
[76] Sipas dëshmisë së Notitia Digmitatum (*Lista e rangjeve)* në Skampin ishte vendosur një nga 9 legjionet pseodocomitatenses të ushtrisë romake në Iliri *(Not. Dign. IX, 39, 48)*. Për analogji në krahasim edhe në kështjella të tjera legjionare mund të mendohet se në Grazhdan mund të jetë sistemuar një garnizon i madh romak i përbërë të paktën nga dy legjione ushtarësh.

DO NOT COPY

kësaj kohe i takojnë fragmentet e enëve të gjetura në shtresën e zezë dhe dheun e djegur të përmendur më lart. Kjo djegje e ky shkatërrim i vendbanimit në gjysmën e shek. VI pas Kr., ndoshta duhet lidhur me valën e parë të sulmeve plaçkitëse sllave të vitit 548 ose 551, për të cilat në burimet historike ka të dhëna indirekte. Prokopi i Cezaresë na tregon se *"aërsisht në këtë kohë, një ushtri skllavenësh, duke kaluar lumin Istër, bëri shkatërrime të tmerrshme në të gjithë Ilirinë deri në Epidamn" (547–548)* dhe se *"në këtë kohë (551-552) një turmë e madhe skllavenësh u derdh në Iliri dhe bëri atje tmerre të papërshkruara..."*[77].

Lidhur me emrin antik të këtij fortifikimi, mendojmë se ai do të mund të identifikohej me fortesën *Deyfrakos*[78], për të cilën është shprehur mendimi se duhet lokalizuar në rajonin e Dibrës[79]. Prej emrit të kësaj fortese mund të rrjedh edhe etimiologjia e emrit të sotëm të krahinës Dibër, por ky është një problem që kërkon studime më të plota gjuhësore[80].

Gjatë periudhës së mesjetës së hershme (shek. VII-XI pas Kr.), vendbanimi tkurret mjaft dhe kthehet në një qendër fshatare. Karakteristikë për këtë periudhë është varfëria dhe thjeshtësia e qeramikës. Në shek. XII-XIV pas Kr. vendbanimi zvogëlohet në mënyrë të ndjeshme dhe një pjesë e tij kthehet në varrezë. Të dhënat e fundit lidhur me vendbanimin në kalanë e Grazhdanit, i takojnë shek. XIV pas Kr. Kësaj kohe i përket kisha pranë hyrjes lindore të kalasë, si dhe monedha e vonë bizantine e gjetur pranë saj. Ajo shërben edhe si një *terminus post quem* i jetës së këtij vendbanimi.

Duke publikuar koleksionin e gjetjeve të mësipërme, kryesisht me karakter rastësor, shpresojmë se do të kemi ndihmuar sadopak në pasurimin e informacionit shkencor mbi kalanë e Grazhdanit, si dhe në zgjidhjen e kontradiktës në mendimin arkeologjik të përmendur në fillim të këtij artikulli. Kërkimet arkeologjike të zhvilluara në këtë kala, do të sjellin të dhëna të reja, dhe do të ndriçojnë më tej aspekte të ndryshme të jetës së këtij monumenti të rëndësishëm të brendësisë kontinentale të Shqipërisë lindore.

DO NOT COPY

[77] Proc. Caes. *De Bella gottica*, VII, 29, VIII, 25.
[78] Proc. Caes. *De Aedificis*, IV, 25.
[79] V. Popoviç, *L'Albanie pendant la basse Antique*, "Les Illyriens et les Albanais", Beograd 1988, f. 255; L. Përzhita, *Të dhëna të reja për fortifikime të shek. IV – VI në luginën e Drinit të Zi*, Candavia, 1, 2004, f. 60.
[80] Lidhur me këtë problem ekzistojnë disa pikëpamje të ndryshme. Një prej tyre është ajo e H. Sadikajt, K. Frashërit dhe A. Baçes që shikojnë në këtë kala rrënojat e qytetit antik të Dobërit, prej të cilit rrjedh edhe etimiologjhia e krahinës (H.Sadikaj, *Përpjekje për lokalizimin e disa kështjellave dhe qyteteve peneste*, Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, Tiranë 1969, f. 255-356: *K. Frashëri*, Në gjurmë... f. 151; *A. Baçe*, Fortifikimet... f. 49-50), mendim i huazuar edhe nga hartuesit e Fjalorit Enciklopedik Shqiptar. (*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë 1985, f, 442.)

Adem BUNGURI

FINDS AT GRAZHDAN'S CASTLE

DO NOT COPY

Grazhdan's castle is the biggest fortification of the castrum type in Albania. It is established in the middle of the road which link cities of Peshkopi and Diber. The castle is placed at the field of Grazhdan village; between Kamenica brook on the north and Bresnica ones back on the south; national road on the east, and up to right riverside of Drini i Zi on the west. It has occupied the field terrain on east and sloppy on the west with total surface 34 hectare. This castle has an important strategic position for controlling the road of Drini i Zi river, which is linked with the most important road of roman era: Via Egnatia on South and Lissus – Naissus on North. Importance of this position is the fact that is established on the junction of the roman province of New Epirus, Prevalitania, Macedonia Secunda and Dardania.

The foreign researchers are attracted by measurements and central position on Drini i Zi valley, since at the end of XIX century. These are geologist and geographer french Mr. A. Boué, famous albanologist J. G. Hahn, russian consul at Shkoder I. S. Jastrebov etc. Albanian searchers of the XX century are: H. Ceka who classifies the castle as a late antique era fortifications. In the middle of 70 years of the last century was A. Baçe who has done the first plan of the Grazhdan's castle, and gives the appropriate data for its size and fortification system, but on the year 1983 D. Komata makes the first excavations and survey at this castle.

Some ideas are given and by S. Anamali, Gj. Karaiskaj, H. Sadiku, K. Frashëri, I. Kaca etc. During the years of 70 – 80 of the last century some efforts are done to find the Illyrian cities tracks of Draudak, Uskana (II-nd century B.C.) or the roman period town Dober(II-nd century A.D). These hypotheses are not supported by chronology of surrounding walls constructions or cultural deposition within them by creating a contradiction between archaeological idea with surrounding supposed cities, walls or castle. Besides publishing the new archaeological material, this article aims to solve this confusion about Grazhad' s castle.

The earliest tracks of life existence at the area close to Grazhdan's castle belong hellenistic period,about III-II century B.C. There is a restored pitos since the III-II century B.C (Grazhdan) and table dish of this period(Herbel) which is imported from Apollonia, which has reached here from Drini i Zi river road. This road which called *"Great Road"*, or *"Caravan Road"* on earlier imperial era (I-III century A.D), represent north branch of Via Egnatia. This link with other Balkan road named Lissus-Naissus on north. During this period close to road branch on Grazhdan' s castle is created dwelling centre with citizen physiognor..).

Just to this periode belong a lot of large quadratic stone blocks, reused in walls of castrum, some pottery fragments of terresigilata and pseudoterrasigilata type as well as one bronze coin of the emperor Filipi Arab (244-249), which let us to suppose this site as an urban trade centre on the centuries II-III A.D. To this urban centre maybe can related and socalled "stadium" placed at the southern parts of Grazhdan'c castle, but it needs further investigations.

Grazhdan will take the status of a city at beginnings of IV Century B.C. because of the castrum was built and the importance of the Drini i Zi road. According to the fact given above we think that "In the Grazhdani castle space on the earlier imperial era (II-III century A.D) must exist an open urban dwelling beginning since II century A.D. Grazhdani castle is a fortress of roman castrum type built on the late of III century and beginning of IV century A.D. This result comes from protecting walls building technique and analogies with its fortified

system with Skampinit, Vig, Bushat and Paleokastra castrums. Grazhdan castrum has a quadrate form, two straight tight sides east and west, but long sides on south and north are in accordance with terrain.

Walls of perimeter are 2760 meters long, enclose 34 hectare, they are preserve on all its length at highness 1-1.50 meters, their width is 2.80- 3.20 meters. Walls are built with river stones of different sizes, linked with lime mortar according to the technique *opus incertum*. They are reinforced by 44 towers at its entire length. Fortified system has 4 tower types: "U "form, square and rectangular and half round on corners and difficult turns. The "U" towers dominate this castrum, are characteristic of its fortified system. Coexistence of these 4 tower types is faced at castrum castles in Albania like (Vig, Skampin, Paleokastër, Bushat), and abroad in East countries: Arabia (el-Leggun, Odruh); Syria (ed-Dumer); European countries: Bulgaria (Abritus); Rumania (Ulmetum, Troesmis, Capidava); England (Porchester) etc. Use of 4 tower types at the same fortification, the studiers considers a new advanced phase of the roman fortifies faced at centuries III – IV A.D.

Castle has three entrances, two at north-south axe and the rest at east side. Existence of two entrances at the same axe according to the style called *via principalis,* is a characteristic of the roman fortifications of castrum type. Each of two entrances is protected from the "U" towers established at two entrance sides. This is characteristic for the castrums of the first half of IV century A.D; this is equal at the east and west entrances of Skampin and Vig. South entrance of Grazhdanit castle is classic model with the entrances with two gates *(photo 21– south entrance plan).*

Between them is a fortified square courtyard which belong to type *propognaculum,* this was the last center of attacker extermination. This is identical with east entrance of Skampin (Elbasan) and west one of the Vig (Shkoder), one of entrances of Ulpiana near Pishtina (Justiniana Secunda), and north entrance of Abritus (Bulgaria). Studiers has find that this entrance type has begun to use since with Emperor Vespasian, and finished at beginning on IV century A.D

Chronology of built Grazhdanit castrum, will be similar with the Skampin castrum , which has its building time on the Dioklecian reign (284-305). Grazhdan castle are huge so we think that this fortification must continued up to Licin I reign (305-324) and may be up to Konstandin reign (324-337).

Grazhdan castrum, may be consider as a *grand castrum,* because of its huge measurements with mainly military functions. It occupies 34 hectare or 3.2 time more than Skampini (10.178 ha), 37 times more than Paleokastra (0.915 ha), 48.6 times more than Bushati (0.7 ha), 56.6 times more than Vigu (0.615 ha), and 2.27 times more than Abritusi (15 ha) etc. A roman garrison with 10-12.000 soldiers can shelter there. This huge castle shows the real importance for the Roman Empire the Drin i Zi river road and Dibra region itself..

Central part of Grazhdan castrum has remains of social or military buildings during the late antic era. These are oriented according to the orthogonal plan, and this is defined by crossing as square angle of the two main roads. First road named *"Livanivi" (cardo maximums)* connect two main entrances south and north but the second road named *(decumanus maximums),* called *"Çelebia"* goes on the middle of the city or divide it in two and connect east entrance of the castle up to tag parcel within the west wall. Two columns and capitol pedestal belong to this period, more accurately to the middle of V century A. D.

Different opinions exist on the city genesis for this castrum. D. Komata include Grazhdan in the group of new fortified centers which rising in the hinterland of the country on the centuries IV-VI A.D, like Shkup, Ulpiana, Justiniana Prima and some small centers with mainly military functions. Gj. Karaiskaj consider as a city created on the roman period and surrounded for first time with the walls on the IV century A.D. A. Baçe, thinks that the Grazhdan city is created since at I -st century A.D as a center at border of trade and craft route, which slowly was developed as a city. S. Anamali, include Grazhdan's castle in the group of the ancient Illyrian castles reinforced according to the military castrums, like Skampin, Vig, Bushat and Paleokastra.

During the V-VI centuries A.D, Grazhdan was a center of whole fortified crown system which surround the Drin i Zi valley. Two sides of the valley have 14 fortifications of this period which secure protection of this region and the road too. During this period the protection of the east entrance of Grazhdan castle

POWERSOFT

reinforce with the transversal wall so for that reason is included by Prokopi on the castles built newly by Justiniani (527–565 A.D). Antic name of this fortification according to our opinion we think that has come identify with *Deyfrakos* fortress[1], for which exist opinion that is localized at Dibra[2] region. Name of this fortress is taken according to the etymology the name Dibra for this region, but this needs lots of language studies[3].

This castle lost protecting function at middle of VI century after Christ the same time was find the remains of dishes found in the burn soil. This burn and destructive must happened at second half of VI century A.D, maybe is linked with first Slav looter of a year 548 or 551, because for this are indirect historical data sources. Prokop fo Cezare had written *"around this time, a slavonian army, passed Istër river and made terrible destroying , at all Illyrian territory and Epidamn too" (547 – 548)* and *" during this time (551-552) a huge number of slavonians made at Illyria enormous terror..."*[4].

During the XII-XIV centuries A D this dwelling is reduced enormously and small part of it is change into a cemetery. Last data linked with Grazhdan castle dwelling belong to XIV century A D. The church close to east entrance of castle and late Byzantine coin belongs to this period. This is as *terminus post quem* of the life to this dwelling.

Archaeological excavation at this castle will give more data for this important monument which is established at inner continental territory of eastern Albania.

DO NOT COPY

[1] Proc. Caes. *De Aedificis*, IV, 25.

[2] V. Popoviç, *L'Albanie pendant la basse Antique*, "Les Illyriens et les Albanais", Beograd 1988, f. 255; L. Përzhita, New data for fortifications of *IV – VI centuries at Drin t Zi valley*, Candavia, 1, 2004, f. 60.

[3] For this problem are deifferent ideas. One of them belong to H. Sadikaj, K. Frashëri and A. Baçe. These classify this castle as portator of Dober Antic City ruins, and region etymology come from this name (H.Sadikaj, *Përpjekje për lokalizimin e disa kështjellave dhe qyteteve peneste*,Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, Tiranë 1969, f. 255-356 : *K. Frashëri*, Në gjurmë... f. 151; *A. Baçe*, Fortifikimet...f.49-50), mendim i huazuar edhe nga hartuesit e Fjalorit Enciklopedik Shqiptar.(*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë 1985, f, 442.)

[4] Proc. Caes. *De Bella gottica*, VII, 29, VIII, 25.

Prof. Dr. Pirro THOMO

AMFITEATRI I DURRËSIT DHE PUNIMET E RESTAURIMIT 2004

DO NOT COPY

Qëllimi i studimit

Amfiteatri i Durrësit është një nga monumentet më të rëndësishëm jo vetëm në shkallë qyteti, por edhe në shkallë kombëtare, madje dhe ndërkombëtare. Ai përfaqëson të vetmin shembull të kësaj gjinie që ruhet në Shqipëri dhe të paktët që ruhen në Ballkan. Duke e vlerësuar si të tillë, përkujdesjet për këtë monument, ndonëse jo në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme, nuk kanë rreshtur. Në kuadrin e këtyre përkujdesjeve ishin dhe ndërhyrjet e kryera gjatë vitit 2004, publikimi i të cilave përbën qëllimin e këtij artikulli.

Projektideja e hartuar[1] për këto ndërhyrje kishte si synim **konsolidimin e pjesshëm dhe evidentimin e monumentit, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, rigjallërimin i tij për plotësimin e kërkesave kulturore dhe artistike të qytetit të Durrësit.**

Kriteret dhe propozimet për ndërhyrjet restauruese të parashtruara ishin:

- Çlirimi i monumentit nga ndërtimet pa vlerë, evidentimi dhe krijimi i rrugëve të përshtatshme për vizitimin e tij.
- Konsolidimi i monumentit në pjesët më të rëndësishme dhe të shfrytëzueshme të tij.
- Rigjallërimi i amfiteatrit duke u integruar në jetën kulturore dhe artistike të qytetit, pa prekur substancën historike të tij.

Realizimi i këtyre ndërhyrjeve do të përbënin fazën e parë në tërësinë e studimit, gërmimit arkeologjik dhe restaurimit të këtij monumenti të rëndësishëm, të cilat do të përfundonin deri në fund të vitit 2004, për të vazhduar më tej me fazën e dytë të studimit, sipas programeve të miratuara.

Mbas miratimit në parim të projektidesë nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, u hartua projekti i fazës së dytë[2]. Duke u mbështetur në kriteret dhe propozimet për ndërhyrje restauruese, tashmë të miratuara, u bë zbërthimi i këtyre propozimeve në një shkallë më të detajuar, në kuptimin e një projekti zbatimi, duke përcaktuar më me saktësi gjendjen e monumentit, shkaqet e dëmtimeve, zonat e ndërhyrjeve, llojin e ndërhyrjeve dhe mënyrën e realizimit të këtyre ndërhyrjeve.

Për të arritur këtë synim dhe në mungesë të një dokumentacioni të mjaftueshëm, u bë rilevimi më i plotë i të gjitha zonave të ndërhyrjes, duke evidentuar dëmtimet dhe përcaktuar masat restauruese për eliminimin e këtyre dëmtimeve.

Vështrim i shkurtër historiko-arkitektonik mbi monumentin

Me pushtimin romak të Durrësit në vitin 229 p. Kr. dhe sidomos me kthimin e tij në koloni romake në vitin 30 p.Kr., në jetën e përditshme të qytetit u futën dhe zakonet e zbavitjes së qytetarëve, një nga të cilat ishte dhe ndjekja e ndeshjeve të gladiatorëve.

Ndeshjet e gladiatorëve në Durrës dokumentohen që në vitin 98-117, kur me rastin e përurimit të bibliotekës së qytetit u organizuan ndeshjet e 12 çifteve gladiatorësh[3]. Gjithashtu, dy relieve me skena gladiatorësh, kanë qenë të murosura në portën e madhe

[1] Projektideja e restaurimit të Amfiteatrit të Durrësit u hartua nga prof. dr. Aleksandër Meksi, prof. dr. Pirro Thomo, prof. dr. Gjerak Karaiskaj, prof. dr. Neritan Ceka, prof. Koço Miho, ing. Gëzim Struga dhe skicograf Ajten Toptani.

[2] Projekt zbatimi u hartua nga prof. dr. Pirro Thomo, prof. dr. Gjerak Karaiskaj dhe skicograf Ajten Toptani. Punimet e restaurimit u kryen nga shoqëria "AD-STAR" me administrator ing. Alfred Çoma dhe drejtues teknik prof. dr. Pirro Thomo

[3] P. C. Sestieri, *Shkrime latine të Shqipnis*, Tiranë 1943, Nr. 25

DO NOT COPY

të kalasë[4]. Por këto të dhëna nuk bëjnë fjalë për ekzistencën e amfiteatrit, ndërtime tipike të ngritura në gjithë botën romake për organizimin e shfaqjeve me gladiatorë. Duhet të vinte viti 1966, kur filluan gërmimet arkeologjike për zbulimin e një monumenti të tillë, të drejtuara nga arkeologu pasionant i Durrësit, Vangjel Toçi, që të vertetoheshin dëshmitë e humanistit dhe historiografit të Skëndërbeut, M. Barletit, për ekzistencën e një arene ose amfiteatri në qytetin e Durrësit[5].

Me zbulimin e amfiteatrit (deri më sot është zbuluar mbi 1/3 e tij) u rrit interesimi për këtë monument të rëndësishëm dhe, paralelisht, u shtuan dhe artikujt studimorë në revista shkencore mbi të. I pari publikim, që na njeh me zbulimet arkeologjike të këtij monumenti, është ai i V. Toçit[6]. Më pas arkitekti i mirënjohur, prof. K. Miho, boton një monografi interesante mbi amfiteatrin[7] dhe pasojnë një sërë artikujsh të L. Mirajt, të botuara në revistën "Iliria" dhe "Monumentet"[8]. Nuk kanë munguar gjithashtu studimet për elemente të veçanta të amfiteatrit, siç është mozaiku i kapelës, nga Dh. Dhamo[9], H. Nallbani[10], Th. Popa[11], H. Buschhausen[12], etj.

Datimi.- Përsa i përket datimit të amfiteatrit, deri më sot nuk është hedhur ndonjë argument, që të ndryshojë datimin e bërë nga V. Toçi, si ndërtim i fillimit të shek. II, ndoshta i kohës së perandor Hadrianit[13], periudhë gjatë së cilës përfundojnë edhe shumë vepra të rëndësishme në Durrës, si ujësjellësi i qytetit etj. Gjatë kësaj periudhe një rritje të veprimtarisë ndërtuese pati në mbarë botën romake, përfshirë këtu edhe ndërtimin e amfiteatrove. Golvin, në veprën e tij thuajse shteruese mbi amfiteatrot romakë, ku analizon 190 shembuj amfiteatrosh, vetëm në kategorinë e amfiteatrove me konstruksion "të zbrazët" numron 17 amfiteatro të ndërtuara gjatë kësaj periudhe[14].

Materiali i ndërtimit, i përdorur për ndërtimin e amfiteatrit, është një tjetër tregues që ndihmon për datimin e tij. Në amfiteatrin e Durrësit janë përdorur gjerësisht tullat, të cilat, ndonëse me përmasa të ndryshme, kanë të gjitha formë të rregullt kuadratike, gjë që është karakteristike e periudhës së Hadrianit, ndërkohë që në periudhën e Trajanit janë përdorur dhe tulla të thyera ose tulla trekëndëshe[15].

Amfiteatri i Durrësit ka qenë në përdorim deri kur perandori Teodosi I (379-395) ndaloi lodrat e përgjakshme me gladiatorë. Pas kësaj amfiteatri u përdor si varrezë dhe në shek.VI në njërën nga galeritë perëndimore u ndërtua një kishë e vogël.

Është i njohur mozaiku i kësaj kapele, që vesh dy faqet fundore të saj, faqen perëndimore dhe atë jugore. Autorë të ndryshëm që kanë studiuar skenat e mozaikut kanë shfaqur mendime të ndryshme përsa i takon datimit të tij, si dhe interpretimit të skenave[16].

Gjurmët tregojnë për një shtresë pikture murale mbi të cilën është aplikuar mozaiku.

Mbi tipologjinë e amfiteatrit të Durrësit.- Përsa i përket konstruksionit të shkallares (*caveas)*, për përcaktimin e tipologjisë së amfiteatrit do të mbështetemi në kriteret e përdoruara nga Golvin. Sipas këtij klasifikimi amfiteatrot ndahen kryesisht në: a) amfiteatro me strukturë të plotë në disa variante (*cavea* mbështetet mbi mbushje dheu, ose mbi terren natyral), dhe në b) amfiteatro me strukturë "të zbrazët", ku përfshin amfiteatrot, shakallarja e të cilave mbështetet mbi një

[4] Heuzey-Daumet, *Mission archéologique de Macédoine*, Paris 1876, f. 384, Nr.157
[5] M. Barleti, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë 1983, f. 636
[6] V. Toçi, "Amfiteatri i Dyrrahit", *Monumentet*, 2,1971, ff. 37-40
[7] K. Miho, *Amfiteatri i Durrësit*, Tiranë 1984
[8] L. Miraj, "Amfiteatri i Durrësit", *Iliria*, 2, 1986, f. 151-169; "Përshtatje në amfiteatër gjatë sheujve VII-XII", *Monumentet*, 2, 1991, f. 47-60
[9] Dh. Dhamo, "Vepra e tipare të pikturës në Shqipëri në shek. V-XV", *Studime Historike*, 1, 1984, f. 148-151
[10] H. Nallbani, "Mozaiku i kishës së amfiteatrit në Durrës", *Monumentet*, 7-8, 1974, f. 111-118
[11] Th. Popa, *Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri (shek. VI-XIV)*, Tiranë, 2006, f. 99-109
[12] H., H. Buschhausen, "Durrësi dhe fillimet e krishtërimit në Shqipëri", *Monumentet*, 2004, f. 49-70
[13] V. Toçi, *vep. cit.*, f. 40
[14] J-C. Golvin, *Amphithéâtre Romain*, Paris, 1988, Tableau 13, f.222
[15] J-C. Golvin, *vep. cit.*, f. 72
[16] V. Toçi e daton mozaikun në shek. X, ndërsa figurën qëndrore të skenës jugore e identifikon me figurën e perandorit të Bizantit, Aleksandër (912-913), V. Toçi, *vep. cit.*, f. 40; Dh. Dhamo e daton të shek. VI-IX, Dh. Dhamo, *vep. cit.*, f. 148-151; H. Nallbani si të shek. X, dhe për figurën qendrore të skenës jugore mendon se duhet të paraqesë ndonjë person me rëndësi nga paria e qytetit, H. Nallbani, *vep. cit.*, f. 113; Th. Popa bashkohet me pikëpamjen e V. Toçit, si për datimin, ashtu dhe për figurën qendrore të skenës jugore,Th. Popa, *vep. cit.*; H. H. Buschhausen e mendojnë të shek. VI, ndërsa figurën qëndrore të skenës jugore ja atribuajnë Theotokosit Basilissa (Shën Marisë Mbretëreshë), H. H. Buschhausen *vep. cit.*, f. 63, 64-65; ndërsa Jando, Janine, Reynis-, "Mozaiku mural në kapelën e amfiteatrit të Dyrrahut", *Iliria*, 1, 1983, f. 227, e daton në shek. VIII

sistem galerish të mbuluara me qemere. Në këtë kategori klasifikohen dhe ato amfiteatro, së bashku me amfiteatrin e Durrësit, që një pjesë e tyre e kanë *cavean* të mbështetura mbi terren natyror[17] (Fig. 1).



Fig. 1. Tipologjia e amfiteatrove (sipas Golvin)

Pjesa e zbuluar e amfiteatrit përmban një pjesë të mirë të elementëve, që na japin të kuptojmë kompozimin e tij, konstruksionin, si dhe teknikën dhe materialet e ndërtimit.

Arena.- Duke qenë ende e pazbuluar, nuk mund të përcaktohet kuota e saj, shtresa, si dhe konstruksioni poshtë saj, gjë që do të saktësonte dhe funksionin e arenës: ishte vetëm për *munera*, ndeshje për gladiatorë, apo dhe për *venatio*, ndeshje me kafshë.

Shkallarja *(cavea)*.- Elementet përbërëse të shkallares janë: podiumi, dy sektorë për ndenjen e spektatorëve (*maenianum*), të cilët ndahen me një korridor (*praecictio*). Në sektorin e sipërm ruhen shkallare të ngushta rrezore (*cuneus*), që shërbenin për lehtësimin e lëvizjes së spektatorëve.

Në gjendjen e sotme ka mbetur vetëm nënshtresa e shkallares, e përbërë nga një përzjerje llaçi e gurësh, por mbetjet e disa blloqeve gurësh në podium, bëjnë të supozohet se mbi këtë nënshtresë ngriheshin shkallaret prej guri.

Galeritë - Shkallarja mbështetet mbi një konstruksion qemeresh dhe harqesh të ngritura mbi mure unazore dhe tërthore, të cilat formojnë një sistem galerish. Galeritë shërbenin për mjedise ndihmëse, shërbimi, si dhe lëvizjen dhe shpërndarjen e spektatorëve në shkallare, e cila kryhej nëpërmjet daljeve (*vomitoria*), të hapura në çdo galeri (Fig. 2, 3).



Fig. 2. Dalje në arenë (vomitor)

[17] J-C. Golvin, *vep. cit.*, Pl. II, f. 157

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3. Shkallë për dalje në arenë

Janë të ruajtura pjesë nga galeria e sipërme (Fig. 4), galeria e mesme (Fig. 5) dhe galeria e poshtme (Fig. 6), të cilat ndjekin konturin eliptik të amfiteatrit. Galeritë eliptike ose unazore ndërlidhen me anë të galerive tërthore ose rrezore (Fig. 7, 8, 9), të cilat janë të pajisura me shkallë.

Përveç galerive të mësipërme ruhen dhe galeritë e hyrjes veriore, si dhe një galeri, e cila është quajtur në mënyrë konvencionale, galeria e "kafshëve", me dalje në maenianumin e poshtëm.



Fig. 4. Galeria e sipërme



Fig. 5. Galeria e mesme



Fig. 6. Galeria e poshtme

Galeritë janë të mbuluara me qemere, të cilat janë të formave dhe teknikave të ndryshme. Mbizotërojnë qemeret cilindrike me prerje gjysmërrethore, të vazhdueshme ose të ndërprera me brinjë rigjiditeti ose nervatura (galeria e hyrjes veriore, Fig. 10). Përveç tyre takohen dhe qemeret cilindrike me prerje çerekrrethore (Fig. 4, 11), por nuk mungojnë dhe mbulesat e rrafshta (Fig. 12)



Fig. 7. Galeri tërthore



Fig. 8. Galeri tërthore



Fig. 9. Galeri tërthore



Fig. 10 - Qemer cilindrik me harqe rigjiditeti

Teknika dhe materialet e ndërtimit.- Në amfiteatrin e Durrësit janë përdorur teknikat karakteristike romake të periudhës përkatëse.

Nënshtresat e dyshemeve, nga sa mund të gjykojmë nga një fragment i ruajtur në dyshemenë e galerisë së "kafshëve" dhe në shkallaren e një prej galerive tërthore,

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11. Qemer cilindrik me prerje çerekrrethore



Fig. 12. Mbulesë e rrafshët

realizoheshin prej një përzjerjeje llaçi me gurë (*opus caementicium*), një teknikë kjo shumë e përhapur në periudhën romake, e njohur në ditët tona dhe si "beton romak". Me një teknikë të tillë është ndërtuar dhe nënshtresa e shkallares, ndërsa një përdorim të gjerë ka gjetur dhe në ndërtimin e qemerëve. Përzierja e gurëve me llaç për ndërtimin e qemerëve hidhej mbi kallëpe prej dërrase, gjurmët e të cilave kanë mbetur ende në qemerin e galerisë së "kafshëve" (Fig. 13). Në disa raste gjatë ndërtimit të qemerëve mbushja alternoheshe me radhë tullash të vendosura këlliç (Fig.14).



Fig. 13. Qemer cilindrik me mbushje



Fig. 14. Qemer cilindrik me mbushje dhe radhë tullash

DO NOT COPY

Për ndërtimin e harqeve janë përdorur tulla të plota me trashësi 5-6 cm. (Fig. 15).



Fig. 15. Hark rrethor me tulla

Përgjithësisht muraturat janë ndërtuar sipas teknikës *opus incertum*, e cila është një teknikë e përzjerë: muraturë guri të alternuara me rreshta tullash. Gurët janë vendosur në muraturë në mënyrë të çrregullt mbi një shtresë të trashë llaçi. Numri i radhëve të tullave është i ndryshëm. Zakonisht radhët e tullave janë pesë (Fig. 16), por takohen dhe breza tullash me katër radhë, madje dhe me më tepër se sa kaq. Nuk mungojnë gjithashtu dhe muratura, ose fragmente muraturash, të ndërtuara, ose të veshura, tërësisht me tulla.

Përmasat e amfiteatrit. - Nga të dhënat që mund të përftohen nga pjesët e zbuluara deri më sot, K. Miho[18] dhe L. Miraj[19] kanë trasuar formën eliptike të amfiteatrit dhe kanë përcaktuar përmasat e tij. K. Miho ka dhënë dy variante për përmasat e amfiteatrit, të cilat nuk përputhen me përmasat që na ka dhënë L. Miraj. Rezultatet e arritura nga autorët e mësipërm jepen në tabelën e mëposhtme:



Fig. 16. Muraturë e përzjerë me pesë radhë tullash

Po të përdorim formulat e Golvinit[20], do të kishim këto rezultate për përmasat e dhëna nga K. Miho dhe L. Miraj:

A = a+2C ose A-a = 2C (1)

B = b+2C ose B-b = 2C (2)

Që këtej rrjedh A-a = B-b (3)

Sipërfaqja e arenës: Sa = ð p xy
Perimetri i saj: Pa = ð p (x+y)
Sipërfaqja e përgjithshme: St = ðp XY
Perimetri i jashtëm: Pt = ð p (X+Y)
Sipërfaqja e *caveas:* Sc = St-Sa

Ku:

A-diametri i madh i amfiteatrit
B- diametri i vogël i amfiteatrit
a- diametri i madh i arenës
b- diametri i vogël i arenës
C- gjerësia e *caveas* në plan

Sipas autorëve	Arena a	Arena b	Amf. A	Amf. B	Num. i spekt.	Për. i arenës	Për. i jasht.	Sip. e arenës	Sip. e amfit.
K. Miho, var. I	63	39	119	95	-	179	335	1900	8900
K. Miho, var. II	63	39	127	103	15.000	179	366	1900	10.000
L. Miraj	61,4	42,2	132,4	113,2	15.000 -20.000	-	-	-	-

[18] K. Miho, *vep. cit.*, f. 80, 83
[19] L. Miraj, *vep. cit.*, f. 162
[20] J-C. Golvin, *vep. cit.*, 283, Pl. LI

X- gjysëm diametri i madh i amfiteatrit
Y- gjysëm diametri i vogël i amfiteatrit
x- gjysëm diametri i madh i arenës
y- gjysëm diametri i vogël i arenës



Sipas autorëve	Arena a	Arena b	Amf. A	Amf. B	Per. i arenës	Per. i amfit.	Sip. e arenës	Sip. e amfit.	Sip. e *caveas*
K. Miho, var. I	63	39	119	95	179	335	1900	8.900	
Sipas Golvin.					160,2	336,1	2014,5	8.879	6.864,5
K. Miho, var. II	63	39	127	103	179	366	1900	10.000	
Sipas Golvin					160,2	361,3	2014,5	10.274	8.259,5
L. Miraj	61,4	42,2	132,4	113,2					
Sipas Golvin					162,7	385,8	2035	11.771	9.736

Në të tre rastet plotësohet relacioni (3), i cili konsiderohet i rëndësishëm, që dëshmon për formën e rregullt të amfiteatrit.

K. Miho e ka shpënë më tej rikonstruksionin grafik të amfiteatrit me rikonstruksionin hipotetik të fasadës[21]. Sipas këtij rikonstruksioni, fasada ishte trekatëshe. Dy nivelet e poshtme ishin të trajtuara me harkada, harqet e të cilave ndaheshin me gjysmëkolona me kapitele. Niveli i sipërm, në trajtën e një parapeti të lartë, përmbante hapje drejtkëndëshe.

Pavarësisht nga luhatjet në përmasat e dhëna nga autorët e mësipërm, amfiteatri i Durrësit rreshtohet ndër amfiteatrot e mëdha të ndërtuara në botën romake.

Gjendja ekzistuese e monumentit

1. **Gjendja statike.** Veprimi i faktorëve natyrorë dhe njerëzorë gjatë shekujve të funksionimit të amfiteatrit, por edhe mbas zbulimit, kanë sjellë dëmtime të strukturave, të cilat shfaqen në rrëzime elementësh konstruktivë, çarje, dekompozime të materialit ndërtimor, si llaçit lidhës, të tullave të muraturës etj., lënia për një kohë të gjatë në këtë gjendje do të shkaktonte dëmtimin e mëtejshëm të monumentit.

Pjesa e zbuluar e shkallares vetëm pjesërisht ka qenë e konsoliduar. Sipërfaqe të konsiderueshme të saj ishin lënë të pa konsoliduara, që ka sjellë si pasojë grryerjen e sipërfaqes së shkallares dhe depërtimin e ujërave të reshjeve në brendësi të monumentit.

Veprimi i faktorëve natyrorë ka shkaktuar gjithashtu dhe dekompozimin e llaçit dhe tullave të muraturës dhe të shtresave, dëmtime të cilat avancojnë me kalimin e kohës.

Rrëzime të fragmenteve muraturash dhe strukturash qemerësh, si dhe çarje të strukturave mbajtëse, rrjedhim siç duket i lëkundjeve sizmike, në disa pjesë paraqisnin rrezikshmëri për qëndrueshmërinë statike të këtyre fragmenteve.

2. **Punimet e kryera dhe vizitueshmëria e monumentit.** Gjatë dhe mbas gërmimeve arkeologjike janë ndërmarrë masa të rëndësishme për konsolidimin e pjesëve të zbuluara, si dhe për të kthyer një pjesë të tyre në gjendje të vizitueshme, por të cilat, për fat të keq, nuk kanë gjetur dritën e botimit.

Megjithatë nga vrojtimi në vend dhe nga informatat e marra nga punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Durrësit, ndër ndërhyrjet më të rëndësishme për konsolidimin e strukturave, mund të përmendim:

[21] K. Miho, *vep. cit.*, f. 90-93

DO NOT COPY

- Puntelimin e hyrjes së një galerie tërthore
- Puntelimin e soletave të rrafshta të ambienteve në anën perëndimore
- Konsolidimin e një pjese të shkallares
- Konsolidimin me anë të rindërtimit të harqeve mbajtëse të pjesës fundore të galerisë eliptike të nivelit të poshtëm
- Drenazhimin e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore
- Pastrimet, rindërtimet e pjesshme dhe fugatimet në disa zona e nivele që paraqesnin rrezikshmëri, por edhe për të rritur shkallën e vizitueshmërisë së monumentit.

Ndërhyrjet restauruese të vitit 2004

Punimet e konservimit dhe të restaurimit në Amfiteatrin e Durrësit të vitit 2004 u ndanë në dy faza: në punime që lidheshin me organizimin e spektaklit ndërkombëtar "Miss Globe International 2004" dhe në punime konsolidimi e restaurimi të mirëfillta.

A. Punimet e fazës së parë

Punimet e fazës së parë u përqëndruan kryesisht në ato punime të projektit, të cilat do të ndihmonin realizimin e spektaklit ndërkombëtar "Miss Globe International 2004", të planifikuar për t'u organizuar në këtë monument.

1. Sistemimin dhe rrafshimin e arenës së amfiteatrit. Varianti i propozuar në projektidenë e paraqitur në Këshillin Kombëtar të Restaurimit, i cili parashikonte gërmimin e arenës deri në kuotën e buzës së shkallares së parë, u ndalua nga Instituti i Arkeologjisë, meqenëse studimi i fundit i paraqitur nga ekipi italian në kuadrin e programit të UNOPS-it parashikon daljen e rrënojave dhe gjetjeve arkeologjike fare pranë kuotës ekzistuese të arenës. Vendimi i përbashkët i Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe të Institutit të Arkeologjisë, kufizonte gërmimin në arenën e amfiteatrit në sistemimin e parregullsive të terrenit dhe lejonte krijimin e rrafshit të arenës me anë të mbushjes provizore, deri në kuotën +1.30 m nga fundi i shkallares së parë.

Për ta bërë të dallueshme shtresën e mbushjes nga terreni fillestar është hedhur një shtresë rëre dhe, pjesërisht, fletë plasmasi.

2. Ndërtimin e shkallares për spektatorë. Në Projektin e Restaurimit dhe të Rijetëzimit të Amfiteatrit të Durrësit, mbas vërejtjeve të bëra nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, ishte parashikuar ngritja e një shkallareje metalike në anën juglindore të amfiteatrit. Ngritja e kësaj shkallareje do të bëhej e mundur vetëm pasi të prisheshin banesat ekzistuese në arenën e amfiteatrit. Meqenëse kjo kërkesë nuk mundi të realizohej në kohë, u bënë ndryshimet e mëposhtme:

Shkallarja për spektatorë u ndërtua në anën veriperëndimore të amfiteatrit. Ajo u ndërtua me konstruksion metalik për të siguruar jetëgjatësinë, me përmasa më të vogla, lehtësisht e montueshme dhe e çmontueshme dhe që jep mundësinë e magazinimit dhe të ripërdorimit të saj në çdo rast të paraqitur në të ardhmen. Për këtë arsye mbështetja e shkallares së re mbi atë ekzistuese është realizuar nëpërmjet pllakave metalike 10x15 cm dhe fiksohet me anë të kunjave metalike, pa ndërhyrë në konstruksionin fillestar të shkallares së amfiteatrit.

Për sigurimin e konstruksionit të shkallares së amfitearit nga ngarkesat e shkallares metalike dhe të spektatorëve, u bë puntelimi në galeritë e amfiteatrit ku mbështetej ajo.

3. Krijimi i rrafshit të arenës. Mbas sistemimit të terrenit me anë të gërmimeve dhe mbushjeve të dherave, duhej të mbulohej dhe kanali i hapur nga gërmimet arkeologjike gjatë segmentit perëndimor të arenës, për të krijuar rrafshin e skenës dhe platformën për spektatorët në gjithë sipërfaqen e arenës.

Kjo u realizua duke ndërtuar një dysheme druri të mbështetur mbi një konstruksion metalik të çmontueshëm.

I gjithë rrafshi i arenës së krijuar nga punimet e dheut dhe platforma prej druri u mbulua me një shtresë çakulli të fraksionuar prej 10 cm.

4. Punime sistemimi dhe vlerësimi estetik të monumentit. Organizimi i spektaklit "Miss Globe International 2004", me pjesëmarrjen e mbi 40 shteteve dhe me transmetim televiziv të lidhur me rrjetin ndërkombëtar, imponente realizimin e një pjese të punimeve të projektuara, që lidheshin me vlerësimin estetik të monumentit. Këto punime konsistonin në:

DO NOT COPY

DO NOT COPY

• Gërmimin dhe largimin e dherave të hedhura arbitrarisht në shkallaren e amfiteatrit, sidomos në anën veriore, ku ishte grumbulluar një sasi e konsiderueshme dherash e mbeturinash.

• Pastrimin e të gjithë sipërfaqes së shkallares dhe territorit të amfiteatrit nga mbeturinat dhe bimësia e egër dhe larja e saj me ujë të bollshëm. Këto punime evidentuan gjithashtu dëmtimet e konstruksionit të monumentit, që do të konsolidoheshin gjatë punimeve të fazës së dytë.

• Realizimin e rrethimit të ri të territorit të amfiteatrit me kangjella metalike të reja dhe më estetike, duke zëvendësuar rrethimin e parregullt ekzistues. Gjithashtu u kufizuan me parapete metalike të gjitha pikat e rrezikshme të kalimit të vizitorëve.

• Përfundimin e fazës së parë të konservimit të mozaikut të kapelës së amfiteartrit, e cila konsistonte në pastrimin e mozaikut dhe të muraturës së kapelës nga lagështia dhe myshqet, për të vazhduar më vonë me konservimin tërësor të tij.

• Zëvendësimin e mbulesës së kapelës së amfiteatrit, nga mbulesë me llamarinë të valëzuar, me një pamje të shëmtuar, në mbulesë me fletë polikarbonati të tejdukshëm.

• Realizimin e sistemimit të gjithë territorit për rreth monumentit, shtrimin e rrugëve dhe të shesheve, prishjen e kioskave etj.

Këto punime ja rritën dukshëm vlerat estetike monumentit.

Mbas përfundimit te spektaklit "Miss Globe International 2004" u çmontuan elementet që kishin të bënin me spektaklin, si:

• Skena me gjithë aksesorët e saj .

• Shkallarja metalike për spektatorë me gjithë ndenjëset prej druri dhe u magazinuan në territorin e monumentit, për t'u ripërdorur në çdo rast që do të nevojitet dhe në çdo pjesë të shkallares së amfiteatrit.

• Platforma prej druri që mbushte rrafshin e arenës.

Në këtë mënyrë monumenti u rikthye në gjendjen fillestare, për t'i lënë vend ndërhyrjeve konsoliduese dhe restauruese të fazës së dytë.

B. Ndërhyrjet restauruese të fazës së dytë

Ndërhyrjet restauruese do të klasifikohen kryesisht në këto kategori kryesore:

1. Ndërhyrje konsoliduese të strukturave konstruktive.

2. Ndërhyrje për evidentimin e elementëve arkitektoniko-konstruktive të amfiteatrit, që çojnë dhe në rritjen e shkallës së vizitueshmërisë të monumentit

3. Punime për eliminimin e shkaqeve të jashtme, që sjellin dëmtime të monumentit.

Shpesh këto kategori ndërhyrjesh janë të gërshetuara me njëra-tjetrën dhe, për këtë arsye, nuk mund të vihet një kufi i prerë ndërmjet tyre. Një ndërhyrje konsoliduese evidenton njëkohësisht dhe elementin arkitektoniko-konstruktiv dhe anasjelltas.

1. Ndërhyrjet konsoliduese u përqëndruan në ato pjesë dhe elemente konstruktive, të cilat ishin të dëmtuara në atë shkallë, sa që rrezikonin humbjen e qëndrueshmërisë së mëtejshme të tyre, si dhe shkaktonin dëmtime të strukturave të tjera të monumentit. Eliminimi i këtyre dëmtimeve është bërë me metodat tashmë të zbatuara gjerësisht nga praktika ndërkombëtare dhe ajo vendase e restaurimit, siç janë fugatimet, injektimet, qepjet e të çarave dhe rindërtimet e pjesshme.

1a. Konsolidimi i shkallares së amfiteatrit. Punimet e kryera për konsolidimin e strukturave që konsideroheshin të rrezikuara, u përqëndruan në radhë të parë në një nga problemet kryesore të monumentit, siç ishte degradimi i sipërfaqes së shkallares së amfiteatrit nga lagështia, luhatja e temperaturave dhe ngricat. Nga ana tjetër ujërat e rreshjeve depërtonin edhe në galeritë e amfiteatrit, duke shkaktuar të njëjtat pasoja në konstruksionin e tyre. Mënyra e zbatuar është konsolidimi i saj me një shtresë të hollë përzierjeje llaçi me gurë sipas teknikës ekzistuese. Kjo mënyrë u zbatua në sipërfaqet e korroduara dhe që kishin humbur konfiguracionin fillestar, ndërsa në pjesët që përmbajnë elementë arkitektonike e konstruktive, si shkallët e ngushta për lëvizjen e spektatorëve ose në pjesët ku ka dalë në dukje teknika e ndërtimit, konsolidimi është bërë me anë të fugatimit sipërfaqësor, pa i mbuluar apo fshehur këto elemente.

Proceset e punës konsistonin në:

- Pastrimin e sipërfaqes me furçë.
- Larjen e sipërfaqes me ujë të bollshëm.
- Hedhjen e një shtrese llaçi deri në 8 cm.
- Fiksimin e gurëve në shtresën e llaçit.
- Fërkimin e fugave të llaçit, për të evituar plasaritjet.
- Spërkatjen me pluhur shtufi për efekte koloristike.

Llaçi i përdorur ka këtë përbërje:

- Rërë lumi e larë 3 pjesë
- Pluhur vullkanik (pucolana)[22] 1 pjesë
- Pluhur guri të bardhë 1 pjesë
- Gëlqere e shuar mirë 2 pjesë
- Çimento 1 pjesë
- Shtuf për ngjyrë

1b. Rindërtimi i pjesëve munguese. Në këto ndërhyrje veçojmë ato, të cilat janë bërë kryesisht për arsye konsolidimi të strukturave konstruktive të monumentit. Këtu hyjnë rindërtimet pjesore të një qemeri në galerinë e sipërme dhe të qemerit të hyrjes veriore të amfiteatrit, të cilat me kohë janë rrëzuar.

Rrëzimi i pjesëve konstruktive në këto elemente ka shkaktuar një gjendje paqëndrueshmërie për pjesët e mbetura dhe që qëndrojnë konsol. Do të mjaftonte një shkak sado i vogël që këto pjesë të humbisnin ekuilibrin statik në të cilën aktualisht ndodheshin dhe të rrëzoheshin, duke sjellë kështu humbjen e pjesëve të tjera të çmueshme të strukturës së amfiteatrit. Nga ana tjetër boshllëku në galerinë e sipërme krijonte shkarkimin e prurjeve të konsiderueshme të rreshjeve të shiut në galeritë e amfiteatrit dhe një përmbytje të vërtetë të galerive të poshtme. Zgjidhja që i është dhënë këtij problemi, duke rindërtuar pjesët munguese, është konsideruar nga projektuesit si zgjidhja më e pështatshme në rastin konkret.

Rindërtimi i qemerëve në këto pjesë u realizua në këtë mënyrë:

- Ndërtimin e kallëpeve prej druri.
- Hedhjen e një shtrese me përzjerje llaçi e gurësh, sipas teknikës ekzistuese.
- Ndërtimin e një këmishe BA, e inkastruar në pjesët e shëndosha të konstruksionit ekzistues.
- Mbushjen e pjesës mbi këmishën BA me një përzjerje llaçi e gurësh, sipas teknikës ekzistuese.

Në rastin e rindërtimit të qemerit të hyrjes veriore, për arsye të mbushjes së madhe dhe dobësisë së konstruksionit të mbetur të qemerit, pra për të zvogëluar ngarkesën, u procedua ndryshe. Mbi këmishën BA u bë mbushje me material të lehtë me bazë polisteroli dhe mbi të u shtrua përzjerja e llaçit me gurë.

Sondazhet arkeologjike në shpatullat e portës veriore zbuluan bazamentin e shpatullave. Ato formohen nga blloqe monolite gurësh gëlqerorë, me përmasa 1,5 x 0,6 x 0,7 m. Gjurmët e mbetura në muraturën e shkallares dëshmojnë se shpatullat e portës formoheshin gjithashtu prej blloqesh gurësh masive, me të njëjtat përmasa me ato të bazamentit të zbuluar. Rikonstruksioni i tyre u krye duke respektuar teknikën dhe formën fillestare, d.m.th. me blloqe monolite gurësh.

Gjithashtu gjurmët e mbetura dëshmojnë se lartësia e harkut që mbyll hyrjen ishte 0,45 m, gjerësia e harkut ishte 0,60 m, ndërsa trashësia e fugave të llaçit në bazën e harkut ishte 2 cm. Rikonstruksioni i harkut u realizua me një veshje tullash të të njejtave përmasa, ngjyre dhe rezistence.

1c. Qepjet e të çarave. Qepjet e konstruksionit (në mure e qemere) u bënë në ato raste kur çarjet ishin të konsiderueshme, d.m.th. më të gjera se 2 cm . Qepjet konsistonin në:

- Pastrimin e llaçit të degraduar.
- Heqjen e tullave ose gurëve të dëmtuar, në distancë të paktën 30 cm nga të dy anët e çarjes.
- Rindërtimin e hapjes me të njëjtën teknikë me atë origjinale.
- Fugatimin e sipërfaqes së muraturës.
- Injektimin e gjithë zonës që përmbante çarje për konsolidimin e gjithë masës së muraturës së dobësuar.

1d. Injektimet. Gjatë pastrimit dhe larjes së sipërfaqeve të shkallares dhe të muraturës së galerive të brendshme dolën në dritë shumë zona, të cilat kishin pësuar çarje kapilare ose ishin të pakonsoliduara. Aplikimi vetëm i fugatimeve në këto zona, nuk mund të siguronte qëndrueshmërinë e duhur të strukturës konstruktive, me qenë fugatimi është një ndërhyrje sipërfaqësore, ndërsa në këto raste kërkohej një ndërhyrje në thellësi të strukturave, siç është injektimi i tyre.

Ky proces konsistoi në parapërgatitjen e strukturave, duke i larë me ujë të bollshëm nëpërmjet vrimave të hapura në muraturë, në distancë 1-1.5 m. Për injektim u përdorën vrimat e hapura për pastrim dhe procesi filloi nga poshtë - lart.

22) Përdorimi i pluhurit vullkanik (pucolanës), i furnizuar nga firma prodhuese TRACELLAS, Selanik (Greqi), është bërë duke u mbështetur në rekomandimin dhe garancinë e Laboratorit të Materialeve të Ndërtimit të Fakultetit të Inxhinierisë të Universitetit Aristoteli të Selanikut, bazuar në analizat laboratorike përkatëse, si dhe në patentën ndërkombëtare të firmës prodhuese dhe furnizuese.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Materiali i përdorur për injektim u përgatit i lëngshëm dhe i përzjerë shumë mirë, për të shmangur dekantimet dhe shtresëzimet. Përbërja e llaçit të injektimit është:

- Rërë lumi i larë mirë 2 pjesë
- Pluhur vullkanik 1 pjesë
- Pluhur guri 1 pjesë
- Gëlqere e shuar 2 pjesë

2. Ndërhyrjet integruese. Ndërhyrje integruese u bënë në zonat ku elementët arkitektonikë dhe konstruktive kishin humbur konfiguracionin fillestar, si dhe në zonat e kalimit të spektatorëve, duke e rritur në këtë mënyrë shkallën e vizitueshmërisë së monumentit.

2a. Punime fugatimi. Fugatimet u kryen në sipërfaqet e muraturës, në zonat ku llaçi i vjetër ishte degraduar. Kujdes i veçantë iu kushtua zonave gjatë rrugëve të kalimit të vizitorëve. Ky proces u krye paralelisht me zëvendësimin e pjesëve të brezave të tullës, të cilat gjithashtu ishin të degraduara. Gjatë fugatimit u krye gjithashtu dhe mbushja e çarjeve kapilare.

Procesi i fugatimit përmbante fazat e mëposhtme:

- Pastrimin e llaçit dhe të tullave të degraduara.
- Larjen e sipërfaqes.
- Vendosjen e llaçit të freskët me shtresa të njëpasnjëshme dhe të tullave të reja.
- Fërkimin e shtresës së fundit të llaçit, duke e lënë atë disa milimetra më thellë nga sipërfaqja e muraturës.

Përbërja e llaçit të fugatimit që është përdorur ka këtë përbërje:

- Rërë lumi e larë 3 pjesë
- Pluhur vullkanik (pucolana) 1 pjesë
- Pluhur guri të bardhë 1 pjesë
- Shtuf për ngjyrë 1 pjesë
- Gëlqere e shuar mirë 2 pjesë
- Çimento 1, 1/2 pjesë

2b. Veshje të muraturës me tulla. Kjo ndërhyrje u krye në ato sipërfaqe të muraturës, ku veshja me tulla kishtë rënë thuajse plotësisht, duke krijuar zona në formë zgavrash, që krijonin një pamje të shformuar dhe estetikisht të papranueshme. Veshja me tulla krijon gjithashtu dhe një lloj mbrojtjeje nga korrodimi i mëtejshëm i muraturës, sidomos aty ku ajo është në kontakt me mjedisin e jashtëm, siç janë disa pjesë në galerinë e sipërme.

2c. Rikonfigurimi i elementeve të dëmtuar. Këto ndërhyrje janë kryer kryesisht në zonat e vizitueshme për të krijuar një kalim më të sigurtë të vizitorëve, si dhe për të mbrojtur elementët arkitektonikë nga dëmtimet e mëtejshme nga lëvizjet e shpeshta të njerëzve. Gjithashtu këto ndërhyrje u shtrinë dhe në zona përbri të parave, për të rritur shkallën e vizitueshmërisë së monumentit.

Zonat kryesore ku u aplikuan këto ndërhyrje janë kryesisht shkallët që lidhin nivelet e ndryshme të galerive dhe në daljet e galerive në shkallaren e amfiteatrit. U plotësuan gjithashtu dhe disa harqe në pamje të shkallares dhe që ndodhen në rrugët e kalimit të vizitorëve.

3. Eleminimi i shkaqeve të jashtme të dëmtimeve të monumentit. Një nga sëmundjet kryesore dhe e vazhdueshme, nga e cila ka vuajtur monumenti, ishte prania e përhershme e lagështisë. Ky fenomen ka shkaktuar dëmtime serioze të monumentit, me pasoja të rrezikshme për qëndrueshmërinë statike të vetë monumentit dhe, në mënyrë të veçantë, për mozaikun e kapeles.

Në kohën e rreshjeve atmosferke gjithë ujërat e pjesës së sipërme të terrenit e të kodrës mbi amfiteatër vërshonin në arenën e amfiteatrit, duke shkaktuar rritjen e konsiderueshme të nivelit të ujit brenda monumentit. Ndikim të ndjeshëm në rritjen e nivelit të lagështisë kishte dhe shtimi i prurjeve të ujërave nëntokësore gjatë periudhave të rreshjeve. Gjithashtu, ekzistenca e hapësirave të zbuluara në galeritë e sipërme, bënte që ujërat e rreshjeve të rridhnin lirisht në shkallaret e lidhjes së galerive dhe të krijonin përmbytje të niveleve të poshtme.

Deri më sot eleminimi i kësaj dukurie ishte gjetur në grumbullimin e ujërave në një pus nëpërmjet një drenazhimi të pjesshëm dhe në instalimin e një pompe për largimin e tyre jashtë objektit. Por, pavarësisht nga këto masa, niveli i ujërave nëntokësore mbetej ende i lartë dhe, nëpërmjet dukurisë së kapilaritetit, depërtonte në strukturat e poshtme të monumentit dhe në mozaikun e kapeles, duke i mbajtur ato në prani të vazhdueshme lagështie.

Masat që u ndërmorën për eleminimin e kësaj dukurie konsistojnë në:

3.a. Në pjesën e ngritur të terrenit, në anën veriore të amfiteatrit, nën rrethimin e ri, u ndërtua një parapet ose bordurë, me lartësi min. 20 cm, e cila ndërpret

vërshimin e ujërave sipërfaqësore dhe, nëpërmjet kunetave, i dërgon ato në pusetat e rrugicave përbri. Kjo masë dha provën e vet gjatë shirave të rrëmbyeshën të muajve shtator, tetor, 2004, kur u ndalua plotësisht depërtimi i tyre në shkallaren dhe në arenën e amfiteatrit.

3.b. Një masë tjetër për eleminimin e rrjedhjeve të ujërave të rreshjeve në galeritë e amfiteatrit ishte dhe ngritja e pragjeve në hyrjet e galerive. Grumbullimi i ujërave nga pjesët e hapura të galerive të sipërme dhe disiplinimi i tyre, duke i larguar ato me anë të tubacioneve drejt pusit në arenën e amfiteatrit, ishte gjithashtu një masë efikase për shmangjen e rrjedhjeve nëpër galeritë e mëposhtme.

3.c. Ndërtimi i pjesshëm i qemerit në galerinë e sipërme, mbulimi i pjesës tjetër me fletë polikarbonati, si dhe mbulimi i hapësirave të zbuluara të hyrjes së galerive, ishin dhe këto masa efikase për ndalimin e vërshimit të ujërave të rreshjeve në brendësi të amfiteatrit.

3.d. Për largimin e ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësore u kërkua kryerja e një gërmimi në anën jugore, i cili, sipas studimit, do të krijonte një diferencë potencialesh të nevojshme për drenazhimin e tyre jashtë territorit të monumentit. Dalja në vendin e propozuar e shumë elementëve, si një numër i konsiderueshëm pusesh, e përligji këtë kërkesë. Gërmimi, të paktën i një pusi deri në kuotën e tabanit të arenës do të krijonte atë diferencë kuotash të mjaftueshme për të grumbulluar ujërat në këtë zonë. Rrënojat e mbuluara të monumentit do të luanin në këtë rast rolin e një lloji drenazhi. Më tej me anë të një kanalizimi jashtë kufirit të monumentit ujërat do të derdhen në kolektorin kryesor të qytetit, i cili kalon në rrugën kryesore dhe është në një kuotë më të ulët se tabani i arenës së amfiteatrit.

Mosrealizimi i kësaj kërkese nga ana e ekipit të arkeologëve solli si rezultat që të mbetej në zgjidhjen e vjetër, d.m.th. në grumbillimin e ujërave në pus dhe largimin e tyre jashtë territorit të amfiteatrit me anë të pompave. Por, tashmë sasia e ujërave të mbledhura në pus, mbas kryerjes së punimeve për ndalimin e rrjedhjes së ujërave nga pjesët e larta të terrenit në anën veriore dhe disiplinimin e tyre në përgjithësi, do të jetë shumë herë më e vogël.

Punimet e restaurimit të vitit 2004, megjithë përmirësimet që sollën në riaftësimin e strukturave konstruktive dhe ripërtëritjen e elementeve arkitektonike, si dhe në elemiminimin e shkaqeve të jashtme të dëmtimeve të monumentit, nuk mund të pretendohet se u zgjidhën të gjitha problemet që paraqiste ai.

Çlirimi i amfiteatrit nga ndërtimet e reja mbi të dhe në afërsi të tij, gërmimet e mëtejshme arkeologjike për zbulimin e pjesëve ende të fshehura të tij, jo vetëm do të saktësojnë dhe do të plotësojnë studimet e filluara, por do të hapin rrugën për restaurime të mëtejshme, të cilat do t'i rikthejnë këtij monumenti të rëndësishëm vlerat e tij të vërteta dhe do t'i japin atij vendin që meriton në bashkësinë e monumenteve të tjerë të së njëjtës gjini në mbarë botën.

DO NOT COPY

Literatura bazë e konsultuar:
J-C. Golvin, *Amphithéâtre Romain*, Paris, 1988
J-C. Golvin, Ch. Landes, *Amphithéâtres et gladiateurs*, Paris, 1990
A. Hönle-A. Henze, *Römische Amphitheater und Stadien*, Atlantis, 1981
D. L. Bomgardner, *The Story of the Roman Amphitheatre*, London and New York, 2000
K. Miho, *Amfiteatri i Durrësit*, Tiranë 1984
Revistat *Monumentet* dhe *Iliria*

PLANIMETRIA E AMFITEATRIT TË DURRËSIT
ZONAT E NDËRHYRJEVE





Tab. I. Fugatimi i shkallares





Tab. II. Vendosja e shkallares metalike gjatë dhe pas montimit, pas çmontimit



Tab. III. Përgatitja e amfiteatrit për spektaklin Miss Globe International 2004





Tab. IV. Ndërhyrje në nivelin e hyrjes

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Tab. V. Ndërhyrje në galerinë e mesme



Tab. VI. Ndërhyrje në galerinë e poshtme dhe në atë tërthore



Tab. VII. Ndërhyrje në galerinë e poshtme (2)





Tab. VIII. Ndërhyrje në galerinë e poshtme (3)

DO NOT COPY



Tab. IX. Restaurimi i kapeles dhe i mozaikut



Tab. XI. Ndërhyrje në galerinë e "kafshëve"



Tab. X. Restaurimi i hyrjes veriore: 1) Gjendja para restaurimit, 2) Sondazhet, 3) Gjendja pas restaurimit.



Tab. XII. Ndërhyrje në galerinë lindore



Tab. XIII. Rrethime dhe sistemime të brendshme



Tab. XIV. Sistemime të jashtme dhe gërmime arkeologjike

DO NOT COPY

Prof. Dr. Pirro THOMO

DO NOT COPY

DURRES AMPHITHEATER AND RESTORATION WORKS 2004

Durres amphitheater is one of the most important monuments not only in the city but national even and international scale. This monument is evaluated constantly, so in this framework were interventions done in 2004, which are to be explaining as follows.

Project idea conducted for these interventions was focused on: **partial consolidation and evidence of monument from one side and from the other side its revitalization, for fulfilling artistic and cultural demands of Durres city.**

After approving of the project idea by the National Restoring Council (NRC) the second phase project was conducted. The proposal and criteria's which were approved; the clarifications of the detailed proposals by defining exactly monuments state, damages, areas and type interventions and manner of realizations of these interventions were used for restoring interventions

.

Historico – architectonic short description of the monument

Roman conquered of the Durres on year 229 b. c. and especially its change in a roman colony on the year 30 b. c., became that: in the daily life of the city were a normal custom citizens enjoying shows of gladiator fights.

During 1966, archaeological excavations under direction of the passionate archaeologist Vangjel Toçi has began for discovering Durres amphitheatre.

With amphitheatre discovering (up to now is discovered over than 1/3 of it) the interest for this important monument was grow and parallel with it was added study articles at scientists magazines.

Date.- The issue of date for amphitheatre, up to now there is not any further argument for change of date made from V. Toçi, as a building of beginning of II-nd century, may be of Hadrian imperator time.

Durres amphitheatre has been in use up to imperator Theodosius I (379-395) who stopped the bloody gladiator games. After that the amphitheatre was used as a cemetery and in VI century at one of west galleries was built a small church.

It is well-known the mosaic of this chapel which wears two west and south bottom faces. Different authors have studied mosaic scenes and give different opinions for its date and scenes interpretations.

Tracts show a mural stratum painting which is applied the mosaic.

Durres Amphitheatre typology. According to the staircase construction (*caveas)*, for defining of amphitheatre typology we will hold at the criteria's used by J-C. Golvin at his work *Amphithéâtre Romain*, Paris, 1988. This defines the Durres amphitheatre as an "empty" structure amphitheatre when its staircase is above at the galleries system covered by vaults.

Arena. - It is still uncovered so is cannot precise its quota, layer and the construction under arena. This will clarify arena function: is only for *munera*, gladiator shows, or and for *venations*, animal shows.

Staircase *(cavea).*- Elements of staircase are: podium, two sectors for spectators (*maenianum*), which are separated by a narrow corridor (*praecictio*). At upper sector are narrow circle stairs (*cuneus*) which serve for easy movement of spectators.

Galleries.- Staircase is above on the vault constructions and arches built at ring or vertical walls which forms a galleries system. Disperse of the spectators at staircases is made throw exits (*vomitoria*), open at each gallery.

Parts of upper, medium, lower gallery has remained up to date and these follow elapse form of the

amphitheatre. Ellipse or ring galleries are linked with vertical or radial galleries which has stairs.

Except of the upper galleries are still and north entrance gallery, and another gallery which is named conventionally "animal gallery" which has an exit at lower maenianumin.

Galleries are covered with vaults which are different form and techniques.

Techniques and building materials.- Floor and staircase sub layers and building of vaults are realized by mixed stone and mortar material (*opus caementicium*).

Building of arches has used complete bricks thicker 5-6 cm.

Mainly walls are built according to the technique *opus incertum,* but are present also murals or their fragments built or covered totally with bricks.

Amphitheatre measurements.- From data's which are available from the parts discovered up to date, K. Miho and L. Miraj has traced ellipse form of the amphitheatre and precise its measurements.

According to the authors	Arena a	Arena b	Amf. A	Amf. B	Spectat figure	Arena figure	Outsid figure	Arena surpha	Amptit surpha
K. Miho, var. I	63	39	119	95	-	179	335	1900	8900
K. Miho, var. II	63	39	127	103	15.000	179	366	1900	10.000
L. Miraj	61,4	42,2	132,4	113,2	15.000 -20.000	-	-	-	-

Durres amphitheatre is one of the biggest amphitheatres built at roman world

Existing state of monument

Influence of natural and human factors during the use of amphitheater, but and after discovering has effected structural damages which are collapse of constructive elements fractures, decompositions of building material, like bond mortar, bricks, masonry etc., so living as it is will cause further damage of monument.

Restauring interventios of 2004

Conservation and restoration work on the Durres amphitheatre of the year 2004 was divided in two phases: restoring and consolidation works linked with organization of the international show "Miss Globe International 2004".

1. First phase works

First phase works was focused at project which will help realization of the international show "Miss Globe International 2004", which was organized at this monument. This works consisted at:

I **Settle and raze of amphitheatre arena.**

I **Building of staircase for spectators.**

Staircase for spectators was built at northwest side of amphitheatre. It was build with metallic construction to secure continuity with small measurements, easily assemble and dissemble and give the possibility of its storing and reuse later on.

I **Settling works and aesthetic evaluation of monument**

These works consisted on realization of the part of projected works linked with inner and exterior aesthetic evaluation of monument.

B. Restoring interventions of the second phase

Restoring interventions were classified at these main categories:

1. Consolidation interventions of constructive structures

2. Interventions for findings architectonic-constructive elements of the amphitheater which helps for growing the visitation scale of monument

3. Works for elimination of external factors which cause monument damages

1. Consolidation interventions was focused at these parts and constructive elements which were damage at the scale of risking loosing of their stability and cause further damages of monument structures. Eliminate of these damages is done with the international and national applied methods of restoration like whirling, injections, stitching of fractures and partial rebuilding.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

1a. Consolidation of the amphitheatre staircase

Interventions done for consolidations of structures consider risky was focused primarily at main problem of monument, like degradation of staircase surface by humidity, temperature fluctuation and freeze. Rain water penetrate at amphitheater galleries by causing the same effects at their constructions. Applying manner is its consolidation with thinner layer of stone mortar according to existing technique.

1b. Rebuilding of missing parts

From these interventions needs to separate those which are done for consolidation of constructive structures for monument. Here am including partial rebuilding of a vault at upper gallery and the vault of amphitheater north entrance destroyed before.

Destroying of constructive parts at these elements has caused unstable state for remain parts which stands console. Only a simple fact can cause for these parts loosing of static equilibrium which were before and they will fall down, by loosing invaluable parts of amphitheater structure.

Archeological sounding at north entrance claps and remains of masonry staircase testify for form, measurements and primary materials of this element. Their reconstruction by ensuring these secure data's, was done by respecting technique and beginning form.

1c. Fracture stitching

Construction stitching (walls and vaults) was done at these cases were they was considered so more than 2 cm wide.

1d. Injections

During cleaning and washing the staircase surface and masonry of the inner galleries was discovered many areas which has occurred capillary fractures or were unconsolidated. Whirling application at these areas can not ensure the necessary stability of the constructive structure because at these cases is demanded a deep structural intervention like their injection.

This process consist at structure preparing by washing them with superabundant water throw holes opened at masonry at a distance 1-1.5m. The open holes were used for injection and the process begins from bottom-up.

2. Integrator interventions

Integrator interventions were done at the areas when architectonic and constructive elements have loose beginning configuration, and at the areas of spectator's passages, by increasing the visitation scale of monument.

2a. Whirling works

Whirling was done at masonry surface, at the areas when the old mortar was degraded. This process was done parallel with the replace of the degraded brick belt. During whirling was done and filling of capillary incisions.

2b. Facing of masonry with bricks

This intervention was done at these masonry surfaces when bricks facing has fallen almost completely by creating areas with cavity forms and deformed view, this was aesthetically. Facing with bricks create also a kind of protection from the further masonry corrosion, especially when it is in a contact with external environment like some part of upper gallery.

2c. Reconfiguration of damage elements

These interventions are done mainly at visited areas with the purpose to create a safety passing of visitors and also for protecting architectonical elements from further damages which happens because of frequently movements of people. Main areas when these interventions were applied are stairs which link different levels of galleries and galleries exits at amphitheater staircases. Some arches which are established at staircases part and also on street of visitors were fulfilled too.

3. Elimination of external causes which cause damage of monument

The sloppy of monument is immanence process and this has caused grave damages at monument which has risky consequences for static stability of monument especially for chapel mosaic.

Measures undertaken for elimination of this phenomenon consist at:

3.a. Building of a parapet or edging on the upraise ground, at north side of amphitheatre, which stops floods of surface waters and by using percolator, direct them at cesspool closed alleys.

3.b. Building of doorsteps at entrance of galleries and dissimilation of waters with a pipe toward at a well in the amphitheater area.

3.c. Partial building of the vault at upper gallery, coverage of other part, and the areas discovered of the gallery entrance with polycarbonate sheets. ,

Restoration works of year 2004 brought the improvements on the rehabilitation of constrictive structures, renovation of architectonical elements and elimination of the external causes of monument damage but we can not pretend that all the problems which are presented are solved.

Liberating of the amphitheater from the new buildings on and close to it, further archeological excavations for the discovering of uncovered parts will clarify and complete the began studies but also will open the road for further restorations.

DO NOT COPY

Latif LAZIMI

STUDIM MBI ADMINISTRIMIN E QENDRES HISTORIKE DHE ZONES TAMPON TE QYTETIT TE DURRESIT

DO NOT COPY

Qyteti i Durrësit është një nga qendrat historike më të rëndësishme jo vetëm në Ballkanin perëndimor, por në të gjithë pellgun e Mesdheut. Autorë antikë e kanë quajtur me të drejtë "Taverna e Adriatikut". Në kohën e perandorisë romake, Durrësi ishte një nga portet më të njohur të Mesdheut dhe pikënisja e rrugës së njohur romake "Via Egnatia", e cila ka lidhur Perëndimin me Lindjen. Duke patur një nënshtresë arkeologjike të pasur dhe vlera të rëndësishme historike, arkitektoniko-urbanistike të mbitokës, të fillimit të shek. XX është bërë një studim mbi administrimin e qendrës historike dhe të zonës tampon të këtij qyteti. Zonifikimi i qytetit të Durrësit është bërë në formën e një rregulloreje, që përmbledh nenet e mëposhtme, duke specifikuar kriteret shkencore dhe ligjore me anën e të cilave do të administrohet qendra historike e qytetit të Durrësit.

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e Qendrës Historike dhe Zonës Tampon të qytetit të Durresit, mbështetur në **ligjin Nr.9048, dt.07.04.2003 dhe ndryshuar me Nr. 9882, dt.28.02.08 ,"Për trashëgiminë kulturore".**

Objektivat kryesore të kësaj rregulloreje janë:

I. Administrimi i Qendrës Historike dhe Zonës Tampon të qytetit të Durrësit, sipas hartës, që i bashkangjitet kësaj rregulloreje si pjesë integrale e saj.

II. Mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe rikonstruksioni i vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike dhe mbrojtjen, konservimin, restaurimin, rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja në Zonën Tampon, të qytetit të Durrësit.

III. Mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Durrësit për administrimin, mbrojtjen, konservimin, restaurimin dhe rikonstruksionin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike dhe administrimin, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja në Zonën Tampon të qytetit të Durrësit.

Neni 2
Struktura e Qendrës Historike dhe Zona Tampon e qytetit të Durrësit

Qendra Historike dhe Zona Tampon e qytetit të Durrësit konsiderohen si dokumentet më autentikë të historisë së zhvillimit të këtij qyteti, si pjesë e Trashëgimisë Kulturore dhe si të tilla i nënshtrohen **ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 dhe ndryshuar me Nr. 9882, dt.28.02.08 "Për Trashëgiminë Kulturore"**. Ato përbëhen nga:

1. **Qendra Historike**, e cila përfshin:

Territorin brenda mureve rrethuese të shek.VI të qytetit dhe pjesën veriore të saj, ku në periudhën e vonë antike dhe në mesjetën e hershme e të mesme dhe të vonë u zhvillua qyteti. Në këtë zonë janë përqëndruar shumica e ndërtimeve shoqërore të fundit të shek.XIX. dhe fillimit të shek.XX. dhe e monumenteve të gjinive të ndryshme dhe përfshin zonat e mëposhtme :

- Rruga Epidamni në të dy krahët, ku përfshihen dhe rrugët Kolonel Tomson, rruga e xhamisë, rruga e kalasë; në krahun e majtë dhe rruga De Rada në krahun e djathtë.
- Sheshi i Lirisë, në vazhdim shëtitorja Dyrrahu, fragment i krahut të djathtë të K.Rama, vazhdimi i rrugës Hafiz Podgorica nga kryqëzimi me shëtitoren Dyrrahu deri tek shëtitorja Egnatia dhe në vazhdim të saj deri tek rruga E.Durrsaku.

- Rruga Maliq Muço deri në kryqëzim me rrugën A. Naci.

- Fragment i rrugës së Dëshmorëve, sheshi Demokracia, deri në kryqëzim me shëtitoren e Dyrrahut.

2. **Zona Tampon,** e cila përfshin:

Territorin përqark zonës muze dhe përputhet me kufirin e gjurmëve të mureve rrethuese të Durrësit, sipas hartës që shoqëron rregulloren.

Neni 3
Qendra Historike

Qendra Historike është pjesa më me vlerë e qytetit të Durrësit. Ajo mbrohet në tërësi si kompleks monumental arkeologjik, urbanistik, arkitektonik dhe ambiental. Në këtë zonë lejohen vetëm restaurime dhe rikonstruksione të ndërtimeve ekzistuese dhe të atyre që kanë qenë dhe të cilat për arsye të ndryshme janë rrënuar dhe mosekzistenca e tyre cënon vlerat urbanistiko-arkitektonike të ansambleve .

Në këtë zonë, përveç monumenteve arkeologjike të zbuluara dhe nëntoka ruan monumente të pazbuluara. Po ashtu në këtë zonë ruhen ndërtime individuale dhe shoqërore të fundit të shek. XIX dhe fillimit të shekullit XX me vlera arkitektoniko - urbanistike .

Projektet e restaurimit, të rikonstruksioneve dhe të çdo ndërhyrjeje tjetër në këtë qendër historike hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), ose subjektet e licensuara për këtë qëllim nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Projektet miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve (KKR).

Rijetëzimi dhe shfrytëzimi i monumenteve të kulturës në Qendrën Historike, për nevoja apo qëllime administrative dhe social - kulturore, mund të lejohet, por pa cënuar vlerat për të cilat ato janë vënë në mbrojtje. Në çdo rast, leja e shfrytëzimit për qëllimet e mësipërme merret nga IMK dhe në raste problematike nga KKR.

Neni 4
Kategoritë e monumenteve të kulturës

Monumentet e Qendrës Historike, në bazë **të ligjit nr. 9048, dt.07.04.2003 dhe ndryshuar me Nr. 9882, dt.28.02.08 "Për Trashëgiminë Kulturore",** grupohen sipas vlerës në dy kategori: monumente të kategorisë së I-rë dhe monumente të kategorisë së II-të.

Grupimi i monumenteve në kategori synon diferencimin, sipas vlerave të tyre, duke u lidhur kjo me metodat e ndërhyrjeve të konservimit.

Neni 5
Monumentet e kategorisë së I-rë

Monumente të kategorisë së I-rë janë shembujt më me vlerë arkitektonike e historike, të gjinive, tipeve dhe të evolucionit të tyre, që ruhen në qytetin e Durrësit. Këta mund të ndodhen në Qendrën Historike, apo në Zonën Tampon, por mund të ndodhen edhe jashtë tyre. Në këtë kategori monumentesh nuk lejohet asnjë ndryshim, që prek kompozimin e volumeve, trajtimin arkitektonik të pamjeve të jashtme e të brendshme, zgjidhjen planimetrike e funksionale, elementët e veçantë arkitektonikë si dhe zëvendësimin e materialeve origjinalë. Në raste tepër të veçanta mund të bëhen adaptime të cilat duhet të jenë riversibël.

Monumente të kategorisë së I-rë cilësohen edhe kalldrëmet, muret rrethuese, trotuaret, gjelbërimi, ndriçimi dhe të gjithë elementët e tjerë të peizazhit urban të Qendrës Historike.

Neni 6
Monumentet e kategorisë së II-të

Monumentet e kategorisë së II-të janë të gjitha ndërtimet e tjera, duke përjashtuar monumentet e kategorisë së I-rë, të cilat përfshihen brenda kufijve të Qendrës Historike, si dhe ato të shpallura të tilla në Zonën Tampon. Në Qendrën Historike të qytetit të Durrësit pamjet e jashtme të ndërtimeve në formë vargu buzë rrugëve trajtohen si monumente të kategorisë së parë. Në këto monumente mund të lejohen ndryshime, apo adaptime të brendshme për një shfrytëzim më racional e komod, duke përdorur për këtë qëllim edhe struktura e materiale të kohës, por me kusht që të mos cënohet pamja e jashtme e tyre. Në raste të veçanta mund të lejohen edhe ndryshime të vogla të pamjes së jashtme në pamje sekondare, sipas studimeve të IMK. Në brendësi të monumenteve të kategorisë së II-të mund të ruhen, kur ekzistojnë, mjediset karakteristike, dekoracionet dhe mobilimet arkitektonike me vlerë.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Neni 7

Ndërhyrjet në Qendrën Historike

Plani rregullues urbanistik i qendrës së qytetit të Durrësit dhe plani i përgjithshëm rregullues i qytetit të Durrësit, duhet të respektojnë zonifikimin e Qendrës Historike. Në ndërtimet ekzistuese, të cilat ndodhen në Qendrën Historike dhe nuk përputhen me karakterin e saj dhe dëmtojnë vlerat tradicionale të ansamblit, mund të kryhen ndërhyrje adaptuese në volume, apo trajtimin e jashtëm të tyre me synim bashkëpërfshirjen në karakterin urbanistiko-arkitektonik të qytetit, por gjithmonë nuk duhet të kalojnë katet e ndërtimeve me vlera urbanistiko-arkitektonike, të cilët ndodhen pranë tyre dhe me themele me thellësi, jo më tepër se 2 metra. Po ashtu në këtë zonë ka dhe ndërtime të papërfunduara në lartësi, për të cilat duhet të bëhen studime në mënyrë që ringritja e kateve të përputhet me trajtimin arkitektonik të ndërtimeve pranë tyre dhe me parametrat konstruktiv të lejuar. Në hapësirat bosh në vargjet e ndërtimeve, ku ka patur ndërtim ose jo mund të bëhen studime për ringritjen e ndërtimeve duke iu përshtatur parametrave urbanistiko-arkitektonik të ndërtimeve pranë tyre, por jo më tepër se dy kate dhe me themele jo më tepër se 2 metra thellësi. Në raste të veçanta për arsye të vlerësimit dhe zbulimit të monumenteve unikale, siç është rasti i Amfiteatrit të Durrësit, mund të lejohet prishja e ndërtimeve që janë ndërtuar në vite mbi konturin e amfiteatrit, i cili ndodhet në thellësi nga sipërfaqja e terrenit ku ndodhen ndërtimet. Këto ndërhyrje duhet të bëhen në përputhje me ligjin nr. 9048 dt. 07. 04. 2003 dhe ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt. 28. 02. 08 "Për Trashëgiminë Kulturore"

Në këto raste vendimet e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë duhet të jenë në përputhje me nenin 38 të ligjit nr. 9048, dt. 07. 04. 2003 dhe ndryshuar me Ligjin nr. 9882, dt. 28. 02.08 "Për Trashëgiminë Kulturore".

Studimet dhe projektet e ndërhyrjeve të mësipërme në Qendrën Historike, hartohen nga IMK, ose subjektet e licensuara për këtë qëllim nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Projektet miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve (KKR).

Neni 8

Studimet dhe projektet e restaurimit në monumentet e kulturës të kategorisë së I-rë dhe të II-të

Studimet dhe projektet për restaurimin e monumenteve të kategorisë së I-rë dhe të II-të hartohen nga IMK, si dhe nga persona fizikë, apo juridikë të licensuar për këtë qëllim dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve (KKR).

Neni 9

Zbatimi i projekteve të restaurimit , në monumentet e kulturës të kategorisë së I-rë dhe të II-të dhe të rikonstruksionit.

Zbatimi i projekteve të restaurimit, në monumentet e kulturës të kategorisë së I-rë dhe të II-të dhe të rikonstruksionit hartohen nga I. M. K, si dhe nga persona fizikë, apo juridikë të liçensuar për këtë qëllim dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve (K. K. R).

Neni 10

Zona Tampon

Zona Tampon cilësohet e gjithë zona përreth Qendrës Historike, që përfshihen brenda konturimit të vijës kufizuese të përmendur, në nenin 2 të kësaj rregulloreje. Kjo përfaqëson zhvillimin urbanistik dhe arkitektonik të qytetit, që nga periudha e vonë antike, mesjetare e hershme, e mesme, e vonë dhe përgjatë shek XIX-XX. Në të ruhen ndërtime me vlera për historinë e zhvillimit të urbanistikës dhe arkitekturës së qytetit të Durrësit përgjatë shekujve nga antikiteti deri në ditët e sotme.

Në Zonën tampon duhet të ruhet karakteri i rrugëve e rrugicave të qytetit, karakteri i banesave, volumet dhe proporcionet e tyre me rrugën. Oborret, rrethimet e tyre dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë e vlerave që vijnë nga e kaluara dhe duhet të ruhen në këtë ansambël.

Gjithashtu, duhet të ruhet karakteri i lulishteve të vëna në mbrojtje, gjelbërimi rrugor dhe gjelbërimi në oborret e banesave private. Çdo ndryshim, apo ndërhyrje në drejtim të peizazhit urban (rrugë, trotuare, gjelbërim, ndriçim, dekor, etj.) në Zonën Tampon, duhet të bëhet e studiuar dhe duke ruajtur maksimalisht vlerat e trashëguara nga e kaluara.

Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve, ndërtimeve të reja dhe të çdo ndërhyrjeje tjetër në Zonën

DO NOT COPY

Tampon, hartohen nga IMK, ose subjektet e licensuara për këtë qëllim nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Projektet miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve (KKR).

Neni 11
Zonat e gjelbëruara në Qendrën Historike dhe Zonën Tampon

Zonat e gjelbëruara janë pjesë e peizazhit dhe kompozimit urban të Qendrës Historike dhe Zonës Tampon të qytetit të Durrësit. Në to nuk lejohen ndërtime të reja. Dekori i gjelbër brenda Qendrës Historike dhe Zonës Tampon, qoftë ky privat apo publik konsiderohet, pjesë e vlerave të ansamblit urban dhe, i nënshtrohet mbrojtjes shtetërore sikurse edhe arkitektura e tyre.

Neni 12
Ndërhyrjet në Zonën Tampon

Plani rregullues i Qendrës së qytetit të Durrësit dhe plani i përgjithshëm rregullues i qytetit të Durrësit duhet të respektojnë zonifikimin e zonës tampon dhe rregullat përkatëse të saj. Krahas ndërtimeve me vlera historike, arkeologjike, arkitektonike e urbanistike, që ndodhen në Zonën Tampon, ka edhe ndërtime pa vlerë, të cilat nuk harmonizohen me ato tradicionale dhe përgjithësisht paraqesin nevojën për rikonstruksione, rindërtime, apo riformulime nga ana urbanistike e arkitektonike. Në këtë drejtim këto zona duhet t'i nënshtrohen studimeve të kujdesshme urbanistike e arkitektonike, në bazë të një strategjie të bazuar në ruajtjen dhe evidentimin e vlerave të trashëguara nga e kaluara. Për rrjedhojë në këto zona mund të bëhen ndërtime të reja duke ruajtur shtresat kulturore të nëntokës dhe thellësia e themeleve nuk duhet t'i kalojë 2 metra, rikonstruksione me katet ekzistuese të ndërtimit duke respektuar thellësinë e themeleve ekzistuese, apo adaptime, por të gjitha këto ndërhyrje duhet të respektojnë kriteret, që përcakton kjo rregullore.

Në këto raste vendimet e Këshillit të Rregullimit të Teritorit të Bashkisë duhet të jenë në përputhje me nenin 38 të ligjit nr. 9048, dt. 07. 04. 2003 dhe ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt. 28. 02.08 "Për Trashëgiminë Kulturore".

Neni 13
Infrastruktura inxhinierike

Studimi dhe projektimi i infrastrukturës inxhinierike në Qendrën Historike dhe në Zonën Tampon kryhet nga subjekte të specializuara në bashkëpunim me IMK, ndërsa zbatimi i punimeve kryhet nga persona juridikë të licensuar për këtë qëllim dhe me supervizimin e IMK-së.

Neni 14
Komiteti Mbikqyrës i Qendrës Historike dhe Zonës Tampon

Pranë Bashkisë së qytetit të Durrësit krijohet Komiteti Mbikqyrës i Qendrës Historike dhe Zonës Tampon, i cili është një strukturë këshillimore, jofunksionale, me përfaqësues të njësisë së pushtetit vendor, të I. M. K, të Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës dhe institucioneve të tjera të specializuara. Ky Komitet këshillon dhe u rekomandon strukturave përgjegjëse të qeverisjes vendore masa për përmirësimin dhe arritjen e standarteve kombëtare për miradministrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Durrësit.

Komiteti përbëhet nga 5 anëtarë. Kryetar i Komitetit caktohet një nga drejtuesit e Bashkisë së Durrësit. Rregullorja e funksionimit të Komitetit Mbikqyrës dhe emrat e anëtarëve propozohen nga vetë subjektet përfaqësues në Komitet dhe miratohen me vendim të Këshillit të Bashkisë së Durrësit.

Neni 15
Format e bashkëpunimit

Komiteti Mbikqyrës i Qendrës Historike dhe Zonës tampon të qytetit të Durrësit bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe atë qendror, në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta midis tyre.

Neni 16
Dispozita të fundit

Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit të Qendrës Historike dhe Zonës tampon të qytetit të Durrësit.

INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS

ZONIFIKIMI I QENDRËS HISTORIKE DURRËS



Autor Latif LAZIMI

DO NOT COPY

Latif LAZIMI

DO NOT COPY

RULE FOR HISTORIC CENTER OF DURRES CITY

Article 1

Purpose and Objectives

This rule has the main purpose to define the rules for the administration, protection, preservation and restoration of the Historic Centre and Tampon Area of the Durres city protected by **law No. 9048, date.07-04-2003 change with law No.9882, date.28.02.08, "For cultural heritage".**

Main objective of this rule are:

-Administration of the Historic Centre and Tampon Area of the Durres city, according to the map attached as an integral part of this rule.

-Protection, preservation and restoration of the historical-cultural of the Historic Centre and protection, preservation, restoration and new buildings at Tampon Area of the Durres city.

-Ways of collaboration with the local governor units of Durres city for administration, protection, preservation, restoration and reconstruction of the cultural heritage values which belong to Historic Centre and administration, protection, preservation, restoration reconstruction and new buildings at Tampon Area of the Durres city.

Article 2

Structure of Historic Centre and Tampon Area of Durres City

Historic Centre and Tampon Area of Durres city are considered as the most authentic documents of the development history for this city as a part of Cultural Heritage which are under the **law no. 9048, date.07-04-2003 change with law No.9882, date.28.02.08, "For cultural heritage".** Here are including:

1. **Historic Centre** include:

Territory within the surrounding walls of VI Century of the city and north part of it, when at the late antic era and earlier medieval era has happen the development of the city. At this area concentrated the most social buildings of late XIX century and beginning of XX century and monuments of different type and is spread at these directions:

- Street of Epidamni at both sides here is including also the roads: Thomson Colonel, Mosque, Castle road on the left side and road De Rada on the right side.
- Liberty Square, Dyrrahu boulevard, part of the lefts side at K.Rama, the road Hafiz Podgorica from cross road with Dyrrahu boulevard up to Egnatia boulevard and its continue up to E.Durrsaku road.
- Road Malig Muco up to crossroad of A.Naci road.
- Part of Martyr road, Demokracia square, up to cross road with Dyrrahut Boulevard.

2. **Tampon Area** include:

Territory around Historic Centre and fits with track of the surrounding walls of Durres according to the map attached this rule.

Article 3

Historic Centre

Historic centre is the most valuable part of Durres City; it is protected as a monumental, archaeological, urban and ambient complex. At this area are permitted only restorations and reconstructions of the existing buildings and these of previous ones, which for the different reasons are destroyed and their nonexistence damage urban- architectonic assembles values. At this area except the archaeological monuments discovered underground are also undiscovered monuments. Different individual and social buildings of late XIX and

DO NOT COPY

beginning of XX century with architectonic – urban values are preserved too. Restoring and reconstructing projects and each intervention at this Historic Centre are conducted and allowed by Institute of Culture Monuments (IMK) or licensed subjects for this purpose by the Tourism, Culture, Youth and Sports Ministry (MTKRS). Projects are approved at National Restoration Council (KKR). Revitalization and use of the cultural monuments at Historic Centre for administrative and social-cultural needs or purposes can be allowed but without damage values which are under protection. The permitting paper for each case is taken by IMK and for problematic cases by KKR.

Article 4
Culture Monuments Categories

Monuments of Historic Centre, according to the **law no. 9048, date.07-04-2003 change with law No.9882, date.28.02.08, "For cultural heritage",** are divided two groups according to the value: monuments of the First and Second category. This is done with the purpose of focusing the difference of their values linked with the conservation intervention methods.

Article 5
First Category Monuments

First Category Monuments (FCM) are the most valuable architectural, historical, different types, categories and evolution monuments which are preserved at Durres City. These are or at Historic Centre or at Tampon Area but may be and out of these areas. No changes are permitted at this type of monuments changes which can effect at volumes compositional, architectonic treatment of external and internal views, functional and charts solutions, special architectural elements and their substitutes with original materials. Adoptions can be done at very special cases and these will be reversible. FCM are and also the cobblestones, surrounding walls, pavements, greenness, lightning and other elements of the urban view of the Historic Centre

Article 6
Second Category Monuments

Second Category Monuments (SCM) are all the other buildings which remain after exclude the FCM, which are within the borders of Historic Centre and these declared like this at Tampon Area. Historic Centre of Durres city the external view of buildings established on a chain form at a side of a roads are treated as FCM. These monuments can allow changes or internal adoptions with idea for more rational and comfort solutions by using for this purpose and structures the nowadays material with the main condition to do not change their external view. Small adoptions can permitted at secondary view of façade at special cases according to the studies conducted by IMK. External of monuments of second category can preserve when characteristic environment, decorations and architectonic valuable furniture exist.

Article 7

Interventions at Historic Centre

Layout of Durres city centre and General Layout Regulator Plan of Durres city must respect borders of Historic Centre. Existing buildings which are established at Historic Centre and these are not fitted with its character, and these damage traditional values of ensemble can have adaptive interventions on their volumes. Treatment of facades must have the main point unification of urban – architectonic character of the city; these will not have more floors than buildings which have architectonic-urban values close to them. Foundations will be no more than 2 meters deeper. Some unfinished buildings are at this area will finish on highness after studies which will define architectonic treatment and allowed constructive parameters. Some studies must do for building up the fabrics which will be according urban-architectonic parameters of constructions close to them. These fabrics must no more than 2-3 stores and no more than 2 meters depth. Some special cases like of Durres amphitheatre as a unique monument, must allow destroy of the buildings which are built between years on the amphitheatre outline.

The amphitheatre is established lower than terrain surface of the buildings. These interventions must be in accordance of law no. 9048, date.07-04-2003 change with law No.9882, date.28.02.08, "For cultural heritage". On these cases the decisions of Territorial Regulation Council of city hall must be in accordance

with article 38 law no. 9048, date.07-04-2003 change with law No.9882, date.28.02.08, "For cultural heritage" Studies and designs for the above interventions at Historic Centre, are compiled by IMK, or the physical or juridical persons licensed for this purpose from MTKRS. Projects are approved by **KKR.**

Article 8
Studies and restore projects for FCM and SCM.

Studies and restoring projects for the FCM and SCM are designed by IMK, and also from the physical or juridical persons licensed for this purpose and approved by **KKR**

Article 9
Apply of the restoration, reconstruction projects at FCM and SCM.

Applying of the restoration, reconstruction projects at FCM and SCM are designed by IMK, and also from the physical or juridical persons licensed for this purpose and approved by **KKR**

Article 10
Tampon Area

Tampon area is all area around the Historic Centre, which is with in the border outline mentioned at Article 2 of this rule. This represents architectonic and urban development since the late antic era, early; middle; late medieval era, and continuously centuries XIX-XX. Building with values for history of architecture and urban development of Durres city up to nowadays are preserved at this area. Tampon Area should preserve the character of streets and alleys of the city, building character, volumes and their proportions with the road. Yards and their fencings, accessory buildings are part of values which has come from the past and will preserve at this ensemble. The character of landscape under protection must preserve, road and private house courtyard greening must preserve too. Every change or intervention on the direction of urban environment (roads, pavements, greengages, illumination, décor etc.) at Tampon Area must be studied by preserving maximally the heritage values from the past. Studies and reconstruction designs, new buildings and each intervention at Tampon Area, are designed by IMK, and also from the physical or juridical persons licensed for this purpose from MTKRS. Projects are approved by **KKR.**

Article 11
Greening areas at Historic Centre and Tampon Area

Greening areas are part of panorama and urban composition of Historic Centre and Tampon Area which belong to Durres city. No new buildings are permitted. Green décor, private and public within Historic Centre and Tampon Area are considered as part of urban ensemble values and is under state protection like their architecture.

Article 12
Intervention at Tampon Area

Layout of Durres city centre and General Layout Regulator Plan of Durres city must respect borders of Tampon area and its appropriate rules. There are some buildings without any value among the buildings with historic, archaeological, architectonical and urban values which are located at Tampon area. These building are not harmonized with traditional and in general they need reconstructions, rebuilding, or reformulating from the urban and architectonic side. According to this direction these areas must be a subject of carefully urban and architectonic studies, with a base strategy for preserving and evidencing the values heritable from the past. New building can built at these areas by saving the cultural stratums of subterranean and the depth of foundations will not surpass 2 meters, reconstructions with existing floors by respecting the depth of existing foundations, or adaption, but above all these interventions must respect criteria which are determine by this rule. On these cases the decisions of Territorial Regulation Council of city hall must be in accordance with article **38 laws no. 9048, date.07-04-2003 change with law No.9882, date.28.02.08, "For cultural heritage".**

Article 13
Engineering Infrastructure

Study and design of the engineering infrastructure at Historic Centre and Tampon Area is done by

DO NOT COPY

specialized subjects in collaboration with IMK, but implementation of the work will done from juridical persons which have license for this purpose and under the supervision of IMK.

Article 14
Inspecting Committee of Historic Centre and Tampon Area

Close to city hall of Durres will create Inspecting Committee of Historic Centre and Tampon Area which is an advisory structure, non-functional, with representatives of vendor unit power, I.M.K., Regional Directories of Culture Monuments (DRMK) and other specialized institutions. This committee advises and recommends responsible structures of vendor units' measurements for the improving and arriving national standards for well administration, protection and restoring of cultural heritage values of Durres city. Committee has 5 members. Head of committee is one of the leaders of Durres city hall. Functioning of Inspecting Committee and names are proposed by the representative subjects on the committee and are nominated with City Hall Council decision.

Article 15
Collaboration Forms

Inspecting Committee of Historic Centre and Tampon Area of Durres city collaborate with the vendor power organs and central one according to the mutual agreements between them.

Article 16
Closing Provisions

Adding and changes at this rule are done with the proposal of Minister of **MTKRS** and are approved by **Council of Ministers.**

This rule has attached the map of the Historic Centre and Tampon Area of Durres City.

DO NOT COPY

Mustafa ARAPI

DO NOT COPY

ZBULIME MBI AUTORËSINË NË DISA IKONA

Gjatë këtyre dekadave të fundit, studiuesit shqiptarë e të huaj kanë dhënë një kontribut të çmuar në zbulimin dhe evidentimin e vlerave të vërteta të artit ikonografik. Ky ka qenë një rezultat i bashkëpunimit midis specialistëve restauratorë, historianëve, studiuesve të artit dhe të teologëve.

Ishte studiuesja dhe bizantologia Viktori Puzanova, e cila bëri të mundur zbulimin dhe evidentimin e emrit të ikonografit të shquar ONUFRI, e më pas vepra të këtij autori, (birit të tij) NIKOLLËS, e disa autorëve të tjerë të identifikuar nga studiuesi dhe teologu Theofan Popa, Dhorka Dhamo, Hasan Nallbani, Mustafa Arapi, Ylli Drishti, Kliti Kallamata, Lorenc Glozheni, Kristofor Nashari etj.

Kontributi i tyre është shumë i çmuar dhe konstatimet e tyre në lidhje me autorësinë e veprave ikonografike janë të bindshme dhe argumentuese. Por në disa vepra të tjera të ndodhura në fondet e muzeumeve si në atë të "Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar" të Korçës, "Muzeut Kombëtar -Onufri" në Berat dhe të "Muzeut Historik Kombëtar" në Tiranë, mendoj se duhet të rishikohen dhe të bëhen saktësime. Pikërisht artikulli në fjalë ka për qëllim të japë disa konsiderata mbi gjashtë ikona që deri më sot u janë atribuuar gabimisht autorëve anonim, në lidhje me autorësinë dhe që mendojmë t'i paraqesim më poshtë. Në bazë të argumenteve të mia do të bëj të mundur saktësimin mbi autorësinë e këtyre veprave ikonografike.

1. **Ikona "KRISHTI PANTOKRATOR"** ka prejardhjen nga kisha "Shën Kolli", në fshatin Paftal të qytetit të Beratit, me përmasa 100 cm X 81 cm, dhe ndodhet sot në fondin e Drejtorisë rajonale të këtij qyteti (fig. 1).



Fig. 1. Krishti Pantokrator. Kisha Shën Kolli, Paftal - Berat.

Ikona aktualisht i atribuohet dorës së ONUFËR QIPRIOTIT[1]. Krishti Pantokrator është pikturuar sipas skemës tradicionale ku me dorën e djathtë të ngritur deri ne gjoks predikon, ndërsa me dorën e majtë mban librin e shenjtë. Duke vërejtur me kujdes, arrijmë të dallojmë se në sytë e Krishtit, më vonë duhet të jetë bërë ritoko, duke i siluetuar me të zezë dhe duke i ndryshuar karakterin dhe shikimin e syve. Gjithashtu i

[1] Mustafa Arapi. Katalogu *"Percorsi del sacro, icone dei musei albanesi"*.

DO NOT COPY

ka hequr vështrimin gozhdues dhe dramatik që ka pasur shenjtori më parë.

Vetullat janë të harkuara dhe kanë një linjë të mprehtë të cilat mbyllin plotësisht formën dhe volumin duke na kujtuar stilin e ONUFRIT (fig. 2, 3). Pjesët mishtore si e



Fig. 2. Detal. Ikona Krishti Pantokrator. Kisha Shën Kolli, Paftal - Berat.

qafës dhe e duarve realizohen nga një modelim plastik dhe formë të mbyllur. Këto janë disa elemente artistikë të cilat na adresojnë tek mënyra apo stilizimi i parë tek veprat e ONUFRIT. Po kështu manteli i hedhur në krahë të majtë është trajtuar si një filigramë me vija të arta mbi një sfond blu të errët dhe i shoqëruar anash me shkrime të kaligrafisë të tekstit të librit të cilët ngjasojnë me Krishtin Pantokrator të pikturuar prej Onufrit, në ikonën që ndodhet sot në ikonostasin e katedrales së "Shën Mërisë", në kalanë e Beratit (fig. 4, 5).

Në të dy rastet e paraqitura mendoj se është po ajo kaligrafi e realizuar tek shkrimet të cilat janë identike me shkrimet e lëna prej mjeshtrit të madh. Pra, mendoj



Fig. 3. Detal. Onufri. Afresk i Kishës Shën Todhri. Kala Berat



Fig. 4. Detal. Ikona Krishti Pantokrator, Kisha Shën Koll, Paftal - Berat.

se ikona është realizuar prej ONUFRI-t që realizoi pikturën e Valshit dhe të Shelcanit (fig. 6, 7).

2. Ikona "SHËN MËRIA ME KRISHTIN" vjen nga kisha e "Shën Kostandinit dhe Helenës", po në kalanë e Beratit, me dimensione 96 cm x 68 cm dhe ndodhet e ekspozuar prej shumë vitesh në muzeun "Onufri" (fig. 8). Vepra në fjalë nuk i është atribuuar asnjërit prej autorëve ikonografë dhe aktualisht i përket autorëve anonim.

DO NOT COPY



Fig. 5. Detal. Onufri. Krishti Pantokrator.



Fig. 6. Detal. Onufri. Mbishkrimi në pikturën morale të kishës Shën Kolli, Shelsan.

Në katalogun "IKONAT E BERATIT", publikuar në Selanik në dhjetor 2003 me autor Ylli Drishti dhe Leon Cika, ikona prezantohet si vepër e piktorëve anonim duke u nisur njëkohësisht dhe nga studiuesit e këtij muzeu, mendoj se në këtë rast kemi të bëjmë sërish me



Fig. 7. Detal. Onufri. Mbishkrimi në pikturën murale të Kishës Shën e Premtja. Valsh.



Fig. 8. Ikona e Shën Mërisë me Krishtin e Kishës Kostandini dhe Helena. Kala Berat.

një vepër të lënë prej dorës së ONUFRI-t. Elementët artistikë, gama koloristike dhe stilistika na shpien tek ky autor. Të gjithë elementët figurativ realizohen nëpërmjet një vizatimi shumë elegant dhe të saktë. Padyshim ngjyra e kuqe e mantelit të Shën Mërisë është ajo për të cilën shquhet Onufri. Ajo është e plotë, tingëlluese dhe e magjishme. Portreti i Shën Mërisë dhe ai i Krishtit janë të pikturuara me ngjyra të ngrohta dhe me tipare karakteristike të tipizuara prej Onufrit në vepra të tjera. Element i ngjashëm me veprat e tjera të realizuara nga ky autor është kaligrafia e shkrimit, tashmë e njohur nga ky mjeshtër. Në bordurën e mantelit pranë krahut të Shën Mërisë dallojmë atë stil dhe sërish germën "E" të zgjatur dhe elegante e cila përfundon e holluar nga poshtë (fig. 9).



Fig. 9. Detaj i shkrimit te manteli në ikonën e Shën Mërisë, të kishës Kostandini dhe Helena. Kala, Berat .

Edhe veshja e Krishtit Emanuel është e njëllojtë me veshjen e Krishtit në ikonën "Deissis", me shenjtorë të kishës së Evangjelizmos në Berat. Jo vetëm ndërtimi i draperisë, por dhe raporti koloristik i përdorur tek bluza rozë e Krishtit dhe vijat e arta në sfondin vermillion tek hitoni i Krishtit. Po kështu ngjasime vihen re tek aureola e ikonës në fjalë me aureola të tjera tek ikonat e Onufrit të cilat kanë si karakteristika të veçanta katër pikat në mes të sfondi të aureolës dhe dendësinë e pikave përreth (shih artikullin e M.Arapit - Monumentet - 2004 "ONUFER QIPRIOTI, ikonograf i shekullit XVI – XVII ").

3. Ikona "KRISHTI PANTOKRATOR". Në pavijonin e muzeut "Onufri" në Berat ndodhet e ekspozuar prej shumë kohësh ikona Krishti Pantokrator e ardhur nga kisha e "Shën Triadha", me përmasa 51 cm me 72 cm, e datuar në shekullin e XVII (fig. 10).



Fig. 10. Ikona Krishti Pantokrator e kishës Shën Triadha. Kala, Berat.

Vepra ka ardhur deri në ditët tona e dëmtuar gjë e cila vështirëson identifikimin e vlerave të vërteta sidomos në përcaktimin e autorësisë. Në vështrim të parë vepra na adreson jo tek Onufri por në lidhje me shkollën e Beratit. Pra, kemi elemente artistikë që lidhen me artin e Nikollës, të birit të Onufrit. Tiparet e portretit të Krishtit, nofullat së bashku me mjekrën dhe qafën janë më të gjera se sa ato te Onufri (fig. 11,12). Një element i ngjashëm me veprat e tjera të Nikollës është dhe trajtimi i aureolave. Motivet e realizuara me punson metalik mbi sfondin e arit janë një motiv shumë i përdorur prej

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11. Detal. Ikona Krishti Pantokrator e kishës Shën Triadha. Kala, Berat.



Fig. 12. Detal. Nikolla Onufri. Pikturë murale e kishës Shën Mëri Vllaherna. Kala, Berat.

Nikollës, ku motivi kryesor i një pikë qendrore e rrethuar me një linjë të hollë duke u mbyllur me pika të shumta, ndërsa Onufri ka përdorur motivin me katër pika që formojnë kryqin[2] (fig. 13, 13/1, 13/2). Duke u nisur nga këto ngjashmëri mund të them se ikona i përket dorës së NIKOLLËS.

[2] Mustafa Arapi, Revista "Monumentet " 2004, monografi për Onufër Qipriotin



Fig. 13. Detal. Ikonë. (Nikolla Onufri)



Fig. 13/1. Detal. Ikonë. (Nikolla Onufri)



Fig. 13/2. Detal. Ikonë. (Nikolla Onufri)

4. Ikona "KOSTANDINI DHE HELENA" ndodhet e ekspozuar në mjediset e Muzeut Kombëtar Mesjetar të Korçës, me prejardhje nga kisha me të njëjtin emër në Berat, me përmasa 87,5 cm X 58 cm dhe figuron si vepër e Onufrit (fig. 14). Nga argumentet dhe



Fig. 14. Ikona, Kostandini dhe Helena.

krahasimet që do të paraqes mendoj se vepra nuk është realizuar prej Onufrit por prej birit të tij, Nikollës.

Në katalogun "Ikonat e Komitetit Ortodoks në Shqipëri", botuar nga Muzeu Bizantin i Kulturës në Selanik, më 2006, në faqen 74, studiuesja Eugjenia Drakopoulou, këtë vepër ia atribuon Onufrit duke rënë dakord dhe me përcaktimin që i kanë bërë dhe studiuesit e Muzeut Mesjetar të Korçës. Po kështu në katalogun "Ikonat Bizantine dhe postbizantine në Shqipëri", nga studiuesi Ylli Drishti, shtëpia botuese "Da Vinçi", Tiranë 2007, vepra i atribuohet Onufrit[3]. Studiuesja Drakopoulou sjell argumenta dhe krahasime për të na bindur me të njëjtën skenë me atë të afreskut të realizuar prej Onufrit në kishën e Apostujve në Kostur (fig. 15).



Fig. 15. Detal. (Onufri). Piktura murale në kishën e Apostujve, Kostur.

Ndërsa unë do ta shqyrtoja problemin duke e krahasuar njëkohësisht edhe me skenën e njëjtë të realizuar në kishën e Shën Mërisë Vllaherna në Kalanë e Beratit nga Nikolla më 1578 (fig. 16). Pra do të mundohemi të nxjerrim se cila pikturë murale, ajo e Vllahernës apo e Kosturit afrohet më shumë me ikonën tonë. Që të tria kanë të njëjtin ndërtim kompozicional, monumental duke i qëndruar besnik traditës së vjetër të Bizantit dhe që përputhen me atë të ikonës. Por duke e vërejtur me kujdes ikonën dhe afreskun e Vllahernës portretet janë absolutisht përballë përveç shikimit pak të mënjanuar të Shën Kostandinit dhe të Shën Helenës, ndërsa tek afresku i Kosturit përveç shikimit të të dy shenjtorëve edhe kokat e tyre janë pak sa të kthyera nga qendra e kompozimit, pra shohim dy figura pak më të lirshme në krahasim me ikonën dhe me atë të Vllahernës. Duke ndjekur siluetat e përgjithshme të figurave dhe të kryqit të madh, tek të dy pikturat murale shohim sërish ngjasime të ikonës më shumë me atë të Vllahernës se sa me atë të Kosturit (skica 1, 2, 3). Veshja e Kostandinit tek ikona është më e thjeshtë nga veshja e Kostandinit

[3] Në kopertinën e katalogut portreti qendror i Kostandinit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 16. Detal. (Nikolla). Piktura murale në kishën Mëri - Vllaherna. Kala, Berat.



Skica 2. Detal. (Nikolla) Piktura murale në kishën Shën Mëri, Vllaherna.



Skica 1. Ikona Kostandini dhe Helena



Skica 3. Detal (Onufri). Piktura murale në kishën e Apostujve në Kostur.

tek ajo e Kosturit, pasi këtu trupi mbështillet me fashatura të dekoruara të cilat kryqëzohen në tors, mbështillet në brez, kalon në parakrahun e majtë dhe zbret poshtë. Elementin e fashaturës e vëmë re edhe tek

figurat e Gabrielit në skenën Ungjillizimi tek afresket e Shelcanit dhe Valshit (fig. 17, 18). Në lidhje me portretin



Fig. 17. Detal. (Onufri). Afresk në kishën Shën Kolli, Shelsan



Fig. 18. Detal. (Onufri). Afresk në kishën Shën e Premtja, Valsh.

duket qartë se ato të ikonës kanë ngjashmëri më shumë me ato të afreskut të Vllahernës që realizoi Nikolla e pikërisht ajo e Helenës. Që të dyja bartin në vetvete të njëjtën psikologji, një vështrim të përhumbur e të lodhur, me të njëjtat rrudha në fytyrë të cilat tregojnë për moshën e thyer të nënës së Kostandinit. Të dyja mbajnë pothuajse të njëjtën kurorë të kuqe të zbukuruar me pika të bardha, si dhe të njëjtën shami e cila zbret nga supet duke krijuar të njëjtat draperi, ndërsa tek piktura e Onufrit shamia e Shën Helenës lë të zbuluar flokët dhe mbulon vetëm supet. E njëjta gjë ndodh edhe me kurorat mbi kokë, duke u afruar më shumë po me atë të Nikollës (fig. 19, 19/1, 20, 20/1). Sërish motivi i aureolës së ikonave është i njëjti motiv që Nikolla e ka përdorur në shumë ikona të tjera. Duke paraqitur këto argumente në lidhje me ngjashmëritë e tyre mendoj se ikona "Kostandini dhe Helena" është pikturuar prej NIKOLLES.

5. Ikona "SHËN DHIMITRI". Ikona në fjalë është objekt i Muzeut "Onufri" në Berat. Prejardhja nuk dihet, përmban dimensione 43,5 cm X 61 cm, dhe është vlerësuar deri tani si vepër anonime e shekullit XIV.

Në vitin 1993 u ekspozua në Nice të Francës së bashku me një numër të madh ikonash nga Shqipëria (fig. 21). Në katalogun e botuar për ekspozitën "Tresors d'art d'Albanie", Editions de la Réunion des musées nationaux, Paris 1993, ikona e Shën Dhimitrit është emërtuar si e tillë, kur në fakt është shenjtori Shën Gjergji. Nëse shihet me kujdes, në sfond, me shumë vështirësi mund të lexosh emrin e këtij shenjtori. Por nuk mjafton vetëm emërtimi, pasi portreti ka të bëjë me paraqitjen dhe kanunizimet e portreteve të hershëm, qysh nga koha e përcaktimit të tipave nga vetë kisha lindore. Pra Shën Gjergji i ka flokët më shumë të përdredhura se sa Shën Dhimitri dhe vijnë me rrethore përqark kokës. Shën Gjergji është i pikturuar deri në brez dhe me dorën e djathtë mban ushtën, ndërsa me të majtën pak më të ulur ka mbërthyer shpatën të kthyer me majë nga poshtë për të evidentuar njëkohësisht dhe kryqin që formohet nga doreza e shpatës, ndërsa mbrapa në supin e majtë duket një gjysmë mburojë e vogël e lidhur me një rrip në qafë, shenjtori është i veshur me pajime luftarake të lehta duke na imponuar një pamje strategu i cili luftoi dhe dha jetën për mbrojtjen e kristianizmit. Që në pamje të parë ikona na orienton drejt një stili të njohur deri

DO NOT COPY

Do not copy



Fig. 19. Detal. Ikonë. Portreti i Kostandinit.



Fig. 19/1. Detal. Ikonë. Portreti i Helenës.



Fig. 20. Detal. (Nikolla). Pikturë murale. Portreti i Kostandinit në kishën Shën Mëri, Vllahern.



Fig. 20/1. Detal. (Nikolla). Pikturë murale. Portreti i Helenës në kishën Shën Mëri, Vllahern.

më tani, e pikërisht ajo na shpie sërish tek atelieja e Beratit dhe e realizuar pikërisht nga Nikolla në shekullin XVI. Për të krahasuar dhe për të gjetur elementë të ngjashëm me këtë ikonë do të marrim një ikonë të ndodhur në fondin e Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës në Berat, ikonë e cila i atribuohet me të drejtë Nikolla Onufri-t (fig. 22). Në të është pikturuar Shën Dhimitri i cili ka të njëjtin kompozim, të njëjtën rekuizite, veshje armësh, por dhe suporti i drurit ku është pikturuar ikona është pothuajse e njëjtë me ikonën e Shën Gjergjit. Domethënë, pasi mbaron kufiri i sipërfaqes së pikturës të strategut mbyllet me një gërshet të gdhendur dhe vazhdon me një sipërfaqe të rrafshët dy herë më e gjerë se gërsheti. E njëjta gjë ndodh edhe me ikonën e Shën Gjergjit por me një ndryshim të gërshetit i cili mbyll në formë harku pjesën e sipërme të kuadratit të sipërfaqes së pikturës, një element i përdorur në shumë ikona prej Nikollës.

DO NOT COPY



Fig. 21. Ikonë. Shën Dhimitri (?)

Elementet stilistik që shoqërojnë të dyja veprat, trajtimi plastik i portreteve, dramaticiteti që pasqyrohet tek shenjtorët, korrektësia në modelimin e plastikës së portreteve dhe të dritëhijeve, realizimi i miniaturave me mjaft saktësi dhe elegancë, si dhe motivi i njohur tek aureolat e ikonave të tjera na shpien tek mjeshtri NIKOLLA të realizuar në shekullin e XVI.

6. Ikona "SHËN MËRIA". Është objekti i fondit të muzeut të Korçës. Vjen nga ikonostasi i kishës "Shën Kolli" të fshatit Perondi të Beratit, me dimensione 80 cm X 61 cm. Deri më tani vepra ndodhet e ekspozuar në mjediset e pavijoneve të këtij muzeu duke u vlerësuar me të drejtë nga studiuesit e saj si ikonë e shekullit të



Fig. 22. Shën Dhimitri. Ikonë. (Fond i DRKKS, Berat).

XVI por e realizuar nga ikonografë anonim. Po kështu ajo figuron në katalogun e ekspozitës hapur në muzeun Marc Chagall të qytetit të Nice-s në Francë me titull "Tressors d'arts d'Albanie". Padyshim kemi të bëjmë me një vepër të realizuar në shekullin XVI, në atelienë e Beratit (fig. 23).

Stili i pikturimit, kompozimi i figurës së Shën Mërisë me Krishtin në lidhje me raportet hapësinore dhe e mbyllur nga sipër, mbi aureolë me harkadën e njohur dhe formën e dy rrathëve brenda hapësirave të trekëndëshave, trajtimi i plastikës së portreteve dhe tipit të portretit të Shën Mërisë i arritur nga kontrastet e fortë të dritëhijeve dhe të modelimit të pjesëve të mishta, pikturimi me ngjyra të theksuara të veshjeve të Shën Mërisë si dhe motivi i aureolave janë elementë artistikë të ngjashëm me shumë vepra të tjera të NIKOLLËS. Pra mendojmë se edhe kjo vepër është e realizuar nga NIKOLLA.

Fotot dhe skicat nga AUTORI

DO NOT COPY







Fig. 23. Ikonë. Shën Mëria me Krishtin. Kisha e Shën Kollit, Perondi - Berat.



Mustafa ARAPI

NEW DISCOVERIES OF SOME ICONS

DO NOT COPY

During these last decades, Albanian and foreign researcher has given a notable contributed for discovering and evidencing the real values of iconography art.

Byzantine Viktori Puzanova , who made discovering and evidencing the name of famous iconographic ONUFRI, and after works of him and his son, also of some other authors identified by researcher and theologies Theofan Papa, Dhorka Dhamo, Hasan Nallbani, Mustafa Arapi, Ylli Drishti, Kliti Kallamata, Lorenc Glozheni, Kristofor Nashari etj.

Some other works saved at different museums like Korce "National Museum of Mediaeval Art", Berat "National Museum Onufri" and Tirana "National Historic Museum" should revise and clarified.

1. ***"Pantocrator* Christ" Icon** Has come from "Shen Kolli" church, at Paftal village, from Berat city with measurements 100 cm x 81 cm and is established at Berat, Regional Directory of Culture Monument (DRMK) (photo 1).

Icon belong has come from hand of Onufer Qipriotit. Pantocrator Christ is painted according to the traditional scheme when at the right hand raised up to the chest and sermon, but on left hand keeps the holy book. Eyebrows are arched and have a precise line that closes totally form and volume by reminded Onufri style. Meaty parts like neck and hands are realised by a plastic model with close form.

These are some artistic elements that address at manner or first style of Onufri work. Mantle wrapped at left arm is treated as filigree with golden lines over dark blue wallpaper; on the side is writings calligraphy of the text book which is similar to Pantocrator Christ painted by Onufri. Two chases presented according to my opinion belong to the same calligraphy realised at writings that are the same with writings left from famous master.

2. **"Saint Maria with Christ" Icon.** Comes from the church of "Saint Constantine and Helen" at Berat castle with measurements 96 cm x 68 cm and is exhibited at "Onufri" museum from many years.

Artistic elements, colourists kind and stylistic directed at this author. The red colour of Saint Maria mantle is that one for which Onufri is distinguished. She is complete, sonorous and magic. Onufri paints Saint Maria and Christ portrait with warm colours and characteristic features that are typical at other works. Mantel strip close to the arm of Saint Maria has the same style and again letter "E" longed and elegant which ends thin from the bottom. Emanuel Christ has the same wearing with the Christ at "Deissis" icon and saints of the "Evangjelizmos" at Berat. The icon aureole is similar with other aureoles at Onufri icons that have as special features four full stops in the middle of aureole wallpaper and full point density around.

3. ***"Pantocrator* Christ" Icon**. Pavilion of "Onufri" museum at Berat city is exhibited from many years the Pantocrator Christ" Icon came from "Holy Trinity" Church with measurements 51 cm x 72 cm dated on the XVII century. First point of this works does not address at Onufri but is linked with Berati School. Some artistic elements are linked with the art of Nikolla, Onufri's son. Motives realised with metallic spike over the gold wallpaper are the kind of motives very used by Nikolla when main motive of a central point circled from a thin line by closing with many points. These similarities certify that this icon is painted by Nikolla hand.

4. "Constantine and Helen" icon. Is exhibited at "Medieval National Museum" of Korca, it has come from the church of the same name in Berat with measurements 87.5 cm x 58 cm and is classified as Onufri work. Catalogue of "Icons of Orthodox Community in Albania published on 2006, researcher Eugenia Drakupolu this work dedicates Onufri, accepting definition done from specialists of "Medieval National Museum" of Korca. I will study this problem by compare the same scene realised by Nikolla at 1578 on "Saint Maria Vllaherna" at Berat castle. (Photo16)

There are more similarities of icon with Vlaherna than these of Costur if we compare two general figure silhouettes and great crux at mural paintings. Constantine wearing is simpler than these of Costur, because the body is wrapped with decorated strips which are crossed at chest, wrapped at belt continue at forearm and go down.

Icons aureole motive again is the same motive that Nikolla has used at some other icons.

I think that the "Constantine and Helen" icon is paint by Nikolla byn representing these arguments linked with their similarities.

5. "Saint Dhimitri" icon. Is object of "Onufri" museum at Berati. It has unknown origin and measurements are 43.5 cm x 61 cm and up to now is evaluated as anonymous work of XIV century.

The Published catalogue for exhibition "Tresors d'art d'Albani", Editions de la Reunion des musees nationaux, Paris 1993, Saint Dhimitri icon is named as it is, but in fact is Saint George saint. If it is looked carefully, on wallpaper, with lot of difficulties can read the name of this saint.

Stylistic elements which are at two works, plastic art of portraits, dramatically represented at two saints, correctness with plastic art of portraits and chiaroscuro, miniatures realisation with accuracy and elegance and well known motive of other icons aureoles clarify realisation by master Nikolla on XVI century.

6. "Saint Maria" icon. Is object of museum at Korca. Comes from iconostasis of "Saint Kolli" church of Perondi village at Korca, with measurements 80 cm x 61 cm. Painting type, composition of figure of Saint Maria with Christ in correlation with spaces reports closed from upper, over aureole with known arcade, and two circles form within spaces of triangles, plastic art treatment of portraits and type of Saint Maria portrait arrived with strong contrasts of chiaroscuro and modelling of meaty parts, painting with strong colours of saint Maria dresses and aureole motive are similar artistic elements with lot of Nikolla works. We think that Nikolla paints this works.

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

PARLAMENTI I PARË SHQIPTAR

Tirana nuk bën pjesë në qytetet më të vjetra të Shqipërisë, megjithatë ajo ka një histori 400 vjeçare, që ka lënë gjurmët e veta në këtë qendër urbane.

Transformimet rrënjësore të strukturës urbanistike të qytetit, sidomos gjatë gjysmës së dytë të shek. XX, sollën për pasojë zhdukjen e monumenteve të veçanta, por edhe të ansambleve të tëra arkitektonike me vlerë. Për këtë ajo çfarë ka mbetur nga dëshmia arkitektonike dhe historike e së kaluarës, na rrit më tepër përgjegjësinë për ta ruajtur me vendosmëri më të madhe.

Në dekadat e para të shek. XX, u krijuan gjithashtu vlera të reja arkitektonike për qytetin, objekte që i përkasin një arkitekture të larmishme, me tipare stilistike dhe dekorative të papërsëritëshme në kohën tonë, pjesë përbërëse e historisë dhe vlerave artistike dhe ndërtimore të qytetit. Në këtë grup bën pjesë dhe godina e Parlamentit të parë shqiptar, e cila përveç të tjerash mbart edhe vlera të veçanta historike, pasi shënon fillimin e parlamentarizmit shqiptar.

Studimi historiko-arkitektonik i këtij objekti i shërben ndër të tjera, rigjallërimit të tij, duke kontribuar që nëpërmjet restaurimit ta sjellë këtë monument sa të jetë e mundur, më afër formës që kishte në periudhën më të rëndësishme historike të tij, kur ai shërbente si parlament shqiptar. Duke vlerësuar si rëndësinë historike të godinës, ashtu edhe vlerat e saj arkitektonike, të fshehura nga shtesat dhe adoptimet e mëvonshme pa vlerë. Studimi është bazuar në gjurmimin e fazave ndërtimore, nëpërmjet zbulimit në vend të gjurmëve origjinale, si dhe në shfrytëzimin e dokumentacionit historik, përshkrimor, grafik, dhe fotografik që gjendet në Arkivin Qëndror të Shtetit, në Arkivin e Ndërtimit si dhe në revista e botime të tjera të kohës.

Gjej rastin të falenderoj Z.Kastriot Dervishi, i cili me bujarinë më të madhe më ofroi një numër të konsiderueshëm fotosh të vjetra të kësaj godine, të gjurmuara prej tij me mundim në Arkivin Qendror të Shtetit si dhe Znj. Mirela Korriku, e cila punoi me përkushtim dhe durim në grumbullimin e dokumenteve të shkruara në këtë arkiv.

Studimi historiko-arkitektonik i monumentit

Historia e godinës së Parlamentit të parë shqiptar e ka zanafillën në vendimet e Kongresit të Lushjes, që u mbajt më 21 Janar 1920.

Vendimet e këtij Kongresi ishin një rishpallje e pavarësisë, për shkak të vënies në diskutim të njohjes zyrtare të Shqipërisë, me kufijtë e vitit 1913, nga fuqitë e mëdha të pas Luftës së Parë Botërore .

Kongresi me vendimet e tij, konfirmoi sovranitetin e brendshëm dhe të jashtëm të vendit, tejkaloi traktatet që përfundimi i luftës i kishte shfuqizuar dhe anulloi marrëveshjen e protektoratit ndaj Italisë të vitit 1919.

Ajo që lidhet drejtpërdrejtë me ndërtesën në fjalë është shpallja e Tiranës, kryeqytet i Shqipërisë më 11 Shkurt 1920, gjë që bëri të domosdoshme ngritjen e një godine moderne dhe funksionale për zhvillimin e veprimtarive të një parlamenti, siç ishte në këtë rast Parlamenti i parë Shqiptar.

Kongresi i Lushnjes zgjodhi "Këshillin e Naltë„ dhe "Senatin", që përbëhej nga 37 anëtarë të zgjedhur nga Kongresi, sipas delegatëve të prefekturave, 1 për 20.000 banorë. Senati nuk luante rolin e dhomës së lartë të Parlamentit ,por të vetë Parlamentit. Për këtë arsye për të mos sjellë keqkuptime, në mbledhjen e katërt të Senatit më 3. 3. 1920, ai u quajt "Këshilli Kombëtar" duke mbajtur këtë emër deri në Janar 1924, në prag të zgjedhjes së Asamblesë Kushtetuese.

Parlamenti i parë shqiptar (i quajtur Këshilli Kombëtar), në pritje të ngritjes së një ndërtese të përshtatshme, i zhvilloi mbledhjet e para në një godinë provizore, të papërshtatshme për funksionet e një Parlamenti, siç ishte ndërtesa ku ndodhet sot selia e Akademisë së Shkencave.

DO NOT COPY

Përpjektjet për ngritjen e një ndërtese për parlamentin shqiptar të quajtur "Pallati Parlamentar"(1923-1930).

Që në vitet e para, pas vendosjes së qeverisë në Tiranë, u bënë përpjekje për ngritjen e një ndërtese të re për Parlamentin shqiptar, e cila sipas skicës së paraqitur, bashkëngjitur detyrës së projektimit do të ishte e denjë për një kryeqytet europian (Fig.1). Shkresa e ministrit të brendshëm, që i drejtohet Ministrisë së Punëve Botore



Fig.1. Planimetria e "Pallatit Parlamentar"

e Bujqësisë, mban datën 4 Shkurt 1923. Në të i kërkohet kësaj ministrie përgatitja e projektit në dy variante. Shpenzimet do të përballoheshin nga donacione, që do të jepte populli i Tiranës. Ndërtesa quhej "Pallati Parlamentar" dhe programi i tij përmbante një sallë me shkallare të harkuar për 150 vetë, si dhe llozha për këshillin e lartë, ambasadat etj., si dhe shumë ambiente të tjera, ku përfshihej biblioteka, arkivi, dhoma e policisë, sallë për shtypin, bufe etj. Zërat e detyrës së projektimit qenë përkthyer me shkrim dore në gjermanisht, që tregon se arkitekti do të ishte me shumë gjasa austriakë ose gjermanë. Në skicën e projekt - idesë shënimet ishin, gjithashtu gjermanisht. Nga korrespondeca e gjerë që duhet të ekzistonte për ndërtimin e "Pallatit Parlamentar" janë ruajtur vetëm tri shkresa, që mbajnë siglën e Bashkisë, Ministrisë së Punëve Botore dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe kapin vitet 1923 -24. Veç tyre, hetohet dhe një shënim i shkurtër i vitit 1930. Nga problemet që shtrohen në këto shkresa janë për t'u përmendur planvendosja dhe përshtatja me arkitekturën tradicionale përreth, gjë që tregon se nuk bëhej fjalë për një vend pranë godinës së sotme të Parlamentit të parë, por për një zonë të banuar dhe më pranë pazarit, ndoshta pranë Xhamisë së Karapicit, e cila më vonë u zëvendësua me godinën e bashkisë së qytetit. Nga korrespondenca del gjithashtu, se për të ndjekur ecurinë e ndërtimit të "Pallatit Parlamentar" ishte krijuar një komision, i përbërë nga 3 deputetë, 3 inxhinierë dhe 2 qytetarë të Tiranës, nën kryesinë e Prefektit ose Nënprefektit. Në përgjigje të një shkrese të Bashkisë me dt. 26.07.1924, nënkryetari i këtij komisioni Ismail Ndroqi, i kërkon asaj bashkie që brenda një muaji të përgatisë projektin e Pallatit Parlamentar ose në pamundësi t'i drejtohej Ministrisë së Punëve Botore, pasi mbledhja e fondeve ishte e lidhur me projektin. Ëndrra për ngritjen e një godine të madhe për Parlamentin vazhdoi deri në vitin 1930 ku në një shënim që mban datën 15 .01.1930, ku thuhet se salla e konferencës do të ishte për 300 vetë. Për mungesë dokumentacioni të mjaftueshëm, nuk dihen shkaqet përse ky projekt nuk u realizua.

Godina e parlamentit të parë shqiptar

(Përshtatja e "Klubit të oficerave" në seli të parlamentit).

Ndëkohë që bëheshin përpjekje për ngritjen Pallatit Parlamentar, në vitin 1924 nga ushtria shqiptare e asaj kohe, kishte filluar të ngrihej një ndërtesë për oficerat që u quajt "Klubi i oficerave". Në një letër të Ministrisë së Luftës të datës 2. 07.1924, që i dërgohet Ministrisë së Punëve Botore, kërkohet një inxhinier i zoti për të kontrolluar godinën që po ngrihet në fushën e Shallvareve për klub oficerash, gjë që tregon se bëhet fjalë për ndërtesën në shqyrtim, që u kthye më vonë në seli të Parlamentit shqiptar. Në anë të letrës shënohet me shkrim dore në gjermanisht "Lutemi për një

inxhinier". Nga korrespondenca kuptohet se themelet e ndërtesës ishin ndërtuar para kësaj date. Në letrën e Ministrisë së Luftës thuhet se themelet e godinës në fjalë deri në sipërfaqen e tokës janë prej guri e prej këndej e lart muri po vazhdon me tulla. Me që boshllëku brenda mureve do të mbushej me dhe, deri në 1 m dhe, pastaj do të shtrohej me çimento, dyshohej se muret prej tulle do të fusnin lagështi nga toka. Nga letra del se tullat prodhoheshin nga ushtarët (gjatë gërmimeve për rikonstruksionin e skenës, në vitin 2003, kanë dalë tulla të asaj periudhe, që kanë rezultuar shumë rezistente). Në shkresën dt. 14.08.1924, që Ministria e Punëve Botore dhe Bujqësisë i dërgon Ministrisë së Luftës, jepen udhëzime për vazhdimin e mëtejshëm të punimeve. Dokumenti është shkruar fillimisht në gjermanisht me dorë dhe pastaj është përkthyer dhe daktilografuar. Aty thuhet se është biseduar me drejtorin e Punëve Botore Z. Baurat (nëpunësi më i lartë ndërtimeve të Dikasterit) Beck dhe Zotërinjtë Major Rexhep Berati, Kapiten Kodheli dhe Ing. Vaja. Z. Beck (gjermanisht folës, ndoshta austriak), duket se është shkruesi i letrës në gjermanisht. Në të jepen udhëzime për lartësimin e themeleve të paktën 50 cm, të vendosej një shtresë eterniti për izolim midis murit të themelit dhe atij që vazhdon mbi të. Në ato vende ku ky izolim nuk mund të bëhet, gjë që tregon se muret ishin ngritur), mureve nga brenda t'u vishej një faqe çimentoje. Duke patur prasysh tullat e dobta të themelit duhej që vëllimi deri në nivelin e dyshemesë të lihej në boshllëk ose të mbushej brenda perdeve me gurë të rreshtuar. Në themele duhet të liheshin gjithashtu vrima për ajrosje. Në pamundësi të ndërtimit të një godine tjetër më të madhe e më të përshtatshme, për parlamentin, "Klubi i Oficerave" u përshtat si i tillë dhe kreu funksionet e godinës së parlamentit deri në pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste më 7 Prill 1939, kur ky i fundit u suprimua nga pushtuesit.

Për dekorimin e godinës së Parlamentit, atëhere Pallati i Senatit interesimi filloi që nga viti 1925.

Në një Notë Verbale, Nr.48 të datës 23 janar 1928, që ambasada gjermane në Tiranë ia drejton Ministrisë së Punëve të Jashtme, thuhet se inxhinieri Robert Vaja, në vitin 1925 ka marrë nga firmat gjermane "Ehrenbauer & co" dhe "Schwäbische Möbelindustrie" skica dhe projekte për dekorimin e „Pallatit të Senatit" të cilat z. Vaja siguron se i ka dorëzuar në Sekretarinë e Senatit. Legata gjermane kërkon që këto skica e projekte t'u kthehen firmave të sipërshënuara, të cilat kanë vlerë për to, dhe thuhet se nuk është bërë konkurs midis tyre. Kjo ngjarje përkon me fillimin e dekorimit të brendshëm të Parlamentit, që u realizua me rastin e themelimit të Mbretërisë Shqiptare, e cila u shpall në këtë ndërtesë në 1 Shtator 1928. Dekoracinet e godinës së Parlamentit ku përfshiheshin dhe simbolet e mbretërisë shqiptare, ruheshin akoma edhe kur pas pushtimit italian, ndërtesa u kthye në seli të Këshillit të Epërm Fashist Korporativ (Fig.2). Por tani pjesa dërrmuese e tyre nuk ruhen më.



Fig. 2. Parlamenti. Pamje e sallës gjatë periudhës së pushtimit fashist, ku shihet stema e Mbretërisë shqiptare në murin mbi skenë.

Në vitin 1931 kishte përfunduar ndërtimi i kompleksit të ministrive. Në këtë kohë, ose rreth vitit 1930, u bë dhe një rikonstruksion i godinës së Parlamentit. Me këtë rast u hoq kupola, si dhe u rikonstruktuan të gjitha çatitë e ndërtesës, të cilat nga veshja me pllaka eterniti mbulohen me tjegulla marsejeze. Gjithashtu, prishen pjesët e hapura të krahëve të rrethuara me parmakë balaustrash dhe, rikonstruktohen të gjitha dritaret. Dritaret sillen në stilin e kohës dhe iu shtohen grilat. Në të dyja anët e çatisë së korpusit qëndror, nga tre tymtarë për secilën anë lihen vetëm dy. Të gjitha këto ndryshime kuptohen nga një foto e kohës ku krahas godinës së Parlamentit shihen edhe ministritë e sapo ndërtuara (Fig.3), ndërsa në një foto të vitit 1929 (Fig.8) ndërtesa e Parlamentit na paraqitet me kupolë, ashtu si në vitin 1925 (Fig.10) dhe 1926 (Fig.4). Ndryshime më të vogla duhet të ketë patur edhe në interier.

DO NOT COPY



Fig. 3. Godina e Parlamentit e rikonstruktuar në vitin 1930, pranë kompleksit të ministrive të papërfunduar.(Ndërtimi i kompleksit të ministrive përfundoi në vitin 1931).



Fig. 4. Parlament. Pamje nga V-perëndimi. 1926

Më i dukshëm prej tyre është zvogëlimi i llozhës jugperëndimore, e cila ndryshe nga të tjerat kishte një hyrje përballë korridorit. Kjo llozhë kryesore ku rrinte personaliteti më i lartë, u unifikua me të tjerat nëpërmjet zgjatjes së korridorit në dëm të sipërfaqes së llozhës dhe u hap një portë anësore. Me këtë rast u eleminuan edhe shkallët e veçanta, që komunikonin me llozhën nëpërmjet një ambienti të veçantë. Në krahët anësore të jashtme u mbyllën portat ballore dhe u eleminuan shkallët. Komunikimi me këto ambiente bëhej vetëm nëpërmjet dyerve të brendshme. Ndryshime u bënë edhe në brendësi të ambientit të krahut të jashtëm lindor, ku ishin WC- të. Gjithashtu u eleminuan edhe dy ndarje të vogla në të dy anët e hyrjes kryesore brenda sallonit. Të gjitha këto ndryshime shihen në një planimetri shoqëruese të një libreze masash të vitit 1941, por që pasqyronte gjendjen e ndërtesës së paku pjesërisht me ndryshimet e bëra që në vitin 1930.

Me këto ndryshime godina e Parlamentit humbi shumë nga pamja fillestare, po aq sa dhe nga vlera



Fig. 5. Parlamenti. Planimetria në vitin 1941.

arkitektonike, duke u kthyer në një ndërtesë më se të zakonshme, ndoshta nga që vazhdonte të ushqehej ideja e ndërtimit të "Pallatit Parlamentar".

Libreza e masave e vitit 1941, u referohet punimeve të kryera, të cilat konsistonin në lyerjen e ambienteve të brendshme, dyerve, dritareve dhe grilave. Muret janë lyer me bojë çimentato dhe në një pjesë të tyre, në ato më të rëndësishmet, është përdorur edhe përzjeria me tutkall.

Ndërtesa u përdor rregullisht jo vetëm si sallë për seancat parlamentare, por në periudhat ndërmjetëse ka funksionuar edhe si vend takimesh qeveritare me trupin diplomatik apo takime jubilare të shoqëruara me koncerte të muzikës së kultivuar. Nga programi i përcaktuar për godinën e re të Parlamentit që do të ndërtohej, ish "Klubi i oficerave" kishte të përbashkët 6 llozha të cilat ishin caktuar për Këshillin e lartë, (Fig. 6, 23) Këshillin Ministerial, për ambasadorët e huaj, për vizitorët e huaj, për korrespondencën e shtypit të brendshëm e të jashtëm dhe për nëpunësit e lartë.

Gjithashtu godina ekzistuese kishte një numur të përafërt vendesh në sallë, por i mungonin shumë mjedise të tjera të parashikuara në projektin e Pallatit Parlamentar.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig.6. Parlamenti. Pamje e brendshme sallës në kohën e pushtimit fashist.

Pas suprimimit në vitin 1939, të institucionit të parlamentit, godina u kthye në Dhomën e Fashios (Seksioni për Shqipërinë) dhe më vonë në selinë e Këshillit të Epërm Fashist Korporativ (Fig.6). Nga kjo kohë ekziston edhe një projekt që synonte transformimin e 6 llozhave të vendosura në të dy anët e sallës së ndërtesës të parlamentit për t'i përshatur ato për nevojat e selisë së Fashios (Fig.7). Projekti konsistonte në zmadhimin e llozhave nga pjesa e mbrapme duke u dhënë atyre një formë drejtkëndëshe, gjë që do të kërkonte krijimin e një korridori të ri, i cili do të komunikonte me secilën nga llozhat nëpërmjet hyrjeve të veçanta. Nga vrojtimi në vend i ndërtesës rezulton që ky projekt të mos jetë realizuar.

Në vitet 1950-1957 godina e parlamentit shërbeu si qendër kulture e sovjetikëve (Klubi i miqësisë shqiptaro-sovjetike), i njohur nga populli si "Klubi i sovjetikëve". Në vitin 1960- 61 godina u përshtat në teatër kukullash, funksion të cilin e ruan edhe sot.



Fig.7. Parlamenti. Planimetria dhe prerja gjatësore e sallës kryesore, në kohën kur ndërtesa u kthye në Dhomën e Fashios.

Në këtë qytet relativisht të ri, siç ishte Tirana, të shpallur kryeqytet të Shqipërisë, Godina e parlamentit të parë shqiptar, në cilësinë e Klubit të oficerave, është nga të parat godina me karakter administrativ e shoqëror, në stil europian perëndimor, të ndërtuara në Tiranë në vitet 1920- 1924. Para saj në grupin e arkitekturës moderne bënte pjesë ndërtesa ku zhvilloi mbledhjet e para Këshilli Kombëtar, e ngritur më 1895 dhe banesa e Kajmekamit. Deri atë kohë mbizotëronte arkitektura tradicionale me tipare ballkanike dhe orientale. Vetëm në vitet që pasuan, pati një bum ndërtimesh të stilit europian perëndimor. Por godina e Parlamentit ndryshon nga shumica prej tyre të orientuara kryesisht nga arkitektura italiane e kohës apo të stileve më të vjetra, siç ishte neoklasicizmi etj. Ajo mbetet e veçantë pasi orientohet nga arkitektura e vendeve gjermanike, pak e përhapur në Shqipëri. Një paralelizëm i përafërt mund të bëhet me ndërtesën e prefekturës së Shkodrës, e ndërtuar nga austriakët rreth vitit 1900. Të dyja ndërtesat kanë të përbashkët çatitë e larta, si dhe ballkonet e mbështetura mbi shtylla drejtkëndëshe, të shoqëruara në pjesën e pasme nga salla të gjera.

Për t'i dhënë më tepër monumentalitet ndërtesës, mbi çati u ndërtua një kupolë mbi një tambur shumëkëndësh në stil barok. Parapeti i ballkonit dhe rrethimet e ambienteve anësore theksohen nga pilastra blloqesh drejtkëndëshe masive të shkallëzuara, që ngrihen mbi

lartësinë e vargut të balaustrave. Të njëjtin efekt bëjnë dhe dritaret e mëdha me kanate të ndara me kuadrate të vogla dhe linja të kryqëzuara (Fig. 8, 25, 27). Të njëjtit qëllim i shërbenin edhe disa dekoracione plastike të thjeshta që theksojnë pjesën e sipërme të pilastrave midis dritareve dhe kollonat drejtëkëndëshe, por që jo kudo ia arrijnë qëllimit (Fig.15,19, 25, 27).



Fig. 8. Parlamenti. Pamje nga Veri-lindja. 1929.

Pozicioni i godinës në raport me planet urbanistike

Themelimi i qytetit të Tiranës në vendin ku ndodhet sot ishte rezultat i nevojës së lindjes së një tregu në zonën e begatshme bujqësore rreth tij. E favorizuar nga një pikë nevralgjike e kryqëzimit të rrugëve tregtare, që lidhnin veriun me jugun, lindjen me perëndimin, si dhe nga kushtet e përshtatshme natyrore për zhvillimin e një qyteti.

Ekonomia bujqësore vazhdoi të luante një rol të rëndësishëm në jetën e qytetit. Në shekujt e parë të jetës së tij, qyteti u zhvillua në terrenin e sheshtë që shtrihej midis Lanës dhe lumit të Tiranës. Banesat ishin të veçuara nga njëra - tjetra dhe rrethoheshin me kopshte të mëdha. Nga ana urbanistike qyteti u zhvillua si qendër mesjetare e tipit lindor, me rrugë të lakuara që i nënshtroheshin spontanitetit, por që gjithsesi më kryesoret prej tyre drejtoheshin nga qendra ku ndodhej pazari.

Një planimetri e qytetit e vitit 1916, (Fig. 9), pra para shpalljes së tij kryeqytet, pasqyron qartë karakterin



Fig. 9. Plan i qytetit të Tiranës, hartuar nga austriakët. 1916.

mesjetar të urbanistikës së qytetit, të trashëguar që nga koha e themelimit të tij. Në këtë planimetri përveç banesave dhe pazarit janë shënuar 8 xhami si dhe 2 kisha. Shumica e monumenteve të kultit grumbullohen rreth qendrës. Kisha Katedrale ortodokse, që ndodhej në fillim të rrugës së Dibrës, qe ndërtuar në vitin 1763, Xhamia e Et'hem Beut përfundoi në vitin 1821, ndërsa Kisha Katolike u ndërtua në vitin 1856.

Plani i parë rregullues, pas shpalljes së Tiranës kryeqytet u hartua nga ing. Eshref Frashëri në vitin 1923. Ky i fundit në fakt përvijoi linjat kryesore të rrugëve që dilnin nga qendra e re e Tiranës, si rrugën e Durrësit si dhe rrugë të tjera që përshkonin lagjet e vjetra të qytetit si rruga e Barrikadave, rruga e Pishës etj. Këto rrugë filluan të hapen gjatë viteve 1923-24. Me hapjen e rrugës së Durrësit, 20 m e gjerë dhe 1 km e gjatë, ndërtesa që do të shërbente më vonë si seli e Parlament përcaktohej përfundimisht në qendër të Tiranës ose më saktë në qendrën e re administrative që do të krijohej. Kjo e fundit do të spostohej në perëndim të qendrës së vjetër ku ndodhej pazari, në një hapësirë deri atëhere të pa ndërtuar pasi qyteti duke injoruar qendrën, që ishte pazari ishte shtrirë në njërin krah nga lindja dhe verilindja. Mjafton të përmendim se Braka dhe Shallvaret, ku ndodhet ndërtesa e Parlamentit

DO NOT COPY

konsideroheshin lagje periferike të banuara nga shtresat e ulta. Në një foto ku paraqitet ndërtesa e parlamentit, e përfunduar ajo paraqitet në një hapësirë boshe e pa sistemuar (Fig.10).



Fig.10. Parlamenti. Pamja kryesore nga veriu. 1925.

Ritmi i ndërtimeve dhe zgjerimit të sipërfaqes së banuar, u rrit me shpejtësi midis viteve 1926-1928, kur u përdorën më shumë mjete financiare me ndërhyrjen më të fuqishme të qeverisë italiane, të krijimit të shoqërisë për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë (SVEA), si dhe të adoptimit të një plani të përgjithshëm transformimesh urbanistike të ideuar nga urbanistë dhe arkitektë italianë.

Në një plan të qytetit të vitit 1930, godina e parlamentit qëndron përsëri e vetmuar në një shesh pa ndërtime , pranë së cilës ndodhej kantieri i ndërtimit të ministrive (Fig.11). Përsa i përket tranformimeve të qytetit në veri të përroit të Lanës, kjo mund të quhet faza e parë e zhvillimit urbanistik të qytetit të Tiranës. Faza e dytë synonte zgjerimin e qytetit në zona të pabanuara ose të banuara rrallë për t'i dhënë një frymëmarrje më të madhe atij nëpërmjet zgjerimit dhe hapjes së arterieve të reja, që pasqyrohen në planin rregullues të vitit 1939 (Fig.12) dhe që pjesërisht ishin realizuar nga studime pjesore. Këto arterie bashkoheshin në sheshin Skënderbej, për zgjerimin e të cilit u sakrifikua xhamia e Karapicit, ku ndërtua godina e Bashkisë. Në këtë plan përfshihej dhe ndërtimi i Bankës së Shtetit Shqiptar si dhe krijimi i Tiranës së Re në jug të përroit të Lanës, me blloqe vilash në të dy krahët e bulevardit "Dëshmorët e Kombit". Bulevardi kryesor ishte rezervuar për ndërtimin e godinave publike me ambicionin e një arkitekture monumentale, që do t'i jepte një pamje të re kryeqytetit të Shqipërisë, gjithë duke duke ruajtur qendrën e saj të vjetër historike, duke shmangur gjithashtu kontrastet volumetrike dhe stilidtike. Më tepër se në çdo qytet tjetër të Shqipërisë në Tiranë bashkëjetonin perëndimi modernizues me orientin tradicionalist.

Godina e Parlamentit, çuditërisht nuk u prek nga planet rregulluese të pas Luftës së Dytë Botërore, ashtu siç ndodhi me bashkinë e qytetit. Por në kushtet e risistemimit të qendrës dhe të ndërtimit të kishës katedrale ortodokse në lulishten pas saj, ajo ka nevojë për ndërhyrje dhe trajtim edhe në pjesët deri tani më pak të ekspozuara. Për të qenë një ndërtesë e pranueshme për qendrën e Tiranës ajo duhet të kthehet në pamjen e saj të hershme më të mirë, që gjithsesi ishte më dinjitoze se ajo aktuale. Nga ana tjetër kjo ndërhyrje restauruese do të krijonte një larmi të këndshme në trashëgiminë arkitekturore historike të qendrës së kryeqytetit.



Fig.11. Harta e Tiranës. 1930.

DO NOT COPY



Fig.12. Plani rregullues i Tiranës. 1939.

Gjendja aktuale e godinës dhe fazat e ndërtimit

Ish godina e Parlamentit të parë shqiptar, sot Teatri Kombëtar për fëmijë, ka arritur në ditët tona mjaft e transformuar megjithëse ruan brenda saj, në masë të konsiderueshme substancën origjinale. Transformimet kanë ardhur si pasojë e përdorimit të saj për një periudhë të gjatë kohe për qëllime të ndryshme, të cilat kanë kërkuar adoptime, shtesa si dhe transformime në interier për t'iu përshtatur funksioneve të ndryshme nga ai fillestar apo i periudhës më të rëndësishme historike kur kjo ndërtesë shërbeu si parlament (fig.13, fig14).



Fig.13. Ish Godina e Parlamentit të parë shqiptar. Pamja kryesore në gjendjen aktuale.



Fig.14. Ish-Godina e Parlamentit të parë shqiptar. Planimetria në gjendjen e sotme (Rilevoi S.Dashi).

DO NOT COPY

Ndërtesa përbëhet nga një korpus qëndror dykatësh, që mbulohet me një çati me katër kullime e mbuluar me tjegulla. Dhe dy krahë anësorë të dyfishtë të mbuluara gjithashtu me çati, me konstruksion druri e tjegulla. Pjesët e krahëve më afër korpusit qëndror, një katëshe, kanë çati tre ujëse, një krah i të cilave mbështetet në murin perimetral të korpusit qëndror, ndërsa pjesët periferike mbulohen nga çati me dy kullime, duke u ndarë nga të parat dhe përfundojnë me kallkan në fasadën kryesore (Fig. 13). Nga kati i dytë i korpusit qëndror del një ballkon që pushon mbi katër kollona drejtkëndëshe. Dy kolonat e mesit kanë dyfishin e gjerësisë të atyre anësore. Në mesin e këtyre kolonave ka patur dikur nga një kanal me prerje drejtkëndëshe, që të krijonte përshtypjen e kolonave të dyfishta (Fig. 25, 27), por që tani nuk ekziston më pasi është mbushur me suva. Balli i ndërtesës në katin e dytë ka katër hapje të stërgjatura vertikale, prej të cilave dy të mesit shërbenin si dyer, ndërsa të tjerat si dritare. Në gjendjen aktuale ato janë të mbyllura me vetrata duralumini. Në katin e parë, drejtkëndëshi i formuar nga kolonat, dikur i hapur figuron aktualisht i mbyllur. Në anën perëndimore, midis dy kolonave është ngritur një mur rreth 2 m i lartë, pjesa që mbetet mbyllet nga një vetratë duralumini, ndërsa nga ana perëndimore kolonada është e mbyllur krejtësisht nga një vetratë duralumini. Me mure janë mbyllur dhe hapësirat anësore midis kolonave të mesit me ndryshimin, që nga ana lindore në lartësi është lënë e hapur një dritare, ndërsa nga perëndimi përveç dritares është hapur dhe një portë. Këto ambiente të sajuara shërbejnë për shitje biletash dhe qëllime të tjera. Platforma e shkallëzuar para hyrjes kryesore ruhet pjesërisht e shtruar me pllakat origjinale çimentoje të ngjyrosura me dekoracione që paraqesin lule tërfili të kryqëzuara (Fig. 28). Nga shkallarja e dikurshme ruhet sheshpushimi i rrethuar nga një kornizë betoni si dhe gjurmët e njërës nga shkallët prej granili, e cila ndodhet 15 cm poshtë nivelit të sheshpushimit. Parapeti i ballkonit aktualisht na paraqitet si një mur i plotë, por që fsheh ndoshta brenda tij një radhë balaustrash dhe kolonash origjinale.

Dy krahët anësorë më pranë korpusit qëndror kanë secila nga dy dritare të thjeshta duralumini të transformuara në fasadë, por që kanë të njëjtën madhësi me ato origjinale (Fig.13, 25). Ndërsa pjesët periferike të krahëve, që përfundojnë me kallkan dhe që janë shtuar më vonë në mënyrë simetrike kanë nga një portë me hark në secilin krah. Ajo nga lindja mbyllet nga një qepen drejtkëndësh.

Fasada lindore

Me gjithë shtesat dhe transformimet e bëra në kohë edhe në fasadat anësore , ajo perëndimore dhe lindore mbeten simetrike. Kati i dytë i korpusit qëndror, që i përket periudhës së parë të ndërtimit, ka një radhë dritaresh të vendosura nën kornizën e çatisë, aktualisht dykanatëshe duralumini, të cilat ndahen nga pilastra që projektohen 10 cm nga muri. Korniza e çatisë megjithëse e transormuar pjesërisht nga riparime të ndryshme ruan mjaft elementë origjinalë. Kreu i pilastrave zbukurohet nga elementë stukorelievi, që formohen nga pesë drejtkëndësha të brendashkruar, të vendosur njëri mbi tjetrin duke krijuar shkallëzime në të katër anët e dekoracionit. (fig.15).



Fig.15. Ish-godina e Parlamentit të parë shqiptar. Pamje lindore e korpusit qëndror.

Pilastra e mesit është dyfish e gjerë, për këtë arsye janë vendosur pranë njëri-tjetrit dy drejtkëndësha dekorativë në stukoreliev. Pilastrat dyfishe në të dyja anët e ndërtesës shërbenin për mbështetjen e kupolës. Dritaret ruajnë madhësinë origjinale, vetëm se janë transformuar në detaje. Në katin e poshtëm, pranë fasadës kryesore

DO NOT COPY

ndodhet një ambient i shtuar, i cili përpiqet të imitojë pjesën e vjetër. Gjendja e kësaj shtese është mjaft e amortizuar. Gjatë ndërtimit të kësaj shtese janë mbyllur dritaret e katit të poshtëm që ndodheshin në korpusin qëndror dhe në vend të tyre janë hapur dyer të cilat komunikonin me këtë ambient (Fig. 14). Në fazën fillestare në vend të këtij ambienti ka patur një ambient të hapur të rrethuar nga një parapet balaustrash dhe kolonash drejtkëndëshe (Fig. 8). Ambienti që vazhdon në drejtim të jugut është i fazës fillestare. Edhe ky ambient është mjaft i amortizuar dhe nuk është vënë dorë për restaurimin e tij për një periudhë shumë të gjatë. Kjo pjesë e ndërtesës përfshihet brenda pesë pilastrave, tre prej të cilave ruajnë ende dekoracionet në stukoreliev që janë të njëllojta me ato të pilastrave të korpusit qendror dhe ndodhen në kreun e pilastrave nën kornizën e çatisë. Korniza është mjaft e dëmtuar. Dritaret janë jashtë përdorimit, të transformuara dhe të mbyllura pjesërisht me mure tullash. Dy nga dritaret e shtesës janë mbyllur tërësisht me mur tullash dhe janë lënë të hapura vetëm dy hapësira të ngushta për ndriçim. Në paturat e dritareve të vjetra dallohet një fazë e hershme por jo origjinalja. Këto janë kornizat prej druri ku ndodhen menteshat e kapakëve të grilave të cilat i përkasin rikonstruksionit të ndërtesës në vitin 1930. Ambientet e vjetra të krahut lindor të ndërtesës përdoren me qira nga një fotograf, ndërsa ambientet shtesë përdoren për zyra të Teatrit Kombëtar për fëmijë.

Ambienti origjinal i krahut lindor arrin deri në murin fundor të korpusit qëndror. Në jug të këtij ambienti kemi një shtesë tjetër, që i mbështetet skenës së rikonstruktuar. Eshtë një ndërtim më i lartë se ai origjinal, që i mbështetet këtij të fundit dhe ka dy dyer dhe një dritare më lart se të parat. Çatia me tre kullime e këtij ambienti mbështetet në njërën anë në murin e skenës së rikonstruktuar. Ambienti në brendësi ndahet me mur tulle në dy pjesë. Pjesa veriore formon një ambient të stërgjatur që lidhet me skenën, ndërsa pjesa tjetër shërben si lokal. Pjesa veriore është shumë e amortizuar dhe ka një tavan kallamash gjysmë të rrëzuar. Këtyre ambienteve i shtohet një portik 4 m i gjerë, i cili zë gjithë ballin e fasadës jugore dhe i shërben lokalit që quhet "Kafe-Bar Pasioni".

Fasada jugore

Fasada jugore është krejtësisht e trasformuar, për shkak të shtesave të shumta pa vlerë dhe rikonstruksionit të skenës, në funksion të Teatrit të kukullave. Në gjendjen aktuale ne shohim një portik që zë gjithë ballin e fasadës dhe i shërben lokalit të sipërpërmendur (Fig.16), i cili përbëhet nga dy pjesë simetrike në të dy anët e portikut.



Fig.16. Ish godina e Parlamentit të parë shqiptar. Pamja jugore në gjendjen aktuale.

Pjesa perëndimore e lokalit në vëllim është identike me atë lindore me ndryshimin që ajo perëndimore është dykatëshe. Midis dy pjesëve të lokalit, të cilat lidhen midis tyre nga portiku, qëndron skena e rikonstruktuar. Kjo e fundit, nga një ndërtim i vogël dhe i ulët në formën e një apside kishe (Fig.17), ka zënë gjithë gjerësinë e



Fig.17.Godina e Parlamentit të parë shqiptar. Pamja jugore në vitin 1930 me skenën origjinale në formë apside

DO NOT COPY

ndërtesës dhe është shtyrë edhe 5.60 m më në thellësi (nga 2. 40 m,që projektohej skena e vjetër nga muret, e reja shkon në 8 m).

Ndërtimi i skenës ka kaluar në dy faza. Faza e dytë ka të bëjë me ngritjen e saj në lartësi (Fig.16), që e kalon lartësinë e korpusit qëndror. Ajo mbulohet me një çati llamarine me dy kullime. Me rikonstruksionin e skenës, që në fazën e saj fillestare u mbyllën edhe dritaret e sipërme të sallës (Fig.17), që shihnin nga jugu.

Fasada perëndimore

Eshtë simetrike me atë lindore. Jo vetëm përsa i përket konceptimit fillestar të ndërtesës, por edhe të shtesave. Në pjesën veriore, dikur të hapur është shtuar një ambient i ri i cili në pamjen e jashtme është identik me shtesën në fasadën lindore. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për pjesën që i përket lokalit "Kafe-Bar Pasioni„ me ndryshimin e vetëm që shtesa e realizuar për lokalin është e ndarë në dy kate, ndërsa nga jashtë ruan të njëjtat proporcione me krahun e saj lindor. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me dritaret e katit të parë të korpusit qëndror në pjesën e shtuar nga veriu, të cilat janë mbyllur me mur. Fasada perëndimore dallohet nga ajo lindore nga që elementët origjinalë ruhen më mirë (Fig.18).

Muret origjinale, si në pjesët e tjera, janë ndërtuar me tulla argjili të pjekur, ndërsa shtesat këtu janë ndërtuar me tulla silikate, që tregojnë se janë shumë të vona. Përveç kornizës origjinale, që këtu ruhet mjaft mirë, ruhet dhe xokolatura e hershme, si dhe një trotuar i mëvonshëm prej betoni. Dekoracionet në stukoreliev janë më të qarta e të ruajtur më mirë.(fig.19)



Fig.18. Ish godina e Parlamentit të parë shqiptar. Pamja perëndimore në gjendjen aktuale.



Fig.19. Pamja perëndimore me kornizën origjinale dhe dekoracionet në stukoreliev të pilastrave.

Xokolatura përbehet nga një brez, që ndahet nëpërmjet suvasë në blloqe drejtkëndëshe të punuar me spruco të cilat kanë një shirit të lëpirë në të tre anët. Shtesat përdoren për agjensi shkëmbimi monetar (Iliria 98) e tj.

Interieri

Për të hyrë në parasallën e godinës do të kalosh nëpërmjet portës së parë, që ndodhet midis kolonave të nënballkonit. Kjo portë me hark është ruajtur origjinale, që nga koha e ndërtimit të godinës. Pjesa e poshtme e portës dykanatëshe është e veshur me pllakë bronxi. Me të njëjtën material janë dhe dorezat, si dhe pjesët e tjera metalike. Mungon ndriçuesi mbi portë.

Pjesa harkore e portës është ribërë sipas formës origjinale, por me një cilësi më të dobët. Për në portën e dytë kalohet nëpërmjet tri këmbë shkallëve. Edhe kjo portë, si e para, ruhet origjinale, që nga koha e ndërtimit (Fig. 20).

Në të dy anët e saj garderobat janë hequr gjatë rikonstruksionit të vitit 1930. Të kësaj periudhe janë dhe portat anësore që komunikojnë me krahët (Fig. 29),

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 20. Porta e hyrjes në hollin e Parlamentit.

ndërsa porta për në sallë është e fazës së parë të ndërtimit (Fig.21, 26).

Salla përbëhet nga skena , vetë salla si dhe gjashtë llozha (Fig. 30), nga tre në secilën anë. Hapja e skenës (Fig. 31), ruhet në madhësinë origjinale, por është ngritur niveli i dyshemesë. Në murin jugor të sallës shihen kornizat e profiluara të katër dritareve, të cilat janë mbyllur kur u bë rikonstruksioni i skenës në periudhën kur godina ishte Klubi i sovjetikëve. Dy llozhat e para janë hapur në njërin kënd të tyre për të komunikuar me skenën në kohën që godina u kthye në Teatër kukullash. Në parapetet e llozhave mungojnë rozetat e vitit 1930 (Fig.30), si dhe rozetat që ndodheshin në fushat e kornizuara sipër llozhave. Të dekoruara me motive floreale në stukoreliev, kanë qenë edhe pjesët e sipërme të pilastrave, ndërsa kornizat ekzistojnë që nga koha e dekorimit të sallës, vetëm se duhen pastruar profilet e mbushura nga lyerjet e shumta. Në të katër këndet e tavanit ruhen stema, që kanë humbur qartësinë e duhur nga lyerjet e shumta, si dhe larminë e ngjyrave origjinale, ndërsa tani janë ngjyrosur thjesht të bardha. (fig. 22).



Fig.21. Porta e hyrjes për në sallë.



Fig. 22. Dekoracion në stukoreliev në këndin e tavanit.

Gjithashtu është prishur stema-simbol i mbretërisë shqiptare që ndodhej në mesin e ballit të skenës. Korridori dhe salla kanë qenë shtruar me pllaka çimento të ngjyrosur me motive tërfili (Fig. 28), ashtu siç takohen dhe në platformën e shkallëve të jashtme, ndërsa llozhat janë shtruar me pllaka të një cilësie më të mirë, me motive floreale më të pasura dhe janë më të hershme se të parat, pasi riparimet janë bërë me pllaka me motive

gjethesh tërfili. Të njëkohshme me pllakat me tërfil janë edhe disa të tjera me motive gjeometrike, me të cilat janë shtruar dhomat para ballkonit dhe dyshemeja e ballkonit. Në të dy krahët, që lidhen me dyer me sallonin e hyrjes, janë prishur ndarjet e brendshme dhe hapësirat janë shtruar me mermer të bardhë e gri me pllaka të vogla të kombinuara. Punimi i shtrimit është i dobët dhe mund të jetë realizuar në kohën e sovjetikëve. Dritaret në krahun perëndimor kanë qenë të hapura deri në vitin 1990, por u mbyllën kur ndërtimi shtesë i kësaj ane u dha për kambizëm. Në krahun lindor gjithashtu janë mbyllur të gjitha dritaret dhe janë zëvendësuar me dyer që të çojnë në ambientet shtesë të kësaj ane. Të transformuara janë dhe ambientet e WC-ve. Nën katin e dytë ku është ndërtuar kabina e projektorit të filmit është hapur një derë e re për në galeri dhe është mbyllur ajo origjinale njëkohësisht porta e hyrjes në sallat para ballkonit ka ndryshuar vendndodhjen dhe është hapur një portë në murin ndarës midis dy sallave. Në përgjithësi suvatimet dhe tavanet janë të amortizuar dhe dekoracionet kërkojnë trajtim pastrimi dhe rigjenerues. Tavani (Fig. 32) me sa duket,i takon periudhës së vitit 1930.

Fazat e ndërtimit dhe vlerësimi i tyre

Në vlerësimin e fazave të ndërtimit të një monumenti me qëllim mbajtjen e një qëndrimi ndaj tyre gjatë procesit të restaurimit. Shqyrtohet vlera e gjithanshme e tyre, historike, artistike, arkitektonike, urbanistike, ambientale e tij. Nuk është e thënë që t'i kushtohet më tepër rëndësi fazës së parë fillestare të monumentit apo njërës nga fazat e tij të ndërmjetme. Mund të ruhen të gjitha fazat me vlerë ashtu si, ai mund të çlirohet nga të gjitha fazat pa vlerë.

Faza e parë e ndërtimit

Në rastin e godinës së Parlamentit faza e parë e ndërtimit, është më e rëndësishmja, si nga vlera arkitektonike ashtu edhe historike. Shtesat e mëvonshme, në përgjithësi, vetëm se e kanë dëmtuar pamjen e monumentit dhe nuk paraqesin ndonjë vlerë në vetvete. Disa ndërhyrje më të vogla vlejnë të ruhen, ndërsa disa nga elementët e humbur tërësisht mund të mos zëvendësohen.

Fazë të parë (Fig.23,8) konsiderojmë godinën kur ajo shërbente si sallë mbledhjesh për parlamentin shqiptar dhe, që përbëhej nga korpusi kryesor qendror dykatësh, me dy krahë simetrikë njëkatësh në të dyja anët, të cilat janë të lidhura organikisht me korpusin qendror dhe që në pjesën veriore të ndërtesës kundrejt fasadës kryesore ishin të hapura, të rrethuara vetëm nga një parapet balastrash.



Fig. 23. Parlamenti. Planimetria në fazën e parë të ndërtimit.

Kati i dytë i korpusit qëndror ishte i pajisur me dritare të njëllojta të vendosura midis pilastrash të dekoruara në pjesën e sipërme, në të tre anët, ndërsa përballë dy dyer dhe dy dritare komunikonin me një ballkon të mbështetur mbi katër kolona drejtkëndëshe. Kati i parë i krahëve dhe i korpusit kryesor ka qenë pajisur me dritare të mëdha midis pilastrash. Mbi çati qëndronte një kupolë, mbi një tambur shumëkëndësh. Kanatet e dritareve ndahen në kuadrate të vogla, të kryqëzuara nga listela që krijojnë rombe, duke u lidhur në këtë mënyrë me formën arkitektonike dhe dekorative të ndërtesës (Fig.8, 25, 27). Në brendësi ndërtesa përbëhej nga ambiente simetrike në të dyja anët e sallës, nga

DO NOT COPY

DO NOT COPY

salla qendrore me gjashtë llozha, të ndara nga tre në çdo anë, si dhe nga shkallët që të çojnë në galerinë e sallës, dhe nga dy ambiente që lidhen me ballkonin.

Faza e dytë e ndërtimit

Lidhet me rikonstruksionin e ndërtesës dhe dekorimin e sallës kryesore në vitet 1930-31. Një pjesë e këtyre dekoracioneve janë zhdukur, siç janë p.sh. disa rozeta në ballkonet e llozhave dhe simbolet e shtetit shqiptar në parapetin e galerisë. Tavani (Fig. 32) ruan një pjesë të dekoracioneve të dikurshme, të cilat kanë nevojë për pastrime e sondazhe për të dalë më mirë në dukje.

Në vitin 1930 u bë dhe një rikonstruksion i rëndësishëm i ndërtesës. Ai konsistonte në rindërtimin e të gjitha çative, si të korpusit qëndror ashtu edhe të krahëve, të cilat nga me pllaka eterniti u mbuluan me tjegulla marsejeze si dhe u hoq kupola. Me heqien u kupolës, u rikonstruktua dhe tavani, i cili mund të jetë pasuruar me elementë të rinj dekorativë. Krahët e hapura të rrethuara me parmakë balaustrash u prishën, u prishën shkallët e jashtme për në ambientet anësore dhe u bënë të pa përdorshme dyert për në ato (fig. 5, 24).



Fig. 24. Godina e parlamentit me ministritë. 1940

Faza e tretë e ndërtimit

Faza e tretë e ndërtimit lidhet me përdorimin e ndërtesës si qendër kulturore nga sovjetikët në vitet 50. Në këtë periudhë u rikonstruktuan dy krahët anësorë të ndërtesës, duke bërë përpjekje që këto të fundit të përshtateshin me arkitekturën origjinale. Ndryshime ka patur dhe në brendësi të ndërtesës, ku janë prishur ndarjet e brendshme që shërbenin si zyra për Parlamentin, të cilat u kthyen në korridore të gjera që komunikonin nëpërmjet dyerve me shtesat aënsore. Me këtë rast u mbyllën të gjitha dritaret që i përkisnin kësaj pjese të katit të parë. U rikonstruktua skena dhe janë bërë ndryshime dhe adoptime në katin e dytë ku është vendosur një aparat projektimi.

Faza e katërt e ndërtimit

Eshtë vështirë të përcaktohen me saktësi të gjitha ndryshimet dhe adoptimet e fazës së katërt, kur godina u përdor si Teatër Kukullash. Janë zhdukur apo eleminuar dekoracionet në stukoreliev brenda sallës, janë bërë ndarje, janë vendosur dyer të reja dhe janë zhdukur krejtësisht mobiljet e vjetra. Janë zhdukur ose mbuluar gjurmët origjinale të parapetit të ballkonit në fasadën kryesore, është dëmtuar shtresa e vjetër e dyshemesë dhe është zëvendësuar me të re në shumë vende. Kohët e fundit u rikonstruktua skena duke u ngritur në lartësi, si dhe u vendosën dritare duralumini.

Gjatë periudhës së tranzicionit janë bërë shtesa të shumta dhe adoptime për t'a përshtatur ndërtesën qëllimeve banale, si mbyllja dhe përdorimi i kolonadës së hyrjes, përdorimi i qepenave tek krahët anësorë shtesë, shtimi dhe përshtatja e ambieteve për qëllime tregtare, tjetërsimi i plotë i fasadës jugore, ku është ndërtuar përveç të tjerave dhe një portik, zhdukja e petinaturës origjinale në fasadën kryesore e tj (fig.13).

Vlerësimi i fazave të ndërtimit dhe qëndrimi ndaj ndërhyrjes restauruese

Në rastin e godinës së Parlamentit të parë shqiptar, vlera historike dhe ajo arkitektonike materializohen në fazën e parë të ndërtimit, edhe pse kjo ndërtesë u ngrit fillimisht si klub për oficerat e ushtrisë shqiptare. Të gjitha ndërhyrjet e mëvonshme i kanë dëmtuar vlerat e këtij monumenti, siç kemi përmendur në trajtimin më të hollësishëm dhe përshkrimin e fazave të ndërtimit në paragrafët paraardhës. Në morinë e ndërhyrjeve të mëvonshme për t'u vlerësuar është pjesërisht ndërhyrja rreth vitit 1930, që ka të bëjë me dekorimin e brendshëm

të sallës së Parlamentit. Ndërhyrjet në arkitekturën e godinës, që u realizuan në vitin 1930 megjithëse në funksion të të njëjtit institucion e dëmtuan pamjen e jashtme të monumentit. Ndryshimet më pak të rëndësishme të brendshme që u bënë në këtë kohë duke patur thjesht qëllim utilitar për t'i shërbyer të njëjtit funksion të pandërprerë të ndërtesës si seli e Parlamentit mund të konsiderohen të pranueshme.

Përsa i përket fazave të mëvonshme, që konsistojnë në përshtatjen e ndërtesës qëllimeve krejt të ndryshme nga ai fillestar dhe cënojnë si vlerat historike ashtu edhe ato arkitektonike e artistike të ndërtesës mund të themi se ato nuk paraqesin asnjë vlerë në vetvete.



Fig. 25. Parlamenti. Anëtarët e Asamblesë Kushtetuese 1928.



Fig. 26. Salla e Parlamentit. 16 Qershor 1941



Fig. 27. Parlamenti.Portali i hyrjes. 1925



Fig. 28. Dyshemeja origjinale e sallonit



Fig. 29. Porta e krahut perëndimor

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 30. Llozhë në gjendjen aktuale



Fig. 31. Skena në gjendjen aktuale



Fig. 32. Tavani i sallës në gjendjen aktuale

Gjerak KARAISKAJ

FIRST ALBANIAN PARLIAMENT

DO NOT COPY

History of the First Albanian Parliament (FAP) begins since when Tirana was declared Capital City of Albanian on February 11, 1920. This brings necessity build a functional and modern building for developing activities of a parliament. Lushnja Congress elected 3 regency members, High Council and Senate which ha 37 members elected by Congress. Because the Senate can not play the role of High Chamber of Parliament change its name on 31-03-1920 on "National Council", so in this manner the misunderstanding was avoid on the 4-th meeting of Senate. This name was kept up to January 1924, at the eve of Constitutional Assembly election.

First Albanian Parliament (named National Council) held first meetings at temporary building un-functional for a new parliament, the Scientist Academy building in nowadays.

Since at the first years after establishing of the government at Tirana many efforts was done to built a new building for Albanian Parliament which according to the sketch attached it will be worthy for a European city (Fig1). Letter of internal minister which was for the Agriculture Works Botore* Ministry keeps date February 4, 1923. There is a request for two solutions of project prepare, first totally concrete and second with external brick walls. Expenses will cover up by donations of Tirana population.

Building was called "Parliament Palace" and its program contain a hall with curved stairs for 150 persons, loges for high council, diplomatic corpse, other ambiances like library; archive; police room; press hall; café etc. Project items was translated in germane language handwritings, this shows that architect was German or Austrian. Sketch of project-idea notes was also in german language. Problem was plan and adoption with surround traditional architecture. Ismail Ndroqi was vice-chief of a commission for this project that never was realised. Dream of an enormous building for parliament continued up to 1930 when a document of date January 15, 1930 was written "The conference hall must be for 300 persons"

Albanian Army on 1924 has begun a building for its officers, which was named "Officer Club". Document of a War Ministry, which kept date July 2, 1924 sent to a Botore Works Ministry, asked for a capable engineer for controlling the building which was built up at Shallvare field, as officers club. "Demand for an engineer" was written in germane language at side of this document. This correspondence shows that the foundations of this building have begun previously. Document of War Ministry explain that the foundations up to surface where by stone and for the walls were used bricks, which were produced by soldiers. Document of date August 14, 1924 that was sent to War Ministry by Agriculture Works Botore give instruction for work continuing.

This document firstly was in germane language hand-written but later on is translated and typed. That document explain discussions were between Mr Baurat (highest building specialist of a ministry) Beck, Rexhep Berati major, Kodheli captain and engineer Vaja . The writer of the document in germane language seems to be Mr Beck. The "Officer Club" was adopted as a building for parliament, because of impossibility of built up of an entire building. The "Officer Club" was used for this purpose up to April, 7 1939 date when the fascist Italy conquered Albania, so at the same date the parliament was suspended by occupiers.

Decoration of Parliament building, previously Senate Palace was done on 1928 date when Albanian Kingdom was proclaimed, but efforts were done since 1925.

Botore* Office which conduct civil engineering projects.

Decoration's of Parliaments when the symbols of Albanian Kingdom were presented was kept in good shape when the building changes destination and was used as headquarter of High Fascist Corporate Council after Italian occupies. Today main of them is not preserved. Ministries Buildings has finished on 1931; time when a reconstruction of parliament building was done. The cupola was removed, all roofs of the building were reconstructed and the Marseille tiles were used instead of eternit** plaques. Open parts of the wings destroyed, which were surrounded with balustrade shutter and all windows, reconstructed. Windows are turned on style of those years and venetian blind were added. All these changes are understandable by photo of that time, when close to Parliament buildings are Ministries that just finished. Photo of 1930 shows the parliament building with cupola, small changes were done at interior.

After Parliament suspended on the year 1939, the building changes its destination and was used as Fascist Room (Albanian Section) and later on as headquarter of High Fascist Corporate Council.

On the years 1950-1957 the parliament building serve as Soviet Culture Centre (Albanian-Soviet Friendship Club), known by people as Soviet Club. On years 1960-61

Building was adopted as a puppet theatre, function kept in nowadays. The last two phases at the building was making many essential changes and lose its begging character.

Tirana as a new capital city the building of a first Albanian parliament, with quality as Officers Club, it was one of the first buildings with social-administrative character and European stile built on the years 1920-1924. While the traditional (Balkan characters) and oriental architecture predominate the building, built up on 1895 (when the National Council kept its meetings) and Kajmekam building participate at the group with modern architecture together with parliament one.

Only at the years after 1924 many buildings of west European style was raised. The parliament building for its fortune was included at all latest urban plans by remaining part of Tirana Centre. It will remain a separate case of architecture with historic indisputable value, if will become at its beginning state and except of this has a very interesting history.

DO NOT COPY

Eternit** Composition material made with asbestos and use to make drainpipes and corrugated roofing.

Agron ISLAMI, Elio HOBDARI

PUNIME KONSERVUESE NË BAZILIKAT PALEOKRISTIANE TË BYLISIT

DO NOT COPY

Duke filluar nga vitit 1999 projektet e kenservuese dhe restauruese në Bylis, të filluara paralelisht me gërmimet në atë qendër që nga fundi i viteve '70, janë koordinuar edhe me projektin e gërmimeve dhe studimit të ndërmarrë në bashkëpunim mes Institutit të Arkeologjisë dhe Misionit Arkeologjik Francez të mbështetur nga Shkolla Franceze e Athinës. Objekti i këtij projekti janë bazilikat paleokristiane të qytetit të Bylisit.

Në koordinim me këtë projekt ndërhyrjet janë përqëndruar në konservimin e mozaikëve të bazilikave dhe në restaurimet e kryera në arkitekturën e tyre.

Punimet konservuese në mozaikë gjatë viteve 1999-2007

Katër bazilika janë gërmuar plotësisht në qytetin e Bylisit duke filluar që në fillim të viteve '80[1], ndërsa bazilika e pestë (bazilika E) është në proces gërmimi duke filluar që në vitin 2005[2] (fig. 1).

Në bazilikën A dyshemetë me mozaikë ndodhen në sanktuar, nefin qëndror dhe verior (ruhen dy pjesë të vogla në ekstremet lindor dhe perëndimor), krahun verior të transeptit, si dhe në narteks (pjesa qëndrore dhe veriore e tij)[3]. Të gjithë mozaikët janë shumëngjyrësh me tesera prej materialesh të ndryshëm: qeramikë, gur gëlqeror, mermer dhe brumë qelqi. Përveç mozaikut të nefit verior



Fig. 1. Pamje e përgjithshme e qytetit të Bylisit (foto Alket Islami).

që është me motive gjeometrike, të gjithë të tjerët janë me motive floreale dhe zoomorfe.

Në bazilikën C mozaikët u trajtuan për herë të fundit në vitet 2000-2003. Dyshemetë me mozaikë ndodhen në sanktuar dhe në aneksin jugor të narteksit. Mozaiku i aneksit paraqitet në gjendje mjaft të mirë (fig. 2), ndërsa



Fig. 2. Mozaiku i aneksit jugor të narteksit të bazilikës C.

[1] S. Muçaj, Gërmimet arkeologjike të vitit 1986. Bazilika e Bylisit, "*Iliria*" 2-1986, f. 270-271; *po ai*, Gërmimet arkeologjike të vitit 1988, Bylis (bazilika B), "*Iliria*"2-1988, f. 271, Gërmimet arkeologjike të vitit 1990, Bylis (bazilika D), "*Iliria*" 2-1990, f. 270-271.

[2] Shih raportet e gërmimeve në arkivin e Institutit të Arkeologjisë.

[3] S. Muçaj, Dy monumente të Antikitetit të Vonë në Bylis, "*Iliria*" 1-1986, f. 323-324 *po ai*, Bazilika A e Bylisit, "*Iliria*" 1-1987, f. 176-191, fig. 5, 12-15, 21-24, 30-35; *po ai*, Les mosaïques de Byllis et leur place en Epir, në "*XL Corso di cultura sull'arte ravennate e bizantina*", Ravenna 1993, f. 585-589.

DO NOT COPY

mozaiku i sanktuarit paraqet probleme për shkak të lakunave mjaft të mëdha në sipërfaqen e tij (mungon krejtësisht pjesa qëndrore dhe dëmtime të tjera në bordurat), si dhe për shkak të suportit të tij shumë të dobët. Mozaiku pothuajse mbështetet drejtpërdrejt mbi dhé dhe megjithë ndërhyrjet konservuese në të e shohim të nevojshme që në një të ardhme të afërt të bëhet shkëputja dhe rivendosja e tij në një shtrat të ri.

Në bazilikën D me mozaikë janë shtruar dyshemetë e nefit qëndror, një pjese të nefit verior, të narteksit dhe të dy anekseve të tij. Megjithë ruajtjen e tyre pothuajse të plotë me lakuna të vogla ato paraqesin probleme për shkak të suporteve të tyre të degraduara. Ndërhyrjet e fundit konservuese janë kryer gjatë vitit 2000.

Bazilika B (katedrale) ka sipërfaqet më të mëdha me mozaikë në qytetin e Bylisit. Me mozaikë këtu janë shtruar dyshemetë e nefit qendror, verior dhe të ekzonarteksit. Fragmente fare të vogla mozaiku ruhen në sanktuarin e bazilikës. Këtu punimet janë në proces, konkretisht ato vazhdojnë në mozaikun e nefit qëndror (fig. 3).



Fig.3. Pamje e përgjithshme e mozaikëve të bazilikës B.

Punime konservuese dhe restauruese në arkitekturën e bazilikave

Në bashkëpunim me ekipin arkeologjik shqiptaro-francez dhe me punonjës të Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës Tiranë[4] janë kryer edhe ndërhyrje konsoliduese në arkitekturën e bazilikave si dhe restaurime (vertikalizim elementësh arkitektonikë) në pjesë të veçanta të monumenteve.

Konsolidimet e mureve (tip kapuç) janë kryer përgjatë këtyre viteve në të gjitha bazilikat e qytetit. Në përputhje me rezultatet e studimit të arkitekturës së monumenteve janë evidentuar gjatë këtyre punimeve konsoliduese fazat e ndryshme të ndërtimit dhe të rindërtimit të bazilikave. Ndërhyrje konsoliduese janë kryer edhe në muret e zbuluara rishtaz në kompleksin peshkopal në bashkëpunim me arkeologët që aktualisht gërmojnë në atë pjesë të monumentit.

Pjesa më e dukshme e këtyre punimeve natyrisht janë ngritjet e kolonave në bazilikat B dhe C.

Pas inventarizimit dhe studimit të elementëve arkitektonikë (baza, kolona dhe kapitele) në bazilikën C, të cilat i takojnë kolonadave ndarëse të nefeve dhe tribelonit të hyrjes në nefin qëndror dhe pas një konsultimi tre vjeçar mes arkeologëve dhe restauratorëve të përfshirë në punimet në Bylis u vendos ngritja e dy kolonave të tribelonit dhe e tri kolonave të tjera, një në harkadën veriore dhe dy në atë jugore (fig. 4). U



Fig. 4. Pamje e bazilikës C pas punimeve restauruese.

vendosën kolonat e ruajtura në gjendje më të mirë në vendet ku mendohet se ndodheshin sipas dokumentimit të bërë gjatë gërmimit të bazilikës, duke marrë parasysh edhe gjendjen e ruajtjes së bazave të tyre. Kolonat e

[4] Ndërhyrjet në arkitekturën e bazilikave u realizuan në bashkëpunim me restauratorin Edmond Haxhiraj i Drejtorisë Rajonale të Monumenteve, Tiranë.

tjera që ruhen aty nuk u ngritën, pas vlerësimit që u bë, për shkak të ruajtjes së tyre jo të mirë dhe sidomos për gjendjen jo të mirë të bazamenteve të tyre. Këto baza në fakt janë të thyera ose të vendosura mbi pjesë muri jo solide duke mos lejuar vendosjen mbi to të ngarkesave të tilla. Në të ardhmen mund të ndërhyhet në këto struktura për të realizuar ngritjen e të gjithë elementëve që disponohen. Në tre nga kolonat e ngritura u vendosën edhe kapitelet.

Një nga pjesët e arkitekturës që prej kohësh mendohet të restaurohej ishte edhe tribeloni i hyrjes për në baptisterin e bazilikës B (katedrale) (fig. 5). Gërmimi



Fig. 5. Pamje e hyrjes së baptisterit para restaurimit.

kishte nxjerrë të gjithë elementët përbërës të kësaj strukture dhe një arsye tjetër për të ndërmarrë këtë restaurim (anastilozë) ishte edhe efekti i këtij vertikalizimi në siluetën e përgjithshme të monumentit. Projekti parashikonte ngritjen e të dyja shpatullave të tribelonit dhe vendosjen mbi to të kornizave përkatëse, plotësimin e dy piedestaleve, bashkimin e dy pjesëve të njërës prej kolonave që ishte e thyer dhe montimin e të gjithë elementëve (fig. 6 dhe 7)[5].

Konsolidimi i mozaikëve në bazilikën E

Gjatë viteve 2006-2007 paralelisht me punimet konservuese në mozaikët e bazilikës B u asistua nga ana e restauratorit të mozaikëve edhe gërmimi i nefit



BYLIS - Bazilika B - Tribeloni i baptisterit (pamje nga perëndimi)

Fig. 6. Rikonstruksioni grafik i hyrjes së baptisterit.



Fig. 7. Hyrja e baptisterit pas restaurimit.

qëndror të bazilikës E[6]. Prezenca e mozaikut në sanktuarin dhe nefin qëndror të kësaj bazilike ishte vërtetuar gjatë një sondazhi të vogël të kryer vite më parë në këtë monument.

Duke qenë se të paktën një pjesë e mozaikut dukej që ishte fare pranë sipërfaqes së tokës mendohej se ajo do të ishte mjaft e dëmtuar nga rrënjët e bimëve. Sidomos për këtë arsye prania e restauratorit gjatë zbulimit të këtij mozaiku bëhej mëse e domosdoshme.

Terreni i pjerrët në të cilin ndodhet bazilika E bën që shtresa e depozitave mbi mozaik të lëvizë nga 120 cm në hyrjen e nefit qëndror deri në fare pak cm në ekstremin

[5] Projekt ideja parashikonte edhe ndërtimin e tre harqeve, por kjo fazë, pas një konsulte me një grup restauratorësh u planifikua të bëhet në një moment të dytë.

[6] Asistenca gjatë gërmimit në këtë bazilikë u krye gjatë fushatave të gërmimit një mujore të kryera në këto vite gjatë muajit maj.

DO NOT COPY

lindor të ruajtur të mozaikut në sanktuar. Për shkak të kësaj pjerrësie pjesa më lindore e dyshemesë me mozaikë të sanktuarit është zhdukur plotësisht dhe në një brez ruhen vetëm nënshtresat e mozaikut (fig. 8).



Fig. 8. Kufiri i pjesës së ruajtur të mozaikut dhe nënshtresa.

Dy mozaikët e bazilikës E, ai i nefit qendror dhe i sanktuarit, janë të lidhur me njëri-tjetrin me anë të panelit në hyrjen e qëndrore të sanktuarit (paneli nr. 6).

Pjesa kryesore e mozaikut të nefit qendror (fig. 9) është e ndarë me anë bordurash (B 1) në katër panele të mëdhenj (panelet 1, 2, 3 dhe 4), brenda të cilëve ka medalione me motive zoomorfe, floreale dhe vegjetale. Në lindje, përpara dy pjesëve të kangjellës ka edhe dy panele të tjerë me dekor katërfletëshesh (panelet 5 dhe 7). Me të njëjtin dekor është edhe paneli nr. 6 i kalimit për në sanktuar. Nga mozaiku i sanktuarit ruhet vetëm ekstremi perëndimor i tij, nga i cili ruhen vetëm tre panele. Paneli jugor (nr. 11) ruhet pothuajse i plotë, qendrori (nr. 10) ruhet në rreth gjysmën e tij, ndërsa nga veriori (nr. 9) ruhet vetëm një këmb.

Nga stilobati i kangjellës së sanktuarit, i cili ndante dy mozaikët ka mbetur *in situ* vetëm një element që përbën pothuajse gjithë gjatësinë e krahut jugor të stilobatit. Elementët e tjerë nuk ruhen.

Shtresa e fundit e depozitimit mbi mozaik u hoq nga grupi i restauratorëve duke bërë në veçanti prerjen e rrënjëve të holla të shumta që nga kjo shtresë futeshin edhe në fugat ndërmjet teserave. Po nga ky grup u



Fig. 9. Skema e mozaikëve të bazilikës E.

PO WOTOCOPY

realizua edhe pastrimi paraprak i thatë (pa ujë) i sipërfaqes me mozaik.

Mozaiku i nefit qëndror ruhet pothuajse i plotë me lakuna dhe dëmtime kryesisht në gjysmën lindore të tij. Dy panelet më perëndimore (nr. 1 dhe 2) janë shumë solidë me nënshtresat në gjendje më të mirë. Ata paraqesin një veshje nga kripëra kalciumi krijuar nga infiltrimet e ujërave nëntokësore. Gjithashtu kanë fraktura sidomos në konturet ndërmjet paneleve dhe bordurave.

Më komplekse ishte situata në dy panelet lindorë. Këtu për shkak të shkatërrimit të strukturës së çatisë dhe djegies ishin krijuar mungesa të konsiderueshme në sipërfaqe, djegie të sipërfaqes së mozaikut (sidomos në pjesën qendrore) dhe valëzime të shumta të shtresës së teserave. Valëzimet ishin shkaktuar si nga deformimi i nënshtresave të mozaikut, ashtu edhe nga shkëputja e shtresës së teserave nga shtrati. Për shkak të depozimit më të pakët të dheut në këtë pjesë edhe veprimi dëmtues i vegjetacionit ishte më i madh. Këtu u konstatuan mjaft raste të futjes së rrënjëve nën tesera dhe zgjatjes së tyre horizontalisht nën to (fig. 10).

Në tre panelet pranë kangjellës (nr. 5, 6 dhe 7) u konstatua kryesisht shkëputje teserash të veçanta.

Në mozaikun e sanktuarit dëmtimet në pjesën e ruajtur ishin të shumta për disa arsye. Këtu mozaiku, për shkak të relievit, ndodhej pothuajse në sipërfaqe dhe veprimi i vegjetacionit ka qenë më i fortë se kudo tjetër. Përdorimi i një numri shumë të madh të teserave prej brumi qelqi, shumica e të cilave ndodhen në një shkallë të avancuar degradimi kompromenton edhe më shumë gjendjen e këtij mozaiku[7].

Në këtë mozaik dallojmë edhe dy shtresa të suportit të tij: një shtresë kalldrëmi realizuar me fragmente tjegullash të vendosura vertikalisht[8] dhe mbi të shtresa e llaçit lidhës të teserave. Këtu duhet thënë edhe që nënshtresa e mozaikut paraqet probleme si në kufirin e



Fig. 10. Rrënjë fieri e futur nën mozaik.

sipërfaqes së ruajtur për shkak të rrëshqitjes, ashtu edhe në sipërfaqen e saj për shkak të dëmtimit të llaçit të saj.

Trajtimi që iu bë këtyre paneleve ishte:

- Mbledhja e teserave të shkëputura, sipas paneleve në të cilat u gjetën dhe ruajtja e diferencuar e tyre.
- Spërkatja me herbicid (realizuar në fund të sezonit të parë të gërmimit në vitin 2006).
- Pastrimi me ujë të bollshëm i mozaikut.
- Pastrim i cipës gëlqerore të depozituar mbi teserat e mozaikut (për panelet perëndimore nr. 1 dhe 2).
- Rivendosje teserash në pikat ku kjo ishte e mundur.
- Mbushja e lakunave dhe e frakturave të mozaikut.

Nga eksperienca e akumuluar nga trajtimi i mozaikëve të tjerë në bazilikat e Bylisit është parë domosdoshmëria e ruajtjes së diferencuar të teserave të shkëputura, sipas paneleve për arsye të përdorimit në këta mozaikë të tipeve të ndryshme të materialeve dhe vende-vende edhe të dimensioneve të ndryshme të teserave.

Në përfundim të gërmimit u konstatua se vegjetacioni (kryesisht fier) kishte depërtuar edhe në thellësi të mozaikut. Për këtë u realizua spërkatja me herbicid me qëllim ndërprerjen e dëmtimit nga vegjetacioni. Për rrënjët e futura nën shtresën e teserave u procedua duke hequr 2-3 rreshta teserash mbi vendet ku ndodheshin rrënjët (që të gjitha mjaft të dukshme për shkak të trashësisë së tyre), eliminimin e tyre, riparimin e suportit të llaçit dhe rivendosjen e teserave në pozicionet e tyre (fig. 11 dhe 12).

[7] Teserat prej brumi qelqi janë sipas rastit të korroduara, të pluhurzuara dhe në përgjithësi me dimensione të reduktuara. Për trajtimin e tyre nevojitet një studim dhe një trajtim i veçantë.

[8] Një kalldrëm i tillë është ndeshur në mozaikun e bazilikës paleokristiane të Tepes në Elbasan (shih S. Kosta, U. Çikopano, Mozaiku i bazilikës paleokristiane në Tepe të Elbasanit. Vlerat dhe restaurimi, *Monumentet* 1-1990, f. 135, fig. 15), si dhe në mozaikun e nefit qendror të bazilikës së Vrinës (shih J. Neguer, G. Abu Diab, A. Islami, *Conservation of mosaics at Butrint, Final Report and Recommendations, 2006*, në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës).

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11. Eliminimi i rrënjës dhe riparimi i nënshtresës së mozaikut.



Fig. 12. Rivendosja e teserave.

Ndërhyrja më e rëndësishme për largimin e shtresës së kalcifikimit u bë në pjesën perëndimore të mozaikut dhe ishte mekanik (fig. 13).



Fig. 13. Heqja mekanike e shtresës së kalcifikimit mbi mozaik.

Aty ku ishte e mundur, në lakuna fare të vogla me pjesën e munguar e dekorit ishte e qartë dhe teserat përkatëse u gjetën në vend u procedua me rivendosjen e tyre (fig. 14 dhe 15). Megjithatë një sasi e madhe



Fig. 14. Dëmtime të vogla të mozaikut para ndërhyrjes.

DO NOT COPY



Fig. 15. Dëmtime të vogla të mozaikut pas ndërhyrjes.

teserash të mbledhura gjatë gërmimit kanë mbetur pa u përdorur dhe janë vendosur në ruajtje të ndara sipas paneleve në të cilat janë gjetur. Këto mund të përdoren në të ardhmen si për plotësime eventuale të mozaikut, ashtu edhe për zëvendësim teserash që mund të dëmtohen.

Lakunat u plotësuan të gjitha me dy shtresa mbushjeje llaçi. Në pjesën e poshtme u vendos shtresa mbushëse më e trashë me llaç me përbërje qeramikë të shtypur, rërë lumi e larë, pluhur guri dhe gëlqere (në raport 1:1:1:1). Shtresa e sipërme e mbushjeve u realizua me llaç me pluhur qeramike, rërë e larë lumi, pluhur guri (të treja të situra imët) dhe gëlqere (në raport 1:1:1:1) (fig. 16).

Në kanalet e krijuara nga mungesa e elementëve të stilobatit të kangjellës i realizua bordurimi i buzëve të mozaikut për të penguar rrëshqitjen e mozaikut brenda këtyre kanaleve. Kjo u realizua me të njëjtin llaç si më sipër. Kjo ndërhyrje është totalisht reversibile nëse do të dalë nevoja për të bërë ndërhyrje restauruese me qëllim plotësimin e stilobatit të kangjellës.



Fig. 16. Lakunat pas vendosjes së shtresës së parë të mbushjes.

Bordurim u bë edhe në buzët e suportit të mozaikut të ruajtur në sanktuar. Kjo do të pengojë rrëshqitjen e tij drejt pjesës lindore ku terreni pëson një thyerje të theksuar.

Për të realizuar mbulimin me rërë të mozaikut që e nevojshme të ngrihej muri i kordës së absidës deri në lartësi të tillë që të mund të jetë në gjendje të mbajë brenda tij shtresën e rërës. Kjo për momentin u realizua me mur të thatë, por në vazhdim, në përputhje me projektin e restaurimeve në këtë bazilikë ky mur së bashku me bërthamën e absidës mund të ngrihet si për nevojën e konsolidimit të krejt strukturës së bazilikës në pjesën lindore të saj, ashtu edhe për t'i dhënë bazilikës një pamje sa më të plotë.

Për sa i takon arkitekturës së monumentit, pas gërmimit dhe studimit të plotë të saj dhe të elementëve të shumtë arkitektonikë të ruajtur në të, projekti vijues i restaurimeve duhet të parashikojë konservime dhe restaurime të harkadave të nefeve, bërthamës së sipërpërmendur të absidës dhe të një pjese të instalimeve liturgjike të saj. Në veçanti numri i madhe i elementëve të ruajtur mirë të parapetit të tribunës mund të lejojë një ngritje të plotë të saj, ndoshta në një sipërfaqe pranë monumentit.

Agron ISLAMI, Elio HOBDARI

CONSERVATION WORKS AT PRE-CHRISTIAN BASILICA, BYLIS

DO NOT COPY

Beginning on the year 1999 the restoring and conservation projects in Bylis which has began since 1970 are coordinated with excavation projects. The coordination for this work is done between Archaeological Institute and French Archaeological Mission which is financed by French School of Athens.

According to this project interventions are focused at basilica's mosaic and restorations done according with their architecture.

Four basilicas are excavated completely at Bylis city at beginning of 1980 years, but fifth basilica (basilica E) is under excavation process since 2005.

The mosaics of Basilica C were treated for the last time on the years 2000-2003. Floors with mosaics are at sanctuary and at south annexes of narthexes.

The mosaics of Basilica D were paved: the floors of central nave, a part of north nave, narthexes and two of its annexes. The small spaces are preserved in good conditions but they have also problems because they have degraded supports.

Consolidations of the walls (hooded type) are done during these years at all city basilicas.

The main part of this field-work is building of columns of B and C basilicas.

After inventory and study of the architectonic elements at C basilica, which belong to dividing colonnades of the nave and entrance tribelon at the central nave and after 3 years consultation between archaeologists and restaurateurs who were involved during the works at Bylis was decided building of two tribelon columns and three other columns, one at north arcade and two at south one. Excavation has shown all essential elements of this structure and another reason to do this restoration (anastiloza) was the effect of this perpendicular at general view of monument. Project forecast building of two tribelon scapulars and fixing two appropriate frames over that, fulfilling of two mounts, enclosing of two parts of one column which was broken and fitting all other elements.

Sloppy terrain of E basilica create distance of 120 centimetres from the deposits layer over mosaic up to some centimetres of east preserved extreme of mosaic at sanctuary. The most east part of the floor with mosaic is disappear totally because of this sloppy and only sub layers of mosaic are preserved.

Main part of mosaic of the central nave is divided with bordures (B 1) on four big panels, and there are medallions with zoomorphic, floral and vegetable motives within these panels. There are two other panels on the east in front of banisters and they have four laminas (panels 5 and 7). Sanctuary mosaic has only west extreme and from these are preserved three panels.

Central nave mosaic is preserved totally with small spaces and damages at half-east part of it. Two west panels are more solid and with better condition of sub layers. They have a stratum with salty calcium contend which is created by infiltrate of underground waters.

More complex was situation on the east panels. Here because of destroy of the roof and burns were created some privation at surface, mosaic surface burn (especially at central part) and many undulations at the cubic layer. Sanctuary mosaic has some damage at preserved part because of some reasons. Use of the great numbers of the cubic with glass paste, compromise the situation of this mosaic because of degradation scale of these cubic with glass paste. Treatments of these panels were as follow:

- Collecting of these unfixed cubic's,
- Herbicide sprinkling,
- Mosaic cleaning with plenty water.

• Cleaning of calcareous peeling remain above at mosaic cubic
• Redress of cubic where is possible.
• Filling of small spaces and mosaic fractures.

According to the experience accumulated by treatment of other mosaics at Bylis basilicas we find that: Ii is necessary to preserve separately the separate cubic's, according to the panels because at these mosaics are used different cubic and material types.

Small spaces were filled with two mortar layers. Thick filled layer of mortar with contend of depressed ceramic, river washed sand, stone and lime powder (ratio1:1:1:1) was fixed at base part. Upper part of filling was realized with ceramic powder mortar, washed river sand, stone powder (all fine bolter) and lime (ratio 1:1:1:1). Bandage of mosaic sides were realized at channels created by privation of stilobat banisters elements with the purpose to stop mosaic sliding into these channels. These were realized with the same mortar as was explained above. Covering with the sand of mosaic were realized with building the wall up to the absida cord at that level which will be possible to held the sand layer.

According to the architecture of monument, after excavation and full study and numerous architectonic elements preserved, a project is necessary for the continuously restoration which has to predict conservations and restorations of the nave arcades, nucleus absida above mentioned and some part of its liturgy installations.

DO NOT COPY

Shpresa PRIFTI

TRASHËGIMIA KULTURORE E RRETHIT TË SHKODRËS DHE KRITERET E VLERËSIMIT TË SAJ

DO NOT COPY

Lindja dhe zhvillimi i qytetit të Shkodrës, është i lidhur ngushtë me Kalanë Rozafat, si përgjithësisht mjaft qytete mesjetare shqiptare ku kalaja konsiderohej zanafilla e lindjes së tyre. Lagjet e shtrira kryesisht në anën lindore të kalasë deri te lumi i Kirit si Qafë, Ajasëm, Tabak dhe Tepe të cilat përbënin qytetin në atë kohë dhe kishin një zhvillim të madh ndërtimor.

Gjatë shekullit XVIII, Shkodra si kryeqendra e Shqipërisë së Veriut dhe njëherazi nyje e rëndësishme ndërlidhëse dhe skelë tranziti me Ballkanin, favorizuar kjo dhe nga pozicioni strategjik i vendndodhjës së saj, ishte një qendër e mirëfilltë zejtaro-tregtare. Si përgjithësisht qytetet e tjerë shqiptarë të kohës, në strukturën e qytetit të asaj periudhe e cila përbëhej nga qendra ekonomike, pazari dhe qendra e banuar, Pazari i Shkodrës konsiderohej si një nga më të mëdhenjtë e vendit. Pazari, i ashtuquajtur Tregu i vjetër i Shkodrës, ishte një pavijon i hapur, shumë interesant dhe karakteristik që ruante shumë nga e kaluara dhe ku ndërtimet e reja, të periudhës së Lidhjes së Prizrenit dhe të Pavarësisë e më tej, kishin zënë vend pranë një porti lumor buzë lumit të Bunës (fig.1). Objekti më përfaqësues i Pazarit të Shkodrës Bexhisteni, (fig. 2) i cili i takonte pushtetit në rritje të Pashallëkut të Shkodrës të Bushatllinjve, ndërtuar në fillim të shekullit XIX sipas kërkesave dhe nevojave të tregtimit në rritje të mallrave me vlerë, ishte një qendër e madhe magazinash me mallra industriale prej të cilit ushqehej gjithë tregu i Pazarit dhe mijëra të tjerë në qytet dhe në gjithë vendin.

Në mbështetje të Salmanesë (kalendarit zyrtar) të vitit 1892, Shkodra ndahej në 14 lagje që ishin Tophana, Rus i madh, Perash i vogël, Ndocaj, Parucë, Rus i vogël, Perash i madh, Dudas, Tabakë, Ajasëm, Bahçallëk, Haxhi Resul, Tepe dhe Bërdicë[1].



Fig. 1



Fig. 2

Deri rreth mesit të shekullit XIX, në Shkodër u ndërtua dhe pati përhapje të gjerë banesa e hapur me çardak në variante të ndryshme të saj. Kjo banesë, e përhapur gjerësisht dhe në qytete të tjera të vendit tonë si në Berat, Elbasan apo në Shkodër, gjeti një zhvillim më të madh kushtëzuar dhe nga ndërtimi i saj në troje të sheshta,

[1] *Hamdi Bushati,* "Historiku i Shkodrës".

karakteristike kjo e Shkodrës. E lidhur ngushtë me formacionin feudal të shoqërisë, ajo i plotësonte më së miri kërkesat e shtresës së tregtarëve shkodranë dhe të borgjezisë të sapo lindur, të cilët ende ishin të lidhur me pronën e tokës. Përpjekjet për kërkesa relativisht të reja për kohën nga mesi i shekullit XIX, u reflektuan ndjeshëm dhe në banesë duke patur një ndikim drejtpërdrejtë, i cili u pasqyrua në synimin për të kaluar nga banesa e hapur drejt asaj të mbyllur. Rastet e shumta të rindërtimeve prekshëm në banesën me çardak, janë shkallë të evolucionit të saj të cilat lidhen me fuqizimin e shtresës së borgjezisë shkodrane në veçanti dhe asaj shqiptare në përgjithësi. Duhet theksuar, se kjo banesë për kushtet specifike të kohës ishte një arkitekturë popullore, ku ideuesi dhe zbatuesi i saj ishte mjeshtri popullor, i cili me intuitën dhe profesionalizmin e tij ka arritur të realizojë vepra të mëdha dhe dinjitoze për kohën.

Shkodra e sotme është krejtësisht e shkëputur nga kalaja duke u shtrirë në një zonë në verilindje të saj. Zhvillimi në tërësi i qytetit gjatë shekullit XVIII-XIX është i lidhur ngushtë me krijimin e qendrës së re të banuar e cila erdhi si rezultat i rritjes së natyrshme të qytetit e pa shkëputur nga procesi i zhvendosjes së qytetit nga qendra e vjetër drejt asaj të re. Kjo zhvendosje e shtyrë nga mjaft faktorë të ndryshëm natyrorë dhe historikë, mori shtytjen vendimtare pas vitit 1860 për shkakun madhor të rikthimit të Drinit në shtratin e tij të vjetër, ku bashkimi me lumin Kir sollën përmbytjen e lagjes së vjetër Tophanë[2]. Ndërtimi i kësaj qendre të re i përfshirë në periudhën kohore nga fundi i shek. XVIII dhe gjatë gjysmës së parë të shek. XIX, solli bashkekzistencën për një periudhë të konsiderueshme kohe të këtyre dy qendrave ku e reja tashmë formohej dhe forcohej ditaditës, ndërkohe që e vjetra dobësohej dhe degradohej.

Shekulli i XIX përgjithësisht për vendet e Ballkanit solli periudhën e shndërrimeve të rëndësishme ekonomiko-shoqërore me rënien e sistemit mesjetar të esnafëve për t'i hapur rrugë zhvillimit të forcave prodhuese, si dhe të lidhjeve më të gjëra tregtare me vendet e Europës Perëndimore. Lindja dhe zhvillimi i marrëdhënieve kapitaliste për qytetin e Shkodrës solli ndryshime të rëndësishme jo vetëm në jetën ekonomiko-shoqërore të qytetit, por dhe në fizionominë e tij duke sjellë tronditje për Pazarin e vjetër, i cili tashmë ishte shpërngulur plotësisht nga qendra e vjetër dhe sistemuar në zonën e re, pikërisht aty ku sot zhvillohet qyteti i Shkodrës. Procesi i zhvendosjes së pazarit tradicional drejt qendrës së re të banuar është i lidhur ngushtë me krijimin e qendrës së re tregtare si një dukuri që nuk e takojmë në qytete të tjera të vendit tonë.

Bashkërendimi i qendrës së re të banuar me atë tregtare, është një moment vendimtar në rrugën e zhvillimit të qytetit të Shkodrës. Ky proçes, është i lidhur ngushtë me transformime të ndjeshme të fizionomisë urbane dhe të tipareve arkitektonike të qytetit. Rrjeti urbanistik pësoi zhvillim me gjallërimin e arterieve kryesore pa u shkëputur qartazi nga rrjeti i vjetër rrugor. Një pjesë e mirë e rrugëve kryesore si Fushë Çela, (fig. 3) Rruga e Piacës, Dugajt e Reja, Parruca etj. janë rezultat i rikonstruksionit që pësojnë trasetë e tyre gjatë viteve të fund shek. XIX dhe fillim shek. XX, 1890 – 1920.



Fig. 3

Zhvillimi i marrëdhënieve kapitaliste solli ndryshime të rëndësishme veçanërisht në strukturën klasore të shoqërisë së kohës duke sjellë shpërbërjen e shtresave zejtaro-tregtare dhe forcimin e shtresës së borgjezisë qytetare shkodrane me koncepte bashkëkohore për jetën dhe veprimtarinë prodhuese. Shkodra përjeton një shpërthim ekonomik, kulturor dhe demografik. Arsimi dhe kultura morën një zhvillim relativisht të lartë dhe qyteti përvijoi tiparet e mirëfillta të një metropoli të kulturës shqiptare dhe të një qyteti të mirëfilltë adriatikas të zhvilluar. Më 1858 për herë të parë në Shqipëri zbatohet arti i fotografimit, ku fotografët Marubi do t'i

[2] *Emin Riza* "Banesa popullore në Shkodër gjatë shekujve XVIII-XIX".Revista "Monumentet" Nr. 4.

DOKUMENT

DO NOT COPY

japin qytetit një fototekë unikale në Shqipëri; më 1870 krijohet shtypshkronja e parë nga etërit jezuite; në fundin e shekullit XIX jezuitët krijuan bandën e parë muzikore si dhe stacionin e parë sinoptik; më 1911 ngrihet teatri dhe nis shfaqja e filmit, gjithashtu krijohet dhe një shkollë pikture[3]. Nga ky qytet do të hidhen bazat e filozofisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe qytetarët e saj do të jenë ideatorët dhe nismëtarët e Lëvizjes Kulturore Shqiptare. Autenciteti shqiptar i këtij qyteti, ishte arsyeja kryesore që i detyroi fuqitë e mëdha të vendosnin përkatësitë e tyre në shtetin shqiptar të sapo krijuar. Këtu kemi konsullatën franceze, atë italiane, dhe austriake. Ky zhvillim i madh kulturor, ishte padyshim rezultat i lidhjeve të shumta tregtare të shtresës së borgjezisë qytetare shkodrane me vendet e Europës Perëndimore. Kjo shtresë, mjaft e pasuruar tashmë relativisht ishte shtresë sunduese. Ajo kishte pretendime dhe kërkesa për ndërtime jo thjesht në aspektin e plotësimit të nevojave për banim në përshtatje me kërkesat e reja të kohës, por dhe për ato që sillte jeta shoqërore, aktiviteti tregtar dhe konceptet e reja bashkëkohore. Kjo solli larminë e funksioneve të ndërtesave si hotele, restorante, agjensi tregtare, ndërtesa administrative dhe sociale, njësi tregtimi dhe shërbimi.

Veprimtaria ndërtimore e kësaj periudhe, është e prirur drejt arritjeve më të reja të veprimtarisë bashkëkohore ndërtuese. Ajo tashmë nuk shfaqet si një veprimtari spontane me autor anonim për veprimtarinë ndërtuese të cilësuar arkitekturë popullore dukuri kjo e përgjithshme në vendin tonë gjatë sistemit mesjetaro-feudal, por arkitekturë e kultivuar me autorë dhe profesionistë me zë si Arsen dhe Kol Idromeno, Kristo Sotiri etj. të cilët u shkolluan në vendet e Europës Perëndimore prej nga prunë arkitekturën bashkëkohore si shprehje e civilizimit dhe përshtatshmërisë me karakteristikat e vendit (fig. 4). Por nuk përjashtojmë dhe mjaft arkitekt apo inxhinierë të huaj si francez, italian e austriakë që dhanë me veprat e tyre një ndihmesë të rëndësishme në Artin e të Ndërtuarit Shqiptar.

Në përputhje me kushtet ekonomiko-shoqërore, kërkesat e kohës dhe arritjet bashkëkohore europiane, zhvillimi urbanistik i qytetit të Shkodrës, si përgjithësisht dhe për qytetet e tjera të vendit, fillon të udhëhiqet nga



Fig. 4

hartimi i planeve rregulluese urbanistike. Karakteristikë për këtë periudhë është krijimi i ansambleve urbanistiko-arkitektonike (fig. 5) në të cilat zunë vend ndërtimet me



Fig. 5

funksione të reja bashkëkohore si hotele, restorante ku përmendet "Kafja e Madhe" (fig. 6), agjenci tregtare etj, por mbi të gjitha dyqane të shumtë ku tregtoheshin kryesisht mallrat e importuara. Një pjesë e mirë e borgjezisë së lartë shkodrane u vendos dhe me banim në katet e sipërme të ndërtesave të këtyre ansambleve, ndërkohë që në katet e poshtëm kishin dyqanet e tyre. Karakteristikë e ndërtimeve të kësaj periudhe, është trajtimi i pasur arkitektoniko-dekorativ i pamjeve të

[3] *Rokin Daberdaku* . Albumi "Shkodra vlera tingëlluese".

DO NOT COPY



Fig. 6

jashtme të tyre, me një shumëllojshmëri motivesh artistike të ekzekutuara në suva në qarkimet e dritareve dhe dyerve si dhe në përpunimin e gurit. (fig. 7)



Fig. 7

Një nga arteriet kryesore të rrjetit urbanistik i cili mori vrullshëm zhvillim gjatë periudhës së re, asaj të fund shekulli XIX dhe fillim shekulli XX, dhe që pasqyronte ndjeshëm karakteristikat e mësipërme, ishte "Rruga e Madhe", e ashtuquajtura "Piaca e Shkodrës" (fig. 8) kufizuar në skajin jug-perëndimor me të ashtuquajturat "Dugajt e Reja". Sot kjo rrugë, e emërtuar "Kol Idromeno", i cili konsiderohet si një nga projektuesit e rrugës dhe të një pjese të ndërtesave të ndodhura në dy krahët e saj, është një shembull konkret i ndërthurjes së arritjeve



Fig. 8

bashkëkohore europiane me trashëgiminë kulturore të vendit, duke u rreshtuar në një nivel me qytetet e tjera të pellgut të Mesdheut dhe më gjerë, të asaj kohe.

Shkodra ruan një pasuri të madhe në fushën e Trashëgimisë Kulturore në gjininë e ndërtimeve të kultit, të fortifikimeve, të ndërtimeve inxhinierike, në fushën e ndërtimeve popullore dhe atë të kultivuar, të arteve të aplikuara si dhe në aspektin urbanistiko-arkitektonik mjedisor, me një hapësirë kohore që nga lashtësia deri në ditët e sotme.

Veprimtaria vlerësuese e kësaj trashëgimie pjesë e pasurisë së paluajtshme në fushën e kulturës materiale, është e bashkëlidhur ngushtësisht me konceptin "Monument Kulture", i cilësuar si ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti i përzgjedhur nga shkalla e vlerës që përfaqëson për çdo dëshmi materiale që nga lashtësia e deri në ditët tona si një vazhdimësi historike e brezave. Monument, mund të jetë dhe një objekt i veçantë, në gjendje rrënojë apo i cunguar, i cili ka mbërritur i tillë në ditët tona që nga lashtësia ose nga periudha të ndryshme historike dhe e merr këtë status për vlerat që mbart.

Pasuritë kulturore të rrethit të Shkodrës janë të gjithanëshme si për kohën nga e cila vijnë, ashtu dhe nga gjinia e tyre ndërtimore. Kemi monumente arkeologjike, vend banime të lashta, qyteza, gradishta si Qyteza e Dakajve në Breg Lumë ajo e Ganjollur në fshatin Ganjollë; ndërtime të fortifikuara, si Kalaja Rozafat, (fig. 9) ajo e Drishtit, e Vigut, e Shurdhahut etj.; ndërtime inxhinjerike si ura, rrugë, hamame si ura e Mesit, (fig. 10) ajo mbi përroin e thatë në fshatin Marshej, rruga me kalldrëm nga Gruemira në Repisht,

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12

Hamami në Parrucë, etj ; ndërtime kulti si kisha, xhami, manastire e tyrbe si xhamia e Plumbit, mbeturinat e kishës së Shirqit pranë fshatit Shirq etj.; ndërtime në gjininë e banesës popullore të periudhës shek. XVIII-XIX si ajo e Roza Sumës, e Ismet Halilit, e Filip Çekës etj., ato me vlera të dyfishta historiko-arkitektonike si banesa e Pashko Vasës, (fig. 11) ajo e Hodo Sokolit, e Migjenit, banesa në fshat si kulla e Lulash Keçit, ajo e Ndue Mark Kolës në fshatin Theth, etj; mjedise karakteristike të brendësisë së odës së miqve në banesën karakteristike shkodrane, si në banesën e Xh. Repishtit, atë të E. Shirokës, të Lluejve, etj; objekte të periudhës së fillim shek. XX, si Prefektura, (fig. 12) Teatri, Kinemaja etj, ansamble të plota urbanistiko-arkitektonike si ai i rrugës "Kol Idromeno", i rrugës "Kardinal Mikel Koliqi"etj.

Të gjitha këto monumente, vlerësohen për vlerat e tyre të veçanta historike, urbanistike, arkitektonike, tipologjike dhe artistike dhe gëzojnë statusin "Monument Kulture" të kategorisë I dhe II. Monumente e kategorisë I, janë shembujt më me vlerë të gjinive, tipave dhe evolucionit të tyre dhe ruhen në tërësinë e përbërësve të tyre kompozicionalë, arkitektonikë dhe teknikë. Në këtë kategori monumentesh nuk lejohet asnjë ndryshim që prek kompozimin e volumeve, trajtimin arkitektonik të pamjeve të jashtme, të brendësisë së tyre, si dhe zëvendësimin e materialeve origjinale.

Monumente të kategorisë II, janë ato objekte të cilat me volumin, pamjen e jashtme dhe elementët karakteristikë të periudhës përkatëse plotësojnë vlerat urbanistiko-arkitektonike dhe ambientale të Trashëgimisë Kulturore. Këtë status e përfitojnë dhe ato objekte të ndodhura në ansamblet urbanistiko-arkitektonike të Qendrës Historike dhe të zonës së Mbrojtur të cilat me karakteristikat e mësipërme plotësojnë vlerat urbanistiko-arkitektonike dhe ambientale të Trashëgimisë Kulturore të qytetit të Shkodrës. Këto monumente vihen në mbrojtje individualisht, ashtu si monumentet e kategorisë I.

DO NOT COPY

Cilësimi monument kulture nuk varet nga përkatësia etnike, fetare apo ajo e formimit kulturor të krijuesit apo e pronarit të veprës e cila propozohet për këtë status. Po ashtu, megjithëse monumentet përgjithësisht vijnë nga periudha të kaluara, vjetërsia nuk është një kriter, sepse të qenët monument nuk kushtëzohet nga koha e ndërtimit, por nga përfaqësimi i vlerave historiko-kulturore të periudhave përkatëse, duke konsideruar dhe ato të shekullit XX deri në ditët tona.

Për karakterin e veçantë të saj, gjinia e ndërtimeve popullore e periudhës që prej gjysmës së dytë të shek. XVIII deri nga fundi i shek. XIX, paraqiste problem të prekshëm social. E lidhur me ndryshimet kompozicionale dhe strukturale për një përshtatje dhe përmirësim të kushteve të jetesës në përputhje me kërkesat e reja të kohës, ndërtesat për banim paraqisnin rrezik serioz për zhdukjen e vlerave të rëndësishme kulturore. Kështu me Vendim Nr. 6, datë 15.01.1963, të Rektoratit të Universitetit miratohet lista e monumenteve të kulturës ku përfshihen dhe objektet e Shkodrës.

Vënia në mbrojtje e monumenteve të kulturës të kësaj gjinie në qytetin e Shkodrës si përgjithësisht në vendin tonë, u parapri nga një veprimtari e gjerë kërkimore e cila kishte si kriter gjurmimin, evidentimin dhe vlerësimin e kësaj trashëgimie kulturore ndërthurur me një dokumentacion të hollësishëm grafik dhe fotografik.

Përzgjedhja u bë mbi bazën e kriterit tipologjik, si një faktor i rëndësishëm dhe njëherazi përcaktues i zhvillimit tipologjik të banesës së hapur me çardak me atë të vlerave arkitektonike e përcaktuar në variantet e saj, tipit mbizotërues në Shkodër, si dhe zgjidhjeve të tjera. Ky kriter, padyshim merr vlerë të veçantë nga faktorët shoqërore-ekonomik të periudhës përkatëse që influencuan në zhvillimin e kësaj gjinie ndërtimore.

Qyteti i Shkodrës ruan në mjaft banesa, të pa cilësuara monumente për shkak të ndryshimeve të thella dhe pa vlera arkitektonike, elementë të mobilimit arkitektonik me vlera të rëndësishme të arteve të aplikuara të pasqyruara në zbukurimoren e të ashtuquajturës "oda e miqve". Kjo kategori monumentesh specifike për qytetin e Shkodrës, përbëhet nga punime druri të daltuara si tavane, trapazane, musandra, sergji, dollap muri, kapak terri të dritareve dhe dyerve; punime në stuko reliev si tavane, oxhak dekorativ dhe piktura në tavan dhe trapazan (fig. 13, 14). Këto monumente, janë një risi e çmuar e kësaj vlere vënia në



Fig. 13



Fig. 14

mbrojtje e së cilës u parapri nga një veprimtari sistematike, e kryer me profesionalizëm. Fatkeqësisht duhet të pranojmë se, kalimi nga njeri sistem te tjetri solli shpërdorimin e kësaj pasurie me shkatërrim dhe dëmtim të saj dhe në mjaft raste, shitje dhe përtej kufijve duke u reduktuar mjaft.

Botim QBK

Kriteri përzgjedhës i veprave të kulturës materiale në cilësimin monument kulture, ka patur parasysh vënien në mbrojtje dhe të shembujve më tipike të evolucionit të banesës fshatare të periudhave të ndryshme, me shtrirje të plotë territoriale. Duke qenë kjo një hapësirë relativisht pak e gjurmuar dhe e evidentuar deri atëherë, për kushtet e reja të krijuara numerike dhe profesionale të specialistëve të kësaj fushe, del vendimi "Mbi gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve popullore" i Këshillit të Ministrave Nr. 229, datë 01.11.1974. i cili i vë theksin veçanërisht vlerësimit të banesës fshatare. Ekspeditat e shumta gjurmuese në fshatrat e Shqipërisë në përgjithësi dhe ato të rrethit të Shkodrës, sollën shpalljen monument kulture të një numri të konsiderueshëm banesash, kulla në zonën e Dukagjinit, fshatin Theth, Breg Lumë etj. Kriteri përzgjedhës për këto monumente është ai tipologjik i cili ka patur parasysh të evidentojë për çdo krahinë banesën tradicionale me vlera përfaqësuese të trashëguar në ditët tona.

Një veprimtari e veçantë në fushën e Trashëgimisë Kulturore është dhe ajo e ansambleve me vlera të rëndësishme urbanistiko-arkitektonike duke kuptuar me këtë cilësim, qendra qytetare apo fshatare të periudhave të ndryshme kohore të cilat përbëjnë tërësi urbanistiko-arkitektonike të qendrave të banuara, formuluar sipas kritereve kompozicionale të së kaluarës. Duke qenë kjo një veprimtari mjaft e gjerë dhe e spikatur për vlerat e saj komplekse në mbarë qytetet tona, përjashtuar Gjirokastrën dhe Beratin të cilat gëzonin statusin e "qytetit Muze", Këshilli i Ministrave me vendimin Nr. 249, datë 01.07.1980, vendosi "Vënien në mbrojtje të lagjeve dhe të ansambleve me vlera arkitektoniko-historike në qytetet Korçë, Elbasan, Shkodër, Vlorë dhe Tiranë".

Shkodra e fund shekulli XIX dhe fillim shekulli XX, paraqiste vlera të rëndësishme urbanistiko-arkitektonike dhe historike të cilat i kalonin vlerat kombëtare. Si të tilla, në Shkodër u vunë në mbrojtje me cilësinë e Zonës Muze, ansambli i rrugës "Kol Idromeno" (ish rruga 13 Dhjetori) dhe ai i rrugës "Kardinal Mikel Koliqi" (ish rruga Branko Kadia) dhe në cilësinë e Zonës së Mbrojtur, ansambli i rrugës "Luigj Gurakuqi".

Në këndvështrimin e vazhdimësisë së vlerësimit të trashëgimisë kulturore për periudhën relativisht të re, atë të fillim shekulli XX, hapësirë kohore kjo, disi e mangët në drejtim të përfaqësimit të shembujve më me vlerë të gjinive të ndryshme në aspektin urbanistik, arkitektonik, historik, tipologjik, funksional dhe artistik, u pa e arsyeshme gjurmimi dhe evidentimi i objekteve për statusin monument kulture. Përzgjedhja e kësaj pasurie, mbështetur dhe në profesionalizmin bashkëkohor solli për qytetin e Shkodrës, shpalljen e objekteve të reja në fushën e ndërtimeve e cilësuar tashmë "arkitekturë e kultivuar" në dallim nga ajo e periudhës së shek. XVIII-XIX si "arkitekturë popullore", me cilësinë monumente kulture të kategorisë II. Me këtë kategori vlerësohen ato objekte të cilat, megjithëse në brendësi janë me ndryshime të thella dhe si të tilla pa vlera tipologjike dhe arkitektonike, me volumin, pamjet e tyre të jashtme dhe elementët karakteristik përfaqësojnë vlerat e periudhës përkatëse. Përsa i përket brendësisë, në këto monumente, lejohet çdo ndryshim apo përshtatje e brendshme për një shfrytëzim më racional e komod në përshtatje me kërkesat e reja të kohës, duke përdorur për këtë qëllim struktura të reja me kusht që të mos cënohet pamja e jashtme e tyre.

Në kuadrin e plotësimit të vlerave të Trashëgimisë Kulturore për qytetin e Shkodrës dhe përcaktimit bashkëkohor të kësaj trashëgimie si Qendër Historike dhe Zonë e Mbrojtur, u bë rizonifikimi i cili kishte për qëllim plotësimin e kuadrit urbanistiko-arkitektonik dhe historik të periudhës së fillim shekullit XX.

Me Qendër Historike, kuptojmë ansamblin qytetar me vlera historiko-kulturore, ndërsa Zona e Mbrojtur është ajo pjesë e qytetit e cila me vlerën e saj plotësuese historike, urbanistike, arkitektonike dhe ambientale luan një rol me rëndësi të veçantë në tërësinë e Trashëgimisë Kulturore të paluajtshme të qytetit. Të dyja këto zona mbrohen nga shteti.

Kështu, Qendra Historike përbëhet nga ansamblet urbanistiko-arkitektonike të rrugëve "Kol Idromeno", "Kardinal Mikel Koliqi"dhe i rrugës "13 Dhjetori" (fragmenti nga Kafja e Madhe deri te Prefektura); Zona e Mbrojtur përfshin ansamblin urbanistiko-arkitektonik të rrugës "Aleksandër Moisiu", të rrugës "Bardhok Biba", të rrugës "Gurazezve", të rrugës "Gurakuqve", të rrugës "Murgeshave", të rrugës "Ndre Mjeda", dhe të rrugës mbas Kafes së Madhe. Gjithashtu në këtë zonë bëjnë pjesë territoret bashkëngjitur ansambleve të Qendrës Historike sipas hartës përkatëse, pjesë integrale e zonifikimit.

Do not copy

Statusin monument kulture të kategorisë II, e përfitojnë dhe ato objekte të ndodhura në ansamblet urbanistiko-arkitektonike të Qendrës Historike dhe të zonës së Mbrojtur të cilat me karakteristikat e mësipërme plotësojnë vlerat urbanistiko-arkitektonike dhe ambientale të Trashëgimisë Kulturore të qytetit të Shkodrës. Këto monumente vihen në mbrojtje individualisht, ashtu si monumentet e kategorisë I.

Si pjesë integrale e Zonifikimit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur vjen në konsideratë rregullorja "Për Mbrojtjen, Restaurimin, Administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Shkodrës". Qëllimi dhe objektivat e kësaj rregulloreje konsistojnë në mbrojtjen, konservimin, restaurimin dhe administrimin e vlerave historike, urbanistike dhe mjedisore të Qendrës Historike dhe zonës së Mbrojtur të qytetit të Shkodrës sipas hartës bashkëngjitur, gjithashtu përcakton mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të ngarkuara për objektivat e mësipërme, si dhe miradministrimin e këtyre vlerave, me njësitë e qeverisjes vendore. Rregullorja përkatëse, detyron institucionet që merren me hartimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe rretheve të bashkëpunojnë me IMK dhe t'i marrin parasysh qendrat historike dhe zonat e mbrojtura, duke i vlerësuar ato në projektet për zhvillim.

Një aspekt mjaft i rëndësishëm dhe vendimtar në fushën e monumenteve të kulturës, është termi "restaurim", me të cilin kuptojmë vlerësimin e thelbit origjinal të monumenteve nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjes në pah të vlerave të tyre. Restaurimi, si ndërhyrje e thellë në monument, konsiderohet si një veprim i jashtëzakonshëm[4]. Ndërhyrja restauruese, bazohet në kritere të mirëpërcaktuara mbi parimet teoriko-praktike të Kartës së Venecias. Autori duhet të njohë vlerat historiko-kulturore të monumentit, evolucionin e tij në kohë, fazat e ndërtimit, vlerat urbanistiko-arkitektonike, teknikën dhe materialet e ndërtimit. Bashkërendimi i historisë së arkitekturës dhe studiuesit restaurator i jep mundësinë restauratorit të hartojë idenë e restaurimit e cila përfshin pjesën grafike, projektin e restaurimit, relacionin përshkrimor, specifikimet teknike dhe preventivin e ndërhyrjeve restauruese.

Kjo e bën të domosdoshëm, që hartimi i projektit të restaurimit për monumente të veçantë apo dhe ansamble, të hartohet dhe të udhëhiqet nga specialisti restaurator, i cili mbi bazën e studimit të monumentit, përvetësimit të parimeve teorike dhe praktike të zbatojë sipas kritereve të duhura projektin e restaurimit.

Zbatimi korrekt dhe cilësor i projektit të restaurimit, është padyshim i varur nga ekipi profesional i mjeshtrave të ndërtimit, të trajnuar me vite pranë institucioneve të specializuara për restaurim, siç janë Drejtoritë Rajonale të Monumenteve të Kulturës nëpër rrethe. Për ato subjekte apo institucione të liçensuara për këtë aktivitet, duhet treguar kujdes gjatë punës së tyre zbatuese në monument.

Monumentet e kulturës, pavarësisht nga të qënurit subjekt shtetëror apo privat, janë vlera kombëtare të vendit. Si të tilla, për ato monumente që janë pronë e subjekteve private, shteti përballon të gjitha ato shpenzime që bëhen për ruajtjen e vlerave historiko-artistike të cilat nuk lidhen me qëndrueshmërinë e monumentit. Për punimet e tjera të restaurimit, për monumentet e kategorisë I, shteti përballon 60% dhe pronari 40% të punimeve ndërsa, për monumentet e kategorisë II, shteti përballon 30% dhe pronari 70 % të punimeve.

Duhet theksuar se, vitet pas tranzicionit për arsye nga më të ndryshmet, kanë sjellë dëmtime të konsiderueshme në fushën e Trashëgimisë Kulturore për qytetin e Shkodrës. Janë dëmtuar vlera unikale historiko-arkitektonike, si banesa e patriotit të shquar Luigj Gurakuqi dhe Daut Boriçi, banesa e Myfti Plakut dhe e Roza Sumës, mjaft mjedise karakteristike të të ashtuquajturës "oda e miqve", transformime dhe ndërtime pa leje janë bërë në Qendrën Historike dhe në Zonën e Mbrojtur të qytetit të Shkodrës duke ia tjetërsuar pamjen karakteristike.

Vlerësimi i monumenteve të kulturës në vendin tonë, është bërë mbi bazën e Kartës Ndërkombëtare të Konservimit dhe Restaurimit të Monumenteve dhe të Ansambleve Monumentale, të miratuara në Kongresin II Ndërkombëtar të Arkitektëve dhe Teknikëve të Monumenteve Historike, mbledhur në Venecie më 23-31 Maj 1964. Megjithëse në vendin tonë mungonte përgatitja fillestare profesionale për këtë gjini kaq specifike të vlerësimit të kulturës materiale, duhet

[4] *Emin Riza.* "Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve në Shqipëri".

theksuar se, saktësia e evidentimit dhe e vlerësimit të këtyre objekteve mbi bazën e kritere ndërkombëtare, është pa dyshim shprehje e profesionalizmit e shpjeguar me cilësitë individuale dhe bashkëpunim në grup udhëhequr nga pasioni për këtë trashëgimi kulturore si dëshmi historike e periudhave të ndryshme ardhur deri në ditët tona. Trashëgimia Kulturore e qytetit të Shkodrës, është pasuria kulturore, materiale dhe shpirtërore me vlera historike, urbanistike, arkitektonike dhe artistike që meriton të ruhet dhe të trashëgohet në shekuj, si pjesë e pandarë e pasurisë kombëtare të vendit tonë.

Proçesi i vlerësimit të monumenteve është i lidhur me proçese të shumta specifike të cilat kanë për qëllim ruajtjen e kësaj pasurije për gjini të ndryshme veprash, të cilat kanë rezistuar deri në ditët tona.

DO NOT COPY

Shpresa PRIFTI

DO NOT COPY

CULTURAL HERITAGE OF SHKODER REGION AND CRITERIA OF ITS EVALUATION

Development and beginning of Shkoder city, is linked closely with Rozafat fortress.

During the century VIII, Shkoder as a centre of North Albania, intercommunication link up and transit mole with Balkan, was also a craft-merchant centre. Bazaar called "Old Market" of Shkoder was an open pavilion, belonging to Prizren Connection and Independence was established at Buna river port. The most representative object of bazaar was Bexhisteni. This belongs to the growing power of Bushatllinj Pashallek of Shkoder built at beginning of XIX century.

During to the middle of XIX century, at Shkoder was built and open garret (çardak) dwelling with different types. This was a typical popular architecture and conception and applier was popular.

Shkoder city of nowadays is separated from fortress and is established on the southeast of fortress. Building of this new centre built during the second half of XVIII century and first half of XIX century brings coexistence of these two centres.

XIX Century mainly for Balkan countries brought general socio-economic development and falling the medieval craft system. This situation brought more merchant connections with West European countries.

Coordination of the habituated centre with merchant centre is a determinative moment on the development road of Shkoder city. This process has close links with sensitive urban transformers and architectonic physiognomy of the city.

Development brought diversity of the building functions like hotels, restaurants, merchant agency, administrative and social building, service and selling point.

Building activity of this period has a modern tendency. It is a cultivated architecture with famous and specialists like Arsen and Kol Idromeno, Kristo Sotiri etc. who were educated at West European schools.

According to the socio-economic conditions, time demand and modern European achievements, urban development of Shkoder city, began designing of city urban plans. Characteristic of this time was a rich architectonic–decorative façade treatment, with lots of artistic motives treated at plaster on the corner of windows, doors and stone carving.

One of the main roads which has take enormous development during the XIX century and beginning of XX century was "Rruga e Madhe", famous "Piaca e Shkodrës" bordered with "Dugajt e Reja" on the south-west. Today this road is named "Kol Idromeno", one of the road designers and part of the buildings too established at its both sides. This is a very concrete example of fitting the traditional cultural heritage with European contemporaneous achievements.

Shkoder is very rich in Cultural Heritage for the cult, fortified, engineering popular and cultivated buildings, and applied arts and in urban-architectonic environmental aspects too.

Evaluation activity of this heritage as part of material cultural heritage is linked closely with "Culture Monument" concept.

Cultural heritage of Shkoder are many kind like: archaeological monuments, ancient dwellings, small cities; fortified buildings; engineering buildings like: bridges; roads; hamame; cult buildings like: churches; mosques; monasteries; tyrbe; buildings of popular dwelling which belong XVIII-XIX century; dwelling in villages like towers; characteristic shkodran dwellings;

ambient of host's room too; objects of beginning XX century and complete urban-architectural ensembles.

All these monuments are evaluated for their especial historic, urban, architectonical, typological and artistic values and have "Culture Monument" status by belonging to the I-st and II-nd category.

Historic Centre is citizen ensemble with historic-cultural values, Protected Zone is that part of the city which with its values as part of the city with fulfil historic, urban, architectonic and environmental values plays an important role for the Cultural Heritage of the city.

"Restoring" is a very important and decisive aspect on the field of culture monuments. Restoring is evaluation of original contend of monument which with interventions we stop further decay and show their unique values.

Restoring is considered as extraordinary intervention in the monument. Collaboration of architecture history with restoring studier gives the possibility to the restorer to create restoring idea. This has drawing part, restoring project, narrative relation, technical specification and preventive of restoring intervention.

Qualitative and correct applying restoring project is connected with the professional team of the building masters who has taken trainee at specialized institutions like Regional Directorate of Culture Monuments many years ago.

Many damages are present at Heritage Cultural field for Shkoder city. Unique architectural-historical values like dwellings, many characteristic ambient of host's room are damage too. Transformations and building without permission are done at Historic Centre and Protected Zone of Shkoder city and these has effected negatively at its characteristic image.

Cultural Heritage of Shkoder city is cultural, material and spiritual assessment with historical, urban, architectonical and artistic values which in necessary to protect, preserved and developed as part of national heritage of our country.

DO NOT COPY

Kastriot DERVISHI

DO NOT COPY

ELEMENTË TË PIKTURËS LAIKE NË IKONOGRAFI

Në Muzeun Kombëtar "Onufri" në Kalanë e Beratit, gjenden dy ikona që i përkasin të njëjtës skenë, dhe pikërisht "Shtatë shenjtorët sllavë". Këto ikona janë realizuar nga dy ikonografë të ndryshëm. E para është realizuar në vitin 1814 nga i famshmi Johan Prend Çetiri, dhe e dyta nga Adam Kristo, e cila daton 27 shtator 1873. Këto dy ikona kanë bërë pjesë në ikonostasin e kishës së "Shën Gjergjit" në Kalanë e Beratit.

Në të dy ikonat paraqiten shtatë shenjtorët sllavë, pesë qëndrojnë në këmbë Kirili, Metodi, Klementi, Naumi dhe Sava dhe dy janë shtrirë (të vdekur) të cilët janë Angjellari dhe Grazhdani, eshtrat e të cilëve gjenden në Katedralen e Kalasë (Muzeu "Onufri"), (fig. 1dhe 2).

Ajo që është me interes dhe që është risi, për artet pamore në Shqipëri, dhe më konkretisht për Beratin, janë elementët real në peisazhin që figuron këto ikona. Koleksioni i ikonave të Beratit përmban vetëm këto dy ikona me elementë të peizazhit të Beratit. Mënyra e pikturimit, ngjyrat, teknika e ekzekutimit, të gjitha përmbajnë vulën e kohës, por ajo që del jashtë kohës është peizazhi i identifikueshëm i qytetit të Beratit.

Në programin ikonografik të çdo kishe të krishterë ortodokse në Shqipëri, ikonat kanë skenat e tyre të përcaktuara. Këto ikona kanë bërë përjashtim jo nga përmbajtja religjioze e skenës, por nga paraqitja figurative e skenës me elementët e peisazhit.

Ajo që i bën me interes, për artin laik në pikturën e Beratit, është peizazhi i Beratit dhe pikërisht janë: Lagjia Kala me banesat dhe muret e saj rrethues, pamja e shkëmbit të thepisur që bashkohet me lumin nga ana e juglindjes ku janë vendosur të shtrirë (të vdekur) dy figurat e shenjtoreve Angjellari dhe Grazhdani dhe Kisha e Shën Mëhillit, Kisha e Shën Marisë pranë Urës së Goricës (e djegur gjatë Luftës së Dytë Botërore) dhe



Fig. 1. Johan Prend Çetiri "Shtatë shënjtorët sllavë", 1814

DO NOT COPY



Fig. 2. Adam Kristo, "Shtatë shënjtorët sllavë", 27 shtator 1873



Fig. 3. Shën Mëhilli



Fig. 4. Shën Mëhilli

lagja "Mangalem" ku dallohen qartë elementët e arkitekturës së Beratit ndërtesat me çardak të mbuluar, dalja në gjysmë kati dhe me erker, si dhe një element mjaft i rëndësishëm dritaret njëpërmbinjë, fasadat e bardha dhe portat tipike (Fig. 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10).

Vlen të theksohet pikturimi në të dy ikonat i rreshtit të parë të dyqaneve në lagjen Mangalem. Arkitekti, Arben Arapi i cili është edhe autor i ndryshimeve të fasadave të dyqaneve, shkruan: "Brezi i dyqaneve në këmbët e lagjes "Mangalem" erdhi në ditët tona i ndryshuar, aq sa vizualisht s'kishte asgjë me vlerë, duke kompromentuar rëndë njësinë e kompozimit të ansamblit, dyqanet kishin humbur gjurmët e dikurshme". Arapi nuk shkruan në studimin e tij për mbështetje në anën vizuale në ikonën e Kristos, por është mbështetur në logjikën e vazhdimit të rrugës tregtare. Pra dyqanet u ritrajtuan në frymën e arkitekturës tradicionale (Fig. 11, 12, 13).

DO NOT COPY



Fig 5. Shën Maria



Fig 6. Shën Maria



Fig. 7. Çardak



Fig. 8. Çardak



Fig. 9. Kalaja



Fig. 10. Kalaja



Fig. 11. Rindërtimi i dyqaneve në frymën e ikonës së Adam Kristos



Fig. 12. Rindërtimi i dyqaneve në frymën e ikonës së Adam Kristos



Fig. 13. Rindërtimi i dyqaneve në frymën e ikonës së Adam Kristos

Ura e Goricës dhe lumi Osum janë dy elementë që plotësojnë peizazhin e plotë të këtyre ikonave (Fig. 14, 15).

Paraqitja e peizazhit sipas figurimit të imazhit bizantin tregon që për piktorin Çetiri, qyteti i Beratit, me natyrën dhe Kalanë e tij të fortifikuar e përmbushte imazhin e një vendi të shenjtë. Ikona e Çetirit e ka të pikturuar imazhin e Beratit në mënyrë tipike bizantine. Ndërsa Adam Kristo e pikturon me shumë realizëm imazhin e Beratit. Krahasimi i elementëve real nga pikëpamja figurative është bërë vetëm me ikonën e Kristos pasi tek ai ka më tepër realizëm.Të dy autorët me anë të peizazhit ilustrojnë mendimin mbi vendin e ngjarjes.

Për herë të parë në historinë e artit botëror një imazh të identifikueshëm në një vepër me elementë realë e shikojmë në veprën e piktorit zviceran Konrad Witz, më 1444 titulluar "Mrekullia e peshqve" (Jezusi iu kërkon peshkatarëve të hedhin rrjetën në krah të djathtë të lundrës dhe rrjeta u mbush aq shumë me peshk sa që peshkatarët nuk e tërhiqnin dot). Në këtë skenë piktori ka pikturuar liqenin e Gjenevës me malin e lartë të Saleve në sfond. Kjo është paraqitja e parë e saktë me një pamje reale të natyrës. (fig. 16)



Fig. 14. Ura e Goricës



Fig. 15. Ura e Goricës



Fig. 16. Konrad Witz "Mrekullia e peshqve" 1444.

Literatura e përdorur:
Gazmend Muka, "Artthënia Bizantine te Çetirët", fq.65.
Ernest Gombrixh, "The History of Art" fq. 244
Fatmir Thaçi, "Eptarithimi" Johan Prend Çetiri (Katro) 1985.
Arben Arapi, "Disa aspekte të restaurimit në ansamblet e qytetit muze të Beratit". Monumentet, nr 38, 1989.
Kartelat e muzeut "Onufri" nr. 37 dhe 86.
Theofan Popa "Mbishkrime të kishave në Shqipëri" fq. 138

DO NOT COPY

Kastriot DERVISHI

ICONOGRAPHY LAIC ELEMENTS OF PAINTING

DO NOT COPY

National Museum "Onufri" at Berat castle has two icons that have the same scene, exactly "Seven Slav Saints". First is realised on year 1814 from the famous Johan Prend Cetiri and the second from Kristo, which is dated September 27, 1873. These two icons have been part of iconostasis established in "Saint George" church at Berati castle.

Seven Slavs saint are painted at two icon, five are standing Kirili, Metodi, Klementi, Naumi and Sava and two are laid down (dead), they are Angjellari and Grazhdani, and they bones are at Castle Cathedral ("Onufri" Museum).

Berat icon collection has only these two icons, which have landscape from Berat. Paintings manner, colours and painting technique all of them keeps characteristic of that time but identified landscape of Berat comes out of these characteristics. These two icons are exception from figurative scene with landscape elements.

Interest for laic art on Berati painting is Berati landscape and precisely are: Castle quarter with surround wall and its dwellings, landscape of sharp-edged rock where are painted laid down (dead) figures of two saints Angjellari and Grazhdani, church of Saint Mehilli, church of Saint Maria close to Gorica bridge, "Mangalem" quarter where are clearly identified Berat architecture elements, dwellings, appearance half of first floor and with esker, and a very typical element windows which are established one over the other one, white facades and typical doors.

Shops are retreated with typical traditional architecture. Gorica Bridge and Osum River are two elements which fulfil completely landscape of these icons. Representing of landscape according to the Byzantine landscape image shows that: painter Cetiri was convinced that Berati city with its nature and fortified castle fulfils image of the holy place. Cetiri icon has painted Berati landscape in a typical Byzantine manner. Cristo paint with more realism Berati landscape.

The world history of art for the first time we see an identified landscape with real elements at Conrad Wits a Swiss painter on 1444 named "Fish miracle". (Jesus asks fisherman's to throw the net on the right side of the boat and the net was full with fish and became so heavy that the fisherman's can not pull over the net). In this scene the painter has paint Geneva Lake with Saleve a high mountain on wallpaper. This is the first exact representing real landscape of nature.

Hasan NALLBANI

KISHA E SHËN MËRISË NË ZERVAT, GJIROKASTËR DHE RESTAURIMI I PIKTURAVE TË SAJ

DO NOT COPY

Vështrim historik

Kisha e Fjetjes së Shën Marisë gjendet në fshatin Zërvat të krahinës së Dropullit, e cila shtrihet në luginën e lumit të Drinosit, ndërmjet malit të Gjerë në njërën anë dhe malit të Strugarës në anën tjetër. Kisha ndodhet në hyrje të fshatit. E rrethuar me mure dhe, hapësira e oborrit përdoret si varresë e fshatit. Kisha është e pikturuar në vitin 1606 nga Mihali dhe Nikolla. Mundet që Mihali të jetë piktori i njohur nga Linotopi, fshat afër Kosturit i cili ka pikturuar kishën e manastirit të profet Ilias mbi fshatin Jorgucat (1617), kishën e manastirit të Ungjillëzimit mbi fshatin Vanisht (1617) si dhe kishën e manastirit të Shpërfytyrimit në Çatishtë (1626). Ndërsa Nikollën e gjejmë në kishën e Shën Kollit në Saraqinisht ku ka piktuar me Mihalin dhe djalin e këtij të fundit Konstandini (1630). Ndërsa në vitin 1653 së bashku me Konstandinin kanë dekoruar kishën e manastirit të profet Ilias në fshatin Stegopul. Veprimtaria e kësaj atelieje është mjaft e gjerë. Piktorët e saj kanë lënë veprat e tyre në muret e shumë kishave të krahinave të ndryshme në Etoli, Pelion, Maqedoni, Epir, Shqipërinë e jugut, Jugosllavinë, Bullgarinë, dhe ndoshta në Malin e Shenjtë në shtrirje kohore gjatë fundit të shek. të XVI e deri në fillim të shek. XVIII. Mbishkrimi i kishës së Fjetjes së Shën Marisë në Zervat ruhet mbi derën e faqes perëndimore që hyn për në narteks.

Duke vështruar me kujdes shtresëzimin e intonakos pikturore kuptohet që piktura nuk është e tëra afreskuar nga një dorë dhe jo në të njëjtën kohë. Kjo bëhet e qartë nga kufij të dukshëm ndarës dhe elementë dekori e shenjash skenografike të integruara në një tërësi tematike, por me diferenca stili dhe niveli artistik. Duhet të shënojmë edhe një të dhënë tjetër të rëndësishme e cila është e dallueshme. Në pjesën fundore të apsidës ku shihet qartë një shtresë suvaje e pikturuar, çka bën të kuptojmë që kisha ka pësuar jo vetëm rindërtime të ndryshme, por edhe është ripikturuar disa herë. Data 1606 është kufiri i fundit i dekorimeve që janë aplikuar në muret e saj.

Tipologjia dhe morfologjia e arkitekturës

Kisha përbëhet nga naosi, narteksi dhe hajati në anën jugore, i cili lidhet me portik në hyrjen kryesore të naosit. Naosi i përket tipit bazilikal trenefëshe me kupolë dhe nef tërthor. Altari ndahet nga naosi dhe me ikonastas druri, i cili mbështetet në çiftin lindor të pilastrave. Në anën lindore janë tre absida ajo e bemës, protezisit dhe diakonikonit.

Në faqen perëndimore është porta që lidhet me narteksin i cili mbulohet në pjesën qëndrore me qemer cilindrik gjatësor, ndërsa pjesët anësore me qemer cilindrik tërthor më të ulët se qemeri qëndror. Hyrja veriore e narteksit mbrohet nga portiku i mbuluar me çati druri. Mbi frontin e murit perëndimor të narteksit ngrihet kambanorja.

- **Regjistrimi ikonografik i pikturave.** Kisha e fjetjes së Shën Marisë është monument që ruan të plotë ciklin tematik të shpërndarë në tërë brendinë e kishës. Krejt mbulesat e nefeve gjatësor dhe atij tërthor, kupola tamburi, trekëndëshat (pandativët), apsidat dhe muret anësore të naosit janë të veshura me piktura. Vetëm narteksi nuk është i mbuluar me pikturë në tërë sipërfaqet e tij të lira.

- **Bërthama qëndrore dhe kupola.** Në qendër të kupolës është paraqitur Krishti Pantokrator i përfshirë brenda një medalioni rrethor. Figura paraqitet deri në

DOKTORATURË

mes me librin në dorën e majtë, ndërsa me dorën e djathtë bekon. Në vazhdim më poshtë në anët e Tumburit janë apostuj dhe kryeengjëjt në këmbë me pamje ballore. Në katër pendativat janë pikturuar ungjillorët. Në dy pilastrat që ndajnë naosin nga altari dhe ku mbështetet ikonostasi është pikturuar skena e ungjillëzimit. Në pilastrin verior, mbi lartësinë e ikonostasit paraqitet Shën Maria në këmbë para një poltroni, ndërsa në pilastrin jugor kryeëngjëlli Gabriel me gjestin e lajmërimit paraqitet gjithashtu i plotë. Faqet e brendshme të harqeve të bërthamës qëndrore, si dhe të gjithë harqet e tjerë janë të veshura me figura apostolike të vendosura simetrikisht ndaj kyçeve të harqeve.

- **Faqja lindore.** Konka e bemës përmban Shën Marinë Platiterë, me krishtin foshnjë në gjoks. Poshtë saj janë paraqitur jerarkët, ndërsa sipër mbi harkun e konkës janë dy ëngjëj përballë njëri-tjetrit. Në pjesët anësore janë paraqitur krishti Emanuel në konkën e diakonikonit dhe skena e vajtimit në qendër të konkës së protezisit. Poshtë platiterës janë një radhë medalione me profetë në formën bust e në brezin e fundit të apsidës jerarkët në këmbë që shpalosin pergamenë në duar. Figurat e etërve vazhdojnë në të dy anët e mureve anësorë të zonës së bemës, si edhe në faqet lindore të pikturave katrore që ndajnë ambjentin e altarit. Një sistem brezash të ngjyrosur ndarës me motive dekorative gjeometrike e floreale përkufizojnë gjithë skenat dhe figurat e kësaj zone.

- **Faqja Veriore.** Në pjesën e sipërme në brezin midis skenave të mëdha dhe figurave të martirëve dhe shenjëtorëve në këmbë, janë një rresht me medalione rrethore me paraqitje martirësh në formë bust. Ndërsa shenjtorët në këmbë, në paraqitje ballore dhe me lëvizje të lehta ruajnë madhësi gati natyrale, poshtë tyre një brez i gjerë dekori gjeometrik, i cili rrethon gjithë sistemin e figurave të brezit fundor në nivelin e stolave anësor të kishës, si dhe në zona të ndryshme ndarëse e veçanërisht nëpër kufizimet anësore e gjatësore të dritareve, paraqitet me forma gjeometrike e floreale, me ngjyra të kuqe e të zeza mbi sfonde të qartë.

- **Faqja jugore.** Përmbajtja e kompozimi i faqes jugore është simetrikisht i ngjashëm me atë të faqes veriore, duke ndryshuar vetëm përmbajtja e figurave dhe skenave sipas repertorit ikonografik, që zakonisht paraqitet në regjistrin tematik të pikturave.

- **Faqja perëndimore**. Në faqien që mbyll nefin gjatësor qëndror, mbi portën që lidh naosin me narteksin është mbishkrimi në të cilin me shkronja greke midis tjerash shënohet data 1606 e pikturimit, si dhe emrat e piktorëve. Mbi këtë kuadrat të kufizuar, është paraqitur skena e madhe e fjetjes së Shën Marisë. Faqet që mbyllin nefat gjatësor dhe anësor, kanë të njëjtin kompozim. Në lunatat e qemerëve janë pikturuar skena të ndryshme, ndërsa poshtë tyre brezi me medalionet e martirëve dhe më poshtë shenjtorët në këmbë të përkufizuar së fundi me brezin dekorativ. Në të djathtë të portës së naosit është paraqitur skena me Konstandinin dhe Helenën, si dhe tre figura shenjtore gra në këmbë. Në të majtë të portës, është kryeengjëlli Mihail, me veshje luftarake me mburojë dhe shpatën në dorë, si dhe katër figura të tjera me të njëjtin qëndrim ballor dhe me përmasa të përbashkëta.

- **Qemeri i nefit jugor**. Në aksin gjatësor, janë pikturuar pesë medalione rrethore që harkojnë figura shenjtorësh me prerje bust. Në të dy krahët e brezit qëndror, ku janë medalionet ndeshin të shpërndara skena nga jeta e Krishtit. Skena si Joan Gojëarti, ose burimi i urtësisë etj, dekorojnë këto zona. Në pjesën e nefit, në zonën e altarit, nuk gjejmë brezin me medalione, duke u mbushur këto sipërfaqe me katër skena të ndryshme.

- **Qemeri i nefit verior.** Ka të njëjtën shpërndarje në kompozime e figura, si dhe mbulesa e nefit jugor. Ndryshe janë vetëm gjashtë medalione me paraqitje grash shenjtore.

- **Qemeri i nefit qëndror**. Në sipërfaqet e qemerit të nefit qëndror, i cili i takon naosit, janë kompozuar dy grupe me skena të ndara me një brez medalionësh që zhvillohen në drejtim tërthor, ndërsa mbyllen me një tjetër brez medalionesh që lidh kolonat rrethore të bërthamës qëndrore. Qemeri qëndror me ambjentin e altarit është gjithashtu i mbushur me skena të kufizuara me një brez medalionesh, i cili lidh pilastrat katrore ku mbështetet ikonostasi.

- **Qemeri i nefit tërthor**. Ka të njëjtin kompozim si dhe qemeri i nefit gjatësor qëndror.

- **Narteksi.** Në mënyrë më të plotë është pikturuar qemeri qëndror dhe pjesërisht muret, ndërsa në qemerët anësor mungon piktura. Në qendër të qemerit qëndror, paraqitet Shën Maria, brenda një medalioni në formën e platiturës me Krishtin e ri përpara. Rreth figurës

shpërndahen një seri medalionesh me paraqitje shenjtorësh dhe të ndërthurur me valëzime ornamentesh, që mbyllen në një rreth më të madh, brenda një katrori në kanalet e të cilit pikturohen figura më të vogla shenjtorësh. Në të dy krahët janë skenat me banesat e Himnit Akanthik. Në murin jugor, brenda një nikeje është paraqitur Krishti i rrethuar nga gratë vajtuese. Një brez dekori me motive gjeometrike përkufizon zonën e nikes. Në murin verior, në krah të një dere, ndërmjet së cilës hyhet në narteks, është paraqitur një skenë katrore me figurën e Shën Gjergjit kalorës si dhe me figurat e grave që presin Shpëtimtarin.

Faqia lindore si zakonisht është e mbuluar nga skena e Gjygjit të Fundit, e cila shpërndahet në të dy anët e derës së hyrjes. Në krahun e majtë të saj, është Shën Kolli, në këmbë me libër në dorë i rrethuar sipër me dy engjëj.

- **Konsiderata mbi pikturën.** Piktura murale e kishës së fjetjes së Shën Marisë në Zervat të Gjirokastrës paraqet një ansambël të plotë të organizuar, tematikisht dhe të shpërndarë në harmoni me ansamblin arkitektonik. Trajtimi dhe organizimi ikonografik i temave, zgjidhjet kompozicionale me silueta, figura dhe skena të ndërtuara me mjeshtëri të nënvizuara nga ndarje dekorative me motive të pasura plot ngjyra e kontraste, përcaktojnë karakterin e kësaj pikture. Elemente të peizazhit natyror si dhe ato arkitekturor janë shumë të përdorur në skemat kompozicionale ku figurat njerëzore gjithsesi zënë vendin kryesor. Peizazhi krijon sfondin e figurave me zgjidhje skenografike dhe përcakton karakterin e temave duke ndihmuar në shprehjen e pathosit dramatik të tyre. Figurave kryesore ju krijohet vendi në plan të parë ose të dytë sipas episodeve përkatëse të çdo skene. Me lëvizjet e tyre figurat përcaktojnë hapësirat dhe krijojnë raporte të përshtatshme me idenë e perspektivës. Pikturat lënë tek shikuesi mbresa të pasura nëpërmjet qartësisë grafike të siluetave të cilat rrallohen ose dendësohen në varësi të përmbajtjes tematike. Figurat paraqiten të lehta me raporte elegante sipas rastit herë në përmasa të vogla ose më të plota e impozante të grupuara ose të paraqitura në ndarje të cilat i japin pikturës vlera të veçanta plastike. Ansambli është mjaft i pasur me portrete e figura të pikturuara nga një dorë që zotëron mirë idenë e hapësirës arkitekturore duke ndërtuar raporte madje në marrëdhënie me figurat dhe shpërndarje tonesh e ngjyrash plotë variacione dhe unitet koloristik. Ndarjet e skenave në kuadrate në tërë sistemin e mbulesave të kurbëzuara të nefeve, të naosit si dhe në sistemin e pilastreve, harqeve dhe kapiteleve të kolonave të qendrës së naosit, zonës së altarit dhe asaj të kubesë janë mjaft të pasura me motive dekorative me shije baroke duke krijuar një ndjenjë pasurie koloristike.

Medaljonet me figurat e martirëve të vendosura në rresht nëpër rrathë, që lidhen me sfonde të ngjyrosur ose dhe ornamente dekorative përdoren gjerësisht në zonat këndore ose në brezat ndarës midis skenave me shumë figura. Organizimi i skenave ndërtohet herë me figura e herë me portrete shënjtorësh. Jerarkët dhe figurat e shënjtorëve të brezit të poshtëm kanë si sfonde raporte tonale me ndryshime të lehta, të përbëra nga dy tonalitete të cilat nga sipër mbi çdo figurë përcaktohen me harqe të valëzuara midis figurave dhe medalioneve. Me qëndrim në këmbë dhe përballë, në përmasa natyrale figurat e brezit të poshtëm krijojnë idenë e pjesëmarrjes dhe marrëdhënies intime me besimtarët. Bordurat dekorative edhe gjeometrike të thjeshta, transparente me inspirim popullor. Në tërësi zotërojnë ngjyrat e ngrohta si e kuqe, jeshile, okër, kafe, blu e errët të cilat gjallërojnë skenat dhe figurat e paraqitura. Ngjyrat e thella të errta kontrastohen nga tone e gama komplementare duke nënvizuar veçanërisht figurat nëpërmjet aureolave përherë të ndriçuara nga okrat e qarta dhe përcaktimet e sfondeve të sheshtë. Skenat kuadratike janë paraqitur në të dy krahët e harqeve të qemerëve të naosit duke u ndarë me borde kuadratike dhe përmasa të ndryshme sipas madhësisë së tyre. Breza gjatësor medalionesh të vendosura në qendër të çdo nefi të qemerëve të naosit krijojnë një marrëdhënie e cila ndihmon në leximin e skemave më të mëdha.

- **Karakteristikat e ambjentit.** Kisha ngrihet mbi një terren të pjerrët të krijuar nga mbushja e përroit të Zervatit. Kuota është 350 metra mbi nivelin e detit. Pjerrësia në drejtim të lindjes luan rolin e një drenazhi natyror për largimin e ujërave sipërfaqësor dhe atyre nëntokësor. Sasia e rreshjeve vjetore është e konsiderueshme dhe luhatet nga 1708 deri në 1953 mm. Në periudha të veçanta të vitit kjo sasi arrin deri në 2367mm. Temperaturat gjatë dimrit arrijnë edhe nën

DO NOT COPY

zero gradë. Kushtet e terrenit si dhe ato klimatike kanë ndihmuar në qëndrueshmërinë e konstruksionit të kishës dhe pikturës murale. Amplitudat e theksuara të temperaturave dimër e verë favorizojnë krijimin e lagështisë së kondesimit e cila është një nga shkaqet e kripave, që kanë dëmtuar shtresat përgatitore dhe pelikulin pikturor. Sigurisht dhe lagështia e ujërave të shiut për shkak të mbulesës difektoze prej vitesh ka dëmtuar mjaft zona të pjesëve të sipërme të nefeve dhe qemerëve të mbuluar me pikturë. Veçanërisht faqja veriore e naosit paraqet dëmtime e shtresëzime të forta kriprash, të cilat janë pasojë e lagështisë së përcjellë nga niveli i dherave nga jashtë si dhe bimës parazitare që gjithashtu ka favorizuar lagështinë në muret e saj. Nga lagështia e shirave ka vuajtur dhe e gjithë zona e tamburit e kryesisht ajo e pendetivave si pasojë e ujit që ka depërtuar në lidhjen e tamburit me pjesët e tjera të mbulesës.

Zona cimiteriale. Kisha është e rrethuar me varre që shtrihen në sipërfaqe 4000 m ^{2} kryesisht në pjesën jugore e perëndimore të saj. Varre ka patur edhe brenda kishës në kufi me muret e saj anësor.

Teknika e muraturës. Kisha është e ndërtuar me gurë gëlqerorë me llaç gëlqereje e rëre. Llaçi është kompakt dhe i ndryshëm, më i dobët në pjesën e bemës, në krahët e kryqit si edhe në kupolën e tamburit, pjesë të cilat i përkasin formës fillestare të kishës. Ndërsa pjesa tjetër e strukturës ndërtohet me llaç më të fortë. Në muraturë përdoren shpesh gurë jo të skuadruar dhe vihen re fugatura e çarje, të cilat dëmtojnë qëndrueshmërinë e saj.

Teknika e ekzekutimit të pikturës. Pikturat janë realizuar me teknikën e përzierjes së ngjyrave me gëlqeren në formën e njohur të gjysëm afreskut. Kjo teknikë është karakteristike për pikturën bizantine e pasbizantine në të gjithë Ballkanin. Ngjyrat kanë origjinë okside dhe përzihen me qëlqeren e cila i jep atyre dukurinë e pikturës me tempera. Shtresa përgatitore realizohet me një shtresë të parë arriçio mjaft të trashë e cila shërben si niveluese dhe mbajtëse e filmit pikturor. Në shtresëm e arriçios nuk përdoret rërë. Në përbërjen e saj ka vetëm gëlqere dhe kashtë. Kjo shtresë është kompakte dhe ruan qëndrueshmërinë me shtresën e filmit pikturor. Vizatimi është bërë me shabllone dhe incizime mbi suva. Sfondet janë realizuar me të zezë në suva të njomë, ngjyra është shtrirë mirë në trashësi të vogël, mbi të është vendosur blu azurite në kohën kur ka qenë e thatë, kjo ka bërë që bluja të ruhet pjesërisht e copëtuar dhe e dobët në qëndrueshmëri. Jo të gjitha ngjyrat janë lidhur mirë me suvanë e njomë. Një pjesë e tyre për shkak të përbërjes pastoze dhe origjinës së tyre defektoze kanë rënë ose janë pluhurizuar e ciflosur duke zbuluar shtresën e arriçios. Të verdhat e sfondeve, okrat dhe të kaltrat shpesh janë të dobëta e kanë pësuar një formë hemoragjie e cila është favorizuar edhe nga faktorë dëmtues e kryesisht nga lagështia. Të lidhura mirë janë ngjyrat që vizatojnë dekoret e brezit fundor si dhe ato të ndarjeve dhe shiritave midis skenave sipër e poshtë dritareve të kishës. Veçanërisht të dobëta janë ngjyrat e karnacionit të figurave në skenat e harqeve të naosit në qemerët e nefeve gjatësorë, ndërsa ato të fazës fillestare janë teknikisht të realizuara më mirë, ato paraqiten më rezistente, të shtrira mirë dhe të lidhura me shtresën e arriçios. Mjaft të dobëta ngjyrat paraqiten në zonën e pendativave ku lagështia i ka fragmentarizuar dhe dëmtuar molekulën dhe unitetin kromatik të tyre. Brezi i fundit i shenjtorëve në këmbë, paraqitet me humbje dhe copëzim të pelikulit pikturor në faqen perëndimore si dhe në faqet e pilastrave katrore të naosit. Mjaft rezistente janë ngjyrat e brezave fundorë.

Masat restauruese

A1 - Pastrimi nga insekte, merimanga, akrepa etj.

Afresket kanë qenë të mbushur me merimanga që kishin lëshuar rrjeta të shumta, gjithashtu mbetje e sekrecione lakuriqësh dhe insekte të llojeve të ndryshëm si akrepa, brumbuj etj. Fillimisht ky operacion u krye me anë të fshesave dhe furçave duke larguar ato mbeturina që mund të hiqeshin mekanikisht.

Konsolidimi i pikturës

A2 - Për konsolidimin e pikturës ishte e nevojshme mbushja e çarjeve të drejtimeve të ndryshme, si dhe bordeve të fragmentuara, të cilat u bënë më llaç të përbërë nga shou blanch, rërë dhe pluhur vullkanik për rastin e çarjeve të ngushta që përshkojnë skenat dhe figurat, ndërsa me llaç më të ashpër me rërë e shou blanch për bordet e afreskave dhe zonat ishullore vendosur në nivel pak më poshtë shtresës së pelikulit pikturor. Kryerja e këtyre përforcimeve bënte të mundur

DO NOT COPY

DO NOT COPY

injektimet e xhepave bosh dhe krijonte raste për penetrimin e mbushjeve në vende të lëna bosh nga sipër xhepit.

Kryerja e këtyre operacioneve para pastrimit favorizonte ruajtjen e pelikulit pikturor, duke qenë pisllëku një shtresë mbrojtëse e pikturës.

A3 – Injektimi i xhepave fillimisht pati vështirësi për shkak të penetrimit të pakët të llaçit mbushës dhe bllokimit të shirinave. Në zonat e thella, ku çarjet dhe gropa krijonin mundësi për injektime të llaçit të ashpër e të pasur me rërë, mbushjet u bënë me një pompë shtytëse, e cila bënte të depërtueshëm llaçin në thellësi me ndihmën e një tubi zgjatues që futej brenda çarjes së murit. Për xhepat më të vegjël u përdorën me sukses shiringat që mbetën të hapura me ndihmën e një teli shpues dhe depërtimit të vazhdueshëm të mbushjes deri sa xhepi rifitonte lidhje të mjaftueshme, e cila bëhej e kuptueshme dhe ndryshimi i tingullit dhe qëndrueshmëria e shtresës së intonakës me murin mbartës. Realizimi i mbushjeve në seri jepte më tepër rendiment në punë. Sipas rastit, trashësia e mbushësit ndryshonte për të bërë të mundur penetrimin e tij në thellësi. Mbushjet ishin më të efektshme kur fillonin nga poshtë brezit të pikturave. Vumë re që niveli i boshllëqeve ishte në lartësinë deri 1 m nga toka dhe veçanërsiht në brezin dekorati të pikturave. Rrjedhje të solucionit mbushës në vrima dhe kanale u mbushën me pluhur vullkanik, një mënyrë kjo me tepër rezultate për rastin e afreskave që kanë shumë çarje e vrima, të cilat pengojnë mbushjen e xhepave.

A4 - Konsolidimi. Procesi i konsolidimit u krye duke bërë një lagie progresive me ujë të distiluar në fazën e vaporimit ose dhe me një letër japoneze të shtrirë me ujë të distiluar me furçë të gjerë dhe pjesë-pjesë. Uji shërbente si ngopës i shtresës së thatë të pikturës dhe riaktivizonte lidhësit duke ruajtur pelikulin pikturor. Në raste të tjera rilidhja e shtresës së dëmtuar të pikturës u bë edhe me një solucion karbonat amoni të shkrirë në ujë dhe të aplikuar me furçë mbi një letër japoneze. Me këtë mënyrë bëhej e mundur edhe ulja e ngritjeve, fletëzimeve dhe pluhurëzimeve të pikturës si dhe një rishëndoshjeje të intonakos së dëmtuar. Për raste më të veçanta, konsolidimi i shtresës pikturore u bë me një solucion primal 2-3%, aplikuar me penel mbi një letër japoneze. Kur gjendja e pikturës ishte më e shëndoshë, aplikimi i primalit u krye direkt me penel mbi piktura. Primali me letër japoneze duhej kryer shpejt për të mos bërë ngjitje të pelikulit pikturor mbi letrën japoneze. Në zonat e veçanta kemi aplikuar edhe hidroksid të barit, por jo shpeshherë.

A5 – Largimi i nxirjeve. Depozitime, tymra, blozë dhe sekrecione insektesh dhe shpezësh krijonin një shtresë të errët dhe opake që pengonte në shumë raste leximin e pikturave. Për të larguar këto mbivënie u aplikua fillimisht një lagie me ujë dhe karbonat amoni, që bënte të mundur gufmimin e ndotjeve dhe shkëputjen e tyre nga lidhja me shtresën e pikturës, ndërsa me anë të tamponeve me sfungjer mbi letër japoneze dhe ujë të distiluar larguam nxirjet duke vepruar paraprakisht me prova në zona të ndryshme. Një lënie prej 24 orë e lyerjes së zonës me karbonat amoni ose bikarbonat, jepte më tepër rezultat. Kjo praktikë u krye në fillim të proceseve pastruese ndërsa më vonë u pa më e efektshme përdorimi i një mishele AB57. Përzihet edhe E.D.T.A si dhe dezogjen të mbajtura nga karboksimetilceluloza. Aplikimi i AB57 u krye me ndihmën e letrës japoneze, por për shkak të mundësisë që në raste të veçanta letra mund të mbetet mbi pikturë, u përdor mishela direkt duke e lënë prej 3-4 minutash dhe larguar me larje të përsëritura me ujë të distiluar. Një shtresë zbardhuese pas pastrimit u largua me ujë të distiluar ose duke e përsëritur operacionin e mishelës mbas 24 orësh.

A6 - Largimi i vernikut të dekompozuar. Në zona të veçanta në narteks (në dy figurat e pantokratorit dhe Shën Mërisë), si dhe në piktura të zonës së pilastrate dhe në dy skena të ciklit të ikonave të ikonostasit, afreskat janë lyer me shtresa verniku, që me kohë është zverdhur e nxirë duke dëmtuar pamjen e pastër të pikturave. Për largimin e vernikut u provua me aceton si dhe me përbërje të acetonit, alkoli dhe amoniakut. Edhe mishela AB57, jepte rezultate duke insistuar me përsëritje disa herë. Largimi i vernikut të shkrirë bëhej më mirë me pambuk ose tampon duke pastruar me zona të kontrolluara në formë katrore.

A7 - Largimi i ripikturimeve. Për ngjyra me bazë tempera, siç ishin ato të bëra mbi figura shenjtorësh në pilastrat e zonës së bemës, heqja e ngjyrave ishte më e thjeshtë. Kjo realizohej duke zbutur ngjyrat me

tamponime me ujë të distiluar dhe më sfungjer e larje të vazhdueshme pastrohej krejt zona. Për ripikturimet me vaj duhej përdorur acetoni ose përzierje solucionesh.

A8 – Largimi i lyerjeve me gëlqere. Kur lyerjet ishin me një shtresë të hollë dhe vendosur mbi pikturën, që ruante një sasi pluhuri para aplikimit të lyerjes, gëlqerja larghe lehtë me ujë të distiluar dhe mbledhur me sfungjer. Për rastet e shresave të forta, largimi i saj u krye mekanikisht me bisturi, duke e larguar me ujë i cili duke hyrë në çarjet eventuale ndihmonte ndarjen e shtresës nga sipërfaqja e pikturës.

A9 – Largimi i lyerjeve me ngjyrë e vaj blu ishte tepër i vështirë mbasi në shumë zona ai ishte lidhur fort me intonakon piktorike. Një lyerje me pentro muover duke e lënë atë disa minuta jepte rezultate të kënaqshme.

A10- Substanca me origjinë natyrore (rezinë, dyllë, vaj etj). Lyerjet e afreskave me substancë të origjinës natyrore ishin të pranishme në zona të veçanta si në figura shenjtorësh në anët e pilastrave të narteksit, në një pjesë të anës veriore të qemerit të nefit qëndror, si dhe në zona të vogla të skenës së Shën Kollit në narteks dhe në niken e faqes jugore të narteksit, ku ka qenë zakoni të vendosen qirinj dhe vajra natyrorë. Për largimin e këtyre substancave është përdorur karbonati i amonit, një solucion me ujë si dhe në formën e mishelës AB57, me një koncentrim të fortë. Pas përsëritjes së operacionit disa herë dhe largimit me sfungjer me shumë fërkim të sipërfaqes së ndotur u bë i mundur pastrimi. Duhet shënuar se në zona ku ka koncentrim kriprash të patretshme, të cilat prezantohen në formën e rikristalizimeve gëlqerore si karbonate të kalciumit, largimi i tyre ishte i pamundur për shkak të ribashkimit të tyre me strukturën e ngjyrosur të afreskut dhe çdo përpjekje për largimin dëmtonte edhe shtresën e pikturës.

A11 - Largimi i kripërave. Kripërat në formën e tyre të tretshme janë larguar nëpërmjet ujit të distiluar, duke e përsëritur veprimin disa herë. Në raste të ndryshme është shtuar një përqindje dezogjeni si tensionaktiv ose edhe E. D. T. A., duke vendosur në zona të veçanta edhe tampona me letër shumëfish. Sulfatet që i ndeshim fillimisht në brevin fundor të pikturave të faqes lindore të afreskut, ka të ngjarë të kenë ndodhur jo vetëm nga lagështia por ndoshta edhe për shkak të përdorimit të këtij ambienti si depo plehrash kimike. Në formën e tyre të veluar e të bardhë, ato ruanin një nivel jo të lartë në brevi fundor të skenave. Një përsëritje e operacionit me E. D. T. A. dhe më vonë me mishelën A B 57 kjo zonë u pastrua plotësisht. Ndryshe ka qenë problemi i kripërave të përsëritshme si nitrate dhe ato të karbonatit të kalciumit, të cilët janë shumë prezentë jo vetëm në të katërt fundet e pendativave të tamburit, por akoma më të theksuara në krejt gjatësinë e murit verior dhe në protezisin e zonës së bemës. Këto kripëra që pjesërisht paraqiten si velime relativisht të forta, u larguan nëpërmjet mishelës AB57 me koncentrim përbërjeje të fortë duke e përsëritur disa herë. Me prova të shpeshta kemi insistat në zonën qendrore të faqes veriore të narteksit për të bërë të lexueshme figura, medalione dhe skena të cilat ishin të mbuluara me një shtresë kripore, e cila fillimisht paraqitej shumë kompakte dhe tepër e fortë. Për të arritur që kjo zonë e pikturuar të bëhej e lexueshme janë bërë fillimisht prova paraprake në zona të vogla. E. D. T. A dhe mishela A B 57 ka dhënë rezultate të kënaqshme.

Migrimi i karbonatit të kalciumit në sipërfaqen e pikturave ka arritur të strukturohet si shtresë kripore e zbardhuar dhe tepër e fortë. Me bisturi por edhe me fërkim me letër zmerile kemi larguar mjaft zona të mbuluara nga kripëra, sikurse mund të vërehet po të krahasohen fotot e bëra para ndërhyrjeve tona. Mendoj që në këto zona ku kemi prezencën e karbonatit të kalciumit në formën e tij tepër të fortë, të mos tentonte më shumë mbasi ngjyra të veçanta të cilat kanë pasur hemorragji ose për shkak të natyrës së origjinës së tyre janë të dobëta, janë të lidhura me shtresën kripore dhe cdo përpjekje për pastrim të mëtejshëm do të dëmtonte afreskat.

A12. Fiksimi fletëzimeve dhe pluhurizimeve. Pjesë mishore të figurave të shenjtorëve në skena të ndryshme dhe kryesisht në zonat e qemerëve të të tre nefeve, si dhe në figurat e zonës së tamburit, në shumë sipërfaqe të afreskut janë të dëmtuara me humbje që paraqiten në formën e hemorragjisë së ngjyrave të tilla si okra, e kuqja e çelët, bluja dhe jeshilja. Bluja e zmaltit që ka qenë vendosur si tempera në të thatë mbi sfondet e zinj të skenave është rrëzuar në shumë zona, duke lënë të pastër sfondet e të zezës. Të qëndrueshme janë kryesisht ngjyrat si e zeza, bluja e veshjeve, kafetë e përbëra dhe të gjitha ngjyrat që janë të përziera. E qëndrueshme është edhe e bardha e përdorur në veshje ose si vijëzime sfondesh, figurash e shkrimesh. Dëmtimet

DOKTORATURA

e ngjyrave para pluhurëzimit, paraqiteshin edhe si shpërbërje në llojin e zhvleftëzimit, çarjeve dhe ngritjeve në nivel mbi shtresën e pikturës. Për konsolidimin e zonave të dëmtuara, vështirësi paraqiste gjendja e ndotur e pikturave (ngritja e depozitimeve bituminoze). Për të bërë të mundur fiksimin e shtresës pikturore dhe intonakos të dëmtuar, u krye një parakonsolidim me karbonat amoni, i cili duke riaktivizuar lidhësitë, bën më të qëndrueshëm shtresën e dëmtuar. Në zona e pjesë të kufizuara, kemi përdorur edhe hidroksidin e barlumi, i cili duke rikristalizuar strukturën e brendshme të intonakos, rrit stabilitetin e afreskut. Primali A C 33 në 2-3 % i aplikuar në zonat me hemorragji në formë të evaporizuar u përdor edhe me letër japoneze duke u larguar me kujdes. Në raste të gjendjes më të qëndrueshme të pikturave, primali eshtë aplikuar direkt me penel të butë. Për aureolat e dëmtuara kemi prerë letër japoneze në formën e rrumbullakët për të bërë të kufizuar fiksimin brenda zonës së dëmtuar. Fiksimi me primal nuk është përdorur për çdo sipërfaqe afresku, veëse për skena e figura që ishin të pluhurëzuara ose fletëzuara ose kur ngjyrat e veçanta paraqiteshin të dobëta.

A13. Hapja e zonave të tiranteve. Për qëllim të qëndrueshmërisë statike të arkitekturës në qemerët dhe harqet e naosit, janë vendosur tiranta metalike, të cilat kanë prekur zona të vogla të pikturës murale. Hapjet fillimisht janë kryer me një matrapik i cili duke qenë me seksion të gjerë dhe i rëndë, ka dëmtuar disa pjesë të pikturës. Hapjet e bëra nga ne u kryen duke prerë me kujdes afreskat në zonat ku do të aplikoheshin tirandat. Në këtë fazë, hapja e kanaleve, u krye më me kujdes.

A14. Largimi i lyerjeve me bojë vaji. Lyerjet me ngjyrë vaji blu zmalt janë vendosur vite më parë mbi zona të dekoracionit të brezit të fundit të dy pilastrate të naosit, si dhe dy kolonat ku mbështeten transepti i kishës. Lyerje me vaj blu janë bërë edhe në brevin fundor të ikonostatit si dhe në pjesë konturuese të gdhendjeve që dekorojnë brezat e zonave ku janë vendosur ikona. Pastrimi i kolonave nga blutë është bërë me pentromuovs dhe mandej mekanikisht. Pastrimi metani ishte më i vështirë, por më i sigurt. Mbas largimit të shtresës së blusë, lyerja me gëlqere larghe më lehtë përherë me bisturi, duke kontrolluar shtresën e pikturuar nga dëmtimet eventuale. Një vello e bardhë që mbetej, larghe lehtësisht me ujë të distiluar.

A15. Integrimi me ngjyrë. Shumë skena të dëmtuara në unitetin e tyre pikturor me humbje jo vetëm në bordet përkufizues, por edhe brenda kompozimit figurativ, paraqisnin mbas pastrimit një pamje shqetësuese që vështirësonte leximin e pastër të tyre dhe unitetin kromatik. Për integrimin e zonave të mëdha, llaçi mbushës, i tonuar me një okër neutrale, shërbente si lidhës dhe për zonat e çarjeve në shumë pjesë të pikturës. Ndërsa për zonat ishullore dhe intonakon e zhveshur nga petikuli pikturor, tonimi u krye sipas zonave dhe ngjyrave lokale me ngjyra akuarel në ujë dhe disa raste duke përdorur si lidhës një përqindje shumë të hollë primali.



Fig. 1. Zona të pikturës me nxirje dhe kripëra para restaurimit



Fig. 2. Skena të pikturës të dëmtuara nga çarje të intonakës dhe mbivënie e nxirje para restaurimit.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3. Faqja veriore e naosit (prova paraprake e pastrimit të kripërave dhe vernikut



Fig. 5. Figura e Shën Mërisë në procesin e restaurimit.



Fig. 4. "Zbritja nga kryqi", pas restaurimit



Fig. 6. Pas restaurimit.

DO NOT COPY



Fig. 7. Zona të pikturës pas restaurimit



Fig. 8. Zona të pikturës pas restaurimit



Skica 1. Nefi qendror i narteksit



Skica 2. Muri lindor i narteksit

DO NOT COPY



Skica 3. *Muri perëndimor*



Skica 4. *Harqet gjatësore*



Skica 5. *Muri dhe nefi verior*

DO NOT COPY



Skica 6. Muri lindor dhe tamburi



Skica 7. Muri dhe nefi jugor

PhD. Prof. Hasan NALLBANI

RESTORATION OF MURAL PAINTING FOR SAINT MARIA CHURCH OF ZERVAT, GJIROKASTRA

DO NOT COPY

The church of Saint Maria sleeping is established at Zervat, village of Dropulli region which is expanding at Drinos valley between Gjere and Stugare Mountains. The church is at the gateway of the village. Entrance batten has an inscription close to narthex a date 1606 which belong painting and painter names Mihal and Nikolla. Building of a church has changes on embryos plan and at painting phases. Year 1606 is the last date of the painting but clear widely of stratifications of differences of decorative and iconographic elements attest for phases which has incur the rebuilding of this church.

This change effected at form from a crux inscription to a basilica with transept and three naves which are hold at four pilasters and two columns on the center and also two other pilasters at the bema area. This church has a partially painted narthex and cloister on the south side which preserves an arches system with columns and a portico which links the main entrance door up to nave. Wooden iconostas which is decorated with carving ornaments on relief which preserves more than 20 different dimensional icons.

The church preserve totally the thematic cycle all around at its interior which include three longitudinal naves, the sidelong nave and also cupola, tambour, spherical triangular, absides and naos perimeter walls. The interior is illuminated by small windows opened at side walls and they have turret form. Today illumination is with electric power. Church masonry is with calcareous stones fixed with lime mortar.

The picture is realized with mixing of colors with lime in a half fresco form which usually is applied at all byzantine and post byzantine churches even and in Albania. The colors are mainly oxides which mixed with lime give to the picture the tempera technique. A preparatory covering up to 1 cm thick serve for leveling, colors spread and drawings with recordings of geometrical parameters which are horizontally spread.

Contend of preparatory covering is with lime and thin minced straw. Color resistance because of the application technique and contend is different so for that reason many pictorial and portraits are damaged in different areas and shades. This has happened because of some damage factors when the main one is humidity. Picture has incurred severe fissures at three longitudinal vaults of naos at cross nave and also at panalitura cupola.

Some restoring interventions with inappropriate technique and materials are done at different figures and at parts of building structure. Painting with oil colors at tag part of pilasters and over the elements of iconostas are parts of early interventions. Picture at many areas is represented with pulverization, leafed and color disappearances at its different parts.

Overlaps of varnish, oils, waxes and tar smoke depositions has effected at darkness of picture and create difficulties for the clear reading of iconographic thematic and also the esthetic values of painting. Other damages such as scratching, lime covering, and writings at other parts of picture represent another problem for the restoring program compile for the restoring interventions.

Examination of the fractures, dissociates, consolidation of preparatory coat, consolidation of painting film, elimination of the saline's and overlaps of decomposed varnish, noireve, painting of different areas with oil color and lime were include for the restoring measurements. Remove of old structures, inject of damage areas with varnish and its integration with original parts of preparatory coat were other measures which done during restoring. Conclusion of pictorial integration was another measure for the creation of full unity and clear coloristic organization possibility on the decorative ensemble church complex.

Ali MUKA - etnolog

BANESA POPULLORE QYTETARE E KOSOVËS TRASHËGIMI E VYER MBARËKOMBËTARE

DO NOT COPY

Në vend të hyrjes

Një libër i shumëpritur, dhe, njëherësh, po aq i dëshiruar. Madje, me këtë rast, më vjen ndërmend një shprehje e urtë popullore, në të cilën thuhet: *më mirë vonë se kurrë*! Një shprehje që bart në sfond një përvojë mësimdhënëse në jetën e brezave njerëzorë që pasojnë njëri-tjetrin. E thënë qartas, çlirimi i Kosovës martire dhe heroike, po i jep frutet e veta. Shumëkush që do të ketë rastin për të lexuar këtë shkrim, ndoshta do të habitet nga ky fillim jo i zakontë, kur, në fund të fundit, është fjala për shënime rreth një libri me përmbajtje shkencore të llojit të vet, që, në kuptimet klasike të terrmit, nënkupton përdorimin e një gjuhe me nota profesionale, të matur e, të themi, të "ftohtë", qoftë në vlerësime pozitive, ashtu dhe në qortime të cilësdo natyrë qofshin ato. Edhe pse duket sikur po "e shkel" këtë normë "të pa shkruar", kam një ndjesi të brendshme, sa natyrore aq edhe njerëzore, se, do të kem mirëkuptimin e nevojshëm nga cilido lexues, mjaft që të jetë i brumosur me ndjenja të konsoliduara tolerance qytetare, për të cilën kemi pasur, kemi dhe do të vazhdojmë të kemi nevojë.

Nuk ka shumë kohë kur studiuesi i njohur i arkitekturës sonë popullore, *prof. dr.* Emin Riza, (i biri i profesor Selman Rizës), dhe, njëherazi me zemër të madhe shqiptari, botoi librin në Prishtinë. Fillimisht, duke e marrë librin në dorë, e urova autorin për këtë sukses. Emini, në një pjesë të mirë të kohës, këto vitet e fundit, ka qenë i angazhuar si *këshilltar* i ministrit të kulturës në qeverinë e Kosovës dhe, duke i shfrytëzuar rrethanat në të cilat qëndroi e punoi atje, arriti që në bashkëpunim frytdhënës me arkitekt Njazi Halitin, të përgatisin dhe të dorëzojnë për botim librin që kemi në dorë.

Qysh kur e lexova *në dorë të parë*, siç thuhet zakonisht, gjatë gjithë kohës që e rilexova e nxorra shënime apo nënvizova, dhe tani që fillova të hedh këto shënime, nga thellësia e shpirtit më dalin vetëm fjalë urimi e përgëzimi. Libër i cili ishte vërtet i dëshiruar, në vështrim profesional-shkencor. Sikundër do të shihet në këto shënime, libri vjen të plotësojë një boshllëk të kahershëm dhe njëherazi një detyrim qytetar të brezave të sotëm për vete dhe për ata që do të vijnë, duke i hapur rrugë, përfundimisht dhe në mënyrë të sigurt, përfshirjes së kësaj trashëgimie të vyer, në korpusin plot arritje të arkitekturës mbarëshqiptare, që trashëgojmë nga e kaluara. Një specifikë e këtij libri lidhet edhe me secilin autor të tij. Kështu, Njazi Haliti, ka meritën që ka ditur të ruajë me dashuri qytetare dhe skrupolozitet të admirueshëm profesional, rilevime të mbledhura në terren në vitet 1955-56 dhe të pahedhura në formate të rregullta vizatimi; ndërsa Emin Riza ka meritën që ka arritur t'i sistemojë me kritere rigoroze shkencore dhe t'i shqyrtojë ato nga pozitat e specialistit e të studiuesit, duke na zbuluar me tërë përmasat, vlera të cilat i bëjnë nder ndërtuesve e përdoruesve të këtyre banesave, duke i përfshirë ato në vendin që u takon: *në historinë e arkitekturës sonë popullore, si pjesë e historisë së kulturës sonë kombëtare*. Mbresën më të fortë ta jep edhe një shënim dedikues i autorëve, vendosur në pjesën e brendshme të kopertinës, i cili është shumë domethënës për nga vlerat që bart dhe mesazhet që përcjell: *Kjo monografi*, theksohet aty, *u kushtohet mbarë brezave të shqiptarëve të Kosovës, gjithherë autoktonë, që u bënë njësh me dheun e tyre edhe nëpërmjet ndërtimeve*.

Shënime për librin "Banesa qytetare kosovare e shekujve XVIII-XIX", *botim i Akademisë së Shkencave të Kosovës; autorë Emin Riza-Njazi Haliti, Prishtinë 2006; 332 faqe.*

DOKTORATË

Libri ka gjithsej 332 faqe, ku përfshihet *hyrja* dhe nëntë *kapituj* (kapitulli i fundit, luan rolin e *vështrimit përmbyllës*). Pjesë organike e këtyre kapitujve janë edhe 122 *figura* (kryesisht *fotografi*) dhe 73 *tabela me paraqitje grafike*, të cilat përmbajnë kryesisht planimetri, pamje e hollësi të ndryshme banesash. Monografisë nuk i mungon edhe një *bibliografi e pasur*, ku përmenden 63 vepra, të cituara me kritere bashkëkohore, në faqet e kapitujve të ndryshëm. Sikurse bëhet e qartë edhe në hyrje, në monografi shtjellohet me profesionalizëm, një tematikë me vlera sa historike për fushën aq edhe aktuale për karakterin e trajtimit.

Kapitulli i parë, gjithsej 15 faqe (f. 9-23), i cili titullohet KRITERET METODIKE PËR HARTIMIN E MONOGRAFISË, sikundër e shpreh edhe titulli, është parë i domosdoshëm, për të paktën dy arsye, të cilat janë: *së pari*, sepse disa prej kritereve metodike të zbatuara deri më sot në këtë fushë, krahasimisht të re studimore, nuk i kanë qëndruar kohës; dhe *së dyti*, në mjaft studime të kryera deri tani, nuk del qartë se në cilat kritere mbështeten. Problematika e përfshirë në këtë kapitull, dëshmon një përvojë të gjatë njohëse dhe angazhimi në fushën e arkitekturës popullore shqiptare në përgjithësi dhe, të asaj qytetare në veçanti, e shtrirë në disa dekada, jo vetëm në fushë të gjurmimit, dokumentimit, vlerësimit e studimit, por krahas edhe në fushë të vënies në mbrojtje e të restaurimit. Të gjitha këto të thëna shkurt, janë të mishëruara në figurën e Emin Rizës, dëshmia më e qartë është CV-ja mjaft e ngjeshur, e përfshirë në veshjen e brendshme të këmishës së këtij monografie. Mjaft të kujtoj se ka botuar mbi 110 *artikuj* në revista e botime shkencore (brenda e jashtë vendit), si dhe 12 *monografi* (pesë me bashkautorë), të lidhura drejtpërdrejtë me problematikën komplekse të këtij fushe studimore.

Në këtë kapitull jepet një tablo e qartë dhe bindëse, për gjendjen dhe nivelin e studimeve të këtij trashëgimie, në mbarë trojet shqiptare, në Ballkan e në mbarë Europën, të cilat, në tërësi, e kanë fillesën e tyre pas Luftës së Dytë Botërore. Më tej hidhet dritë për karakterin dhe tiparet thelbësisht specifike që bart banesa popullore në raport me ndërtime të natyrave të tjera siç janë ato *mbrojtëse, të kultit, inxhinierike* dhe *shoqërore*. Ndryshe prej tyre, banesa popullore si e tillë, është ndikuar në lindjen, zhvillimin dhe ecurinë e saj, nga një bashkësi faktorësh, siç janë: *mënyra e jetesës së banorëve, zhvillimi ekonomik e shoqëror, klima, materialet ndërtimore natyrore, traditat ndërtimore, karakteristikat e truallit të ndërtimit* etj. Pikërisht ky kompleks faktorësh ka diktuar edhe metoda të caktuara hulumtuese e studimore, e klasifikuese-tipologjike. Nga të gjithë kriteret e përdorur deri tani, si më domethënësi, vihet në fokus ai *i zhvillimit kompozicional*, i kundruar në hapësirë e në kohë, gjithnjë i parë në bashkëmarrëdhënie me kontekstin historiko-shoqëror dhe natyror. Ngulmohet në këtë aspekt pasi në ballafaqim me realitetin që ofron kjo trashëgimi, ka munguar profesionalizmi në studim; madje në hapësirën ballkanike, lexohet pa ndonjë vështirësi të madhe edhe një notë *diletantizmi*. Të kësaj natyre konsiderohen, fjala vjen, *pseudoprobleme të origjinës së një tipi, roli i faktorëve ndikues në cilindo tip a variant të tij; hiperbolizim i punës reale që ka bërë mjeshtri anonim popullor; datime të pamotivuara; konkluzione që s'i përballon dot materiali faktik; vlerësime estetike gjenerike* e ndonjë tjetër. Duke perifrazuar një thënie të Ainshtainit, theksohet se, *shkenca fillon me përcaktimin e metodave e termave, duke shmangur kështu çdo lloj "aktualizimi" kundërhistorik*. Theksohet me të drejtë se, *funksionalizmi, utilitarizmi apo dobishmëria, e banesës popullore shfaqen si dominuese dhe e qëndrueshme, duke i lënë pak hapësirë interpretimeve formale; prandaj dhe duhen shmangur shfaqje të skajshme në emërtimin e tipologjive të ndryshme të banesave; lidhje formaliste e mekanike të kësaj apo të asaj etnie, me këtë apo me atë tip banese;* çka nuk do të thotë gjithashtu se faktori etnik nuk ka veçantitë e veta, të cilat shfaqen në shkallën e zhvillimit dhe në mënyrën specifike të jetesës së kësaj apo të asaj etnie. *Lidhja e banesës me tipologjinë*, thekson me të drejtë autori, *nuk do të thotë ekskluzivitet tipologjik*, por trajtimin e saj në përputhje me rrethanat e kontekstit historik, siç janë: jeta e tipit dhe marrëdhëniet me simotrat në hapësirën historike-kulturore, në të cilën përfshihet kjo apo ajo etni konkrete. Njëherazi, kërkesat për dobishmëri, theksohet më tej në këtë kapitull të monografisë, *përjashtojnë natyrshëm atë që do ta quanim purizëm etnik në banesë;* çka do të thotë se, banesa e lidhur me një etni të caktuar, nuk mund të konsiderohet *vetëkrijim kulturor autentik*. Prandaj dhe theksimi i vlerave të supozuara etnike për banesën popullore, mund të ketë si burim mos

mbështetjen ose mungesën e materialit faktik, nga njëra anë, por edhe mos zbatimin e metodave të mirëfillta shkencore në analizën e këtij materiali. Është tjetër gjë kjo dhe tjetër gjë aftësia apo predispozita e një etnie të caktuar për të përvetësuar arritje të kësaj fushe, pavarësisht burimit të këtyre arritjeve.

Aq më tepër të mendohet që një etni udhëheqëse në planin politik, të jetë e tillë edhe në zhvillimin e banesës popullore të etnive nën sundimin politiko-shtetëror të saj. E thënë shkurt, jeta ka treguar se njësia hapësinore-gjeografike në plan politik, nuk mund të jetë e tillë edhe në krijimin e arkitekturës popullore në rastin konkret; ndryshe mund të flitej edhe për globalizim procesesh tejet të veçanta në hapësirë dhe në kohë, siç janë edhe ato etnokulturore. Prandaj dhe nëse Perandoritë e Mëdha kanë qenë formacione politike shumëkombëshe, krijuesit e arkitekturës popullore kanë qenë me përkatësi shumetnish. Në këto kuptime mund të flitet, fjala vjen, për *trashëgimi ilire* në periudhën romake; *trashëgimi arbrore* në periudhën bizantine dhe *trashëgimi shqiptare* në periudhën turke. Ndryshe, të përfshish arkitekturën popullore në terma politikë gjithëpërfshirës, do të thotë të deformosh procesin real historik. Në një kohë që edhe realisht, qoftë pushtuesit e sapopërmendur (apo ndonjë tjetër në Kosovë posaçërisht), që kanë shkelur apo kanë uzurpuar, për periudha krahasimisht të gjata apo të shkurtra, troje shqiptare, *nuk kanë sjellë se nuk mund të sillnin, modele të gatshme në këtë fushë të krijimtarisë popullore.*

Në kapitull i kushtohet vëmendje edhe raporteve *origjinalitet-huazim* a *ndikim*, ku përmes një analize bindëse të rendit shkencor, argumentohet se, *origjinaliteti i pastër është cilësi e ndonjë bashkësie tejet primitive, e ndonjë bashkësie tejet të izoluar*, dukuri që s'ka pasur e s'ka vend për etnosin tonë. E themi këtë pasi historia tanimë e ka thënë të qartë fjalën e saj, sipas të cilës kjo etni, ky komb e ky popull, kanë jetuar në mënyrë aktive nën cilindo pushtues e nën cilëndo perandori shumëkombëshe; nuk ka njohur ekzaltimet fanatike vetëmbyllëse, duke mbetur edhe në këtë fushë, dobishmëria si kriter bazë përvetësimi. Kështu, edhe në banesën qytetare të *shek.* XVIII-XIX, ka pasur vend për ndikim e huazim, por në kontekste historiko-shoqërore të ngjashme. Madje, autori thekson, fjala vjen, se, *është instruktiv në këtë kontekst, rasti i ballkanik dhe ai shqiptar, që elemente të kulturës islamike dhe asaj lindore në përgjithësi, i kanë marrë me ndërmjetësinë e turqve.* Veçse fjala është për *huazime elementesh* dhe aspak në ndonjerin prej përbërsëve themelorë të saj.

Vëmendje i kushtohet edhe kritereve të klasifikimit tipologjik të banesës. Në monografi theksohet se, *klasifikimi i vërtetë, realist dhe bindës, i banesës duke qenë një element thelbësor sintetizues i karakteristikave të saj, nuk mund të identifikohet me atë larmi klasifikimesh në qarkullim, dëshmi e një faze të pakonsoliduar studimesh;* prandaj dhe si të tilla, ato nuk mund të merren si klasifikime të rendit shkencor. Pikërisht këto lloje klasifikimesh bëhen objekt shtjellimi në monografi, për çka dhe arrihet, midis të tjerash, në përfundimin se, *cilido klasifikim bëhet bindës kur kombinohet me kronologjinë e tipologjisë,* por edhe me formulimin arkitektoniko-dekorativ; duke ndjekur klimën, materialet ndërtimore, mjeshtrit dhe veçanërisht kushtet ekonomiko-shoqërore. Prandaj dhe, në studimin e klasifikimin e banesës popullore, sipas kriteresh shkencore, duhen mbajtur parasysh tre blloqe bashkëformuese të banesës që janë: *njësitë kompozicionale* (i pari), *materialet ndërtimore* (i dyti) dhe *teknika e ndërtimit* (i treti). Dy blloqet e fundit konsiderohen krahasimisht më të qëndrueshëm në kohë, kurse kompozimi shihet si përbërësi më i ndryshueshëm, në raport me ta. Njëherazi, mund të flitet edhe për një përbërës të katërt, siç është trajtimi arkitektoniko-dekorativ, i cili është jo vetëm relativisht më evolutivi, por edhe më i prirur drejt huazimeve dhe ndikimeve të mirëfillta, pasi, në fund të fundit, lidhet me konsiderata të karakterit soditës, theksohet në monografi.

Në **Kapitullin e dytë**, QYTETI KOSOVAR I SHEKUJVE XVIII-XIX, LAGJET E BANUARA DHE KOMPLEKSET E PAZAREVE (f. 25-56), në 32 faqe, ku përfshihen edhe 24 figura (shumica fotografi), bëhet objekt shqyrtimi qyteti kosovar, duke filluar me një histori të shkurtër të lindjes, formimit e të konsolidimit me tipare të qytetit bashkëkohor dhe duke u ndalur më me hollësi, te njësi themelore kompozicionale, siç janë *pazaret, lagjet e banuara* dhe njësi e elemente të tjerë që hedhin dritë reale mbi fizionominë dhe karakterin e këtij qyteti, njëherazi pjesë natyrore e qytetit mbarëshqiptar të kohës. Përmes kësaj analize krijon bindjen se, qyteti kosovar është një realitet i hershëm në kohë, i cili nuk lidhet me

DOWNLOAD

Do not copy

përfshirjen në suazën e Perandorisë Turke. Pasi shtjellohen me profesionalizëm faktorë, të natyrës parësore apo dytësore, që kanë ndikuar në lindjen e zhvillimin e qyteteve mesjetare në përgjithësi, ndalohet më konkretisht te hapësira e Kosovës. Theksohet se, kriteri bazë në cilësimin *qytet* të një qendre të banuar, pa nënvlerësuar domethënien e peshën e ndonjë kriteri tjetër, është *lloji i ekonomisë* që ushtrojnë shumica e banorëve të saj. Në këto kuptime, edhe kalimi i një qendre të banuar fshatare në qytetare, *nuk është një akt, por një proces*. Vetëm atëherë kur shumica e banorëve të një qendre të caktuar banimi, e kanë zejtarinë dhe tregtimin e produkteve të prodhuara, si aktivitet mbisundues, pra, parësor, ajo qendër banimi merr fizionominë e një qyteti. Praktikisht rreth kapërcyellit të *shek.* XIX-XX, asnjë qendër qytetare, jo vetëm në Kosovë, por në mbarë Ballkanin, nuk ka qenë e shkëputur nga bujqësia dhe blegtoria si aktivitete ekonomike, ç'ka lexohet pa asnjë vështirësi edhe në tipare të banesës së kohës dhe të oborrit të saj. Në monografi, konsiderohet me të drejtë *absurd* dhe aspak i bazuar në kritere të rendit shkencor, cilësimi i qytetit të Mesjetës së Vonë në Kosovë e në Ballkan, si *qytet turko-oriental*.

Përsa më sipër na sillet në kujtesë fakti që, pushtimi turk, nga një anë ishte vazhdues i marrëdhënieve feudale të pranishme edhe në këto treva dhe, nga ana tjetër, pushtuesi zbatoi një administrim feudalo-ushtarak, duke mos arritur të sjellë *ex-nuovo*, ndonjë lloj qyteti të ri. Dhe ndodhi kështu pasi qyteti në këto treva kishte arritur, qysh para pushtimit, nivele krahasimisht të rëndësishme për kohën. Prandaj dhe me të drejtë vihet në dukje se, *energjia pushtuese nuk është e njëjtë me novacione të tilla si formulimi urbanistik i qytetit*. Organizimin në lagje, apo veçimin e pazarit prej tyre etj., të gjitha këto pushtuesi i gjeti, kur, siç dhe dihet, *turqit vetë kanë jetuar si nomadë*. Fjala vjen, edhe vendi i xhamisë në hapësirën e qytetit të kohës, vështruar si ndërtim kulti, *nuk përbën ndonjë risi që e futi pushtuesi*. Deri dhe minarja e kësaj xhamie, ndonëse i jep një lloj theksi siluetës së qytetit, është pak për ta quajtur ndryshuese, aq më tepër përcaktuese, të kësaj siluete. Na sillet në kujtesë gjithashtu se, *zhvillimi i paplanifikuar i qytetit, me pasojat e tij, është ndeshur në mbarë Europën*; prandaj dhe nuk mund të flitet për imitim apo zbatim të ndonjë norme arkitekturore-urbanistike e për varfëri të institucioneve publike në qytete, si ndikim a risi orientale, kur dukuri të tilla ndeshen deri rreth fundit të *shek.* XVIII në mbarë Europën, duke përjashtuar pak qendra të spikatura. Çka do të thotë se, *nuk ka vend të flitet për kundërvënie ballore të qytetit ballkanik me atë të Europës Perëndimore* të mesjetës së vonë (*shek.* XVI-XVII), kur filluan të duken aty pasojat e marrëdhënieve kapitaliste. Në një kohë që marrëdhëniet feudale mbetën mbizotëruese në Ballkan deri rreth mesit të *shek.* XIX.

Shumica e qyteteve të Kosovës (dhe jo vetëm aty), kanë lindur nëpërmjet procesit të natyrshëm të kalimit prej qendrës së vogël administrative, apo thjesht fshatare, në qendër qytetare, përmes peshës gjithmonë në rritje të prodhimit zejtar. Ai shfaqet për periudhën në shqyrtim kryesisht si qendër zejtaro-tregtare, me ngarkesa të ndryshme administrative, por që lidhja me ekonominë bujqësore, filloi të bjerë gradualisht me rritjen e prodhimit zejtar e të shitjes së këtij prodhimi. Edhe *pazari*, si koncept, *që përbën thelbin cilësues të një qyteti*, njihej qysh para pushtimit osman. Pra, *edhe ai*, pavarësisht se nuk është paraprirë nga planifikimi, në cilindo qytet të Kosovës, *ka lindur dhe është rritur e zhvilluar, duke respektuar disa parime*, si ndarja në njësi sipas mjeshtërive që kishin përparësi praktike, apo kushtëzimi nga nevoja të tilla si uji i rrjedhshëm etj. Pazari ka zënë një vend me peshë të ndjeshme në mbarështrimin urbanistik të qyteteve të Kosovës dhe përgjithësisht formohej nga dy njësi që janë: bashkësi e dyqaneve (*pazari i mbyllur*), dhe bashkësi e trojeve (*pazari i hapur*), ku i pari funksiononte çdo ditë ndërsa i dyti vetëm në ditë të caktuara të javës. Praktikisht në gjysmën e dytë të *shek.* XIX, dalloheshin dyqane të prodhimit zejtar, të shërbimeve, thjesht tregtare (manifakturë, pije, bakej, kafene etj.); raporti i të cilëve, fjala vjen, në Prizren, ishte respektivisht 67,9 %; 4,6 %; dhe 27,5 %. Në monografi sillet informacion edhe për kategori të tjera të pranishme në qytet si bezistani, hane, kulla sahati, hamame, ndërtime kulti etj., duke u ndalur konkretisht edhe për secilën nga këto njësi të përmendura. Arrihet në përfundimin se, *në fizionominë dhe karakterin e qyteteve të Kosovës*, për periudhën në shqyrtim, *lexohet qartë sensi praktik i cili duket se ka qenë mbisundues në zgjidhjen e problemeve urbanistiko-arkitekturore*.

Kapitulli i tretë, BANESA QYTETARE KOSOVARE E SHEKUJVE XVIII-XIX DHE KLASIFIKIMI I SAJ (f. 57-222), me gjithsej 166 faqe, ku një vend të rëndësishëm zënë edhe 73 shembuj banesash (të sjella në tabela me paraqitje grafike e fotografi), mund të konsiderohet si më voluminozi e më thelbësori i monografisë që kemi në dorë, për çka dëshmon edhe vetë titulli i saj. Këtu, përmes një analize të rendit shkencor, mbështetur jo vetëm në një material relativisht të bollshëm grafik e fotografik, i dorës së parë, por edhe në burime të natyrave të ndryshme, jepet një pasqyrë e plotë e tipologjisë së banesës qytetare kosovare për periudhën e marrë përsipër. *Tipat* e banesave shqyrtohen secili veçmas mbi bazën e *varianteve* e të *nënvarianteve*, duke u ndalur në dallimet që bartin, arritjet që shënojnë, shkallën e përhapjes të secilit në kohë dhe në hapësirë. Vëmendja e duhur i kushtohet rrugës që ka përshkuar historiku i studimit të saj. Sikundër dhe dihet, hapësira e Kosovës u përfshi në fillim të *shek.* XX, në suazën e Serbisë, duke iu nënshtruar edhe gjurmimi e studimi i banesës dhe i mbarë trashëgimisë në këtë fushë, trajtesave jashtë shkencore, në shërbim të idesë absurde të Serbisë "historike".

Në analizën serioze që u bëhet studimeve të deritanishme (dhe autorëve të tyre), për banesën qytetare kosovare, dallohen tre grupe studiuesish: *serbë, të ndryshëm* dhe *shqiptarë*. Lidhur me shkrimet e autorëve serbë (B. Kojiq, Gj. Petroviq, S. Nenadoviq), theksohet se, *në thelb veprën e tyre, e përshkon sindromi* "i të ardhurve" nga njëra anë (për shqiptarët) dhe "i mitit serb" (përvetësim i trojeve të tjetërkujt), nga ana tjetër; duke mos iu ndarë *tri premisave*, sa të pavërteta aq edhe jashtë shkencore që janë: *Kosova është djepi i Serbisë* (e para); *shqiptarët zbritën në Kosovë në shek. XVIII-XIX* (e dyta) dhe *Kosova u çlirua më 1912* (e treta); ndonëse që të tre autorëve të përmendur, nuk mund të thuhet se u mungonte niveli i mjaftueshëm i njohurive shkencore. Nga grupi i dytë i studiuesve vëmendje u është kushtuar dy turqve: Sedat Eldem dhe Reha Gunai, të cilët, në thelb, pavarësisht ndonjë nuance dalluese (madje edhe pozitive), pa njohur realisht gjendjen e banesës ballkanike në fillim të pushtimit turk, *bëjnë pohime gratuite*, duke lëshuar supozime të pambështetura në realitetin e gjërave, sipas të cilave, pushtimi turk na paskej qenë bartës dhe përhapës i tipologjisë së banesës qytetare të Kosovës në *shek.* XVIII-XIX, duke shpërfillur kështu, në mënyrë flagrante thelbin e konceptit banesë dhe të faktorëve që kanë lënë vulë në tiparet e saj. Në monografi theksohet gjithashtu se, largimi i turqve në *shek.* XIX nga Ballkani, krijoi kushte për zhvillim më të shpejtë, por jo për të ndryshuar karakterin e banesës në këto hapësira. Praktikisht u krijuan rrethana të cilat gradualisht ndikuan edhe në karakterin e banesës, siç ishin rikonstruksione të pjesshme të banesave ekzistuese, lindje tipash të rinj dhe trajtime të reja.

Në fokus të monografisë janë vënë edhe studime të shqiptarëve të Prishtinës (M. Krasniqi, F. Draçolli e F. Doli), ku edhe ndaj mendimeve të tyre të pasqyruara në shkrime të botuara deri tani, nuk mungojnë qortime prej specialisti, të lidhura me ndonjë supozim, që vështirë të gjejë mbështetje bindëse në materialin faktik.

Pas shqyrtimit profesional të veprës së të tre grupeve, lidhur me banesën qytetare kosovare të *shek.* XVIII-XIX, rivihet theksi te faktorët, që kanë ndikuar në ecurinë e saj, ku përcaktues janë kushtet ekonomiko-shoqërore, të cilat kanë bërë që, *edhe qyteti i kohës dhe banesa të pasqyrojnë karakterin e një shoqërie qytetare në zhvillim.* Përveç veprimit të këtij faktori përcaktues, theksohet në monografi, duket se, *edhe momenti etnopsikologjik ka luajtur rol domethënës në konceptimin e banesës së kohës.* Mjaft të kujtojmë *kultin e mikpritjes* dhe cilido koment do të ishte i tepërt. Njëherazi rolin e tyre kanë pasur edhe materialet dhe teknika e ndërtimit; mjeshtrit ndërtues; trualli, klima etj. Theksohet gjithashtu se pavarësisht veprimit në bashkësi të faktorëve, ndonjëri prej tyre, në rrethana të caktuara, ka marrë vlera të rëndësishme, duke mbetur kështu edhe ushqyes i larmisë.

Momenti më i rëndësishëm i këtij kapitulli është *klasifikimi i banesës qytetare kosovare*, ku dallohen katër tipa (veç grupit të zgjidhjeve të veçanta), emërtimi i të cilëve lidhet me elementë të spikatur kompozicionalë, por që bart edhe një nëntekst emërtimi popullor, çka i bën lehtësisht të kuptueshme nga cilido. Dhe konkretisht fjala është për: 1) banesa me hajat; 2) banesa me çardak; 3) banesa me qoshk dhe 4) kulla qytetare; duke na bërë gjithashtu të ditur se, janë ngritur nga po ato grupe mjeshtërish ndërtues dhe janë realizuar me materiale natyrore dhe me teknikat e njohura të kohës.

DOKTORATURA

DOKTORATË

Shqyrtimi i secilit tip, veçmas bëhet mbi bazën e materialit faktik, duke e zbërthyer në *variante* dhe *nënvariante*. Kështu Banesa me hajat (f. 73-93), shqyrtohet në *dy variante* dhe secili prej tyre në *dy nënvariante*. Varianti i parë, *me hajat qëndror*, dhe varianti i dytë, *me hajat anësor*, kanë si nënvariante respektive: *me hajat të hapur* dhe *me hajat të mbyllur*. Banesa me çardak (f. 93-137), më e përhapura në qytetet e Kosovës, trajtohet përmes *tre varianteve* (*me çardak në ballë*, *me çardak në qendër* dhe *me çardak anësor*). Secili prej këtyre tre varianteve ndiqet respektivisht sipas *dy nënvarianteve* (*me çardak të hapur* dhe *me çardak të mbyllur*). Trajtohen gjithsej 22 shembuj banesash, të fiksuara respektivisht në Gjakovë (12), në Prizren (5), në Janjevë (2) dhe në Vushtrri (1).

Tipi i tretë, Banesa me qoshk (f. 138-190), gjithashtu trajtohet përmes *dy varianteve* që janë: *me qoshk të hapur* e *me qoshk të mbyllur* dhe secili prej tyre në *dy nënvariante* respektive (*përdhes* dhe *me kat*), ku i dyti ka pasur përhapje relativisht më të madhe për periudhën në shqyrtim. Mbështetje për analizën e këtij tipi kanë shërbyer 31 shembuj, për të cilët sillen tabela me paraqitje grafike (kryesisht *pamje* e *planimetri*), të fiksuar respektivisht në qytetet Gjakovë (11), Prishtinë (7), Pejë (5), Gjilan (5), Janjevë (2) dhe Vushtrri (1). Duke hedhur dritë mbi fizionominë dhe karakterin e këtij tipi, nuk janë lënë pas dore edhe raporte krahasuese me të dy tipat pararendës, ku na bëhet e ditur gjithashtu se, *tipi i banesës me qoshk shënon fundin e një rruge të gjatë shumëshekullore të banesave të hapura, të parapëlqyera gjerësisht edhe prej shqiptarëve*. Thelbi i karakterit të këtij tipi banese qëndron te prirja thjeshtëzuese në trajtimin e brendshëm e të jashtëm; te heqja dorë nga mobilimi fiks arkitektonik; te përdorimi i strehëve të mbyllura dhe te mospërdorimi i dritareve të vendosura në blloqe.

Për tipin e katërt dhe të fundit, Kulla qytetare (f. 190-205), sillen katër shembuj për të cilët ka tabela me paraqitje grafike (me pamje e planimetri) dhe fotografi. Këta shembuj janë fiksuar respektivisht në qytetet Pejë (3) dhe Gjakovë (1). Mësojmë se ky tip shfaqet në qytetet e Kosovës, nga fundi i *shek.* XIX, por që më herët takohet në fshatin kosovar. Sikurse vihet në dukje, ky tip për nga formulimi tërësor të imponohet me pamjen e jashtme, të realizuar me mjete arkitektonike të *shtëpisë së fortë*; ndërsa në formulimin e brendshëm shfaqet qartazi ndikimi nga arritjet e shquara të banesës qytetare të kohës. Madje me të drejtë vihet në dukje se, arritjet e këtij tipi, të realizuara në fshat, i janë përshtatur nevojave të jetës qytetare, duke u ndërtuar së shumti si *shtëpi miqsh*, prej familjesh të kamura, veçanërisht gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Nuk lihet jashtë vëmendjes ndalesa te *hipoteza absurde*, sipas të cilës, *kulla na qenka huazim, fantazi tanimë krejt diletante*, theksohet me të drejtë në monografi. Nisur nga rruga e lindjes dhe e konsolidimit të këtij tipi, fillimisht në fshat dhe pastaj në qytet, theksohet se, *shfaqja e kullës sa krahasimisht e re, aq kohësisht e shkurtër, i shton repertorit tepër të pasur të banesës shqiptare, një kategori qartësisht të veçantë. Le ta quajmë zgjedhje shqiptare* (vënia në dukje është imja-A. M.). Dhe, natyrshëm do të mund të shtrohej pyetja: Si thoni, a vlen të diskutohet?

Më tej (f. 205-222), përmes 9 shembujve të përcjellë me tabela me paraqitje grafike, të fiksuara respektivisht në qytetet Gjakovë (3), Janjevë (2), Prishtinë (1), Prizren (1) dhe Pejë (1), shqyrtohet grupi i rasteve të veçanta, të cilët, ndonëse kanë të njëjtën frymë me tiparet thelbësore të banesës qytetare kosovare, kanë shmangie nga tipologjia e parashtruar, çka ka vështirësuar përfshirjen në njërin apo në tjetrin tip të përmendur.

Edhe të dy kapitujt që pasojnë merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me plotësimin e tablosë njohëse të banesës qytetare kosovare, zhvillimi kompozicional (tipet, dhe respektivisht variantet e nënvariantet për secilin tip), i të cilës ishte objekt shqyrtimi të gjerë në kapitullin e tretë.

Në **kapitullin e katërt** me titull NJËSITË KOMPOZICIONALE DHE ELEMENTËT FUNKSIONALË TË BANESËS QYTETARE KOSOVARE TË SHEKUJVE XVIII-XIX (f. 223-259), në gjithsej 37 faqe, përfshihen edhe 40 fotografi, ku takon *ndërtime ndihmëse* të përfshira në oborrin e banesës, *çezma, oxhaqe, çardaqe, qepenë shkallësh, qoshqe, dollape muri, musandra, blloqe dritaresh, porta të jashtme, dyer odash, dritare, tavane* etj. Vëmendja këtu përqëndrohet në *njësitë kompozicionale* e në *elementët funksionalë*; ku të parët konsiderohen si *hapësirat formuese të banesës*, ndërsa të dytët si *njësitë e domosdoshme të saj*, që çojnë në përmbushjen e qëllimeve për të cilat ajo është ndërtuar. Dhe, të gjitha këto njësi të marra së

DOKTORATURA

bashku, *formojnë një bashkësi ku kompozimi mbetet dukuria më evolutive*, që shfaqet nëpërmjet një morie zgjidhjesh të mishëruara në tipe, variante, nënvariante dhe zgjidhje të veçanta, *bazë me peshë e larmisë brenda njësisë*. Theksohet se, *elementët funksionale i karakterizon një inerci relative*, duke mbetur krahasimisht gjatë në gjendje thelbësisht të pandryshuar, ku trajtimi dekorativ i tyre nuk cënon thelbin funksional, prandaj dhe shfaqet me zhvillim krahasimisht të shpejtë. Në këtë kapitull i kushtohet vëmendje edhe *oborrit të banesës* e *ndërtimeve ndihmëse* të përfshira aty; *furnizimit me ujë* etj. Natyrisht, shqyrtim relativisht të hollësishëm u bëhet njësive të tilla formuese të banesës si, *oda, shtëpia e zjarrit* etj. Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se, përmes një zbërthimi me profesionalizëm të njësive kompozicionale dhe elementëve funksionalë e arkitektonikë, plotësohet më tej shkalla e njohjes së fizionomisë dhe karakterit të banesës në fjalë.

Kapitulli i pestë, me titull MATERIALET DHE TEKNIKA E NDËRTIMIT TË BANESËS QYTETARE KOSOVARE TË SHEKUJVE XVIII-XIX (f. 261-283), në 23 faqe, përfshin edhe 23 fotografi. Aty hidhet dritë mbi *materialet e ndërtimit* të përdorura e mbi *teknikat e zbatuara* në ngritjen e strukturave formuese të kësaj banese. Ndër materialet ndërtimore, vëmendje i kushtohet gurit, drurit, gëlqeres, dheut; rrugëve konkrete të sigurimit të tyre dhe përkujdesjes në përpunim e përdorim, çka, së bashku me teknikat e zbatuara, ndikonin në jetëgjatësinë e qëndrueshmërinë e ndërtimit. Nuk ka mbetur jashtë vëmendjes edhe *mjeshtri ndërtues*, i cili, ndonëse me formim autodidakt (sipas parimit: *puna të mëson*), shfaqet si njohës i thellë i profesionit, duke e përvetësuar atë në vazhdimësi brezash.

Pas shqyrtimit me karakter disi teknik të banesës qytetare kosovare, në dy kapituj të mëtejshëm (kap. VI dhe kap. VII), vëmendja përqendrohet te *raportet e kësaj banese me atë fshatare në arealin e Kosovës* (kap. VI) *dhe me atë qytetare në Shqipëri, në mbarë Ballkanin e më gjerë*. Kështu, në kap. VI, me titull BANESA QYTETARE KOSOVARE DHE AJO FSHATARE, në rreth 6 faqe (f. 285-290), ato vihen përballë njëra-tjetrës, si kategori të së njëjtës familje dhe të pranishme në të njëjtin areal, por në vendbanime që kanë dallime specifike midis tyre, sikundër u vu re edhe në kapitullin e dytë. Dhe, ndonëse mungon ende një tablo e plotë dhe analitike për banesën fshatare kosovare, për realizimin e detyrës duket se janë shfrytëzuar të gjitha botimet e realizuara nga autorë shqiptarë, qoftë të Prishtinës ashtu dhe të Tiranës, pa lënë pas dore potencimin e mangësive me natyrë objektive, në njërin krah (Prishtinë) dhe përvojën krahasimisht të pasur, në krahun tjetër (Tiranë). Na bëhet me dije se, ndarja në *banesë fshatare* dhe *banesë qytetare*, nuk është ndonjë abstragim me karakter teorik, por shprehëse dhe pasqyruese me mjetet e saj, e mënyrës së jetesës, ku ndikimi parësor ka ardhur prej faktorit ekonomiko-shoqëror. Kështu, po t'i referohemi fshatit kosovar të *shek.* XVIII-XIX, ai ishte në nivele relativisht të ulëta të zhvillimit ekonomik, çka ka ndikuar ndjeshëm edhe në karakterin dhe tipin e banesës, duke u shfaqur me një larmi zgjidhjesh e arritjesh. Dallimet midis banesës së njërit dhe të tjetrit, shfaqen si në vetë atë, në kuptimin e ngushtë të fjalës, ashtu dhe në oborrin e secilës prej tyre.

Fjala vjen, ka lloje banesash fshatare që në periudhën për të cilën bëhet fjalë, nuk ndërtohen në qytete; siç është, *banesa e tipit trarë*, e cila ndeshet në vendbanimet e përkohshme të barinjve. Po ashtu, *tipi i banesës me hajat*, është ndërtuar edhe në fshatin kosovar, zakonisht nga familje të mëdha me disa kurorë të martuara në përbërjen e tyre, ku hajati ka pasur gjerësi të vogël, ndonëse shtrihej përgjatë kthinave të banimit, duke shërbyer thjesht e vetëm si ndërlidhës; çka dëshmon se, krahas konceptit të njëjtë me atë të po të njëjtit tip të ndërtuar në qytet, ndeshim dallime të rëndësishme të lidhura me funksionet e këtij hajati. Kështu, ndërsa në banesën fshatare ai është thjesht një parahyrje në kthinat e banimit, në banesën qytetare, jo vetëm shfaqet në disa variante, por bart edhe funksione të mirëfillta banimi. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për *tipin e banesës me çardak*, ku në fshat ajo shënon arritje mjaft modeste dhe përhapje të kufizuar; çka për qytetin, cilido koment do të ishte i tepërt. Dhe, të para me të njëjtin këndvështrim, mund të thuhet se edhe *tipi i banesës me qoshk*, ndeshet në fshatin kosovar me të njëjtat tipare, pa u ndalur këtu për *tipin e kullës*, për raportet e të cilit me qytetin u fol më lart. Edhe nga kjo tablo e shkurtër, del e qartë se dallimet nuk dëshmojnë ndonjë

ndarje të prerë. Mjaft koncepte jetësore të përbashkëta, materialet dhe mjeshtrit ndërtues të njëjtë, si dhe afritë e lidhjet e natyrave të ndryshme, ku me peshë mbetet momenti etnopsikologjik, e dëshmojnë krijimtari të të njëjtit etnos.

Në **kapitullin e shtatë**, me titull BANESA QYTETARE KOSOVARE NË KUADRIN E BANESËS SHQIPTARE DHE ASAJ BALLKANIKE (f. 291-308), në 18 faqe, ku përfshihen edhe 8 fotografi banesash (nga qytetet Tiranë, Gjirokastër, Berat, Korçë e Shkodër), sillen raporte krahasuese midis banesës në fjalë me atë qytetare brenda trojeve të Shqipërisë aktuale dhe më tej me atë të vendeve ballkanike. Lidhur me përqasjet e kësaj banese me banesën qytetare të Shqipërisë së sotme, theksohet se, në Shqipëri, për të njëjtën periudhë kohore, dallojmë pesë tipa banesash (disa emërtime të të cilave janë lidhur me qendra të caktuara qytetare), të cilat sipas një kronologjie relative, janë: *banesa tiranase*, *banesa me hajat*, *banesa me çardak*, *banesa gjirokastrite* dhe *banesa korçare*. Në një kohë që në Kosovë, po sipas asaj kronologjie relative, kemi: *banesa me hajat*, *banesa me çardak*, *banesa me qoshk* dhe *kulla qytetare*. Ndërsa kur është fjala për grupin e zgjidhjeve të veçanta, ato në qytetet e Kosovës, janë relativisht më të pakta se në qytetet e Shqipërisë së sotme. Më tej vihet në dukje se, *banesa tiranase* dhe *banesa gjirokastrite*, nuk ndeshen në Kosovë; banesa e *tipit kullë* e pranishme në qytete të Kosovës, nuk ndeshet në ato të Shqipërisë; ndërsa tipat e tjerë janë të njohur në të dy krahët. Njëherazi, banesa *me hajat* dhe ajo *me çardak*, shfaqin respektivisht dallime e parapëlqime me këtë apo atë variant a nënvariant. Në një kohë që, sidomos varianti me kat i *banesës me qoshk*, i ndeshur në të dy krahët, shpreh rritjen e marrëdhënieve ekonomike ndërkrahinore e ndërqytetare; forcim të ekonomisë qytetare dhe largim prej asaj fshatare. Karakteri përherë e më qytetar i kësaj banese, shihet në disa drejtime, madje relativisht më herët në qytetin kosovar, me shenja të dukshme të futjes së parametrave të vendeve të zhvilluara europiane, siç janë, fjala vjen, *oda me banjë të veçantë*, *me ngrohës e me musandër* dhe *shmangia e mobilimit arkitekturor fiks*, etj., dëshmi e theksimit përherë e më shumë të mënyrës qytetare të jetesës.

Kështu, pas një analize bindëse, arrihet në përfundimin se, banesa qytetare në Shqipërinë e sotme dhe në Kosovë, formon një unitet, ku e dyta, si rajonale, është pjesë natyrore e të njëjtës krijimtari etnokulturore shqiptare. Ndërsa treguesit kryesorë të saj janë të së njëjtës frymë, ata dytësorë, janë bartës kuptimplotë të larmisë së kësaj trashëgimie dhe si pasqyruese të kohës, në kuptimin që tipologjia e banesës ka qenë një proces evolutiv në hapësirë dhe në kohë dhe jo një akt i njëhershëm. Kur është fjala për raportet me banesën serbe, ritheksohet se, serbët ruajtën jetën e fshatit në shtëpi të thjeshta prej druri, duke i karakterizuar një statizëm i theksuar në mënyrën e jetesës. Vetëm nga *shek.* XIX, shfaqet në hapësirat e tyre një variant i banesës me hajat e çardak, me përmasa krahasimisht të vogla, në disa raste të kompozuara edhe me gjysmëkat. Nga kjo tablo e shkurtër por domethënëse, del e qartë se banesa qytetare kosovare, nuk ka qenë dhe s'kishte si të ish pjesë krijimtarie e etnisë serbe. Edhe në raportet krahasuese me Maqedoninë (ku në pjesën perëndimore të saj jetojnë shqiptarë autoktonë), ashtu dhe me Greqinë, pa mohuar paralele me banesën me hajat dhe atë me çardak, ku nuk mungojnë nota të dukshme të individualitetit, nuk mund të flitet për po atë tipologji banese qytetare në kuptimin mekanik të fjalës.

I gjithë ky realitet dëshmon se, banesa qytetare kosovare e *shek.* XVIII-XIX, si pjesë e arkitekturës mbarëshqiptare, përfshihet në arkitekturën ballkanike, ashtu si kjo e fundit përfshihet në arkitekturën popullore europiane dhe më gjerë.

Kapitulli i tetë, me titull MBROJTJA E BANESËS QYTETARE KOSOVARE TË SHEKUJVE XVIII-XIX (f. 309-319), në rreth 11 faqe, trajton në mënyrë mjaft sintetike, probleme të mbrojtjes dhe të restaurimit të monumenteve të Kosovës në përgjithësi dhe ato që lidhen me arkitekturën popullore në veçanti. Fillimisht jepet një informacion i qartë në vijat themelore, lidhur me historikun e mbrojtjes e të restaurimit të këtyre monumenteve, dukuri që e ka nismën e parë në vitin 1947, ndërsa të fundit në vitin 1990. Me interes është edhe statistika që përcillet lidhur me sa më sipër, ku na bëhet e ditur se, nga 425 monumente të vëna në mbrojtje në territorin e Kosovës të asaj periudhe, 139 (ose 32%), janë të kultit ortodoks dhe 70 (ose 16%) banesa popullore, nga të cilat 34 (ose 8%), banesa qytetare të *shek.* XVIII-XIX. Thelbi i këtyre të dhënave zbulon në dritë të diellit, një shpërkujdesje që, është pak ta quash

POKOTOPY

thellësisht të shpërpjesëtuar, ku në krye qëndrojnë ndërtime të kultit serb-ortodoks, apo të pretenduara si të tilla. Mjaft domethënës është edhe fakti që specialistët vendas (pra shqiptarët e Kosovës), janë mbajtur jashtë sistemit të vlerësimit të këtyre monumenteve, çka dhe i ka lënë rrugë të lirë shtrembërimit të së vërtetës, jashtë çdo konsiderate shkencore. Për më tepër që nuk janë bërë të njohura kriteret metodologjike të përdorura, çka e dëshmojnë shpallje fragmentare, përjashtimi i ansambleve tërësore, mos interesimi i plotë për fshatin etj. Pra, e thënë shkurt, bie në sy një përkujdesje e instrumentalizuar, e dëshmuar edhe në legjislacion, i cili karakterizohet nga paqartësi në pasqyrimin e përvojës, në mbikëqyrje, në dokumentacion, në shpenzime etj. Prandaj dhe nuk duket rastësi që, ndërsa kriteret e restaurimit kanë mbetur në fazën e diskutimit, numri i banesave të cilat u janë nënshtruar ndërhyrjeve, është i vogël. Mbi të gjitha është mbajtur qëndrim mospërfillës edhe ndaj përvojës ndërkombëtare, e cila ka gjetur materializim qysh në Kongresin e Dytë të mbajtur në vitin 1964, ku është miratuar Karta Ndërkombëtare e Konservimit dhe Restaurimit. Pa folur pastaj për veprime të pajustifikuara shkencërisht, siç është spostimi i Konakut të Tahir Begut në Pejë, apo veprimet me selitë e sotme të IMK (Instituti i Monumenteve të Kosovës) dhe të ASHAK (Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës), ku me të drejtë, në monografi, cilësohen si raste pararendës shkatërrimi ndaj vlerave kulturore, veprime që s'do t'i merrte përsipër asnjë restaurator profesionist serioz.

Në këto rrethana, çlirimi i Kosovës, u ka hapur rrugë kushteve për rivlerësim, duke filluar që me shtimin e institucioneve mbrojtëse dhe krijimin e organizmave lokalë vlerësimi. Urdhëruese, theksohet në monografi, mbetet ngritja e brezit të ri të restauratorëve, të cilët duhet të jenë njëherazi edhe studiues; duke rekomanduar edhe rrugë konkrete që mund dhe duhet të shfrytëzohen në rrethanat e sotme, krahasimisht të favorshme. Parësore, theksohet më tej, mbetet gjithashtu njohja sa më e plotë e gjendjes, duke filluar nga Ligji i Trashëgimisë Kulturore në këtë fushë, i cili duhet të pasqyrojë sa më prektas veçantitë e realitetit kosovar, vërtet *suigeneris*. Çdo humbje kohe, vihet në dukje në mbyllje të kapitullit në fjalë, ka pasoja të dhimbshme e të pakorrigjueshme, për vlera të mirëfillta sa kombëtare aq edhe mbarëeuropiane.

Kapitulli IX, me titull PËRFUNDIME (f. 321-326), në rreth 6 faqe, hedh dritë mbi analizën e sjellë në faqet e kësaj monografie, e cila mund të konsiderohet si një sipërmarrje me vlera të veçanta në kushtet e sotme të Kosovës së çliruar njëherë e përgjithmonë nga sundimi i imponuar serb. Fjala është për analiza dhe vlerësime të rendit shkencor, duke hedhur dritë të pamëdyshtë mbi këtë trashëgimi e njëherazi pasuri të vyer, e cila i është kthyer bashkësisë së etnosit tonë, si pjesë e natyrshme e krijimtarisë së tij. Këtu dëshmohet përmes analizës dhe vlerësimit të materialit faktik, se etnosi ynë ka pasur vijueshëm lidhje përparësore me banesën e vet, madje të asaj shkallle, sa që, mund të flitet për *kultin e banesës ndër shqiptarë*. Autoktonë që prej muzgut të historisë në këto troje, intuitivisht ata kanë kërkuar të lidhen me to, duke ngulur aty banesën, si një dëshmitar natyror e organik dhe si një prej qëllimeve kryesore të jetës së tyre. Po ashtu, analiza dëshmon se, në ecurinë e banesës ka qenë e pranishme pirja për të përqafuar gjithçka te re, të cilën koha apo rrethanat e ditkonin apo e ofronin, në dobi të përmirësimit të saj, si një shprehje tjetër e lidhjes së natyrshme me kultin e banesës. Të sjellim ndërmend, fjala vjen, *kultin e mikut e të mikpritjes*, të cilat lexohen qartë edhe në një kthinë të posaçme të bansesës, të përcaktuar si *oda e miqve*, dhe çdo koment tjetër do të ishte i tepërt. Të gjitha sa thamë në mënyrë mjaft të përmbledhur, dëshmojnë se sajesat dhe shpifjet ogurzeza të cvijiçëve, s'janë gjë tjetër veçse mbetje të atrofizuara tanimë që i përkasin koshit të një historie sa dashakeqëse aq edhe të dështuar, me të cilat, siç flet e tashmja dhe perspektiva e saj, mesa duket, është humbje kohe (për të cilën kemi aq shumë nevojë), të merresh më tej. Banesa popullore kosovare, ashtu si ajo mbarë shqiptare, si krijim qartësisht utilitar, mbetet dëshmitare autentike-historike, trashëgimi etnokulturore e kësaj etnie, këtij kombi dhe populli njëherësh.

Nëse do të shtrohej pyetja se cili do të ishte një tipar, pse jo thelbësor dallues, i kësaj monografie, tipar i cili i jep asaj edhe një notë të thukët individualiteti, mendoj se një përgjigje disi e plotë do të ishte sa më poshtë. Ajo nuk është një monografi e zakonshme, të themi lineare, por përkundrazi. Kështu, nëse kapitulli i parë, ndalet te metodat studimore të banesës popullore, bazuar mbi një përvojë njohëse të akumuluar në dekada të vijueshme; mbetet instruktiv për të gjithë kapitujt që

DO NOT COPY

pasojnë, ndërsa kapitulli i dytë, ndalet te fizionomia dhe karakteri i qytetit të kohës dhe raportet e tij me arealin që e ka rrethuar dhe e rrethon, qoftë në kohë ashtu dhe në hapësirë. Këta dy kapituj, pavarësisht karakterit, të themi gjithëpërfshirës në monografinë si tërësi, kanë edhe një lloj pavarësie sa logjike aq edhe të natyrshme midis tyre. Në një kohë që, "ndryshe" prej tyre, kapitujt e mëtejshëm, mund edhe të shihen të grupuar, sipas specifikash që bart secili. Kështu, kapitujt III, IV dhe V, të cilët, të kundruar së bashku, merren drejtpërsëdrejti me aspekte të mirëfillta teknike të banesës, të lidhura me tipologjinë, materialet, teknikat e ndërtimit etj., formojnë një grup me peshën e vet në monografi, duke i dhënë edhe titullin kësaj të fundit. Më tej, një grup "më vete", formojnë edhe kapitujt VI dhe VII, të cilët, të marrë së bashku, hedhin dritë mbi vendin e kësaj banese në arealin të cilit i përket dhe pjesë natyrore e të cilit është. Përmes këtyre dy kapitujve, mësojmë se, këto banesa i përkasin një kulture banimi e jetese, kur sidomos ke parasysh troje e banorë që u janë dashur të përballojnë plot tallaze edhe në fushën e historisë së kulturës në përgjithësi e jo vetëm në fushën te e cila ndalet kjo monografi. Pra, edhe në këto dy kapituj ndjehet përpjekja, jo pa sukses, që konfirmon me argumente të rendit shkencor se, banesa qytetare kosovare e *shek.* XVIII-XIX, nuk është një krijim i realizuar në ndonjë oaz të mbyllur, dhe nuk është sjellë si dhuratë nga ndokush, por përkundrazi. Ajo ka lindur, është zhvilluar e konsoliduar në një areal të vetin dhe, ashtu siç formohen rrathët koncentrikë, kur hedh një gur mbi një sipërfaqe të qetë ujore, këto banesa, qofshin qytetare kosovare, apo fshatare kosovare, ashtu si në mbarë trojet shqiptare, janë pjesë e të njëjtës tablo, janë përvijuar e kanë plotësuar njëra-tjetrën, kuptuar si një proces. Dhe, nëse në renditje të grupimeve të thëna, ndjehet kalimi nga e përgjithshmja te e veçanta apo anasjelltas, edhe kapitulli i VIII, ka specifikën e vet; ai ndonëse të duket sikur "shkëputet" nga i gjithë materiali dhe analiza pararendëse, në fakt, është një kujtesë dhe njëherazi një zë i fortë, sa paralajmërues aq edhe mbrojtës e vlerësues i tyre. Ai, me mënyrën si na i tërheq vëmendjen, të duket sikur ka në sfond e sikur të thotë në çdo çast: *me mua nuk mbeteni thjesht histori, por edhe përherë në aktualitet, përherë me ju e pranë jush.* Besoj se ky mesazh, i kuptuar jo thjesht e vetëm figurativisht, do ta kishte të tepërt cilindo koment. Pa folur këtu për kapitullin IX (dhe të fundit), i cili është i njohur në cilindo studim normal të natyrës monografike, realitet që shprehet qysh në titullin që bart: PËRFUNDIME.

Në vend të mbylljes

Përgatitja dhe botimi i kësaj monografie nuk ka qenë një punë e lehtë dhe një angazhim rutinor sa për të kaluar radhën. Kujtoj se një punë jo e lehtë ka qenë grumbullimi dhe sistemimi i rendit shkencor të burimeve, që kanë shërbyer si trase e sigurt, e cila i ka krijuar kushte hartimit të monografisë. E theksoj këtë aspekt pasi nuk është vështirë të konstatohet nga lexuesi se autorët janë ndodhur përballë një realiteti me natyrë komplekse. Mjaft të themi së është konstatuar qysh në hapat e para të grumbullimit të burimeve e të bazës materiale sa të nevojshme aq edhe të domosdoshme, një mospërputhje, për arsye jashtëshkencore, midis vlerave që ka bartur dhe vazhdon të bartë kjo pasuri e mirëfilltë kulturore dhe shkallës së gjurmimit, dokumentimit, studimit dhe vlerësimit të saj, në kuptimin më domethënës të këtyre fjalëve. Kështu, ndonëse banesa popullore kosovare (qytetare dhe fshatare), është pjesë natyrore e banesës shqiptare, e ndërtuar prej shqiptarëve për shqiptarët, deri tani nuk ka qenë e përfshirë në studime të trevave historike dhe aktuale shqiptare, si një pengesë mjaft serioze për studim dhe vlerësim të integruar.

Do not copy

Ali MUKA

KOSOVAR CITIZEN DWELLING DURING XVIII-XIX CENTURIES

DO NOT COPY

Book has in total: 332 pages, introduction, 9 chapters, and summary. Part of these chapters are and 122 photos and 73 graphic designs which mainly have plans, view and details of dwellings. There is also and bibliography with 63 works, which are used for explanations at bottom page. First chapter (*Methodic criteria for monographs writing*), explain some methodic criteria applied at this field up to date. Some explanations are done for the specific characters which have popular dwelling compared with other buildings like *protecting, cult, engineering and social.* Popular dwelling is effected by many factors, like: living conditions, social and economic development, weather, natural building materials, building tradition, characteristic of building terrain etc. These factorial complexes have effected at research, study, typological and classify methods. Compositional development is one of the most explained in cooperation with socio-historical and natural context. *Functionalism, utilitarianism or uses of popular dwelling are notated as dominant, sustainable by living no space to formal interpretations;*

Creators of popular architecture have been multiethnic persons. That is the reason why we are saying, *Illyrian heritage at* roman era; *Arber heritage* at Byzantine era and Albanian heritage at Turk era.

According to the convenient analyze of scientific type is argued that the *pure originality* is the quality of primitive commune or totally isolated which has never been or placed at our ethnical or have part *with borrowing, original ratios.* This fact has come because our people have been living actively at each invasion done at our country and we are not affected to closing exaltations. These fields utility have been remain as a base.

Second chapter the Kosovar city is a study object and these begin with a short nascence story, their consolidations with contemporaneous characteristics by explain them in details at essential compositional units like: bazaars; inhabitant quarters and other units or elements. These come to real light on the physiognomy and character of this city as a natural part of Albanian cities which belong to that time. Main criteria to categorize a city is type of economy which is exercise by most of its citizens so in that sense the transition from a peasant living center to city it is not an act but a process.

Third chapter the most voluminous one of this monograph is composed with superabundant material like: graphic and photographic of very good quality and different natural sources give a full image of citizen dwelling typology. Dwelling types are treated in accordance with types or subtypes and by focusing on their differences, achievements which shows the diffusion scale of each one.

The most important moment of this chapter is *classify of Kosovar dwelling*, where are individualize four types, which are named linked with notable compositional elements, but they have also a popular names and these became them more understandable by every person. These are: *Hajat, Çardak, Qoshk dwelling* and *citizen turret;* built by the same building masters groups from Dibra (dibranë). Each of them has *types and subtypes.*

Hajat dwelling is treated with *two types* and each of them has *two subtypes.* Çardak dwelling, the most diffusive one at Kosovo cities, is treated with *three types* and each of them has *two subtypes.* Qoshk dwelling is treated with *two types* and each of them has *two respective subtypes.* The second type is the most diffusive one. Citizen turret, is shown at Kosovo cities at ending of XIX century, but previously existed at Kosovo village.

This type at façade has architectonical elements of *strong dwelling* but sat internal part has obviously effected the notable achievement of citizen dwelling of that period. Rightly is mentioned that the achievement of this type are in accordance with citizen living needs and these are built mostly as *guest house* by rich families during the Albanian National Renaissance. Beginning by the road and consolidation of this type is mentioned that: *presence of turret as new as shorted ads at rich repertory of Albanian dwelling a very special category. Let call that Albanian solution.*

Fourth chapter is focused at *compositional units and functional elements*, which are characterized by a relative inertia, by remaining unchanged essentially.

Fifth and sixth chapters treated the ratio of this dwelling with dwelling village of Kosovo (chap. VI) and citizen dwelling in Albania and Balkan too. All published books of Albanian authors of Tirana and Pristine are used for Kosovo village dwelling. Division into *village and citizen dwelling*, is not an abstract theoretical result but the way of expressing living conditions.

Seventh chapter has compared ratios of village dwelling with citizen dwelling in Albania and Balkan countries. Similarities with Albanian citizen dwelling are mentioned that for the same period of time in Albania are 5 dwelling types (some names are linked with some specific cities), which according to a certain chronology are: *Tirana dwelling, Hajat dwelling, Çardak dwelling, Gjirokaster* and *Korce* dwelling. According to the same chronology in Kosovo we have: *Hajat, Çardak, Qoshk dwelling* and *citizen turret.* The fact that *Tirana and Gjirokaster dwelling*, are not in Kosovë is also mentioned too; but *citizen turret dwelling* is find only in Kosovo cities and not present in Albania; other types are known at both countries. Type a floor of *Qoshk dwelling*, shows growing of economic relations between cities and regions. This shows the tendencies of growing citizen economy and reducing village economy.

Eighth chapter explain problems of protecting and restoring of Kosovo monuments in general and for popular architecture separately. Full and clear information in general is given linked with history of protecting and restoring of culture monuments which has have the first effort in 1947, but the last one in 1990. Great interest has and statistical data which says: from 425 monuments under protection in Kosovo territory, 139 (or 32%), belong to orthodox religion and 70 (or 16%) popular dwelling but out of these 34 (or 8%), *citizen dwelling of* XVIII-XIX century.

Ninth chapter, shows analyze of this monograph. There are evaluations and analyze according to scientific terms which belong to our heritage which belong to our ethnos. Through analyze of factice material is testify that our ethnos has continuously relations with its dwelling in that size that we can talk about the *dwelling Albanian citizen cult.* This analyze testify that the tendency of embrace everything new have been present always in the direction of dwelling improve as a natural linkable with cult of this dwelling. Kosovar popular dwelling as Albanian one remain authentic-historical witness, ethno-cultural heritage of this people and country en bloc.

Distinctive lineament of this monograph is that this is not linear one. *Chapter I* shows the study method of popular dwelling, base on the accumulated experience by remaining as instructive indicator for the remaining chapters. *Chapter II* shows the physiognomy and character of contemporaneous city and its ratios with circumjacent realm, in time and space. These two chapters have logic independence between them. *Chapters III, IV e V*, shows the technical aspects of dwelling linked with typology, building materials and technique etc.

Chapters VI, VII, shows the place of this dwelling on its realm which belong and is a natural part of dwelling itself. Through them is learned that these dwellings belong to living and life's culture of land-bank inhabitants which have passes problems and also in the history of culture field. The successfully efforts confirms with the scientific arguments that the Kosovar city dwelling of XVIII-XIX century, it is not a creation realized at close oasis.

Chapter VIII in essence is a recall and also a strong, prognostics, protective and evaluates voice. It suggest every moment: *with me you do not remain history, but always actuality, always with you close with you.*

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Instituti i Monumenteve të Kulturës
Monumentet

Formati: 21x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: (4) 22 40 116

DO NOT COPY

800 lekë (7,00 euro)